



UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE I FILOLOGJISË
KORÇË



AKADEMIA JUBILARE ME RASTIN E 40-VJETORIT TË KONGRESIT TË
DREJTSHKRIMIT

Korçë, nëntor 2012

(Përmbledhja e akteve të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare me rastin e 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe u realizua në kuadrin e Projektit “Botime FEF”

REDAKSIA PËR BOTIM

Prof. dr. ALI JASHARI

Prof. dr. GJOVALIN SHKURTAJ

Prof. dr. EMIL LAJE

Prof. dr. QEMAL MURATI

Prof. dr. BEGZAD BALIU

Prof. dr. VALTER MEMISHA

Redaktimi dhe përgatitja për shtyp: Msc. Olger Brame

ISBN: 9789928146151

Shtëpia Botuese “PROMO PRINT”

Korçë, 2014

PËRMBAJTJA E LËNDËS

PËRKUJTESA E AKADEMISË JUBILARE ME RASTIN E 40-VJETORIT TË KONGRESIT TË DREJTSHKRIMIT

FJALA E HAPJES SË AKADEMISË JUBILARE

Prof. dr. ALI JASHARI

Dekan i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë të Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë.

NDERIM PËR KONGRESIN E DREJTSHKRIMIT DHE DELEGATËT E TIJ

PËRSHËNDETJE

MESAZH I AKADEMIKUT DHE SHKRIMTARIT DRITËRO AGOLLI PËR AKADEMINË SOLEMNE KUSHTUAR 40-VJETORIT TË KONGRESIT TË DREJTSHKRIMIT

PËRSHËNDETJE E AKADEMIKUT REXHEP QOSJA

PËRSHËNDETJE NGA PROF. VICTOR A. FRIEDMAN, ALBANOLOG, UNIVERSITETI I ÇIKAGOS (SHBA)

PËRSHËNDETJE NË EMËR TË AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË NGA AKADEMIK JORGO BULO

KUJTIME NGA DELEGATË TË KONGRESIT TË DREJTSHKRIMIT

PËRSHËNDETJE E REKTORIT TË UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”, PROF. AS. DR. GJERGJI MERO

KUMTESA

XHEVAT LLOSHI

Zgjidhje që i qëndruan kohës në shërbim të kombit

QEMAL MURATI

Kongresi i Drejtshkrimit - ngjarja më e rëndësishme gjuhësore e simbolike e shekullit XX

GJOVALIN SHKURTAJ

Kahet e reja të kulturës së gjuhës shqipe mbas Kongresit të Drejtshkrimit (1972)

ASLLAN HAMITI - AJTEN QAMILI - ISMET OSMANI

Kontributi i delegatëve të Kongresit të Drejtshkrimit nga Maqedonia për shqipen standarde

EMIL LAFE

Rëndësia historike kombëtare dhe vlera kulturore e Kongresit të Drejtshkrimit

JANI THOMAI

Çështje leksikore në Kongresin e Drejtshkrimit

HYSEN MATOSHI

Njësia kombëtare dhe gjuha standarde

VALBONA REMZI NESIMI (TOSKA)

Gjuha shqipe në Republikën e Maqedonisë

BAHTIJAR KRYEZIU

Kongresi i Drejtshkrimit dhe jehona e tij sot

THANAS FEKA

Normativiteti në fjalorët shpjegues kombëtarë

SULEJMAN DËRMAKU

Kongresi i Drejtshkrimit-ngjarje epokale e historisë kombëtare

ABDULLA ZYMBERI

Standardi i shqipes, 40 vjet pas

AGRON DURO

Probleme të diferencimit kuptimor në shqipen standarde

ELONA ÇEÇE (BIBA)

Tradita elbasanase dhe gjuha letrare shqipe

MIÇO SAMARA

Rreth së ashtuquajtës *gjuhë e drunjtë* në stilin e publicistikës

KLEDI SHEGANI

Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe dhe probleme të drejtshkrimit të shqipes sot

RAMI MEMUSHAJ

Gjuha standarde si makrosistem

SHEFKIJE ISLAMAJ

Kongresi i Drejtshkrimit dhe çështje të leksikut

VALTER MEMISHA

Shqipja standarde dhe fjalorët shqip-gjuhë e huaj

ANYLA SARAÇI (MAXHE)

Norma drejtshqiptimore dhe probleme të saj

SEJDI GASHI

Ngecjet e shqipes standarde në administratën publike në Kosovë

ADELINA ÇERPJA

Drejtshkrimori i shqipes - përmirësimi dhe plotësimi i tij

RAGIP MULAKU

Ndërhyrjet në standard - plotësime të vogla, jo ndryshime

SHEREMET KRASNIQI

Ç'vlerësim iu bë Komisioni Letrare të Shkodrës në Kongresin e Drejtshkrimit (1972)

ZEKI MORINA

Zbatimi i drejtshkrimit dhe kultura gjuhësore në mbishkrimet dhe botimet zyrtare në Gjakovë

LIRI SEITLLARI

Shkrimtari Mitrush Kuteli, një ndihmës i madh në pasurimin e gjuhës letrare shqipe

ISA BAJÇINCA

Në 40-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit

SADRI FETIU

Konsultat gjuhësore dhe përvjetori i Kongresit të Drejtshkrimit

BEGZAD BALIU

Diskutimet për shqipen standarde ndërmjet dy vendimeve të mëdha

VILMA PROKO

Terminologjia shqipe në rrafshin e globalizmit

DHORI QIRJAZI

Leksikografi dhe ortografi. Aspekte të normës drejtshkrimore në fjalorin shqip-greqisht të Th. Mitkos

NEXHMIJE KASTRATI

Zbatimi i standardit në esetë e pjesëmarrësve të garës “Gjuhëtari i ri”

HYSNIE HYSKA

“Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe” i A. Dhimos e R. Memushajt (krahasuar me normat e Kongresit të Drejtshkrimit)

VALBONA EMINI- OLIANA PAPA

Pastrimi i shqipes nga fjalët e huaja-çështje e ditës



PËRKYFTESË

Më 16-17 nëntor 2012, u mbajt në Universitetin "Fan S. Noli" të Korçës Akademia Solemne kushtuar 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit, e organizuar nga Universiteti "Fan S. Noli" i Korçës, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë Tiranë.

Në këtë veprimtari përkujtimore jubilarë, morën pjesë delegatë dhe pjesëmarrës të Kongresit të Drejtshkrimit, si dhe studiues dhe pedagogë të gjuhës shqipe të universiteteve dhe instituteve shkencore të Korçës, Tiranës, Prishtinës, Shkupit, Tetovës, Prizrenit, Gjiçanit, Gjakovës, Ulqinit, si dhe të ftuar nga gendra albanologjike të huaja (Selanik, Çikago).

Veprimtaria u zhvillua me pesë seanca plenare, ku u mbajtën rreth 40 kumtesa.

Në çelje të Akademisë u bënë përshëndetje nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, nga ministria e Arsimit dhe e Shkencës, nga delegatë të Kongresit të Drejtshkrimit, si dhe nga rektori i Universitetit të Korçës, prof. as. dr. Gjergji Mero, i cili në emër të Senatit Akademik të Universitetit dha "Certifikatë Mirënjohjeje" dhe simbolin e ABC-së për delegatët e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe.

Me emocion u pritën sidomos përshëndetjet që kishin dërguar akad. Dritëro Agolli dhe akad. Rexhep Zosja.

Kumtesat u përshkuan nga nderësimi i Kongresit të Drejtshkrimit si shprehje dhe realizim i idealeve të Rilindjes sonë Kombëtare për një gjuhë letrare shqipe të përbashkët, si njësi e pandashme e kulturës dhe shpirtit kombëtar të të gjithë shqiptarëve.

Në Akademinë Solemne të Korçës u pohua njëzëri karakteri gjithëkombëtar i zbatimit të drejtshkrimit të njëzuar dhe frytet e tij të ujera në praktikën shkrimore të Republikës së Shqipërisë, të Republikës së Kosovës dhe të mediave të shkruara e të folura në Maqedoni, në Mal të Zi e në diasporën arbëreshe të Italisë e më gjerë.

Kumtuesit dhe pjesëmarrësit nderësuan se Kongresi i Drejtshkrimit e dëndësoi dhe e ngjeshi indin e përbashkët kulturor kombëtar, e ngriti çështjen e kulturës gjuhësore në lartësinë e kërkesave intelektuale të një shoqërie moderne, e shtoi kujdesin shoqëror për pastërtinë dhe pasurimin e gjuhës, dëshmoi para botës njësinë etnike, gjuhësore dhe kulturore të shqiptarëve në gjithë hapësirën

e tyre të banimit, pavarësisht nga kufijtë shtetërorë, e lartoi prestigjin e gjuhësisë shqiptare në vendet përkatëse dhe në rrethet shkencore në botë. Prandaj ajo ngjarje meriton nderimin tonë të përhershëm.

Pjesëmarrësit u shprehën njëzëri për ruajtjen e parimeve dhe të përfundimeve bazë të shprehura në Rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit, si dhe shtruan kërkesa për masa të mëtijshme në mbrojtje të shqipes standarde dhe për rritjen e kulturës gjuhësore në institucionet shtetërore dhe shoqërore në Shqipëri dhe në të gjitha hapësirat shqiptare.

Në mënyrë të veçantë, Akademia Solemne vuri theksin në punën që duhet të bëjnë shkollat shqiptare për mësimin sa më cilësor të shqipes në sistemin shkollor parauniversitar, por edhe për përgatitjen gjithnjë e më të mirë të mësimeve të gjuhës shqipe në shkollat e larta e pikërisht:

të vijohet praktika e frytshme e ligjëratave për njohjen e drejtshkrimit dhe normave kryesore të shqipes standarde në të gjitha dikasteret dhe institucionet shtetërore dhe private, që kryejnë botime ose publikime dokumentesh të shkruara:

të punohet për kualifikimin gjuhësor të zëdhënësve të shtypit, të redaktorëve dhe korrektorëve letrarë të gazetave, revistave dhe shtëpiave botuese të Shqipërisë, Kosovës dhe më gjerë.

Pjesëmarrësit u shprehën që të ruhet vijimësia dhe fryma e Kongresit të Drejtshkrimit në organizmat kombëtare ekzistuese dhe të tjera që mund të krijohen, në të cilat të përfaqësohet sa më gjerë mendimi i kualifikuar i gjuhëtarëve dhe dashamirëve të shqipes.

Kongresi i Drejtshkrimit mbetet ngjarje me rëndësi themelore në historinë e kombit shqiptar dhe përbën gurin e themelit të kaheve të reja të njësimi gjuhësor, kulturor e shpirtëror të shqiptarëve në të gjitha trojet e veta etnike dhe në diasporat e hershme e të reja në botë. Prej kësaj ideje burojnë edhe ulërsimet e tjera e pikërisht: drejtshkrimi i njësuar si bazë për praktikën shkrimore e botuese me karakter zyrtar e publik, por edhe si udhëheqës për vijën përbashkuese të drejtshqiptimit dhe të kaheve më largvajtëse të shqipes së folur.

Korçë, më 17 nëntor 2012

(vijojnë firmat e pjesëmarrësve)

PJESËMARRËSIT E AKADEMISË SOLEMENE

ABDULLA ZYMBERI, prof. dr.

ADELINA ÇERPJA, dr.

AGRON DURO, prof. dr.

AJTEN QAMILI, ma

ANILA MAXHE, dr.

ASLLAN HAMITI, prof. dr.

BAHTUAR KRYEZIU, prof. dr.

BEGZAD BALIU, prof. asoc. dr.

ÇLIRIM BIDOLLARI, prof. dr.

DHORI QIRJAZI, dr.

ELONA BIBA, dr.

EMIL LAJE, prof. dr.

GJERGJI MERO, prof. dr.

GJOVALIN SHKURTAJ, akad. as.

HYSEN MATOSHI, prof. dr.

HYSNIE HYSKA, ma.

ISA BAJÇINCA, mr. sc.

ISMAIL DODA, mr. sec.

ISMET OSMANI, prof. as.dr.

JANI THOMAI, akad.

JORGO BULO, akad.

LIRI SEITLLARI, ma.

MIÇO SAMARA, prof. dr.


MUZAFER KORKUTI, akad.

NAILE NIMANI, dr.

NEXHMIJE KASTRATI, dr.

NIKOLETA CIKULI, doc.

OLIANA PAPA, ma.

QEMAL MURATI, prof. dr. 
 RAGIP MULAKU, prof. dr. 
 RAMI MEMUSHAJ, prof. dr. 
 REXHEP QOSJA, akad.
 SADRI FETIU, prof. dr. 
 SEJDI GASHI, ma. 
 SULEJMAN DËRMAKU, 
 SHEFKUDE ISLAMAJ, prof. dr. 
 SHEREMET KRASNIQI, mr. sc. 
 THANAS FEKA, prof. dr.
 VALBONA EMINI, ma. 
 VALBONA REMZI NESIMI (TOSKA), prof. ps. dr. 
 VALTER MEMISHA, prof. dr. 
 VICTOR A. FRIEDMAN, akad. 
 VILMA PROKO, dr. 
 XHEVAJ LLOSHI, prof. dr. 
 ZEKI MORINA, ma. 
 ALI JASHARI, prof. dr. 

FJALA E HAPJES E AKADEMISË SOLEMNE

PROF. DR. ALI JASHARI

Dekan i Fakultetit të Edukimit dhe të Filologjisë

NDERIM PËR KONGRESIN E DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE DHE DELEGATËT E TIJ

Të nderuar pjesëmarrës në këtë Akademi Solemne.

Ju falënderoj që keni ardhur për të përkujtuar dy ngjarje të rëndësishme në jetën e kombit shqiptar, siç është përvjetori i dyzetë i Kongresit të Drejtshkrimit, që përkon me jubileun e madh të 100-vjetorit të Pavarësisë. Këto dy data për ne shqiptarët janë simbolike dhe jetësore, sepse lidhen drejtpërdrejt me qenien tonë si shqiptarë.

Mbajtja e kësaj Akademie Solemne për Kongresin e Drejtshkrimit në Korçë, në Universitetin që mban emrin e Nolit të madh, ishte dëshirë e shumë prej studiuesve që janë sot në këtë sallë, sepse Korça ka qenë dhe mbetet djepi i atdhetarisë dhe i dashurisë për gjuhën shqipe. Fakte të tillë, si Shkolla e Parë Shqipe, Kongresi i Manastirit ku Korça kishte 7 delegatë, Liceu Francez, shkolla pedagogjike etj., e bëjnë edhe më domethënëse veprimtarinë e sotme.

Unë personalisht kam një kujtim të veçantë për Kongresin e Drejtshkrimit, sepse si student i vitit të parë në Fakultetin e Filologjisë, bashkë me një grup studentësh të degës gjuhë-letërsi, falë kujdesit të prof. Shaban Demirajt, që atëherë ishte shef i katedrës së gjuhës shqipe, kam ndjekur në sallë punimet e Kongresit dhe i kam përjetuar me emocion të gjitha seancat.

Aktet e Kongresit të Drejtshkrimit dhe veprat që u botuan pas tij, ishin dhe mbeten udhërrëfyese për punën e qindra mësuesve të shqipes dhe studiuesve të saj, si dhe për nxënësit dhe studentët e filologjisë.

Kjo Akademi Solemne për Kongresin e Drejtshkrimit bëhet edhe më domethënëse në ditët e sotme, ku, siç dihet, prej kohësh, në qarqe të caktuara intelektuale dhe në shtypin shqiptar është ngritur zëri dhe është harxhuar shumë bojë për “shprishjen” e gjuhës shqipe. Mendoj se dysia dialektore nuk duhet të çojë në dysinë e gjuhës letrare, njësimi i së cilës nuk u arrit aq lehtë. Kryesorja është që shqiptarët, ata që e quajnë veten shqiptarë, të mërgojnë mendimet e mbrapshta për gjuhën tonë amtare dhe, ndonjë lëvrues i shqipes të mos luajë rolin e branarit në këtë çështje, që ka të bëjë me vetë qenien e kombit shqiptar.

Kumtesat që do të mbahen në këtë Akademi Solemne do ta pohojnë edhe një herë me zë të lartë, se sot nuk ka pse të mos ecim në hullinë që çelën dhe rrahën rilindësit e më pas atdhetarë të tjerë. Gjuhën e sotme letrare e tumirën gjithë shqiptarët në trojet ku shqipja është gjuhë e amës. Guri i themelit që vuri Kongresi i Drejtshkrimit nuk ka pse të marrë rrokullimën e të bjerë ndër gremina dasish gjuhe, sepse nënshkrimi i delegatëve të Kongresit, si E. Çabej, Sh. Demiraj, O. Myderrizi, M. Domi, I. Ajeti, R. Nesimi, B. Bokshi, I. Kadare, L. Poradeci, S. Spase, D. Agolli, R. Qose, J. Ferrarri etj., dhe i delegatëve që janë sot të pranishëm, ishte nënshkrimi i të gjithë shqiptarëve.

Siç dihet, problemi i shqipes në ditët e sotme është shumë serioz. Shoqëria jonë demokratike duhet të merakoset më shumë dhe të veprojë. Përndryshe, t'i varësh fatet e shqipes standarde në duart dhe mendjen e disa njerëzve, është pak. Për më tepër, mendimet ndjellakeqe për shqipen, si gjuhë e njësuar, janë shpërfaqur gjithandej në gazeta, radio e televizion. E, njerëz të tillë, sadopak që janë, në vend që “të rrëmbejnë” penat e mikrofonët e të përkryejnë gjuhën tonë, bëjnë të kundërtën.

Sot termi “shqipja standarde” vazhdon të lakohet në të gjitha raset, duke thënë se ne e kemi këtë, se do të vazhdojmë të mbajmë këtë standard duke e pasuruar dhe përmirësuar, pavarësisht ndonjë zëri për të krijuar një standard tjetër si konkurrent ndaj këtij që kemi. Por nuk mjafton vetëm të thuash që kemi gjuhë standarde për të qenë e tillë, pa e lidhur ngushtë me faktin se ku zbatohet dhe sa jetësohet ajo, pa marrë parasysh dukuritë e sotme siç janë prirjet për ta dhënë në mënyrë të formalizuar dhe “besnike” standardin në shkollat tona, duke e shkëputur gjuhën nga dëshmitë shkrimore origjinale dhe përdorimin e saj në ligjërime.

Argumenti ynë në këtë rast mbështetet në shtjellimin e dy ideve kryesore: e para, që politika gjuhësore e çdo shteti sendërtohet në radhë të parë e mbi të gjitha në mësimin e organizuar dhe të detyrueshëm të gjuhës amtare në të gjitha ciklet e arsimit parauniversitar, madje edhe më tej në shkollat e larta; e dyta, që arrijtjet më të shënuara dhe të kodifikuara të shkencës gjuhësore shqiptare të jenë baza shkencore e gjithë dijeve të njësuara që duhet të marrin nxënësit shqiptarë që nga abetarja deri në maturën shtetërore, në përshtatje me moshën, sipas kriterëve pedagogjike të studiuar mirë e mirë, duke u selitur atyre mirë e bukur gjuhën shqipe, ashtu siç gjallon dhe përdoret.

Ndaj dhe në këtë Akademi Solemne ne nderojmë veprën e 87 delegatëve të Kongresit të Drejtshkrimit, duke kujtuar emrat e atyre që sot nuk janë më, por që vepra e tyre do të kujtohet brez pas brezi ndër shqiptarët, si: Eqrem Çabej, Mahir Domi, Androkli Kostallari, Aleks Buda, Dhimitër Shuteriqi, Lasgush Poradeci, Lirak Dodbiba, Anastas Dodi, Jup Kastrati, Bedri Dedja, Josif Ferrari, Remzi Nesimi, Kolë Koci, Luigj Franja, Fatmir Agalliu, Fadil Podgorica, Ali Dhrimo, Dalan Shapllo, Dhori Qirjazi, Gaqo Peci, Jakov Xoxa, Henrik Lacaj, Kolë Ashta, Llazar Siliqi, Petro Janura, Sterjo Spasse, Shevqet Musaraj, Zihni Sako, Osman Myderrizi, Spiro Floqi, Sofika Morcka, Stefan Prifti, Menella Totoni etj.

Në këtë Akademi Solemne marrin pjesë me kumtesa dhe përshëndetje rreth 50 studiues, profesorë të shqipes, mësues dhe delegatë të Kongresit të Drejtshkrimit nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë i Tiranës, Universiteti i Tiranës, Universiteti i Korçës, Universiteti i Çikagos, Universiteti i Shkupit, Universiteti Shtetëror i Tetovës, nga Mali i Zi etj., si dhe kanë dërguar përshëndetjet ose kumtesat e tyre, në pamundësi për të marrë pjesë për shkak të veprimtarive që kanë edhe: Prof. Shezai Rrokaj, Hamit Xhaferri, Aljula Jubani, Miço Samara, Fehari Ramadani, Enver Hysa, Zeqirja Neziri, Abdulla Ballhysa, Tomor Osmani, Vebi Bexheti, Tef Topalli, Dhimitër Bello, Zeqir Kadriu, Thoma Dhima, Bahtijar Kryeziu, duke veçuar përshëndetjen e prof. Remzi Pernaskës, i cili shkruan: Më së pari, falënderoj me mirënjohje organizatorët për ftesën që më dërguan. Si korçar, si delegat në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, si shqiptar, përshëndes mbajtjen e kësaj Akademie Solemne për 40-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, që organizon qyteti im, që organizoni ju dashamirës, mbrojtës dhe studiues të shenjës së parë të kombit, të gjuhës. Do të kisha marrë pjesë me gjithë dëshirë e plot kënaqësi në këtë Akademi Solemne, por, për fat të keq nuk mund të jem midis jush, të ardhur

nga të gjitha trojet shqiptare dhe specialistë të dorës së parë për hetimin e këtij kolos-thesari, që e quajmë me gojën plot *gjuha jonë*, sepse pikërisht më 16 nëntor do të marr pjesë me kumtesë në Konferencën që organizojnë bashkarisht Instituti i Gjuhëve dhe i Qytetërimeve Lindore në Paris dhe Qendra e Studimeve Albanologjike e Shqipërisë. Gjuha gjithandej në botë dhe në çdo kohë ka qenë përbërës bashkues i kombit. E tillë është edhe gjuha shqipe. Ç'gjë madhështore është mbajtja e kësaj Akademie përkujtimore dhe pune në kuadrin e festimeve të 100-vjetorit të Pavarësisë! Akademi Solemne që i bashkon shqiptarët. Ju përgëzoj me shpirt për këtë veprimtari tejatdhetare dhe i uroj Akademisë Solemne punime të mbara e të frytshme me nivel të lartë shkencor. Remzi Përnaska

Më në fund, dua të përmend me fjalë mirënjohjeje punën e palodhur që bënë dhe idetë që dhanë për organizimin e kësaj Akademie Jubilare edhe bashkorganizatorët, akad. Gjovalin Shkurtaç, prof. dr. Emil Lafi, prof. dr. Valter Memisha, si profesorët Shefkije Islamaj, Qemal Murati e Begzad Baliu, që propozuan dhe ideuan të parët për të zhvilluar një veprimtari të tillë në Korçë.

Duke ju uruar edhe një herë mirëseardhjen, punimet e Akademisë Solemne për 40-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit i deklaroj të hapura.

Faleminderit!

MESAZH I AKADEMIKUT DHE SHKRIMTARIT DRITËRO AGOLLI DREJTUAR AKADEMISË SOLEMNE NË 40-VJETORIN E KONGRESIT TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Të dashur miq, në pamundësi të vij në Universitetin e Korçës me këtë rast kaq të mirë, e ndiej se jam me ju, ashtu si edhe para një viti, kur ju më dhatë titullin e lartë “Doctor Honoris Causa”.

Edhe tashi pas dyzet vjetësh unë i kam të gjalla kujtimet nga Kongresi i Drejtshkrimit të Shqipes, që ju me këtë Akademi Solemne po e nderoni, duke nderuar gjuhën tonë të bukur. Tashi që flitet e shkruhet kaq shumë për gjuhën letrare, unë them se shumë veta rrahin ujë në havan, se gjërat ndjekim kohën vetvetiu dhe gjuha vetvetiu zhvillohet e zbukurohet, por ca nga këta duan ta prishin bukurinë e gjuhës sonë. Të gjithë para nesh kanë thënë se duhet të kemi një gjuhë të përbashkët, Konica thoshte që të kemi një gjuhë për të gjithë; edhe Fishta që shkroi në gegërisht ka thënë që të kemi një shqipe të përbashkët. Kongresi ishte një sukses i madh, që e filluan kosovarët dhe pastaj e bëmë edhe ne në Shqipëri të gjithë bashkë. Kur them se gjuha bëhet vetvetiu, ja shiko, ne sot themi *ranishte* dhe jo *rërishte*, themi *zanore* dhe jo *zërore*, më parë thoshim *mësonjës*, *këndonjës*, *lexonjës*, po tashti themi *mësues*, *këndues*, *lexues*, se kështu është mësuar edhe më mirë veshi për t’i dëgjuar, se nga 12 gjëra që shqipja letrare ka marrë nga dialektet, tetë janë nga gegërishtja. Ca nga këta studiuesit e sotmë merren me ë-të dhe me e-të që janë zgjidhur me kohë. Edhe ne kemi fjalët *tre* dhe *tri*, po gjuha po pranon vetëm *tre* dhe jo *tri*, themi *tre* vajza, *tre* studente. Pale kur thonë *kush parti*, *kush ministër*, *kush ligj*, e duket që këta s’ marrin vesh fare nga shqipja letrare, se shqipja s’i pranon këto gabime të trasha.

Po më e keqja është ndotja e gjuhës sonë nga fjalët e huaja, që shumë veta i përdorin për t’u treguar më të mençmë se të tjerët, si *agravohet* për *rëndohet*, *përkeqësohet*, apo *implementoj* (se edhe unë mezi e them këtë fjalë), se ndotja e gjuhës është si ndotja e natyrës, e kur ndotet kjo s’ marrin dot frymë. Se po i lëmë mënjatë fjalët tona të mira dhe po futim fjalë të huaja, e pastaj katandiset kokoshi një thellë, ç’i mbetet shqipes pastaj?

Dua të flas ca më gjatë, por nuk mundem, po edhe njëherë ju uroj të gjithëve nga zemra që këtë “kongres”, desha të them këtë përkujtim të Kongresit të Drejtshkrimit, e bëtë në Korçë, në Universitetin e saj dhe kjo ka lezetin e saj, se korçarët, kolonjarët, devollinjët e të tërë kanë qenë të penës me kohë.

PËRSHËNDETJA E AKADEMIKUT REXHEP QOSJA

DY PËRVJETORË TË PANDASHËM

Kam kënaqësi të veçantë të përshëndes pjesëmarrësit e Akademisë Solemne kushtuar 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe dhe 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe t'ua uroj këto dy ngjarje të mëdha në historinë e popullit shqiptar, t'ua uroj dhe t'u them: keni bërë jashtëzakonisht mirë pse po i kremtoni përnjëherë, bashkë, në një akademi solmne këta dy përvjetorë.

Ata janë përvjetorë me domethënie e me rëndësi të pandarë në historinë e popullit shqiptar.

Shteti modern shqiptar, Shqipëria, i krijuar në Vlorën liridashëse dhe heroike, më 28 nëntor të viti 1912, është ngjarja më e madhe në historinë politike të popullit shqiptar. Jo vetëm shqipëtrët në Shqipërinë shtetërore, por edhe shqiptarët kudoqofshin ata sot – në Republikën e Kosovës, në Maqedoni, në Mal të Zi, në Luginën e Preshevës, në Greqi, në Turqi, në Itali, në vende të tjera të Bashkimit Evropian, në SHBA, në Kananda në Australi e gjetiu, e shënojnë 100-vjetorin e Shqipërisë shtetërore, sepse ajo u ka bërë të mundshme të mbahen në histori e të ruajnë identitetin e tyre kombëtar me të gjitha vlerat e traditës, të kulturës e të historisë.

Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, i mbajtur në Tiranë në vitin 1972, 60 vjet pas krijimit të shtetit modern shqiptar, është ngjarja më e madhe në historinë kulturore dhe qytetëruese të popullit shqiptar. Ky kongres do t'i sjellë popullit shqiptar, në të vërtetë do t'u sjellë gjithë shqiptarëve kudo qofshin ata, gjuhën, që atëherë për shumë arsye i thoshim gjuha e njësuar letrare kombëtare, kurse sot i themi gjuha standarde shqipe. Dhe, me këtë gjuhë të njësuar letrare kombëtare, shqiptarët do të ngrihen në shkallën e popujve me kulturë e qytetërim të lartë.

Në përpjekjet për krijimin e shtetit kombëtar shqiptar janë të përmbajtura edhe përpjekjet për krijimin e gjuhës së njësuar letrare kombëtare.

E kuptueshme.

Ata që ndërtuan ideologjinë kombëtare shqiptare, ata që krijuan programin kombëtar shqiptar, ata që, më në fund, bënë Shqipërinë dhe bënë shqiptarin, rilindësit tanë të mëdhenj, duke filluar prej Naum Veqilharxhit, Pashko Vasës, Jani Vretos, vëllezërve Frashëri, Asdrenit, e deri te Luigj Gurakuqi dhe babai i Shqipërisë, Ismail Qemali, ata njëkohësisht bënë përpjekje për krijimin e alfabetit të përbashkët dhe për krijimin e gjuhës së njësuar letrare kombëtare. I bënë ata këto përpjekje për krijimin e alfabetit kombëtar në Kongresin e Manastirit në vitin 1908 dhe krijimin e gjuhës së njësuar letrare kombëtare në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe në Tiranë, në vitin 1972, të vetëdijshëm se shteti kombëtar shqiptar, i krijuar në Kuvendin e Vlorës më 28 nëntor 1912, do të jetë vërtet gjithëkombëtar dhe do të jetë vërtet i qëndruar gjithmonë, në qoftë se do ta kenë të njësuar domethënien gjithëkombëtare dhe vlerën e tij të madhe, të gjithmonshme, gjuhën.

E kuptueshme.

Ata, rilindësit tanë të mëdhenj, e dinin mirë se këtë dije e kishin mësuar prej historive të popujve të mëdhenj evropianë, se njësia e gjuhës do të thotë njësi e kombit.

Prandaj nuk është e çuditshme, pse disa nisma të njëzet viteve të fundit, për krijimin e gjuhës së dytë standarde, a për dialekt të standardizuar a, më në fund, për ndryshime, në të vërtetë për cënime të themeleve të gjuhës së njësuar letrare kombëtare, përjetohen dëshpërueshëm dhe refuzueshëm prej numrit më të madh të shqiptarëve kudoqofshin ata sot dhe përjetohen kështu dëshpërueshëm dhe refuzueshëm për shkak të bindjes së tyre të drejtë, se cënimet e njësisë së gjuhës shpien në cënimet e njësisë së kombit.

Ndihem i privilegjuar e i nderuar, kolegë të çmuar, pse më bëhet e mundshme që edhe fjala ime të dëgjohet në këtë akademi.

Ju faleminderit!
Juaji me përzemërsi,
Rexhep Qosja

Prishtinë, 15.11.2012

PËRSHËNDETJA E ALBANOLOGUT VICTOR A. FRIEDMAN - UNIVERSITETI I ÇIKAGOS (SHBA)

Për mua, si një i huaj, Kongresi i Drejtshkrimi të Gjuhës Shqipe i vitit 1972 ishte një gëzim i madh. Në të vërtetë, gëzimi ishte edhe më i madh kur doli nga shtypi libri “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe” në 1974. Për një student të gjuhës shqipe, si edhe për gjuhëtarët në përgjithësi, një libër i tillë është jo vetëm shumë i nevojshëm, por është edhe një thesar me të dhëna për pasurimin e gjuhës shqipe. Si në çdo gjuhë që jeton dhe po vazhdon të jetojë, ashtu edhe në gjuhën shqipe ka ndryshime dhe ka pasurim të vazhdueshëm. Por, për një të huaj, gjuha standarde është dera e pasurive të gjuhës. Për ne që jemi nga jashtë, standardi është një mjet shumë i rëndësishëm për afirmimin e gjuhës shqipe.

Gëzohem shumë edhe që jemi në Korçë. Korça është në radhë të parë e njohur për shkollat shqipe, se këtu më 7 Mars 1887 u hap shkolla e parë fillore në gjuhën shqipe nga organizata “Drita”. Kjo datë festohet si Dita e Shkollës Shqipe dhe Dita e Mësuesit . Po në Korçë, në vitin 1891 u hap shkolla e parë për vajza nga familja Qiriaz. Nuk është e rastit që stema e Korçës ka penën dhe ngjyrën. Edhe në Korçë, edhe në rrethinën e saj ka përfaqësues të grupeve të gjuhëve të tjera të Ballkanit: të maqedonishtes, të vllahishtes, të greqishtes dhe të gjuhës rome, gjë që paraqet një pasuri të vërtetë. Naim Frashëri, nëna e të cilit ishte korçare, i cili u bë poet kombëtar i gjuhës shqipe, ashtu si Pushkini për rusët apo Mieskieviç për polakët, si Shekspiri për gjithë botën anglishtfolëse, ka shkruar jo vetëm në shqip, por edhe në turqisht, në persisht dhe në greqisht. Edhe vëllezërit e tij, Abdyl dhe Samiu, që të tre me të vërtetë, heronj të mëdhenj të popullit shqiptar, shkruanin edhe në shqip edhe në gjuhë të tjera.

Por nuk është rastësi që Naimi ka shkruar në vjershën e tij të bukur me titullin “Korça”, këtë strofë të pavdekshme për gjuhën shqipe:

Gjuha jonë sa e mirë!

Sa e ëmbël, sa e gjerë!

Sa e lehtë, sa e lirë!

Sa e bukur, sa e vlerë!

Dashuria e shqiptarëve për gjuhën e tyre dhe veçanërisht për shkronjat e saj, është një dukuri e veçantë midis popujve të botës. Siç këndohet në këngën korçare “Alfabeti shqip”: *Shkronjat tona janë të arta...*

Korça dhe gjuha shqipe janë të pandara. Universiteti juaj le të jetë krenar që ndodhet në këtë qytet ku zuri fill arsimi kombëtar shqiptar. Le të jetë krenar që mban emrin e të përndritshmit peshkop Fan Stilian Noli, një nga lëvruarit e mrekullueshëm të gjuhës shqipe, një mësues i madh i demokracisë moderne dhe një simbol rrezatues i miqësisë shqiptaro-amerikane.

PËRSHËNDETJE NË EMËR TË AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË NGA AKAD. JORGO BULO

Para së gjithash dëshiroj që në emër të Akademisë së Shkencave të falënderoj komisionin organizues për ftesën dhe t'ju përgëzoj për organizimin e kësaj konference që i zhvillon punimet e saj nën shenjën e 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit dhe në atmosferën e kremtimeve për 100-vjetorin e Pavarësisë, këtu në Korçë, në qytetin e Mësonjëtores së Parë Shqipe.

40 vjet më parë, delegatë nga të gjitha trojet etnike të shqipes dhe nga diaspora arbëreshe, përfaqësues të shquar të shkencës filologjike, të letrave e të kulturës shqiptare, të mbledhur në një kuvend kombëtar, morën një vendim historik: njohën rezultatin e zhvillimit shekullor konvergjent të shqipes dhe kodifikuan normën e saj letrare, duke i dhënë shqipes fytyrën e një gjuhe moderne të njësuar.

Kongresi i Drejtshkrimit me vendimet e tij kurorëzoi një proces të gjatë zhvillimi të shqipes, prirjen e saj drejt njësimi si shprehje e njësisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve. Gjuha letrare e njësuar është vepër e gjithë brezave të lëvruessve e të studiuesve të shqipes, të cilët i kanë dhënë asaj njësinë, forcën dhe hijeshinë e një gjuhe kulture të përpunuar, të normëzuar e të aftë për të shprehur shpirtin e popullit të vet, konceptet e jetës, të mendësisë e të dijes bashkëkohore.

Tradita historike kulturore dhe gjuha e njësuar, ka qenë dhe mbetet faktori kryesor i krijimit të hapësirës kulturore kombëtare të mbarë botës së sotme shqiptare; ato i japin kësaj hapësire forcën e jetës dhe qenies së saj, si një realitet dhe e drejtë natyrore e një populli me identitet, pavarësisht prej konteksteve të ndryshme shtetërore në të cilat ai jeton ose mbijeton.

Fakti që shqipja e sotme ka arritur të jetë një sistem i njësuar dhe i standardizuar, nuk i kufizon, përkundrazi i çliron aftësitë dhe mundësitë e saj për t'u zhvilluar e pasuruar më tej, duke përthithur brenda këtij sistemi pasurinë e pashtershme të rrjedhave të gjuhës popullore, të krahinave e dialekteve të ndryshme. Vetëm në këtë vijë zhvillimi ajo mund të kryejë funksionet e saj në kushtet e zhvillimeve bashkëkohore dhe t'i bëjë ballë trysnisë e ballafaqimit me gjuhët e tjera në klimën e globalizmit.

Edhe pse pas 40 vjetësh shqipja standarde e ka kaluar provën e kohës dhe funksionon më së miri, duhet të pranojmë se për rrethana jashtëgjuhësore, prestigji i saj është tronditur.

Nuk na lejohet të mbylлим sytë, kur shohim përditë një shkujdesje të pafalshme për kulturën e gjuhës, kur shohim përditë se shkelet norma leksikore dhe vërshojnë pa fre fjalë të huaja të panevojshme, se shkelet norma drejtshkrimore, dhunohen trajtat morfologjike dhe struktura sintaksore e shqipes, se shëmtohet pamja e saj. Aq më keq kur shohim, se niveli i përvetësimit të shqipes në shkollë ka rënë tek s'mban.

Pra po ndodh ajo që s'duhet të ndodhte, në një kohë që gjuhësia shqiptare ka realizuar vepra themelore normative, vepra bazale për një gjuhë të standardizuar si gjuhë kulture.

Konferenca juaj do të trajtojë problemet me të cilat shqipja përballohet sot, me synimin fisnik për përsosjen dhe përvetësimin e normës gjuhësore në të gjitha nivelet. Përgjegjësia juaj si studiues dhe pedagogë të shqipes është e madhe, për të ruajtur dhe zhvilluar atë që është arritur dhe për t'u vënë gardh prirjeve prapavajtëse.

Duke falënderuar edhe një herë Universitetin "Fan S. Noli", Institutin Albanologjik të Prishtinës dhe Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, për nismën e organizimit të kësaj veprimtarie shkencore kombëtare, i uroj konferencës suaj punë të mbarë.

ISMAIL DODA

**MBRESA TË PASHLYESHME NGA KONGRESI I DREJTSHKRIMIT TË
GJUHËS SHQIPE (TIRANË, 20-25 NËNTOR 1972)**

E nderuara Kryesi e Akademisë Solemne,
I nderuar Prof. as. dr. Gjergji Mero, rektor i Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës,
I nderuar Prof. dr. Ali Jashari, dekan i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, pranë
këtij universiteti,

I nderuar z. Ardian Tana, zv.ministër i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së
Shqipërisë,

Kolegë, pjesëmarrës të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe,
Zonja, zotërinj dhe përfaqësues të medias!

Si delegat i Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (Tiranë, 20-25 nëntor 1972),
ju përshëndes në emrin tim personal dhe të Komisionit të Arsimit pranë Këshillit Nacional të
Shqiptarëve në Malin e Zi, të cilin e drejtoj.

Korçën e njoha në mënyrë të përafërt gjatë vizitës që bëra këtu më 21-22 tetor 1978 (e
shtunë - e diel). Tani gëzohem edhe më tepër që në këtë qytet me frymë atdhetare dhe rrënjë
historike të shkollës shqipe po mbahet kjo Akademi Solemne, e cila i kushtohet 40-vjetorit të
Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, në 100-vjetorin e krijimit të shtetit të pavarur të
Shqipërisë. Ndihej i lumtur që në këtë rast, të shpalos ndonjë episod kujtimi nga ai kongres
historik. Pesë vjet para se të zhvillohej ai, Enti Arsimor-Pedagogjik i Titogradit (Podgoricës
së sotme), me shkresën numër 424, dt. 4 nëntor 1967, kërkoi informacion për gjendjen dhe
problemet e gjuhës shqipe edhe në shkollën tonë fillore në Krajë (Mali i Zi), e cila, nga 10
mars i vitit 1968 u quajt “Gjergj Kastrioti – Skënderbeu”. Si arsimtar i gjuhës shqipe, me
shkresën nr. 287, dt. 22 nëntor 1967 ia ktheva përgjigjen, duke kërkuar me këmbëngulje që,
ashtu si në Maqedoni, të përdoret gjuha e njësuar shqipe edhe në Malin e Zi dhe në Kosovë,
në kohën kur po zhvilloheshin debate para Konsultës Gjuhësore të Prishtinës.

Kjo domosdoshmëri m’u bë e afërt, kur më ra në dorë ftesa e datës 14 gusht 1972 nga
Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës, për të marrë pjesë në
Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë. Pjesëmarrjen e konfirmova me letrën e datës 23 gusht
1972 që ia dërgova komisionit të organizimit.

Pasi më njoftuan me telegram nga Tirana për datën dhe kohën e saktë, që të gjendesha
në kufirin shqiptaro-jugosllav, u nisa për atje të shtunën më 18 nëntor 1972. Në orën 14.00,
në Bozhaj, u bëra bashkë me kolegët e ftuar nga Kosova. Disa nga ata ishin shokë a pedagogë
të mi nga Normalja a Fakulteti Filozofik i Prishtinës, si edhe të njohur të tjerë. Në pikën e
kalimit kufitar Hani i Hotit na doli përpara pala mikpritëse nga Tirana, e kryesuar nga
bashkëpunëtori i vjetër shkencor Koço Bihiku, zv.drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të
Letërsisë. Ma ofruan një vend të veturë. Si më i riu që isha, i falënderova dhe hyra në
autobus. Ndenja pranë studiuesit Sulejman Drini, njohës i mirë i gjuhës shqipe. Në orën 15.00
nisemi. Gjatë udhëtimit deri në Shkodër, në anën e djathtë, qëndronte përpara Kraja ime,
matanë liqenit me emrin e qytetit që i rri pranë. Ajo dukej si në pëllëmbë të dorës. Këto

rrethina i ndanë nga Shkodra Fuqitë e Mëdha. Prishja e marrëdhënieve shtetërore Jugosllavi–Shqipëri, për shkak të Informbyrosë (qershor 1948) i largoi edhe më.

Vëllezërit mikpritës na shtruan darkë në “Turizëm” të Shkodrës. Meqë pushuam pak gjatë, duke shëtitur aty pranë, rastësisht takova Milihan dhe Xhevatën, fëmijët e dy vëllezërve me prejardhje nga Kraja, të cilëve, që andej, u solla të fala. Në librarinë pranë Kafes së Madhe u njoha me Dritën, një zonjë e re fisnike dhe e kulturuar, që në shenjë nderimi m’i dhuroi disa libra.

I lamë lamtumirën qytetit mbi Barbanë. Pas një udhëtimi të lodhshëm, prej më shumë se dy orësh (duke kaluar nëpër urën prej hekuri në Bahçallëk që u ndërtua aty nga viti 1913, ndërsa nga fillimi i dhjetorit të vitit 1972 u ndërtua ajo që është sot), nëpër atë rrugë jo aq të mirë, arrijmë dikur vonë në Tiranë. Para hotel “Dajtit”, për një kohë të gjatë më i miri në Shqipëri, në një atmosferë madhështore na presin vëllazërisht: inxh. Agim Mero (1933), rektor dhe prof. Osman Kraja (1933), zëvendësrektor i USHT-së, Prof. Androkli Kostallari (1922-1992), drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë dhe personalitete tjera të botës shkencore dhe universitare. Zumë vend në hotel. Mua dhe shokut tim, tani të ndjerit Zijadin Munishi, na caktojnë dhomën 312.

Të nesërmen njihemi me delegatë dhe të ftuar tjerë të Kongresit të Drejtshkrimit. Fillimisht njihem me studiuesin Emil Lafe dhe mbesim miq të përjetshëm. Ai, si sekretar i Komisionit Organizues të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentacionit tim si delegat dhe përfaqësues i shqiptarëve në Malin e Zi në atë kongres. Po ashtu njihem edhe me gjuhëtarin Gjovalin Shkurtaj, mikun tim të madh, i cili, të premten, më 27 dhe të diel, më 29 qershor 1980, bashkë me Menella Totonin dhe Shaqir Beranin ishin mysafirë në shtëpinë time dhe incizuan materiale dialektologjike nga nëna Emine Doda, tani e ndjerë. Ajo vdiq më 11 mars 2012, ditë e diel, në moshën 103-vjeçare, në prag të këtyre dy jubileve: 100-vjetorit të Pavarësisë së Shtetit Shqiptar dhe 40-vjetorit të këtij Kongresi të Drejtshkrimit, duke zënë vend të rëndësishëm në Atlasin Dialektologjik Shqiptar, si informuese, nr. 15, Vëllimi I, 2007, f. 25.

Kongresi, që u mbajt në sallën e Kuvendit Popullor të Shqipërisë, filloi të hënën, më 20 nëntor 1972. Si delegat më caktuan karrigen numër 40, përbri gjuhëtarit të njohur Kolë Ashta.

Të martën, më 21 nëntor 1972, paradite, në Seksionin A, ku u trajtuan vërejtje të përgjithshme rreth drejtshkrimit dhe çështje të zbatimit të tij, lexova kumtesën “Mbi përdorimin e gjuhës letrare shqipe dhe ca vërejtje rreth Projektit të drejtshkrimit të shqipes” (kumtesa është botuar në vëllimin e dytë të akteve të Kongresit, f. 585-591). Gjatë pushimit më shprehu urime personalisht profesor Eqrem Çabej. Po ashtu më uroi edhe studiuesi Kolë Luka dhe shtoi: “Jam pinçanjuer”. Pra, me prejardhje nga fshati Pinç i Krajës. Një pjesë e kumtesës u transmetua edhe në Televizionin Shqiptar në orën 22:00 të mbrëmjes. Të nesërmen, lidhur me këtë shkruan:

1. Zëri i Popullit, Viti i 31-të i botimit, Nr. 280 (7572), E mërkurë, f. 1;
2. “Bashkimi”, Viti i 30-të i botimit, Nr. 280 (8682), f. 1;
3. “Rilindja”, Prishtinë, e enjte, 23. XI. 1972, f. 8;
4. “Mësuesi”, Tiranë etj.

Përmendem edhe tek vëllimi i parë i akteve të Kongresit, f. 11, 19 dhe 28 (nr. rendor 40 si delegat).

Nga Mali i Zi, në Kongres, mori pjesë si mysafire Medete Brisku (1934-1999), arsimtare nga Ulqini, e lindur në Manastir (Maqedoni). Kongresin e përshëndetën me telegrame edhe pedagogët e gjuhës shqipe: Bajram Rexha (1933-2000) nga Ulqini, si dhe Gjergj Hasanaj (1933-1978) nga Trieshi.

Të shtunën, më 25 nëntor 1972, u miratua dhe u nënshkrua Rezoluta e Kongresit. Në vëllimin e parë dukem në fotografi: pas f. 49, në rreshtin e dytë, në këmbë, në anën e djathtë të prof. Çabejt, pas shkrimtarit Shefqet Musaraj dhe docent Anastas Dodit: “Delegatët e Kongresit të gjuhës shqipe”; duke firmosur tek numri rendor 40 dhe pas f. 208: duke diskutuar. Mbajta një fjalim përshëndetës (f. 201-202). Një pjesë e tij u botua edhe nga “Zëri i popullit”, Viti i 31-të i botimit, Nr. 283 (7575), Tiranë, e shtunë, 25 nëntor 1972, f. 3. Atëherë, ndër të tjera, theksova se duhet të hartohen fjalorë. Këtë e përsërita edhe në kumtesën që lexova në Konferencën e Tiranës para dhjetë vjetësh (2002, f. 345). E përsëris edhe sot (2012), meqë ka ngelur puna në këtë rrafsh.

Në vëllimin e dytë të Kongresit të Drejtshkrimit, dukem në fotografi: pas f. 79: “Pamje nga salla e Kongresit”, rreshti i dytë, ndenjur, në mes. Në vijim, në atë pozicion: “Delegatë të Kongresit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”. Pas f. 527: “Nga vizita e pjesëmarrësve në Muzeun Arkeologjik”, rreshti i dytë, në këmbë, i dyti pas Prof. Josif Ferrarit, me syze e mjekër të bardhë.

Gjatë kohës që zhvillohej kongresi, na u krijuan kushte shumë të përshtatshme pune. U njohëm me Tiranën, por na përcolli kohë me shi. Vizitua Krujën dhe ndonjë qytet tjetër.

Ndërkohë, përveç Prof. Çabejt, u njoha edhe me studiuesit: Zihni Sako, Qemal Haxhihasani, Rrok Zojzi, Mahir Domi, Aleks Buda, me të cilët u konsultova lidhur me folklorin, etnografinë, gjuhësinë, historinë, letërsinë. Zura mjaft miq e shokë. Me shumicën nga ata mbaj lidhje. Por, për fat të keq, një numër i madh ka ndërruar jetë dhe më mungon. Mirëpo në zemër e mendje i mbaj. Kjo mbresë që po paraqes, le të shërbejë si një kujtim i përjetshëm për ta.

Ky Kongres zulmëmadh u zhvillua në kohën kur në ish-Jugosllavi ndiqeshin vazhdimisht intelektualët shqiptarë dhe synohej që edhe si komb të na ndajnë. Për sllavët, ne atje, ishim *Šiptari*, kurse ju këtu në Shtetin Shqiptar – *Albanci*. Fatkeqësisht pak dinim për njëri-tjetrin. Në shtetin amë ndërlikoheshin madje edhe Ulqini me Tetovën. Megjithatë, në ato rrethana, atëherë, bëmë bashkimin kombëtar në segmentin kryesor – atë gjuhësor.

U ktheva në Krajë me përshtypjet më të mira nga Shqipëria dhe Kongresi Gjuhësor Gjithëkombëtar. Mirash Gojçaj (1933-1976), reporter i redaksisë në gjuhën shqipe, në Radion e Malit të Zi, më 13.XII.1972, në shtëpinë time bëri një intervistë me mua, për Rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit, e cila u transmetua më 19.XII.1972, në orën 18:00. Rezoluta u vu në përdorim për qëllime praktike në shkolla, në radio, në administratë, madje edhe në jetën e përditshme. Prandaj Prof. Androkli Kostallari, në letrën e 28 shkurtit 1973 më shkruan: “Përpykjet tuaja për t’ju bërë të njohura kolegëve tuaj rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit dhe vendimet e tij janë një kënaqësi për ne. Kontributin tuaj dhe të kolegëve në lëmin e shkencave albanologjike ne e vlerësojmë si përpjekje për të zbuluar vlerat e mëdha kulturore të krijuara gjatë shekujve nga populli ynë dhe për t’i bërë ato pasuri të përhershme të tij”.

Më 26 maj 1973, në mbledhjen e gjerë të Këshillit të arsimtarëve të shkollës fillore “Gjergj Kastrioti - Skënderbeu” në Ostros, si drejtor, ligjërova lidhur me zbatimin e Gjuhës Letrare Shqipe dhe rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe.

Për pjesëmarrjen time në Kongresin e sipërpërmendur, si dhe për të gjitha këto përpjekje të garantuara me ligj, shteti jugosllav u hakmor, pa i bërë asnjë faj.

Në janar të vitit 1973 m'u ndalua dalja jashtë tij, meqë ma morën pasaportën nr. CA 147612, edhe pse e kisha bashkë me bashkëshorten. Ma kthyen në shtator të vitit 1977, kur s'isha më drejtor.

Në këtë vazhdë, kjo polici ma rrethoi shtëpinë gjatë ceremonisë së dasmës së vëllait: të enjten, më 9 dhe të premten më 10 gusht 1973, kur, papritmas, më vdiq vajza njëvjeçare (të premten, më 12 gusht).

Rastet e tilla të çelikosin. Durimi është ilaçi më i madh që të shëron. Ndaj, duke i kujtuar me gëzim ditët e punës gjatë Kongresit të Drejtshkrimit, shpreh dëshirën që të ruhet korniza e tij dhe të plotësohet me prurje nga të folmet e krahinave. Të ribotohet Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe, me plotësime dhe përmirësime. Të lirohet teksti nga mbingarkesa me ato shprehje ideologjike që u ka tejkaluar koha. Të mënjanohen lëshimet dhe përsëritjet e panevojshme, që u kanë shpëtuar autorëve të komisionit me rastin e botimit.

PËRSHËNDETJE E REKTORIT TË UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI” PROF. GJERGJI MERO, NË AKADEMINË JUBILARE PËR 100-VJETORIN E PAVARËSISË DHE 40-VJETORIN E KONGRESIT TË DREJTSHKRIMIT

I nderuar z. Andrea Mano Prefekt i Qarkut,

I nderuar z. Ardian Tana zv/ministër i MASH,

I nderuar z. Myslym Islami zv/kryetar i Akademisë së Shkencave,

Të nderuar, akademikë, profesorë, përfaqësues të institucioneve mike, nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, Institutit i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, studentë, miq dhe të ftuar,

Të nderuar pjesëmarrës!

Duke ju falënderuar për mirëseardhjen tuaj në Universitetin e Korçës dua t’ju përcjell përshëndetjet e singerta në emër të Rektoratit të Universitetit, të stafit akademik dhe të studentëve, duke ju uruar: Punime të mbara në këtë Akademi Jubilarë.

Fjalët e mia të përshëndetjes në këtë Akademi Solemne, kushtuar 100-vjetorit të Pavarësisë dhe 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit, janë shprehje e vlerësimit të stafit akademik dhe studentëve të Universitetit “Fan S. Noli”, për veprën e gjithë atyre që i dhanë gjuhës sonë të bukur e të dëlirë, pamjen e një gjuhe të përpunuar në nivelin që kërkon kultura moderne e një kombi të qytetëruar dhe i siguron asaj, rolin e komunikimit mbarëkombëtar. Kjo vepër merr nderimin më të thellë nga ana jonë dhe e brezave që vijnë, si një trashëgim historik e kulturor pa të cilin nuk mund të kuptohet qenia e kombit, përparimi i kulturës kombëtare dhe i arsimit kombëtar. Për këtë arsye Kongresi i Drejtshkrimit është quajtur me të drejtë ngjarja më e rëndësishme në historinë kulturore të kombit në shekullin XX, pas Kongresit të Manastirit.

Shkolla shqipe gjatë gjithë jetës së saj 125-vjeçare ka qenë dhe mbetet institucioni më i rëndësishëm kombëtar që e ka lidhur jetën, qenien dhe misionin e saj, me gjuhën shqipe; udha e saj ka qenë udha e shkronjave shqipe. Gjatë këtyre dyzet vjetëve nga Kongresi i Drejtshkrimit, ajo ka qenë po ashtu institucioni më i rëndësishëm kombëtar që e ka lidhur jetën, përhapjen dhe ngulitjen e normës letrare shqipe, tashmë të njësuar, në brezat e rinj që ka në dorë, bashkë me të ardhmen e vendit dhe të ardhmen e gjuhës. Arsimi shqiptar i të gjitha niveleve e ka për mision të mbrojë kulturën gjuhësore të shqiptarëve mbi bazën e zgjidhjeve shkencore që ka vënë Kongresi i Drejtshkrimit, sepse niveli gjuhësor i një shoqërie është tregues edhe i nivelit të saj kulturor dhe i qytetërimit të saj.

Duke përshëndetur këtë akademi solmne ju uroj punë të mbarë, juve dhe të gjithë punonjësve të shkencës dhe arsimit, prej të cilëve varet formimi i brezave të rinj me kulturën gjuhësore që kërkon zhvillimi shoqëror në Shqipëri dhe zhvillimi mendor i shqiptarëve kudo që jetojnë.

Kam kënaqësinë, që në emër të Senatit Akademik të Universitetit të Korçës, të nderoj me një certifikatë mirënjohjeje dhe një dhuratë simbolike delegatët e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, që janë të pranishëm në këtë Akademi Jubilarë:

1. Akdamik Jani Thomai
2. Prof. dr. Emil Lafe
3. Ismail Doda, nga Mali i Zi

4. Isa Bajçinca, nga Prishtina
5. Akad. Jorgo Buló
6. Nikoleta Cikuli
7. Prof. dr. Xhevat Lloshi

Edhe një herë ju falënderoj që jemi sot së bashku në Universitetin e Korçës, falenderoj të gjithë miqtë e të ftuarit që na nderojnë sot, autoritetet vendore, por në mënyrë të veçantë drejtuesit e institucioneve bashkorganizatore të kësaj Akademie Solemne, të Institutit Albanologjik të Prishtinës, të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, të Tiranës dhe komisionin organizator, për punën e palodhur dhe cilësore që kanë bërë, duke ju siguruar se punimet e kësaj Akademie Solemne do tu shërbejnë mjaft në punën e tyre studiuesve të saj, pedagogëve e studentëve tanë, sepse shkolla shqipe e ka për detyrë të përcjellë fjalën shqipe të pastër e të përpunuar, ta zhvillojë shqipen si gjuhë të dijes, të shkencës e të kulturës, në të gjitha rrafshet dhe përmes të gjitha disiplinave mësimore.

Edhe një herë ju faleminderit të gjithëve dhe i uroj punime të mbara kësaj Akademie Jubilare.

XHEVAT LLOSHI

ZGJIDHJE QË I QËNDRUAN KOHËS NË SHËRBIM TË KOMBIT

Gjuha është një dukuri shoqërore, por ka një rrjedhë të mirëfilltë natyrore. Këto dy anë dalin ballas kundrejt njëra-tjetrës kur gjuha nis të shkruhet. Me mundime të gjata dega kryesore e rrjedhës së gjallë i nënshtrohet një drejtimi, në të cilin pastaj lëvrohet, zgjerohet, pasurohet, lëmohet dhe shndërrohet në mjetin e përsosur për mishërimin e kulturës së shkruar dhe në përbërësin e pazëvendësueshëm të identitetit kombëtar. Këtë rrugë e ka përshkuar edhe shqipja jonë, prandaj nuk do të ishte përjashtim, që do të vinte dita kur edhe ajo do të fitonte trajtën, të cilën shkurt tashmë e quajmë gjuha standarde. Kjo ka ndodhur si një ecuri e gjatë historike, por ka edhe një cak, nga i cili e quajmë se ka, si të thuash, datëlindjen. Ky cak u takon dyzet vjetëve më parë dhe do të mbetet në histori si Kongresi i Drejtshkrimit.

Ndonëse në studimet tona nuk i është kushtuar aq vëmendje shtjellimit konkret të përpunimit dhe përdorimit të gjuhës në fushat shtetërore e publike, por më shumë pikëpamjeve të autorëve jo të paktë, që janë marrë me këtë fushë. Sot, në këtë përvjetor, kemi mundësinë të japim gjykime të mbështetura mbi përvojën e dyzet viteve të fundit.

Rilindja Kombëtare çështjen e gjuhës e vuri në qendër të programit të vet jo vetëm sepse ajo ishte simboli madhor i kombit, por edhe sepse vendosja e shqipes si gjuhë zyrtare ishte hapi i parë dhe shenja vendimtare e pavarësisë. Kur Lidhja Shqiptare e Prizrenit nisi luftën për një shtet shqiptar, problemi i gjuhës për këtë shtet doli që në hapat e parë të saj. Nevoja e një alfabeti të vetëm të shqipes, e cila si zgjidhje përfundimtare u arrit në Kongresin e Manastirit, nuk u shtrua me forcë në fund të shek. XIX vetëm për shkak të shqetësimit që sillte prania e shumë alfabeteve, por në radhë të parë sepse shteti shqiptar, që tashmë po projektohej në horizont, nuk mund të konceptohej pa një alfabet të vetëm. Nuk mund të përfytyrohet një shtet, dokumentacioni i të cilit të përpilohet me alfabete të ndryshme. Me fjalë të tjera, ishte shtysa e ngutshme për një gjuhë zyrtare, që përcaktoi edhe njësimin e alfabetit.

Shqipja e shkruar e Rilindjes nuk ndoqi traditën e shkruar të shekujve të mëparshëm, për arsye të njohura të gjendjes nën një sundim të gjatë të huaj. Ajo u rinis nga shumësia dialektore e kohës dhe përmes mjaft luhatjeve e përpjekjeve individuale, arriti në vija të përgjithshme të dy variante letrare kryesore, me pikënisje toskërishten dhe gegërishten, të nënkuptuara si tërësi të mëdha. Hapin e mëtejshëm deri te *një gjuhë e shkruar kombëtare* rilindësit ia lanë së ardhmes, kur shqiptarët të kishin formuar shtetin e tyre. Thirrjet ngulmuese për ta futur shqipen në administratë, në gjyqe, në shkolla etj., tingëllojnë gjithnjë e më me forcë në shtypin shqiptar në prag të pavarësisë. Njëkohësisht vërehen sprova për t'i përpunuar konkretisht mjetet gjuhësore. Dokumentet e qeverisë së Ismail Qemalit në nëntor 1912 në Vlorë, shënojnë hyrjen në fuqi të një varianti në funksionin shtetëror. Akti i shpalljes së Pavarësisë më 28 nëntor është teksti i parë i një qeverie shqiptare.

Shqipja u vendos si gjuhë zyrtare më 23 shtator 1913. Sado jetëshkurtër që qe Qeveria e Vlorës, menjëherë pasi shpalli shqipen si gjuhë zyrtare të shtetit shqiptar, e nisi punën me krijimin e disa komisioneve për njësimin e terminologjisë ushtarake, të shërbimit postar etj. Ecuria u ndërpre dhunshëm me fillimin e Luftës së Parë Botërore. Gjatë dy viteve të fundit të kësaj lufte (dhjetor 1916 – nëntor 1918), pjesa më e madhe e territorit shqiptar ndodhej nën

pushtimi austrohungarez me qendër Shkodrën. Austro-Hungaria gjatë Konferencës së Ambasadorëve në Londër më 1913, kishte qenë fuqia e madhe e kohës, me këmbënguljen e së cilës (natyrisht, brenda interesave të saj perandorake), Shqipëria u pranua në nivel ndërkombëtar si shtet i pavarur. Është e vërtetë, që kjo ishte Shqipëria e cunuar, por pa këtë, pas Luftës I Botërore nuk do të kishte një atdhe të shqiptarëve, sepse atë do ta kishin fshirë përgjithnjë fuqitë shoviniste ballkanike. Gjithsesi, Austro-Hungaria shpresonte në fitoren e luftës, pas së cilës Shqipëria do të vijonte jetën si shtet i pavarur dhe, dëshiroj ta theksoj me forcë, se edhe në ato kushte të luftës botërore, ajo si pikë të parë për atë shtet vinte zgjidhjen e çështjes së gjuhës standarde. Tashmë e dimë fare mirë dhe nuk ka nevojë të zgjatemi, se për këtë u mbledh Komisia Letrare, e cila synonte caktimin e standardit të shkruar mbi bazën e dialektit të mesëm, të folmes së Elbasanit.

Nga këta pak rreshta, për një ecuri historike të gjatë, del e qartë se domosdoshmëria e standardit gjuhësor ishte shoqëruese si e projekteve për shtetin e pavarur shqiptar, ashtu edhe kur ai u ngrit si realitet politik. Në po ato vija, siç ishin pranuar në Shkodër, Kongresi Pedagogjik i Lushnjes (shkurt 1921) vendosi pranimin e dialektit të Elbasanit në shtypjen e teksteve shkollore. Më 1922 u dha urdhri, i cili në janar 1923 doli si vendim i kryeministrit, që të përdorej “gjuha zyrtare” në shkollë e në administratë, duke qenë një variant mbi bazë dialektore të mesme, por ecuria ka qenë e ndërlikuar dhe çështja e gjuhës zyrtare në thelb u shkri në çështjen më të gjerë të gjuhës standarde. Që prej asaj kohe kemi të trashëguar ngatërrimin terminologjik, i cili në ditët tona është e mira të mënjanohet, duke e dalluar qartë gjuhën zyrtare nga gjuha standarde, nga gjuha letrare, nga gjuha e njësuar e kështu me radhë.

Kongresin e Manastirit dhe Komisinë Letrare të Shkodrës mund t’i quajmë si institucione parashtetërore, që dhanë argumente dhe zgjidhje konkrete për vendimet e mëvonshme shtetërore. Pavarësisht nga ndërlikimet e kuptueshme, në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore, shqipja ka pasur një variant standard, që ka funksionuar si gjuhë zyrtare; për më tepër, ai funksionoi edhe në trevat e Kosovës, ku përcaktoi zhvillimet e mëpastajme pas përfundimit të Luftës II Botërore. Në atë periudhë shteti shqiptar ndoqi një politikë elastike, madje liberale kundrejt gjuhës standarde.

Gjatë pesë viteve të Luftës II u bë fakt edhe politizimi i çështjes gjuhësore. Nuk ka filluar “lufta për pushtet brenda gjuhës” pas Luftës II Botërore, por përkundrazi, gjatë asaj lufte nisi përdorimi i zgjidhjeve gjuhësore në shërbim të luftës për pushtet. Dhe kjo nuk është ndërprerë as në ditët tona, por nuk dëshiroj të zgjatem në këtë drejtim. Sidoqoftë, krahas rrjedhës natyrore dhe nevojës shtetërore e kulturore për gjuhën standarde, kështu, u shtua në këtë ndërthurje edhe faktori politik. Procesi historik, bashkë me diskutimet e viteve të fundit, nganjëherë të ashpra dhe pa asnjë bazë të mirëfilltë shkencore, megjithatë dëshmojnë bindshëm, se gjuha standarde vlerësohet si një arritje madhore e zhvillimit të shqipes, për të cilën është luftuar dhe luftohet, sepse përbën një lartësi të re, me vlera të jashtëzakonshme në jetën e kombit.

Kongresi i Manastirit përmbylli një etapë të gjatë përpjekjesh e pështjellimesh, por rëndësia e tij e posaçme ishte se hapi një etapë të re; zgjidhja e tij ishte për të ardhmen dhe i qëndroi kohës. Edhe Kongresi i Drejtshkrimit, dyzet vjet më parë përmbylli një etapë të gjatë përpjekjesh e pështjellimesh, por rëndësia e tij e posaçme është se hapi një etapë të re; zgjidhja e tij ishte për të ardhmen dhe i qëndroi kohës.

Është e natyrshme që të studiohet edhe më tej shkencërisht e paanësisht procesi që solli arritjet deri te Kongresi i Drejtshkrimit, si edhe të përmirësohen disa zgjidhje, siç e ka parshikuar Rezoluta e Kongresit. Kurse në rastin e sotëm jubilar, mjaftojnë pak fjalë për të treguar se në vitet e para pas Luftës II për zgjidhjen e çështjes gjuhësore nuk u ndërmor ndonjë veprim vendimtar. Institutit të Shkencave iu vu detyrë të punonte në atë drejtim. Rregullat drejtshkrimore (1948, 1951) dhe *Fjalori i gjuhës shqipe* (1954) të punuara nga Instituti i Shkencave, merrnin parasysh të dyja variantet letrare, ndërsa prof. K. Cipo si për gramatikën shkencore, ashtu dhe për gramatikën shkollore (të dyja më 1949) zgjodhi toskërishten letrare, duke e argumentuar këtë me arsye gjuhësore e kulturore-historike.

Me dy sesionet shkencore të Institutit të Shkencave të vitit 1952, zuri fill një politikë gjuhësore e importuar nga gjuhësia sovjetike, ndërsa më tej, gjuhësia jonë u orientua më fort drejt studimeve në kuadrin e institucioneve, sesa në caktimin e menjëhershëm të një norme letrare të njësuar nëpërmjet ndonjë forumi shkencor. Lëvrimi i të dy varianteve në letërsinë artistike, në botimet shkencore, pjesërisht në përkthime e në publicistikë vijoi si më parë. Kësaj gjendjeje i përgjigjen edhe rregullat drejtshkrimore të vitit 1956, të cilat përmbajnë në rastet e nevojshme, edhe udhëzime për format e gegërishtes.

Dy momentet vendimtare për të shkuar te Kongresi i Drejtshkrimit ishin hartimi i projektit të ri të drejtshkrimit më 1967, me prirjen drejt *një forme* gjuhësore dhe Konsulta Gjuhësore e Prishtinës (prill 1968), e udhëhequr nga kryefjala “*Një komb – një gjuhë letrare kombëtare*”. Ishin këto dy platforma, për kodifikimin e statusit të një varianti gjuhësor, që shërbyen si mbështetje institucionale në politikën e planifikimit gjuhësor. Kongresi i Drejtshkrimit ishte sanksionimi i tyre, pas një diskutimi të gjerë, duke mundur marrjen e vendimeve shtetërore përkatëse.

Pas dyzet vjetësh ne shohim se gjuha standarde është një realitet funksional. Megjithatë, bashkë me përmbyjsjen e regjimit monist njëzet vjet më parë, u shfaqën edhe përpjekjet për një përmbyjsje gjuhësore, e cila si hapin e parë do të godiste Kongresin e Drejtshkrimit. U përvijua një grup i kufizuar militantësh aktivë në fushën e planifikimit gjuhësor, të cilët kanë bërë dhe bëjnë çmos që të shtien në duar monopolin ligjor si të vetmit standardizues. Nga sa ceka shkurt më lart, kjo do të thotë se ka përpjekje për t’u kthyer në gjendjen kur nuk kishte asnjë standard, nga tetëdhjetë vjet prapa. Pa u hyrë komenteve të hollësishme, e theksoj se kjo do të thotë të goditet vetë shteti shqiptar, t’i vihen atij pengesa në rrugën e përparimit, pa përmendur atë që e kam thënë shpesh, se kjo çon deri te përçarja kombëtare e modelit të sllavëve të jugut pranë nesh. Ai model përbën një provë historike, se lakmia për standarde të ndryshme të gjuhës, është lajmëtare e sajimit të identiteteve të ndryshme kombëtare, drejt shpëputjes së mëpastajme si shtete të veçanta.

Kombi shqiptar e ka sot një gjuhë standarde dhe e ka tejet të nevojshme, në rrethanat kur është i shpërndarë në disa shtete. Kombi shqiptar e ka të domosdoshme një gjuhë zyrtare për shtetin shqiptar. Kombi shqiptar po i plotëson gjithë kërkesat e veta publike me gjuhën standarde. Kombi shqiptar paraqitet në marrëdhëniet me shtetet e tjera, duke përdorur një gjuhë standarde.

Të gjitha këto janë rrjedhim i drejtpërdrejtë i vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimit. Ai e ngriti shqipen në lartësinë e këtyre detyrave. Në rrethanat kur në Ballkan tashmë janë dy shtete shqiptarësh, ka shpresa të plota, pavarësisht nga përpjekjet për hir të interesave të disa grupeve të caktuara, se në ecurinë e mëtejshme do të ndodhë afrimi jo vetëm sepse jemi

historikisht i njëjti komb dhe sepse orientimi ynë i sotëm është i njëjtë ndaj Europës së Bashkuar, por edhe sepse kjo u shërben interesave mbarëkombëtare. Zgjidhja është duke ndjekur një strategji kombëtare në kushtet e dy shteteve shqiptare dhe këtë domsdoshmërisht, e shoqëron jo zbatimi i thjeshtë në trevat shqiptare, por edhe lëvrimi e pasurimi i përbashkët i mëtejshëm i gjuhës standarde.

Proceset e sotme janë bërë më të ndërlikuara, për shkak se afrimi me legjislacionin europian, duke e quajtur hyrjen në BE dhe në NATO zhvillimin më madhor në jetën e shtetit shqiptar, ka lindur probleme krejt të reja. Gjithashtu ndikojnë edhe zhvillimet e sotme të teknologjisë elektronike dhe varësia gjithnjë më e madhe nga komunikimi elektronik ndërkombëtar. Anglishtja ushtron trysni të madhe edhe si gjuhë e globalizimit.

Ndërkaq, vërej me kënaqësi se nga ana e shtetit nuk ka pasur ndërhyrje të drejtpërdrejta dhe, në mënyrë pak të papritur, gjendja mund të krahasohet me politikën ndërmjet dy luftërave botërore. Kohët e fundit madje kemi një fakt pozitiv, që nxënësit në të dy anët e kufirit politik ndërmjet shqiptarëve, do të mësojnë me të njëjtën abetare. Megjithatë, heshtja institucionale deri më tash, për të përkujtuar qoftë vetëm simbolikisht 40-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit, është një tregues jo pozitiv për konsekuencën e politikës shtetërore në këtë lëmë.

Shqipja e ka të ardhmen përpara, sepse dyzet vjet të shkuara u ngrit në lartësinë për të ardhmen. Kombi shqiptar nuk ka nevojë për abetare të ndryshme, për drejtshkrime të ndryshme, për gramatika dhe fjalorë me baza dialektore të ndryshme. Kombi shqiptar nuk ka nevojë për fjalorë dygjuhësh shqip-shqip, ose po ta shpreh ndryshe, nuk ka nevojë të përgatisë përkthyes ndërmjet dy gjuhësh si të huaja nga shqipja në gjuhën shqipe, sipas shembullit nga kroatishtja në serbishte dhe anasjelltas. Shteti shqiptar nuk ka nevojë ta paraqesë Kushtetutën e tij në dy standarde të ndryshme. Në sallat dhe në zyrat e Bashkimit Europian do të përbënte shfaqjen e hapur të frymës antieuropiane prania e dy përkthyesve për dy standarde të shqipes dhe kërkesa që dokumentet përkatëse për shqipen të ishin dypalëshe. Në mjedisin e veçantë të shqiptarëve në Maqedoni, shpallja e standardit si të deklasuar dhe kallja e një standardi tjetër, do ta minonte Marrëveshjen e Ohrit, sepse do të ndillte pyetjen ogurzezë: *Për cilën gjuhë tuajën keni pretendime? Sheshoni një herë grindjet tuaja, pastaj kërkon marrëveshje me të tjerët.*

Kongresi i Drejtshkrimit u dha përgjigjen e qëndrueshme shkencore dhe të çmueshme kombëtare gjithë skenarëve, që do të ishin rrjedhojë e zhvillimeve të panevojshme, të cilat i përmenda në paragrafin e mësipërm.

Kundërshtarëve të Kongresit të Drejtshkrimit u ngarkoj pikërisht barrën, se përgatisin një skenar ogurzi, duke arritur deri aty, sa të botojnë gazeta për të deklasuar standardin, i fajësoj se duan dy standarde të ndryshme: për Tiranën dhe për Prishtinën. Nuk kam asnjë dyshim se këta dyzet vjet e kanë provuar që tashmë kanë dështuar dhe vetëm dështimi i pret në të ardhmen. Por përndryshe qëndrimi i tyre do të çonte edhe në një përleshje, se nga cila anë do të shkonin shqiptarët e Maqedonisë. Dhe me aq sa jam në dijeni, ka pasur përpjekje të nëndheshme për ta hapur rrugën e këtij skenari.

Përvjetori i dyzetë i Kongresit të Drejtshkrimit, dëshmon se zgjidhjet e miratuara prej tij në tërësi i kanë qëndruar kohës. Tashti po bëhet pothuaj gjysma e periudhës së shtetit të pavarur shqiptar, gjatë së cilës ai ka në përdorim një gjuhë standarde dhe jo thjesht një gjuhë zyrtare. Por nuk dëshiroj, që në këtë përvjetor të përdoren tone ngadhënjimtare. Kjo është

historia jonë, si gjithmonë e ndërlikuar, me kundërshti e probleme, të cilat, për mendimin tim, janë pjesë përbërëse e procesit, madje edhe ato kanë pjesën e tyre në mbarëvajtjen e përparimit të tij.

Më lejoni të përmend një të dhënë nga studimi i gjuhëve të tjera. Gjuha standarde përcakton edhe standardizimin shtetëror. Del se dokumentet standarde kursejnë deri në 70% të kohës dhe perceptimi i tyre është nëntë herë më i shpejtë sesa i teksteve jostandarde. Anasjalltas, deklasimi i standardit dhe përpunimi i diçkaje mbi një bazë tjetër do të kërkonte shpenzime të jashtëzakonshme kohe dhe mjetesh financiare për një popull jo të madh siç jemi ne. Në epokën e globalizimit elektronik destandardizimi do të thotë vështirësim i komunikimit, kundërshtim i përparimit teknologjik, obskurantizëm, rënie nga lartësia e arritur historikisht, mesjetë. Zërat mesjetarë do të mbeten të shkretë në hapësirën gjithëshqiptare.

Rregullat e drejtshkrimit dëshiroj t'i quaj si një farë kushtetute të shqipes standarde. Është provuar se ndryshimet e shpeshta të kushtetutave sjellin pështjellime në jetën shtetërore e politike. Ndërsa shembulli i Kushtetutës së SHBA-ve, vërteton se qëndrueshmëria është një e mirë e paçmueshme për jetën e vendit. Për analogji, drejtshkrimi i shqipes ka nevojë vetëm për amendamente të shtrira në kohë dhe për asnjë lloj kongresi tjetër. Le t'i kremtojmë dhjetëvjeçarët e ardhshëm të Kongresit të Drejtshkrimit.

Shqipja e standardizuar e ka të ardhmen përpara në një rrugë pasurimi, lëvrimi e përsosjeje. Tradita tashmë dyzetvjeçare e bën atë solide dhe e ndihmon që të mos perceptohet si diçka e vjetëruar, përkundrazi, të përvetësohet si mjet i shkëlqyer i përbashkësisë kombëtare, i identitetit dhe i kulturës së shqiptarëve në kohët e reja.

KONGRESI I DREJTSHKRIMIT - NGJARJA MË E RËNDËSISHME GJUHËSORE E SIMBOLIKE E SHEKULLIT XX

1. “Nga pikëpamja gjuhësore dhe simbolike, dy ngjarjet më të rëndësishme për standardizimin e gjuhës shqipe në shekullin e njëzetë kanë qenë Kongresi i Manastirit në vitin 1908 dhe Kongresi i Drejtshkrimit në vitin 1972. Që të dyja ishin ngjarje me efekte edhe jashtë Ballkanit” – shprehet albanologu dhe ballkanologu i shquar amerikan Viktor Fridman (*Shqipja standarde në Amerikë: Studime shkencore, pedagogjike dhe planifikimi gjuhësor*, te Konferenca shkencore “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, Tiranë, 11-12 nëntor, 2002, ASHSH, Tiranë, 2003, 155). Ndërsa Kongresi i Alfabetit i unifikoi shqiptarët në grafi të njëjtë, Kongresi i Drejtshkrimit i unifikoi shqiptarët të komunikojnë me një formë gjuhësore të përbashkët kombëtare. Në këtë vështrim, “*Historia e kulturës sonë në tërësi, jo vetëm e asaj shkrimore, nuk ka asnjë vepër që mund të krahasohet me Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe*” (Shpëtim Çuça).

Kongresi i Drejtshkrimit, 40 vjet më parë, u dha mundësi studiuesve të gjuhësisë, të përfundojnë përpjekjet për unifikimin e gjuhës shqipe dhe Kongresi vetëm sa e përshëndeti këtë, - shprehej një dashamir i shqipes në një blog të internetit. Ndërkaq, koha e sotme u ka dhënë “liri” gjithkujt që nuk merret me gjuhën, që të gdhendë pa mëshirë, mbi atë që është ndërtuar me shumë mund e sakrifica.

Me gjithë arritjet e pakontestueshme, gjuha shqipe sot, në vigjiljen e 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, ndodhet përpara dy sfidave të mëdha: së pari, përpara sfidave për ta ruajtur këtë vlerë të madhe nacionale dhe së dyti, përpara shkatërrimit të kësaj gjuhe, të cilin ia shkaktojnë vetë shqipfolësit, me gërryerjen e normave gjuhësore standarde, me përdorimin e kësaj gjuhe me fjalor të varfër e me gramatikë dhe sintaksë të zbërdhulët. Animozitetet, tundimet, bastardimet, huazimet, hibridizimet, mëtimet për rikthimin e standardit në dialekte, përbëjnë korpusin e problematikave me të cilat përballet gjuha shqipe sot.

Me shqipen, në cilësinë e studiuesit, sot merren të gjithë, marrin e japin se si duhet të jetë standardi, paçka se nuk kanë as njohuritë më minimale mbi mekanizmin e quajtur *gjuhë letrare*. E folura shtëpiake ka pushtuar ambientet publike dhe pothuajse është bërë normë gjuhësore e ligjëritimit.

Pasojat e standardit të rrezikuar më shumë janë duke u parë në jetën publike, si në të folur ashtu edhe në të shkruar. Sot është vështirë të kesh në dorë një dokument zyrtar të institucioneve shtetërore pa gabime drejtshkrimore. Dokumentet e lëshuara nga gjykatat shpesh kanë më shumë gabime sesa fjalë, për të mos folur për strukturën e fjalisë. Ndërsa, mjerimi retorik i politikanëve ka bërë shpesh, që edhe debati demokratik të mos na duket shumë tërheqës (Hasan Salii).

Parimi themeltar i gjuhësisë është që gjuha vete kurdoherë duke ndërruar (Faik Konica), apo “gjuha shkon gjithmonë *“tue ba ndryshime”* – siç thoshte gramatikani i shquar Justin Rrota. Pra, si të thuash “*Gjuha ndryshon, por nuk ndryshohet*” (Helena Grillo), që do të thotë se gjuha ka zhvillimin e saj të natyrshëm. Ndryshon me evolucion, por atë nuk mund ta ndryshojë askush me revolucion, me përdhunë.

2. Denotimet dhe konotimet gjuhë standarde - dialekt

Format shprehëse të gjuhës: *standardi letrar* e *dialektet*, kanë një marrëdhënie të ngushtë ndërmjet tyre, ngaqë standardi mbështetet mbi dialektet, por kanë dhe denotimet e konotimet specifike. Nocioni civilizues *gjuhë standarde* denoton diferencimin funksional, kurse konoton përdorimin e përgjithshëm në shoqëritë moderne dhe varietetin e prestigjit; termi *dialekt*, që tradicionalisht i takon rrafshit horizontal, d.m.th. e folura karakteristike e një rajoni ose lokaliteti, është i ngarkuar me konotacione negative të ambientit rural, të prapambetjes – dhe këssoj në mënyrë eksplicite ose implicite kontraston me varietetet standarde ose letrare që janë me prestigj të lartë (Ranko Bugarski, *Evropa u jeziku*, Beograd, 2009, 92).

Në marrëdhënien *gjuhë standarde – dialekt*, identiteti gjuhësor krijon dhe identitetin shoqëror, tribal, kombëtar, etj. Prandaj duhet të kihet parasysh gjithmonë ky fakt relevant: t'i jepet standardit atë që i takon standardit dhe t'i jepet dialektit atë që i takon dialektit, e jo të bëhen këto kaçamak e kryelënë, të përshfaqim identitetet tona tribale a krahinore edhe aty ku nuk do të duhej.

“Ne të gjithë kemi një identitet tonin tribal, e secili është ndoshta po aq krenar për këtë identitet, e për rrjedhojë secili mund ta theksojë e demonstrojë si e sa të dojë këtë identitet. Asnjë e keqe nuk na vjen prej kësaj; përkundrazi. E keqja na vjen prej sublimimit të këtij identiteti në kurriz të një identiteti më të madh, atij nacional, të cilin kemi rënë dakord ta mbrojmë e ta zhvillojmë, pasi e shohim si një mënyrë për t'u bërë më të mbrothët e më të mbrojtur në botën ku jetojmë. Dhe e përsëris e saktësoj, që e keqja nuk është theksimi e manifestimi i identitetit lokal; e keqja është sublimimi i tij në një kontekst nacional dhe një nga mënyrat për ta sublimuar është dhe qëndrimi përçmues që mbahet ndaj gjuhës zyrtare, standardit, në majë të institucioneve nacionale”, – shprehet publicisti i shquar Mustafa Nano, - duke iu referuar normëshkelësve që janë madje në krye të institucioneve.

Si i bëhet me ata që, edhe pse janë zgjedhur në krye të institucioneve kombëtare, nuk e flasin dot standardin? Në këtë rast nuk ke se çfarë të bësh. Duket pak e pamundur, në fakt, që dikush që ka një marrëdhënie gati zero me standardin, të ngjitet deri lart në maja institucionesh, pasi standardi, duam apo s'duam, përbën një stekë që duhet kaluar prej të gjithë atyre që duan të marrin grada në hierarkinë shtetërore e kombëtare. Secili prej nesh ka mbeturina të të folmeve të vjetra, të cilat i demonstrojmë gjatë ditës në të gjitha rrethanat e mundshme. Gramoz Ruçi e Dashamir Shehi kanë gjithashtu, paranteza dialektore në ligjërimin e tyre publik. Por te të dy këta, ashtu si tek gjithë të tjerët, vihet re një kokëçarje minimale për të respektuar një simbolikë shtetërore dhe kombëtare në daçi, siç është gjuha standarde zyrtare. Kur nuk ia dalin ta bëjnë këtë gjë, nuk kemi ndonjë hatá. Në fund të fundit edhe Topalli nuk ka tronditur ndokënd me të folmen e vet nga tribuna e Kuvendit (duke përjashtuar ndonjë të sëmure nga trutë), por ajo të shock-on në momentin që deklaroi se “e bëj qëllimisht e me vetëdije të plotë këtë gjë”. Kjo do të thotë se ajo mbi të gjitha vë identitetin e vet tribal, e prandaj nuk e meriton atë post nacional që mban (Mustafa Nano).

3. Mendësia jonë gjuhësore tribale e pakundshoqe në botë

Në vendet me qytetërim të konsoliduar, qytetarë dhe zyrtarë nuk mund të sillen në këtë mënyrë banale me gjuhën: standardin zyrtar domosdoshmërisht do ta përdorin aty ku e

ka vendin, në institucionet publike e shtetërore, kurse mund t'ia dredhin në dialekt në mjedise private, familjare, miqësore e rurale. Albanologu gjerman Hermann Ölberg sjell si shembull rastin e austriakëve e të bavarezëve që flasin në shtëpi bavarishten, por në veprimtarinë shoqërore e shtetërore përdorin gjermanishten e lartë (standarde), pa kërkuar që "të bavarizojnë" ndonjë pjesë të sistemit të saj. Në kulturat e mëdha perëndimore, shtetari Zhak Shirak, përmes mbrojtjes së gjuhës, fitonte epitelin e liderit, që mbron interesat e kombit; ai aq shumë e mbronte gjuhën frënge, pa pyetur se mbi ç'bazë dialektore është formuar ajo, saqë asnjëherë, me një përjashtim të një interviste në BBC në vitin 1998, nuk ka pranuar të fliste publikisht anglisht, edhe pse thoshte se e fliste rrjedhshëm dhe një pjesë të studimeve i kishte bërë në Amerikë (Augustin Paloka, *Shikim nga Brukseli: Agim Çeku më i moderuar se Jacques Chiracu!*, Koha Ditore, 27. 3. 2006). Kurse ne, edhe në elementin gjuhë, dallojmë nga Evropa e nga evropianët si delja e zezë, sepse jemi shumë larg nga të qenit evropian kulturalisht e gjuhësisht, sado që gjithë ditën shtiremi e gajasemi se jemi të orientuar nga Perëndimi evropianisht, ne vazhdojmë sillemi lindorsisht, të rendim pas dialektit tonë krahinor e pas pseudofilologëve akademikë, që kanë marrë sot në dorë flamurin e krahinorizmit gjuhësor pandan shqipes standarde a zyrtare! Dhe të fërkojmë duart: kur do të bëhet kongresi i ri i drejtshkrimit, të krijojmë standarde të reja të shqipes, shqipen neostandarde e marrëzira të ngjashme ordinere. Jemi të pakundshoq e veç dynjasë, siç thotë populli, sepse në mendësinë tonë gjuhësore po profilizohen rryma që nuk i gjen tek asnjë popull dhe tek asnjë gjuhë e botës, si: “*e majta gjuhësore*” dhe “*e djathta gjuhësore*”! “*enverizmi gjuhësor*” etj. (M. Kraja, *Enverizmi gjuhësor dhe të tjera marrëzi*, Shekulli Online, 15 korrik 2012).

Gjuha është sendi më i çmueshëm i një populli dhe për popullin shqiptar është i vetmi thesar!

Në kuptimin e asaj se gjuha u takon të gjithëve, një dallim tjetër që na karakterizon është dhe kjo, se tek ne, me gjuhën merren më shumë diletantët, pseudofilologët, njerëz jo të zanatit, të cilët nuk kanë asnjë vepër për të qenë. Kundër pseudofilologëve që kishin ngritur krye këtu e afro një shekull më parë, gjuhëtari i madh prof. Eqrem Çabej shprehej me zemëratë: *Sot secili në Evropën e qytetëruar, para se të merret me shkrime filologjike, i shkon mjaft vjet në bankat e universitetit, atje ku gjuha studiohet e analizohet me exaktitudë matematike, duke qenë se filologjia është një nga dituritë më të shtrëngueshme (severe) e më exakte që mund të jetë në botë...! Kurrkush nuk ka të drejtë të shkruajë mbi gjuhë pa u pat marrë vjet me radhë me studimin e vërtetë të saj! Kurrkush! Se gjuha është sendi më i çmueshëm i një populli, dhe për popullin shqiptar është i vetmi thesar!...Kush do të shkruajë mbi shqipen, më parë duhej të jetë marrë me studimin e gjuhëve indoevropiane përgjithësisht, e pastaj duhet të ketë studiuar gjithë shkrimtarët shqiptarë e gjithë albanologët e huaj, numri i të cilëve është aq i madh, sa studimi i tyre lyp vjet me radhë pune të pareshtur...* (Eqrem Çabej, Kundër pseudofilologëve, Graz, 1929, botuar në Bota shqiptare, 2008). Ky do të duhej të ishte një mësim i mirë edhe për këta pseudofilologët tanë të sotëm, t'i rreken mirëfilli filologjisë, e të lënë anësh verbëritë krahinoriste.

Edhe një albanist i klasit dhe personalitet shumë i veçantë, me erudicion të pashoq, prof. Selman Riza, ishte një armik i përbetuar i diletantizmit, i gjysmëdijes që promovohet si dije, - i kësaj sëmundjeje foshnjore nga e cila shqiptarët nuk janë shëruar mjerisht as sot e kësaj dite. Për këtë ai qysh në vitin 1938 botoi te revista e famshme “*Përpjekja shqiptare*”

artikullin programatik e me peshë “*Dilletantismi dhe zanati*”, për një dukuri të tillë, kur gjithkush pretendonte se mund të merrej me punë gjuhësie pa e mësuar e pjekur mirë më parë këtë zanat. *Dilletantismen e gjejmë pa fjalë në çdo vend të botës së qytetëruar edhe në çdo lëmë të diturive e të mjeshtërive. Mirëpo mua s’më besohet që dilletantismi të lulëzojë gjëkund gjatë si ç’lulëzon përgjithësisht në Shqipëri edhe në albanologji posaçërisht. Kur merr e vështron edhe sot se kush merret e si merret me gjuhën, ky gjykim lapidar i Rizës vjen sikur ta kishte thënë sot. Thënia e intelektualit dhe shkrimtarit të madh gjerman Gëte: *Secili që flet, kujton se mund të flasë edhe mbi gjuhën*”, gjen shprehjen e vet sidomos tek ne shqiptarët edhe sot e kësaj dite.*

Hebrenjtë sillen ndaj Izraelit vetëm si hebrenj, jo si ithtarë të ndonjë partie politike (Ilija Milçin, Jazikot na mediumite, Skopje, 2001, 53). Ky duhet të jetë mësim edhe për të tjerët: të sillemi dhe ne shqiptarët ndaj vendit, kombit tonë dhe gjuhës standarde shqipe vetëm si shqiptarë, jo si “e majtë gjuhësore” e si “e djathtë gjuhësore”, si “enveristë” e si “antienveristë”, si “gegë” e si “toskë”, si “të jugut” e si “të veriut”, si “shqiptarë” e si “kosovarë”, sepse gjuha shqipe është një dhe e përbashkët dhe shumë e vogël që të mërgohet e të katandiset në kaq shumë ndarje e nënndarje.

Kjo kohë të kujton ato vargjet e pavdekshme të poetit vlonjat Ali Asllani: “*Koha është e maskarenjve/ Po Atdheu është i shqiptarëve!*” Edhe kjo kohë është e pseudofilologëve, që kujtojnë se kanë fatet e gjuhës shqipe në dorë dhe mund të bëjnë ç’të duan me të/ *Por shqipja standarde është e shqiptarëve. Problemi i standardit të shqipes është zgjidhur njëherë e mirë, njëjtë sikurse e kanë zgjidhur dhe gjuhët e tjera indoevropiane: në mënyrë të logjikshme, të suksesshme dhe përfundimtare. Madje mund të pohojmë me plot gojë që ky është një nga standardet gjuhësore më të arrira në Evropën linguistike.*

E lënë kështu siç e kemi lënë, pa asnjë mbrojtje institucionale e shoqërore, shqipja sot ndodhet në kalvarin e vuajtjeve të përdorimit të stihisë e arbitraritetit, është vënë në “Shtratin e Prokrustit”, ku secili mund të bëjë çfarë të dojë me të. Prokrusti, personazhi i mitologjisë klasike greke, i shtrinte krijesat në një shtrat të shkurtër e të ngushtë prej hekuri, që ai vetë e kishte farkëtuar, duke ua mpakur gjymtyrët dhe kufizuar lirinë: nëse i kishin këmbët më të gjata, ua priste, e nëse i kishin më të shkurtra, ua zgjaste! Ngjashëm sikur ndodh dhe me gjuhën shqipe: kur nuk kishin gjuhë standarde, breza të tërë punuan që ta krijonin këtë pasuri të madhe kombëtare; e tani që e kemi krijuar, po punohet ta rrënojmë këtë gjuhë e të rikthehemi prapë në dialekte! Të folurit e shqipes kombëtare në dialekt duket sikur është bërë fiksion për ne, sëmundja jonë e tejzgatur.

Ata që punojnë pa grat e dobi për gjuhën shqipe duket se nuk e kanë të njohur atë thënien nga Fletoret e Gramshit: “*Kush flet vetëm dialektin ose e kupton gjuhën kombëtare në shkallë të pamjaftueshme, natyrisht e kupton botën pak a shumë në mënyrë të kufizuar, të fosilizuar, provinciale*” (A. Gramsci, Quaderni dal carcere, II, Einaudi, Torino, 1975). Në këtë kuptim, shqipfolësit duhet ta përdorin më me vëmendje gjuhën letrare (standarde), të mos i bëjnë buzë asaj, për sa kohë që duan të mos mbeten provinciale gjithë kohën. Nuk e thotë kot Julia Morais se “*pa gjuhë s’ka kulturë dhe pa kulturë s’ka gjuhë*”.

Një nga studiuesit që i ka kushtuar karrierën studimit të shqipes dhe prejardhjes së saj, Joachim Matzinger, shprehet me të drejtë se: “*Nuk ka arsye që ndryshimi i standardit të gjuhës shqipe të jetë një temë diskutimi. Standardi i shqipes është ashtu si i çdo gjuhe tjetër dhe standardet nuk duhet të ndryshohen herë pas here. Nuk ka pse të ndryshohet standardi.*

Shqipja ka një standard më se të stabilizuar dhe kjo është një gjë shumë e mirë, pasi shumë gjuhë nëpër botë nuk kanë arritur në këtë stad. Shqipja ka një standard të vetëm dhe ky duhet të respektohet nga të gjithë shqiptarët”. Ky fakt na bën të reflektojmë se shqipja nuk është gjuhë për skrap, sikundër e perceptojnë disa lokal-patriotë, por është sikurse të gjitha gjuhët e tjera standarde të kombeve të qytetëruara: një gjuhë funksionale e arrirë, që duhet ta mirëmbajmë, ta pasurojmë dhe ta zhvillojmë, sepse kjo është dhe pasuria jonë kombëtare më e madhe që kemi - atdheu i përbashkët i shqiptarëve.

Norma e shqipes letrare është e fiksuar (ngjizur) me tiparet më të mira dialektore, nga gjuhëtarët tanë eruditë nga më të mirët që kemi pasur (Androkli Kostallari, Eqrem Çabej, Mahir Domi), është miratuar në mënyrë plebishitare në një kongres të madh gjuhësie dhe kjo gjuhë letrare ka një të ardhme të sigurt. Shqipja standarde mund të krahasohet me gjuhët standarde rajonale dhe evropiane dhe si e tillë, e ngre dhe e lartëson kombin tonë, po aq sa dhe ky komb do të punojë për ta lartësuar këtë gjuhë.

KAHET E REJA TË KULTURËS SË GJUHËS SHQIPE MBAS KONGRESIT TË DREJTSHKRIMIT (1972)

Ideja e kryesore e kumtesës sime është pohimi, se Kongresi i Drejtshkrimit mbetet ngjarje me rëndësi themelore në historinë e kombit shqiptar dhe përbën gurin e themelit të kaheve të reja të njësimit gjuhësor, kulturor e shpirtëror të shqiptarëve në të gjitha trojet e veta etnike dhe në diasporat e hershme e të reja në botë. Prej kësaj ideje burojnë edhe vlersimet e tjera e pikërisht:

Drejtshtkrimi i njësuar si bazë për praktikën shkrimore e botuese me karakter zyrtar e publik, po edhe si udhëheqës për vijën përbashkuese të drejtshqiptimit dhe të kaheve më largvajtëse të shqipes së folur.

Karakterit gjithëkombëtar i zbatimit të drejtshkrimit të njësuar dhe frytet e tij të vyera në praktikën shkrimore të Republikës së Shqipërisë, të Republikës së Kosovës dhe të mediave të shkruara e të folura në Maqedoni, në Mal të Zi e në diasporën arbëreshe të Italisë e më gjerë.

Roli i drejtshkrimit të njësuar si modernizues dhe mënjanues i vendorizmit (lokalizmit) të ngushtë dhe si përçues i vijës lartësuese dhe fisnikëruese të shqipes standarde.

Hapësira të reja drejt lartësive të mëtejshme të kulturës së gjuhës së shkruar e të folur.

Roli i mbrojtjes shetërore dhe institucionale të gjuhës shqipe dhe standardizimit të saj të mëtejshëm në veprimtarinë botuese publike dhe private, si dhe forcimi i mëtejshëm i ndikimit të shoqërisë për kujdesin dhe pastërtinë e gjuhës së institucioneve publike dhe mediave të shkruara e të folura.

Sot, hapësirat shqiptare ballkanike kanë mbërritur një shkallë të re të përparimit e të kontaktit me anglishten e gjuhët e tjera me të cilat ka qenë në kontakt të drejtpërdrejtë, si p.sh. me maqedonishten në universitetet e Shkupit, të Tetovës etj. në Maqedoni, me serbokroatishten në universitetet e Kosovës e të Malit të Zi dhe, sidomos, me anglishten në të gjitha hapësirat e sotme universitare, duke qenë se anglishtja tashmë është gjuha e dytë kryesore në krejt formimin e shkollarëve që ndjekin shkollat e mesme dhe studimet e larta universitare dhe diplomimin në sistemin e masterit dhe në shkollat doktorale.

Përparësia që i është dhënë anglishtes, ndërkaq, shtrun edhe më me forcë e ngut përmirësimin e statusit të shqipes si gjuhë e parë, si *gjuhë e nënës* dhe si *“gjuhë e zemrës”* në të gjitha hapësirat shqiptare e shqipfolëse të trojeve kompakte ballkanike, madje edhe në diasporën shqiptare, posaçërisht atje ku ka edhe katedra, institute a lektorate të shqipes, si p.sh. në Universitetin e Kozencës (Kalabri), të Palermos (Sicili), të Napolit dhe në “La Sapienza” të Romës.

Të nxënëtit dhe përdorimi i gjerë i anglishtes dhe i gjuhëve të huaja të tjera, sidomos i italishtes, që përhapet shumë edhe nëpërmjet televizionit e radios, kanë sjellë dobi në përparimin e shkencës, të teknikës, po edhe në artin e në kulturën e intelektualëve shqiptarë, si në Shqipëri, ashtu edhe më gjerë; janë shtuar edhe përkthimet nga këto gjuhë dhe nga gjuhë të tjera, gjë që ka vënë në shërbim të shkollarëve e universitarëve shqiptarë ajkën e mbërritjeve të reja të shkencës e dijes botërore. Ndërkaq, nga ana tjetër, kjo ka pasur edhe pasojat të pamira në nxënien, vlerësimin dhe kujdesin për gjuhën shqipe. Kudo ka rendje pas

anglishtes, pëlqehen e blihen me ëndje librat dhe revistat në anglisht e në gjuhë të tjera të huaja, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për gjuhën shqipe. Përkundrazi, nuk mund (dhe s'ka pse) ta fshehim: *ka pasur rënie të ndjeshme të kujdesit ndaj të nxëniet të shqipes dhe, sidomos, mungesë vullneti e dëshire për ta pastruar, pasuruar dhe mbrojtur shqipen. Në radhë të parë është për t'u kritikuar rënia e disiplinës së shtetit e të institucioneve shtetërore e shoqërore të lejuara prej tij ndaj gjuhës shqipe*. Nuk zbatohet drejtshkrimi i njësuar i shqipes, ka thyerje të rënda të normave të shkruarit edhe në fushën akademike, duke u theksuar prirja për të shkruar me të madhe çdo lloj emërtimi, pa asnjë kriter drejtshkrimor. Të gjitha rubrikat e reja të televizioneve shqiptare, ndërsa në Itali e gjetkë në Evropë, përkthehen nga anglishtja, si p.sh. “Grande Fratello”, “Ballando con le stelle” etj., tek ne, për fat të keq, përballen me zulmë e gëzim të pashpjegueshëm vetëm në anglisht: “Big Brother”, “Dancing with the stars”, për të mos folur edhe për rubrika të tjera, të gjitha në anglisht e pa nevojë, si “INSIDE”, “Tonight” etj.

Thelbi i kësaj kumtese është, pra, të shkojmë drejt Evropës, të nxëmë anglishten dhe gjuhët e tjera, si mjete të domosdoshme, madje, si shkallë të pamënjanueshme të bilingualitetit e bilinguizmit të domosdoshëm, por edhe të mbetemi shqiptarë, të ruhemi nga anonimia sociale e nga teprimet në qasjen e së huajës.

Pa gjuhë asnjë popull nuk mund të zhvillojë kulturën e vet. Gjuha shkruar, e ngritur mbi bazën e ligjërimit të folur dhe në bashkëvajtje e konkurrencë të natyrshme me të, gjatë shekujve ka ndihmuar në zhvillimin e përparimin e dijes, shkencës, teknologjisë dhe industrisë. Në kohët e reja, praktikës shkrimore tradicionale, me anë të librave e botimeve të tjera, qysh nga gazetat e revistat deri te publiciteti me anë të fjalës së shkruar, përkthimet me subtitrim etj., i janë shtuar tashmë edhe aq shumë mjete e forma të reja kumtimi e publikimi nëpërmjet atyre, që në sociolinguistikën e sotme i quajmë “*flukse të padukshme*” ose postë elektronike (përkth. botime “on-line”), që si një hapësirë gjigande e nëndheshme i është veshur sot botës së komunikimit, duke e konkurruar dukshëm, përditë e më masivisht gjuhën e shkruar në letër. Krahas ligjërimit të shkruar e botimeve në faqe librash, gazetash a revistash, që natyrisht vazhdojnë e shtohen, kanë fituar rëndësi të madhe mediat e shkruara dhe të folura “on-line”: radioja, televizioni, posta elektronike me internet si dhe gjithë ato mundësi e forma të tjera të botimit a publikimit elektronik, që qarkullojnë në mënyrë të padukshme nga njëri vend në tjetrin, nga njëri kontinent në tjetrin dhe që tashmë, bota dhe ecja përpara e saj as që mund të kuptoheshin pa përdorimin e tyre. Mund të themi se sot, ndërsa ka pasur e ka jo shumë njerëz që kishin mundësi të blinin e të përdornin në shtëpinë vet ndonjë fjalor të madh ose enciklopedi, me shtimin e internetit nëpër zyra, në qendra pune e biznesi dhe deri në familje, kushdo, brenda disa sekondash mund të futet në sitet e Enciklopedive “on-line” dhe të gjejë informacionin që i duhet. Prandaj, mund të thuhet se edhe në komunikimin gjuhësor, sot, globalizimi vështrohet si dukuri që çon në rritjen marramendëse të ndikimit të anglishtes si gjuhë pune e informacioni me peshë aq të madhe në botë. Përkundër këtij ndikimi të anglishtes, i cili bëhet kryesisht përmes mediave dhe internetit, risitë teknologjike janë duke krijuar hapësira të reja edhe për përdorimin e gjuhëve të tjera të botës. Hapja e Shqipërisë ndaj ekonomisë së tregut dhe futja e investimeve të huaja, si dhe zhvillimi i madh i teknologjisë së prodhimit, i mediave dhe i teknologjisë informative kanë krijuar hapësira për përparime cilësore në kuadër të bashkësisë shqiptare, e cila, ndonëse me ritme e veçanti të dallueshme nga Evropa, sidoqoftë nuk mund të mos i nënshtrohej

ndikimit të globalizimit. Globalizimi është dukuri që ndikimin e tij e shtrin edhe në proceset gjuhësore dhe ky ndikim nuk mund të ngushtohet vetëm në ndikimin që anglishtja si gjuhë e sotme globale është duke ushtruar në gjuhët e tjera dhe as si ndikim në kuptim e përhapjes së huazimeve prej saj në gjuhët e ndryshme të Botës. Ky kah madhor i ecjes së sotme të njerëzimit në mbarë rruzullin tokësor nuk mund të shihet vetëm si dukuri që rrezikon t'i gërryejë e t'i zhdukë dalëngadalë gjuhët kombëtare të popujve të vegjël. Aq më pak mund të shihet sot, përhapja e gjerë dhe e shpejtë e internetit dhe e ndikimeve që vijnë me të si “armik” i përparimit dhe zhvillimit të kulturës e gjuhës kombëtare. Mjetet e reja të komunikimit masiv kanë marrë shtrirje të gjerë. Shumica e brezave aktivë sot shërbejnë jo vetëm nga telefonia fikse, por edhe nga telefonia e lëvizshme a celulare, përfshihen përherë e më shumë në hapësirat e internetit, qoftë me anë të e-mail-eve, sistemit të komunikimit me chat në të shkruar, si dhe me ato pamore “skypes”. Këtu vlen të përmendim komunikimet e të rinjve me njëri-tjetrin me anë të mesazheve me internet dhe me celularë, duke u krijuar, madje, edhe një fushë e re e hulumtimve sociolinguistike të ligjërimit rinor, me anë të shkurtimeve e shkurtesave tejet të veçanta. Mund të shohim aty, natyrisht, edhe ployën e ndikimeve të pamira në gjuhën shqipe, sidomos të pakujdesisë ndaj rregullave të gramatikës e të drejtshkrimit, duke u bindur se përveç avantazheve në lehtësinë e komunikimit, vihen re dhe deformime e dëmtime të rënda të kulturës së gjuhës shqipe, të cilat nuk ishin shfaqur dikur as në “flukset e dukshme” që kanë ekzistuar gjithmonë (letërsia artistike, teatri, filmi, shkollat, radio-televizioni publik), ku gjuha shqipe shfaqej me origjinalitetin e saj. Gjuha shqipe në internet ose në mesazhe me celular karakterizohet nga synimi për shkurti dhe shpejtësi kumtuese, çka është edhe e kuptueshme, le të themi edhe e pranueshme, por bashkë me këtë cilësi po shumohen në atë lloj ligjërimi edhe elemente të “ligjërimit të fshehur” e ku, krahas anonimatit e përdorimit të shtuar të pseudonimeve, po vërshojnë edhe shkrime fjalësh mbrapsht, fjalë banale etj., karakteristike të zhargonit rinor. Deri këtu, sidoqoftë, nuk do të ishte rasti për t'u shqetësuar, porse puna është se shprehjet e përdorura gjatë komunikimit në internet që krijohen për të kursyer kohë gjatë bisedave, (si “flm”, “ska ps”, etj.), kalojnë edhe në praktikën shkollore, duke mos i kushtuar kujdes aspak të folurit dhe të shkruarit letrar, madje këto kalojnë në shprehje, të cilat bartin me vete shumë ndikime negative tek nxënësit. Duke shqyrtuar këtë lloj ligjërimi a zhargoni të të rinjve, një pasuniversitare e sistemit MND të FGJH shkruan: *“Nuk konsiderohesh komunikues i mirë nëse nuk përdor këtë lloj gjuhe, prandaj kjo formë e bisedave në mes njëri-tjetrit, të disa të rinj bëhet edhe e imponuar, nëse nuk e praktikon nuk mund të jesh “modern”. Këto ndikime mund të vërehen edhe me rastin kur nxënësit pyeten apo vlerësohen nga profesorët”*.

Në rrafshin e shqipes, dukuria e globalizimit ka ndikuar që shqipja t'i nënshtrohet një procesi të rishkallëzimit ose të ripërshtatjes në rrafshin global dhe lokal. Ky proces është duke u shoqëruar dhe me ndryshimin e diskurseve, zhanreve dhe stileve të komunikimit të gjuhës shqipe.

Një tjetër dukuri, e cila është e lidhur ngushtë me përhapjen e proceseve globalizuese është interneti. Siç u tha më lart, përkundër faktit që interneti konsiderohet nga shumë autorë si mjeti kryesor për përhapjen e anglishtes si gjuhë globale dhe për ndikimin e saj në gjuhët e tjera, megjithatë duhet të themi se ky mjet i komunikimit dhe i publikimit “on-line” ka krijuar edhe hapësira a fusha të reja për përdorimin e shqipes. *Shqipja sot është gjuhë e shumë siteve elektronike në gjuhën shqipe, e email-it, e forumeve dhe blog-eve të ndryshme*

në internet, në të cilat shqipja del në format e saj të shkruara: herë në formë standarde, herë në forma të varieteteve të tjera të shqipes dialektore ose, sidoqoftë, jostandarde.

Prandaj, duke e mbyllur këtë dukuri, duhet të themi se ndikimi i globalizimit në shqipe nuk mund të shihet vetëm si ndikim i anglishtes dhe që shprehet nëpërmjet huazimeve e barbarizmave. Globalizimi dhe proceset integruese janë të lidhura fort edhe me aspektet e zhvillimeve të përgjithshme politike, ekonomike, kulturore, letrare dhe, pa dyshim, gjuhësore, që kanë ndikuar edhe në laryshinë apo llojshmërinë e ligjërimeve a diskurseve të shqipes së sotme, duke i pasqyruar të gjitha këto procese ekonomike, politike dhe kulturore nëpër të cilat po kalon shoqëria shqiptare.

Ngërçe të alfabetit të shqipes që pasqyrohen edhe në drejtshkrim

Në mbyllje të kumtesës sime do të ndalem edhe dy probleme, në dukje të vogla, por me pasoja të dukshme në drejtshkrim e në drejtshqiptimin e shqipes së sotme: a)shqiptimi i shkurtesave dhe b) problemi i fjalëve dhe emrave të huaj që përmbajnë shkronjën /ë/. Përvoja e zbatimit (përkate e moszbatimit) të disa normave të drejtshkrimit të shqipes ka treguar se pikërisht në gjënë më të thjeshtë, në abëcënë (alfabetin) e shqipes, gati masivisht, folës e redaktorë të emisioneve radiotelevizive, por edhe shumë njerëz të shkolluar, të gati të gjitha mjediseve shoqërore, gabojnë dhe po i shqiptojnë kundër natyrës së shqipes shumë prej shkurtesave, si dhe emrave të përveçëm të huaj e shqiptarë. Gjithmonë kemi thënë *FëBëI*, tashti “modernët” po e thonë vetëm *eFBial*. Pak, shumë pak janë ata që thonë: dërgoj një *SëMëSë*, më të shumtët thonë *eSeMeeSe*; pra, po na shtohen si këpurdhat e kërmillat mbas shiut edhe shqiptimet sipas gjuhëve të huaja e sidomos sipas anglishtes.

Qysh në pikë të mëngjesit e deri sa të biem të flemë, na e “shpon: veshin thirrja e reklamës “Igëll Mobaill”, ndërsa një radio e kryeqytetit na fton, gjithashtu, gjithë ditën të dëgjojmë “Kllëb eFeM”. Po edhe shumë njerëz, sidomos prej atyre që e mbajnë vetën si VIP-a, po e bëjnë zakon të thonë *kllëb* në vend të klub, për të mos përmendur fjalët mirëfilli të huaja të tipit *llajf* (muzikë *llajf*), *fajll*, *fejsbuk*, *majkrosoft*. Një emërtim i një emisioni të ri në TV Klan shkruhet “INSIDE”, por do të jemi të shtrenguar ta lexojmë “insajd”, ashtu si drejtuesja e emisionit dhe si thuhet në reklamën përkatëse, përndryshe do të na qortojnë si “analfabetë”.

Në një kumtesë të mbajtur parvjet në Seminarin e Prishtinës, po edhe në disa artikuj të botuar e në biseda në radio e televizione, kam pyetur me ironi: po me automobilin e shkretë dhe me Klubin e Selanikut të Çajupit çfarë do të bëjmë?! Kur do të nisemi të themi edhe *automobajll* e *automobajllizëm*? Kur do të fillojmë të lexojmë edhe “Kllëbi i Selanikut”. Kështu, pra, norma e sotme gramatikore, po ndeshet me trysninë e fortë e gërryese të gjuhëve të huaja, sidomos të gjuhëve që dallohen shumë nga natyra eptimore e shqipes, si anglishtja, gjuhë kryesisht idiomatike që nuk ka as lakim emrash as zgjedhim foljesh etj. Ndikimi i shqiptimit të gjuhëve të huaja, pa përmendur vërshimin e fjalëve dhe termave të huazuar, po ia marrin frymën shqipes, duke dëmtuar sidomos atë që quhet etnografi e të folurit shqiptarisht. Deri edhe pasthirrat shqiptare po pakësohen duke na u servirur në vend të tyre pasthirra të gjuhëve të huaja, a thua se televizionet tona i shohin dhe i mbajnë gjallë të huajt e jo forca blerëse e kontribuesve dhe e shikuesve shqiptarë.

Çfarë të bëjmë?

Të mos përulemi para së huajës, të mbrojmë tonën, sidomos atë pjesë që dihet se e

kemi të mirë, të bukur e të pavidrë: strukturën morfologjike të shqipes.

Shkronja e 37 e Alfabetit: /w/

Një problem grafik jo pa rëndësi, që vjen nga prurjet e reja, është edhe shtimi i fjalëve dhe emrave të huaj, kryesisht anglo-amerikanë që përmbajnë shkronjën *ë* apo sikundër po e shqiptojnë modernët “dabëll ju”. Kohëve të fundit, nga ndikimi përherë e më i fuqishëm i gjuhëve të huaja, kanë hyrë e po zënë vend në shqipen edhe disa fjalë, kryesisht emra të përveçëm, po edhe fjalë të artit e të politikës, që shkruhen si në gjuhët huazuese (*Show, Show-Biz, News, News-24, Euro-News*). Kemi shtënë në përdorim kompjuterin dhe aty, ndër të tjera, kemi edhe programet e tilla, kryesore, si *Word, Word-Perfeckt, Windows* etj. Këto fjalë tashmë janë shtruar dukshëm në veprimtarinë shkrimore dhe në ligjërimin e folur të njerëzve me shkollë. Pyetja që shtrohet është edhe këtui: si do të shkruhen fjalë të tilla?

Mesa shihet, shtimi i fjalëve dhe emrave të huaj të tillë po sjell edhe domosdoshmërinë e përfilljes së shkronjës /ë/ në shqipe. Rregullat e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, duke u nisur nga situata e kohës kur me atë shkronjë dilnin vetëm disa emra personalitetesh të shkencës e të letrave, si *Wat, Wiliam, Wilson* etj. dhe të disa emërvendesh (toponimesh) gjithashtu të arealit anglo-amerikan, kishte parashikuar që në shqipen emra të tillë të jepen ose me *U*

si p.sh.: *Uat, Uashington, Uells, Uljam, Nju- Jork, Nju- Delhi, Nju- Orleans* (Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, *Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 1973).

Prirja është e dukshme dhe anon nga forma e huaj. Edhe ndaj kësaj dukurie normativistët nuk mund të vijnë më tej me “lojën e strurit”. Prurjet gjithmonë në shtim të fjalëve të tilla dhe përdorimi i gjerë që kanë disa prej tyre në mediat e sotme, natyrisht, nuk mund të kalohen vetëm me qesendishje a shpotitje ironizuese. Ditë për ditë dëgjojmë të jepen reklamat duke shënuar edhe adresën e faqeve të internetit, të cilat, duam apo nuk duam, fillojnë patjetër me tri dopio-*v* njëra pas tjetrës. Edhe këtu, sigurisht, mund të kishim zgjidhje të ndryshme, duke përfutur edhe nga sa kanë bërë fqinjët tanë, p.sh. italianët, e shkruajnë *w* si në gjuhën dhënëse, por e shqiptojnë sipas traditës italiane: *vu-vu-vu*, prej nga edhe ne mund të merrnim gjedhen pozitive të thoshim *vë-vë, vë-vë, vë-vë*, porse ka edhe asish që e thonë *dabëll* a *dabëllju*, si p.sh. kur i referohen Bushit: *Georges W. Bush* (shqiptohet *Xhorxh Dabëll Bush*).

Dhe, për ta mbyllur, po edhe duke ritheksuar domosdoshmërinë e kujdesit të vazhdueshëm e të organizuar kombëtarisht ndaj gjuhës shqipe të shkruar e të folur, kam edhe këtë propozim:

të rishikohet dhe të riformulohen detyra e Këshillit Ndërkademi i Gjuhës Shqipe, të forcohet karakteri gjithëkombëtar i tij, duke e zgjeruar e përfshirë në të forcat më të gjalla e cilësore të profesoratit, që merret me studimin dhe mbrojtjen e gjuhës shqipe. Këshilli duhet të jetë gjithëkombëtar dhe për këtë të shtohet numri i anëtarëve, duke përfaqësuar të gjithë gjuhëtarët me titullin: akademik, akademik i asocuar dhe profesor.

Këshilli, mbasi të jetë riformatuar, duhet të kthehet në një organizëm veprues, që zgjedh edhe Kryesinë e tij prej pesë vetash dhe Kryetarin (ose bashkëkryetarët) sipas hapësirave kombëtare e etnike të tij.

Korçë, 16.11.2012

**KONTRIBUTI I DELEGATËVE TË KONGRESIT TË DREJTSHKRIMIT
NGA MAQEDONIA PËR SHQIPEN STANDARDE**

Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe është kurorëzim i përpjekjeve shekullore të popullit shqiptar, veçmas i mendjeve më të ndritura të kombit për njësimin e shqipes. Procesin e kodifikimit të shqipes, patën fatin ta bëjnë njerëzit e letrave shqipe, intelektualët më në zë të kohës, e ta nënshkruajnë 87 delegatët nga Shqipëria, nga Kosova, nga Maqedonia, nga Mali i Zi, si dhe nga arbëreshët e Italisë.

Delegatë të ftuar nga Maqedonia ishin veprimtarët tanë të nderuar:

1. Remzi Nesimi, pedagog i gjuhës shqipe në Akademinë Pedagogjike të Shkupit;
2. Petro Janura, drejtues i Degës së gjuhës shqipe të Universitetit të Shkupit dhe
3. Sefedin Sulejmani, drejtor i Njesisë së Bashkuar të Punës Botuese “Flaka e vëllazërimit”, që botohej në Shkup.

Përveç tre delegatëve të sipërhënuar, në Kongres ishin ftuar dhe morën pjesë edhe tetë përfaqësues të tjerë nga Maqedonia, përkatësisht:

1. Ali Aliu, kritik letrar dhe redaktor i Shtëpisë Botuese të Librit Shqip në Shkup.
2. Nehat Bëllçishta, mësues i gjuhës shqipe në gjimnazin e Dibrës.
3. Kimete Agai, mësuese e gjuhës shqipe në tetëvjeçaren “Liria” të Shkupit.
4. Mahmyt Hysa, pedagog në Akademinë Pedagogjike të Shkupit.
5. Emin Pustina, mësues i shqipes në gjimnazin e Dibrës.
6. Xhevat Gega, pedagog në Akademinë Pedagogjike të Shkupit.
7. Hamza Reka, pedagog në Akademinë Pedagogjike të Shkupit.
8. Shahe Jegeni – Sulejmani, mësuese nga Manastiri dhe
9. Hatixhe Nesimi, gazetar e Radio Shkupit.

Nga nëntë të ftuarit, vetëm Nehat Bëllçishta për shkaqe të panjohura për ne, nuk arriti të merrte pjesë në Kongresin e Drejtshkrimit.

Trinomi Janura – Sulejmani – Nesimi, janë ndër veprimtarët më të dalluar të arsimit, të shkencës dhe përgjithësisht të kulturës shqiptare në Maqedoni. Ata janë mësuesit e pedagogët më të mirë të kohës, hartues tekstesh shkollorë, albanologë, themelues të institucioneve të larta arsimore, të gazetave e të revistave shkencore në gjuhën shqipe në Maqedoni. Me veprimtarinë e shumanshme arsimore, shkencore, shoqërore e kulturore dhanë ndihmesë të madhe në përhapjen e dijes, në ngritjen e vetëdijes kombëtare si dhe në përparimin e përgjithshëm të popullit shqiptar në trojet tona. Këta intelektualë më në zë të kohës, si edhe gjithë masa e gjerë në Maqedoni, kanë përkrahur dhe do të përkrahin idenë për një gjuhë standarde të përbashkët për gjithë shqiptarët.

Për t’u njohur me jetën dhe veprimtarinë e këtyre figurave të shquara të kulturës shqiptare në Maqedoni, e shohim të udhës të japim disa të dhëna për ta:

Petro Janura (1911-1983)

Janura është ndër themeluesit dhe pedagogu i parë i Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare në Universitetin e Shkupit. Ai lindi më 25 mars të vitit 1911 në Fier (Shqipëri). U shkollua në Rumani dhe në Itali. Pas Luftës së Dytë Botërore jetoi dhe veproi në Maqedoni

dhe gjithë jetën u angazhua për emancipimin e shqiptarëve të kësaj pjese të trungut. Shquhet për kontributin e tij në ruajtjen dhe kultivimin e gjuhës, të kulturës dhe të traditës kombëtare të shqiptarëve në këto anë.

Në Shkup e kaloi pjesën kryesore të jetës dhe aty zhvilloi, afirmoi dhe përmbylli veprimtarinë publicistike, arsimore, shkencore dhe intelektuale, duke punuar 30 vjet rresht si mësues e profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqiptare. Është ndër personalitetet e rrallë shqiptarë me arsim të lartë në Maqedoni. Do të punojë si profesor në shkollën e parë të mesme në gjuhën shqipe (në normalen e Shkupit), pastaj në Fakultetin e Filologjisë e në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Shkup. Ishte themelues i gazetarisë shqiptare në Maqedoni (si drejtor i parë i gazetës “Flaka e vëllazërimit”), i mendimit shkencor albanologjik në Maqedoni dhe themelues i Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Shkupit, në të cilin punoi prej fillimit të saj: si lektorat (1952-1956) e seminar (1956-1971), mandej katedër (1971), derisa vdiq më 1983. Është pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në Kongresin e Drejtshkrimit (1972).

Përgjatë tri dekadave e gjysmë, sa u mor aktivisht me veprimtari të ndryshme shoqërore, publicistike dhe shkencore, arriti të botojë një numër të madh artikujsh gjuhësorë (rreth 20), kritikë letrare dhe historike për vepra dhe autorë të ndryshëm shqiptarë të traditës e të letërsisë së huaj. Ai shkroi në një kohë, kur ndër trojet shqiptare të mbetura jashtë trungut të shtetit shqiptar, kishte fare pak njerëz që shkruanin për gjuhën shqipe, që rrihnin probleme të gjuhës së përbashkët kombëtare, kur shkruhej shumë pak për kritikën letrare dhe kur për gjithçka që shkruhej duhej pasur kujdes të mos u bërë viktimë e censurës ideologjike dhe përndjekjeve politike.

Ndër artikujt shkencërisht të qëndrueshëm mbesin studimet për dokumentet e para të shkrimit të shqipes, veçmas për “Perikopenë e Ugjillit”, të cilën e nxjerr në kontekst të jehonës së Principatës së Arbërit (fondi i shekullit XII) dhe fillimeve të Humanizmit Evropian (fillimshekulli XIII), si vazhdimësi e veprimtarisë iluministe të shqiptarëve të Dubrovnikut, ku më 1284, për herë të parë përmendet gjuha shqipe, si *lingua albanesca*.

Ndërkaq, si kurorëzim i veprimtarisë kërkimore-shkencore të profesor Petro Janurës llogariten dy studimet monografike: “Për historinë e alfabetit shqip” (1969) dhe “Migjeni” (1982) të dyja të botuara në Shkup. Historia e alfabetit përgjithësisht është ndër të parat studime monografike për diakroninë e alfabetit të shqipes.

Prof. Petro Janura, në Kongres lexoi referatin “Disa mendime marginale rreth ortografisë së shqipes”. Ndër të tjerat ai tha: *Ata, të vjetrit, na ndihmuan të njohim gjuhën e shkruar të kohës së tyre. Ne, sot duhet të bëjmë një ortografi edhe për ata që do të vijnë pas nesh, të dijnë se si e kemi shkruar gjuhën e sotme e si e kanë shkruar të parët tanë, të cilëve u jemi mirënjohës për punën e tyre...*

Sefedin Sulejmani (1938- 2007)

Është filozof, poet, dramaturg, eseist, publicist e politikan i lindur më 30 maj 1938 në fshatin Izvor të Kumanovës në Maqedoni. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, më pas shkollën e mesme (normalen) “Liria” në Shkup më vitin 1958. Dy vjet punoi mësimdhënës në shkollën fillore “Bajram Shabani” në Kumanovë. Më vitin 1960 regjistrohet në Fakultetin e Filozofisë në Shkup dhe më 1962 diplomohet. Më pas punoi si profesor i lëndëve të filozofisë në gjimnazin “Goce Dellçev” të Kumanovës. Në periudhën kohore ndërmjet viteve

1962 – 1968 ishte kryetar i rinisë për qarkun e Kumanovës. Më 1968 u zgjodh deputet i Kuvendit të Maqedonisë. Në këtë vit botoi përmbledhjen e poezive me motiv patriotik dhe frymë iluministe “Drita e kohës së re”. Gjatë kësaj periudhe organizoi kurse për nxënien e shkrim-leximit, përkatësisht për zvogëlimin e analfabetizmit te masa e gjerë popullore. Ushtrroi edhe detyrën e punëtorit politik të Këshillit Qendror të Lidhjes Komuniste të Maqedonisë. Më pas, u emërua drejtor i Teatrit të Kombësive në Shkup dhe anëtar i Këshillit Redaktues të revistës mujore letrare-artistike “Jehona” në Shkup. Në këtë revistë ai botoi një numër të madh punimesh filozofike, letrare si dhe tri drama të shkurtra: “Rrugët e fatit”, “Shkëndijat e para” dhe “Abelardi e Heloiza”. Njëkohësisht, përveçse në këtë revistë, ai botoi shumë punime në revista dhe gazeta të tjera shqiptare në Kosovë e në Maqedoni, si në “Fjala”, “Rilindja”, “Flaka e vëllazërimit”, “Jeta e re”, “Përparimi” etj.

Më vitin 1970 botoi veprën e parë filozofike “Disa aspekte kontemplative mbi filozofinë e jetës”. Më 1970 së bashku me disa intelektualë të tjerë (prof. Eshtref Saraqinin etj.), ishin nismëtarët e parë për themelimin e Akademisë Pedagogjike në Shkup, me studime dyvjeçare, për të siguruar kuadro për të gjitha lëndët mësimore të tetëvjeçareve dhe për mësimin klasor në gjuhën shqipe. Më vitin 1971, Sefedin Sulejmani u zgjodh profesor në Fakultetin e Filozofisë në Universitetin e Prishtinës për lëndët filozofi, etikë dhe estetikë. Më vitin 1972 u zgjodh kryeredaktor i “Flakës së vëllazërimit”, gazetë e vetme në gjuhën shqipe në Maqedoni, që botohej së pari një herë në javë e më pas tri herë në javë. Edhe revista “Jehona” u përfshi në kuadrin e “Flakës së vëllazërimit”, për të mos pasur probleme në financimin e saj.

Më 1973 doktoroi në Universitetin e Prishtinës në temën “Mendimi filozofik në veprën e Naim Frashërit”, duke u bërë asokohe doktori i parë shqiptar në Maqedoni. Më 1974 u emërua anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Maqedonisë, prej ku u angazhua dhe dha mbështetje të fuqishme që në Universitetin “Shën Qirili e Metodi” të Shkupit, të fuste mësimin e gjuhës shqipe në këtë institucion të lartë arsimor, së pari si lektorat, seminar e më vonë si Katedër e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe, studentë e mësimdhënës të së cilës jemi tani edhe ne.

Gjatë karrierës së tij politike, ushtroi edhe detyrën e zëvendësministrit të kulturës, profesor në Fakultetin Pedagogjik “Shën Klimenti i Ohrit” në Shkup, nga viti 1998 në mandat të rregullt katërvjeçar edhe dekan i këtij fakulteti.

Prof. Sulejmani ka edhe një veprimtari të pasur krijuese. Ai shkroi 90 vepra nga filozofia, arti, sociologjia, etika, estetika, dramaturgjia, kultura, politika. Na la trashëgim edhe shumë punime, artikuj, studime, ese nga sfera të ndryshme. Ndërroi jetë në Shkup, më 24 shtator 2007 në moshën 69 vjeçare.

Prof. Sefedin Sulejmani në detyrën, siç quhej atëherë, e drejtorit të Njesisë së Bashkuar të Punës Botuese “Flaka e vëllazërimit” në Shkup, në fjalën përshëndetëse të mbylljes së punimeve të Kongresit, mes tjerash tha:

“Ky kongres sintetizoi të gjitha përpjekjet dhe arritjet në lëmin e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe dhe drejtshkrimit të saj. Nga ana tjetër, ai hapi shumë horizonte, mundësi të reja dhe perspektiva të shndritshme për zhvillimin e gjuhës sonë. Pra, shoqe dhe shokë, Kongresi vetëm fizikisht po mbyllet. Puna e tij tani fillon. Puna e Kongresit të Drejtshkrimit do të mbarojë atëherë kur ne do të zbatojmë në mënyrë më konsekuente fjalën, shkronjën e tij, porositë dhe vendimet e tij. U tha se detyrat e Kongresit janë historike. Të gjithë pajtohemi me këtë bindje, pse ato janë edhe aksiomatike. Por, në qoftë se mungon zbatimi praktik i tyre,

*atëherë ato nuk paraqesin kurrfarë fuqie. Në rastin më të mirë, do t'i ngjanin ndonjë pikturë të bukur, e cila është mbyllur në atelienë e piktorit dhe nuk është në relacion me faktorin që e shijon, me masën, së cilës i kushtohet. Marksi fare mirë thotë se idetë për vete nuk janë dhe nuk paraqesin asgjë. Ato duhet të zbatohen, e premisë për zbatimin e tyre është fuqia praktike e njeriut. Atëherë Kongresi na obligon që vendimet e tij t'i zbatojmë gjithkund, në çdo sferë të jetës edhe atje ku jetojmë edhe atje ku punojmë. Zotohemi, shoqe dhe shokë, që vendimet e Kongresit t'i bëjmë pjesë përbërëse dhe aksion të patjetërsuar të jetës sonë të përditshme.*¹

Remzi Nesimi (1933)

Remzi Nesimi lindi më 25. 12. 1933 në fshatin Odër të Tetovës në Maqedoni. Jeton dhe vepron në Shkup. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, ndërsa të mesmen në gjimnazin “Kiril Pejçinoviç” të Tetovës. Në vitin akademik 1955-1956 u regjistrua në Fakultetin e Filozofisë në Beograd (kryeqyteti i ish-Jugosllavisë) në Degën e Albanologjisë, ku dhe u diplomua. Menjëherë pas kryerjes së studimeve, një vit punoi në redaksinë e botimeve “Rilindja” në Prishtinë si lektor – redaktor. Në këtë cilësi ka punuar edhe në redaksinë e “Flakës së vëllazërimit” deri në tetor të vitit 1962, kur zgjidhet lektor i gjuhës shqipe në Katedrën e Albanologjisë në Beograd, ku punoi plot dy vjet. Dhjetë vjet (1964 – 1974), punoi pedagog i gjuhës shqipe në Akademinë Pedagogjike “Klimenti i Ohrit” në Shkup. Nga viti 1975 e deri më 1999 ishte profesor në Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare të Fakultetit të Filologjisë në Shkup. Po kështu, për disa vjet profesori mbajti edhe leksione në lëndët e gjuhës shqipe në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup.

Remziu nga karakteri është i sinqertë, bujar, besnik, zemërgjerë, human, arsimdashës, largpamës, patriot. Me një vetëdije të lartë kombëtare, i shtyrë nga dëshira e flaktë për arsimimin e shqiptarëve, për disa vite rresht, ligjëroi në Universitetin (siç e quanin jolegal) të Tetovës edhe përsëri rreziqeve e pasojave që mund të kishte asokohe.²

Veprimtaria e prof. Remziut është e pasur dhe e shumëllojshme: lektor – redaktor i një numri të madh (afër 30) veprash të ndryshme letrare, shkencore, kulturore si dhe i shumë teksteve shkollore të botuara në Maqedoni e Kosovë.³ Pothuajse katër dekada ligjëroi gjuhën shqipe në arsimin e lartë. Për nevojat e shkollimit fillor dhe të mesëm në Maqedoni hartoi disa gramatika. Veprimtaria profesionale e profesor Remziut pasqyrohet edhe në mbi 100 artikuj, studime, shqipërime (mbi 20) e monografi me vlerë shkencore. Ka qenë anëtar i Komitetit Republikan të Arsimit e të Kulturës, anëtar i Pleqësisë Republikane Pedagogjike të Maqedonisë, anëtar i kolegjiut të Redaksisë së Jehonës (përgjegjës dhe redaktor i rubrikës së gjuhësisë), anëtar i Këshillit Redaktues të Teksteve Shkollore në gjuhën shqipe në Shtëpinë Botuese “Prosvetno Dello”, anëtar i Komisionit Republikan për përsosje kërkimore-shkencore të kuadrit, anëtar i Pleqësisë për përkujdesjen dhe zhvillimin e gjuhës letrare në Radio-Televizionin e Maqedonisë, anëtar i Kolegjiut redaktues i revistës shkencore “Gjurmime albanologjike” – Prishtinë etj. Për bashkëpunim profesional të frytshëm dhe të

¹ *Përsëritetja* e Mr. Sefedin Sylejmanit, drejtor i Njësisë së Bashkuar të Punës Botuese “Flaka e vëllazërimit”, Shkup, ASH e RP të Shqipërisë, Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe 20-25 nëntor 1972, I, Tiranë, 1973, f. 199-200.

² Asllan Hamiti, *Prof. Remzi Nesimi – pedagog, humanist dhe studiues i shqipes*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 11-18.

³ Agim Poloska, *Bibliografia e punimeve, studimeve, artikujve dhe monografive shkencore të prof. dr. Remzi Nesimit*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 19-28.

vazhdueshëm me institucionet arsimore e kulturore, prof. dr. Remzi Nesimi është nderuar me disa mirënjohje, diploma e medalje.⁴

Profesor Remziu është pishtar i arsimit të lartë në gjuhën shqipe në Maqedoni si dhe studiues i zellshëm i shqipes. Me punën e frytshme arsimore, shkencore e kulturore ka dhënë ndihmesë shumë të çmuar për përvetësimin e normës letrare në shkollat shqipe, në mediat e shkruara dhe elektronike në Maqedoni dhe përgjithësisht për kultivimin, pasurimin, ruajtjen e pastërtisë së shqipes nga elementet e huaja, në veçanti nga elementet sllave. Çështja e pastërtisë së gjuhës dhe zbatimi praktik i normës letrare përbën boshtin kryesor të gjithë veprimtarisë së tij kërkimore në fushë të shqipes. Me çështje gjuhësore fillon të merret që në vitin 1960, kur në faqet e gazetës Rilindja boton tre artikuj lidhur me pastërtinë e gjuhës letrare shqipe. Dy vjet para mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit, përkatësisht që më 1970, në faqet e gazetës “Flaka e vëllazërimit” që botohej në Shkup, në shtatë numra të njëpasnjëshëm, paraqet dhe arsyeton rëndësinë dhe nevojën e konstituimit të një gjuhe të përbashkët letrare dhe standardizimin e saj.

Si kryetar i Lidhjes së Shoqatave të Arsimitarëve të Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare të Maqedonisë ishte njëri ndër organizatorët kryesorë për përgatitjen e Konferencës Shkencore për shënimin e 20-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit dhe njëri ndër tre bashkëkryetarët e Konferencës. Takimi, në të cilin morën pjesë gjuhëtarët më në zë të Shqipërisë, Kosovës e Maqedonisë, u mbajt në Tetovë në qershor të vitit 1992.

Nga shkrimet e prof. Remziut mund të nxirret porosia se jemi një komb, prandaj duhet të kemi një gjuhë të përbashkët. Ai vazhdimisht ka shkruar e folur për pastrimin, pasurimin dhe përgjithësisht, për kulturën e gjuhës në Maqedoni e më gjerë. Në Kongresin e Drejtshkrimit ai tha : “Sikurse në qendra të ndryshme – në Stamboll, në Bukuresht etj., ashtu edhe në Maqedoni, janë bërë mjaft përpjekje për zhvillimin e shqipes letrare. Sidomos një vend të rëndësishëm në këtë proces, përkatësisht në krijimin e alfabetit përfundimtar të shqipes, zë edhe Manastiri, i cili prej kohësh ka qenë qendër e njohur kulture në Gadishullin Ballkanik. Një vit pas mbajtjes së Kongresit të Manastirit ..., Shoqëria Botuese Letrare e po këtij qyteti botoi edhe Abetaren e njërës prej pedagogëve të para të arsimit kombëtar, Parashqevi Qiriazi. Dhe jo vetëm kaq. Në këtë vend e në qendrat e tjera vepruan edhe mjaft shoqëri kulturor, u botuan gazeta, siç janë “Kosova” (1908) e “Shkupi”, që dilnin në Shkup. Por për shkak të rrethanave të njohura historike, për më se 30 vjet, sikurse në Kosovë ashtu edhe në Maqedoni, u shua çdo gjurmë e kulturës kombëtare. Vetëm pas Luftës së Dytë Botërore, krahas me hapjen e shkollave në gjuhën shqipe prej fillores e gjer në shkollat e larta, filloi tek ne edhe veprimtaria e gjerë botuese në gjuhën shqipe”.

Më se gjysmë shekulli, përkatësisht që nga vitet '60 të shekullit të kaluar, me përkushtim e vetëmohim ka punuar për ngritjen e përgjithshme arsimore e kulturore dhe të vetëdijes kombëtare të popullit shqiptar në Maqedoni e më gjerë, për të lëvruar, kodifikuar dhe përpunuar shqipen standarde.

Jo rastësisht profesor Remzi Nesimi moto të referatit të lexuar në Kongresin e Drejtshkrimit,⁵ me titull “Procesi i njësimin të shqipes letrare në Maqedoni” kishte vënë

⁴ Qani D. Mehmeti, *Kontributi i prof. Remzi Nesimit për gjuhën shqipe*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 115-125.

⁵ Mr. Remzi Nesimi (Shkup), *Procesi i njësimin të shqipes letrare në Maqedoni*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20-25 nëntor 1972, Prishtinë, 1974, f. 139-142.

thënien e profesor Aleksandër Xhuvanit: *“Njisia e gjuhës është njisia e kombit”*. Në këta rreshta me vlerë na njofton për rrjedhën e zhvillimit të shqipes letrare në Maqedoni pas Luftës së Dytë Botërore e më pas. Ai me të drejtë konstaton se: *“Që në vitet e para pas çlirimit të ne u krijuan dy qendra kulture: Prishtina në Kosovë dhe Shkupi në Maqedoni. Në të dyja këto qendra u zhvillua edhe një veprimtari botuese. Përveç shumë teksteve shkollore, në Shkup filloi të dalë “Flaka e vëllazërimit”, në Prishtinë “Rilindja” e më vonë edhe revista e botime të tjera. Ndonëse në këto dy qendra gjer më 1968 u përdor gegërishtja letrare. Në pikëpamje ortografike kjo gegërishte nuk ka qenë krejtësisht e njëjtë”*.

Në Maqedoni si në shkolla ashtu edhe në teatër, në shtyp e në radio edhe para vendosjes së një gjuhe letrare të njësuar është përdorur gjuha dhe ortografia e variantit letrar verior të mesëm. ...*“Procesin e njësimit të gjuhës së shkruar sipas variantit letrar të mesëm e ndihmuan mjaft edhe një numër i madh arsimtarësh ish-normalistët të Elbasanit, si dhe të krahinave të tjera jugore të Shqipërisë që shërbyen vite me radhë në qendra të ndryshme të Maqedonisë – në Shkup, Tetovë, Gostivar, Dibër, Strugë etj. Për shërbimet e tyre të mëdha të gjithë këta punonjës të zellshëm meritojnë respektin dhe mirënjohjen tonë të thellë... Qysh kur filloi të përdoret gjuha letrare, në Maqedoni kemi pasur një ecuri paralele si me drejtshkrimin, ashtu edhe me gjuhën standarde të përdorur në vendin amë. Në vitet e para u përdor drejtshkrimi që ishte përdorur në tekstet gramatikore të profesor A. Xhuvanit, pastaj ortografia që u botua më 1948, drejtshkrimi i vitit 1951 dhe më në fund “Ortografia e gjuhës shqipe” e vitit 1956... Pas botimit të “Rregullave të drejtshkrimit të shqipes”, disa muaj para se të mbahej Konsulta gjuhësore në Prishtinë, “Flaka e vëllazërimit” kishte filluar të dalë në gjuhën e sotme letrare dhe me këtë u realizua edhe një e vërtetë shkencore, u realizuan dëshirat qindvjeçare...”*

Qëndrimin e delegatëve të Kongresit si edhe të të gjithë shqiptarëve të Maqedonisë për njësimin e shqipes, që atëherë, Nesimi e shpreh haptas se: *“Parimi themelor i intelektualëve tanë gjithnjë ka qenë që të ndiqet ajo ortografi dhe bile edhe ajo gjuhë që përdoret në vendin amë”*.

Me pranimin e vendimeve të Kongresit e më pas me zbatimin si dhe me përhapjen e shqipes standarde, këta intelektualë nga Maqedonia kanë dhënë ndihmesë të madhe në ruajtjen e njësisë gjuhësore si dhe në ngritjen dhe ruajtjen e identitetit tonë kombëtar.

Falë veprimtarisë së atdhetarëve tanë, ne i kemi bërë ballë politikës asimiluese. Pandaj, sot jemi mbledhur tok, krahinash e visesh të ndryshme shqiptare, toskë e gegë: nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Kosova Lindore, diaspora e nga gjithë bota të shënojmë, të festojmë e të madhërojmë mbijetesën tonë gjuhësore e rrjedhimisht edhe mbijetesën kombëtare.

Vetëm kështu të bashkuar do të hapërojmë drejt botës së qytetëruar e do të shënojmë edhe shumë suksese në qindjvetorë të ardhshëm.

Referime:

1. Asllan Hamiti, *Prof. Remzi Nesimi – pedagog, humanist dhe studiues i shqipes*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 11-18.
2. Agim Poloska, *Bibliografia e punimeve, studimeve, artikujve dhe monografive shkencore të prof. dr. Remzi Nesimit*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 19-28.
3. Qani D. Mehmeti, *Kontributi i prof. Remzi Nesimit për gjuhën shqipe*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 115-125.
4. Mr. Remzi Nesimi (Shkup), *Procesi i njësimit të shqipes letrare në Maqedoni*, IAP, Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20-25 nëntor 1972, Prishtinë, 1974, f. 139-142.
5. Mr. Sefedin Sylejmani, *Përshëndetje*, ASH e RP të Shqipërisë, Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20-25 nëntor 1972, I, Tiranë, 1973, f. 199-200.
6. *25 vjet gjuhë shqipe në Fakultetin Filologjik të Shkupit 1951-1976*, Shkup, 1977.
7. IAP, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974.

EMIL LAFE

RËNDËSIA HISTORIKE KOMBËTARE DHE VLERA KULTURORE E KONGRESIT TË DREJTSHKRIMIT

Përkujtimi i 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit me këtë Akademi Solemne dhe atmosfera e festimeve për ditën e shënuar të 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, ne delegatët dhe pjesëmarrësit e të tjerë të tij na bëjnë të ndiejmë sërish përjetimet dhe ngazëllimin e asaj ngjarjeje të madhe. Java nga 20–25 nëntor 1972 ishte java e gjuhës shqipe dhe gjuhësisë shqiptare. Më 25 nëntor 87 delegatë të Kongresit, të mbledhur në sallën e Kuvendit të Shqipërisë, miratuan dhe nënshkruan Rezolutën, ku përcaktohet:

“Gjuha shqipe ka arritur një shkallë të tillë zhvillimi, që na lejon të pohojmë shkencërisht se populli shqiptar ka tashmë një gjuhë letrare të njësuar, norma kombëtare e së cilës është kristalizuar në të gjitha hallkat kryesore të strukturës fonetike, gramatikore, fjalëformuese e leksikore”.

Për herë të parë, 60 vjet pas Kuvendit të Vlorës, që e shpalli Shqipërinë më vete dhe të pavarur, delegatë nga të gjitha trojet shqiptare, të mbledhur në një kuvend shkencor mbarëkombëtar, hidhnin nënshkrimin mbi një dokument, i cili sanksiononte një formë të vetme të gjuhës letrare shqipe për gjithë shqiptarët. Ky ishte një ribashkim kombëtar i shqiptarëve të ndarë nga kufijtë e vendosur më 1913 dhe të kërcënuar me tjetërsim të identitetit kombëtar. Rezoluta e Kongresit të Drejtshkrimit mbetet edhe sot akti më i rëndësishëm përfaqësues kombëtar, që shpall dhe sanksionon unitetin e kulturës shqiptare dhe shtetin kulturor shqiptar, përtej kufijve, mbi bazën e një gjuhe letrare kombëtare të njësuar ose të shqipes standarde. Ajo Rezolutë me moton *Një komb – një gjuhë letrare kombëtare*, i sfidoi kufijtë e imponuar dhe gjendjen politike, duke shprehur vullnetin e përbashkimit të shqiptarëve rreth flamurit të një gjuhe letrare të përbashkët për shkollën, për letërsinë, për shkencën dhe kulturën shqiptare. Ky është kuptimi i vërtetë i veprës së Kongresit të Drejtshkrimit, këtu qëndron rëndësia e tij historike kombëtare e kulturore. Njëkohësisht këtu qëndron edhe arsyeja e kundërshtimeve që i janë bërë e i bëhen.

Kongresi i Drejtshkrimit, i organizuar nga Universiteti i Tiranës, ishte vepër kolektive e shkollës shqipe dhe e inteligjencës shqiptare këtej e andej kufijve shtetërorë. Në përgatitjen dhe suksesin e tij morën pjesë studiuesit më në zë të gjuhës shqipe dhe krahas tyre edhe mjaft studiues të rinj, njerëz të letrave, veteranë e veprimtarë të shquar të arsimit kombëtar. Ai ringjalli ndjenjat dhe frymën atdhetare të rilindësve të mëdhenj, që nga Naum Bredhi-Veqilharxhi, të cilët përhapën dritën e diturisë dhe ndezën flakadanin e lirisë. Përpara qëllimit të lartë të Kongresit privimet e mungesat e tjera të kohës mbeteshin mënjanë dhe ne iu vumë me mish e me shpirt punës për të dalë faqebardhë përpara gjindes shqiptare. Edhe ne kemi punuar dhe do të punojmë *“en së dashunit së botës së sanë”* (nga dashuria për popullin tonë), ashtu si stërgjyshi ynë i nderuar, Gjon Buzuku, që “është arratisur” këto ditë nga vetmia e tij e ftohtë në Bibliotekën e Vatikanit dhe na ka ardhur për të bujtur në truallin amtar, në ngrohtësinë e afshit të zemrave të qindra mijëra pasardhësve të tij, të mbledhur në Bibliotekën Kombëtare, ku nuk rresht gjithë ditën vargu i kureshtarëve për të parë nga afër atë përmendore të parë të shkrimit shqip dhe të vullnetit e të mendjes shqiptare.

Rruga deri te Kongresi i Drejtshkrimit nuk ka qenë e lehtë. Shqipëria doli nga Lufta II Botërore me një popullsi gati 90 për qind analfabete. Në Kosovë, në Maqedoni, në Malin e Zi, përqindja e analfabetizmit ndër shqiptarët ka qenë edhe më e lartë. Zhdukja e analfabetizmit, hapja e shkollave në çdo fshat, shumëfishimi i shkollave të mesme, krijimi i arsimit të lartë shumëdegësh, zhvillimi i veprimtarisë shkencore, i letërsisë dhe arteve, bashkë me përparimin e ekonomik, shtroni detyra edhe në fushën e normëzimit të gjuhës. Pas disa projektesh të rregullave të drejtshkrimit të botuara në vitet '40-'50, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë i Universitetit të Tiranës botoi në shkurt 1967 një projekt të ri të rregullave të drejtshkrimit dhe organizoi një diskutim të gjerë të tij, në radhë të parë me arsimtarët, në të 36 rrethet e atëhershme administrative të vendit. Ky projekt u ribotua në Prishtinë, ku në prill 1968 u organizua Konsulta gjuhësore e Prishtinës, në të cilën u përfaqësuan gjithë shqiptarët në shtetin jugosllav të atëhershëm: Kosova, Maqedonia, Mali i Zi. Konsulta ngjalli interesim tepër të madh, mori karakter masiv dhe pas dy ditë diskutimesh, shpalli se njeh njëzëri gjuhën letrare të vendit amë si gjuhë letrare të gjithë shqiptarëve të përfaqësuar atje. Sipas vendimit të Konsultës, filloi, me një entuziazëm të vetvetishëm, edhe zbatimi i projektit të ri të drejtshkrimit në shtyp, në botime, në shkolla e kudo, duke hequr dorë nga varianti i mëparshëm letrar. Bashkimi gjuhësor ishte kryer. Konsulta e Prishtinës na bëri më të vetëdijshëm se kishim në duar një detyrë me përgjegjësi jo vetëm shkencore, po edhe kombëtare. Rruga për te Kongresi i Drejtshkrimit kaloi më tej përmes diskutimesh rreth projektit dhe çështjeve të gjuhës letrare në përgjithësi gjatë katër viteve që pasuan dhe që dëshmuuan se zbatimi i projektit ishte plotësisht i mundshëm e i dobishëm edhe në treva me një bazë dialektore të ndryshme.

Dy vëllimet e botuara me aktet e Kongresit të Drejtshkrimit dëshmojnë se ai ishte një kongres pune serioze, ku u diskutua me përgjegjësi shkencore e kombëtare jo vetëm për çështje të ngushta të drejtshkrimit, po edhe të gjuhës letrare shqipe në tërësi. Herë pas here është shtruar çështja: si duhet vlerësuar ai Kongres në kohën tonë, në kushtet e një shoqërie demokratike pluraliste; a mos ishte i parakohshëm apo i imponuar? Lidhur me këtë mendoj se Kongresi i Drejtshkrimit duhet vlerësuar për atë që arriti dhe jo nga pikëpamja e regjimit politik dhe e ideologjisë që sundonte në atë kohë në Shqipëri e në Jugosllavi. Ajo që arriti Kongresi i Drejtshkrimit i ka qëndruar e po i qëndron provës së kohës, ashtu siç i ka qëndruar provës së kohës edhe ajo që arriti Kongresi i Manastirit.

Duke përmbushur detyrat që shtroi ai Kongres, gjuhësia shqiptare ka hartuar një varg veprash themelore normative, që tashmë njihen. Këto vepra kanë pasur ndikim mjaft të frytshëm për përhapjen, zotërimin dhe zbatimin e normës letrare. Tashmë që kanë kaluar katër dekada, mendoj se synimi ynë është që të njohim më mirë veçoritë e përdorimit dhe proceset e zhvillimit të gjuhës letrare në të gjithë hapësirën ku përdoret ajo. Mbi këtë bazë do të bëhen plotësime e përmirësime në veprat normative, do të ndërmerren studime të reja për probleme të veçanta të normës, që nuk janë trajtuar ende në mënyrë të mjaftueshme. Por gjithmonë në një frymë bashkëpunimi mbi një platformë të përbashkët, e cila nuk mund të jetë tjetër veçse njohja pa rezerva e arritjeve të Kongresit të Drejtshkrimit, të cilat përbëjnë bazamentin e qëndrueshëm dhe të patundshëm të gjuhës standarde shqipe.

Kongresi i Drejtshkrimit e dendësoi dhe e ngjeshi indin e përbashkët kulturor kombëtar, e ngriti kërkesën e kulturës gjuhësore në lartësinë e kërkesave intelektuale të një shoqërie moderne, e shtoi kujdesin shoqëror për pastërtinë dhe pasurimin e gjuhës, dëshmoi

para botës njësinë etnike, gjuhësore dhe kulturore të shqiptarëve në gjithë hapësirën e tyre të banimit, pavarësisht nga kufijtë shtetërorë, e lartoi prestigjin e gjuhësisë shqiptare në vendet përkatëse dhe në rrethet shkencore në botë. Për këtë ajo ngjarje meriton nderimin tonë të përhershëm.

Duke përfunduar fjalën time dëshiroj të përmend formulimin e një dëshire të guximshme të shprehur te “Gazeta e Korçës” e 18 janarit 1921, dhe që prof. Androkli Kostallari, duke shprehur edhe aspiratat tona, e ka shqiptuar, jo pa guxim, në referatin e vet në Kongresin e Drejtshkrimit. Një autor i panjohur u përmendte atëherë deputetëve që do të zgjidheshin në legjislaturën e parë të parlamentit shqiptar, se çfarë prisnin populli e atdheu prej tyre:

“Shqipëria bashkë me popullin e saj dëshëron të shohë një përparim dhe i ka shtënë syt’ e saj nga Perëndimi. Do t’i shohë fushat e saj të lëruara pas mënyrës së re; do t’i shohë pyjet të prera pas mënyrës moderne, që të mos mbeten nesër të shkreta; do t’i shohë mademet të shfrytëzuara pa e shtënë popullin nën robërinë ekonomike; do t’i shohë shkollat të përparuara dhe baras me të Evropës; do ta shohë qytetarin, fshatarin dhe bujkun e saj kryelartë, të pasur, të lumtur dhe çdo qendër të madhe a të vogël, të lidhura me udhë të hekurta. Do ta shohë dhe do ta pjekë Korçën me Shkodrën në 5-6 sahat; do ta përziejë Veriun me Jugun, ta heqë fanatizmin dhe të krijojë një komb të përbashkët, të përparuar, të qytetëruar dhe të kulturuar në çdo pikëpamje.”

Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe është pikërisht shprehje e këtyre kërkesave dhe idealeve. Duke risjellë ato fjalë emocionuese, dëshiroj të bëj një homazh për autorin anonim e mendjendritur të tyre në vitin e largët 1921, dhe për prof. A. Kostallarin, që ka një meritë të veçantë në përgatitjen dhe zhvillimin e mbarë të Kongresit të Drejtshkrimit, i cili do të mbetet si veprimtaria shkencore më emancipuese, më atdhetare, më frytdhënëse në historinë moderne të gjuhësisë shqiptare.

15 nëntor 2012

ÇËSHTJE LEKSIKORE NË KONGRESIN E DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Çështjet leksikore në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972) përshkajnë shumë analiza shkencore, diskutime e zgjidhje drejtshkrimore në dy rrafshet a në dy drejtime: *në rrafsh të përgjithshëm*, që lidhet me interpretimet teoriko-shkencore të studimeve, të diskutimeve e të vendimeve, si edhe me vetë parimet e pranuar për drejtshkrimin e shqipes dhe *në rrafshin leksikologjik*, që lidhet me trajtesat e veçanta shkencore rreth disa çështjeve të leksikut të shqipes, rreth disa dukurive ndikuese në zgjidhjet drejtshkrimore dhe në strukturimin e shqipes standarde në këtë fushë. Në të dyja rrafshet njësia bazë dhe më e përgjithshme e trajtimeve është njësia themelore e leksikut, fjala e kuptimi i saj, si edhe norma leksikore. Në fund të fundit, normë drejtshkrimore do të thotë rregulla si shkruhen fjalët. Ky drejtim i punimeve të Kongresit është gjithashtu një përbërës tjetër mbi detyrat thjesht drejtshkrimore që ai zgjidhi dhe i jep atij vlerën e një kongresi me synim e profil më të gjerë, të një kongresi për “gjuhën letrare shqipe të njësuar” në përgjithësi, që vjen sot si “gjuha standarde shqipe”.

Që drejtshkrimi merret kryesisht me grafinë e fjalës, kjo dihet dhe nuk përbën ndonjë veçanti për shqipen, por drejtshkrimi si i trajtës përfaqësuese, edhe i disa trajtave kryesore të fjalëve rrezatohet drejtpërdrejt në rrafshin leksikologjik e leksikografik, duke zgjidhur së paku tri çështje të mëdha: 1) Standardizimin drejtshkrimor të fjalëve me dallim semantik dhe me ngjashmëri grafike; dihet që një opozicion fonologjik shpreh një dallim semantik leksikor (*mal*<>*mall*), ose një dallim semantik gramatikor (*dal*<>*del*); 2) dallimin e fjalëve të njësuar leksikologjikisht nga “jofjalët” me të njëjtën përbërje tingullore (lokucione, togjalështa); 3) standardizimin drejtshkrimor të glosarëve të fjalorëve normativë, shpjegues e dygjuhësh, duke filluar me *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980), që renditet në vargun e veprave kodifikuese të hartuara në një kohë shumë të shkurtër, brenda tetë vjetëve, pas Kongresit të Drejtshkrimit: *Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe* (1973), *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe* (1976), *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe* (1976), *Gjuha letrare shqipe për të gjithë* (1976), si edhe *Shenjat e pikësimit në gjuhën shqipe*. Duke përcaktuar normën drejtshkrimore të fjalëve, u përcaktua ajo normë në leksik që përjashton variantet fonetike dialektore e krahinore, shtrembërimet fonetike të fjalëve etj.; kështu është ndihmuar leksikografia, duke i lehtësuar punën për hartimin e glosarëve të atyre fjalorëve.

Në rrafshin a në drejtimin e parë, të përgjithshëm, Kongresi i Drejtshkrimit, në tërësinë e diskutimeve e të analizave dhe në thelbin e zgjidhjeve drejtshkrimore, ka pasur në themel e një lidhëse njësinë leksikore, strukturën e saj fono-morfologjike, rrënjën, temën, trajtat gramatikore dhe derivatet fjalëformuese, pra, praqitjen e saj shkrimore në trajtën përfaqësuese, në eptim (fleksion) e në fjalëformim (derivacion). Ana semantike ka shërbyer pjesërisht në disa tipe fjalësh, si te homoformat e diferencuara sipas kuptimit gramatikor të gjinisë, të tipit *këshill(ë)-a / këshill-i* (~ pedagogjik), *klas(ë)-a / klas-i* (i klasit të parë), *problem(ë)-a / problem-i* (~ shoqëror), *rregull-i / rregull-a* (~ gramatikore), *rrjet(ë)-a / rrjet-i* (~ hekurudhor; ~ i agjentëve), *trup-i / trup/ë-a* (~ e teatrit) etj., të cilat mund të shkruheshin,

po themi, edhe në të dyja trajtat njësoj: *këshill/ë,-i, klas/ë,-i, problem/ë,-i, rrjet/ë,-i*, d.m.th. me *-ë* fundore, ose *rregull,-i, trup,-i*, d.m.th. pa *-ë* fundore, por gjuha tashmë e ka bërë vetë dallimin.

Në rrafshin *a* në drejtimin *e* dytë, leksikologjik, në hulli të objektit të punës së Kongresit, që ishte si të shkruhen fjalët në variantin e njësuar të gjuhës shqipe, d.m.th. në standard, u mbajtën referate e kumtesa dhe u bënë diskutime edhe për çështje të mirëfillta të leksikut, natyrisht me synimin që të ndihmonin qëllimin kryesor, drejtshkrimin e njësuar e të përbashkët për gjithë kombin shqiptar.

Të tria parimet kryesore të pranuar për drejtshkrimin e gjuhës shqipe (fonetik-fonologjik, morfologjik e historik-tradicional) gjithashtu kanë si njësi bazë fjalën: Sipas parimit fonetik, “*fjalët* dhe pjesët e tyre të kuptimshme shkruhen ashtu siç shqiptohen në ligjërimin letrar”; sipas parimit morfologjik “*fjalët* dhe pjesët e tyre përbërëse të sistemit trajtëformues e fjalëformues ... shkruhen njësoj, pavarësisht nga ndryshimet tingullore të shkaktuara prej ligjeve fonetike që veprojnë sot në gjuhën tonë”; sipas parimit leksikor kuptimor e historik-tradicional ruhen trajtat *e fjalëve* të motivuara nga ana leksiko-senantike ose nga ana etimologjike e të ngulitura prej kohësh⁶. Pra, është pranuar veçan edhe një parim leksikor kuptimor. Në kapitujt e “Drejtskrimit të gjuhës shqipe” “është trajtuar në radhë të parë leksiku i përgjithshëm”⁷. Edhe në Rezolutën e Kongresit përmendet shkrimi *i fjalëve* me burim të huaj (nga gjuhët klasike etj.), shkrimi *i fjalëve* bashkë ose ndaras dhe bashkë ose me vizë në mes, ndarja *e fjalëve* në fund të rreshtit etj.⁸ Edhe vetë formulimi i rregullave të drejtshkrimit mbi bazën e fjalëve dhe, pas kësaj, hartimi *i fjalorit*⁹ drejtshkrimor, flasin gjithashtu për truallin leksikologjik ku u mbështetën trajtimi i dukurive dhe zgjidhjet që dha Kongresi.

Vendin qendror të fjalës në arsyetimin e zgjidhjeve drejtshkrimore e dëshmojnë edhe vlerat që marrin disa kategori e paradigma leksikore, si semantika leksikore, homonimia etj. Drejtshkrimi, në pajtim me kriteret e pranuar, pasqyron jo vetëm përbërjen fonetike të fjalëve (si *zemra* // *zëmra* me kuptime të ndryshme, ose *fillozofi* // *filozofi* me të njëjtin kuptim), por edhe përbërjen e tyre morfematike. Drejtshkrimi u përgjigjet dallimeve kuptimore të njësitë fono-leksikore me anë të mjeteve a të formanteve që shprehin kuptime gramatikore dalluese për kuptimet leksikore, si gjinia, numri etj. Kështu është zgjidhur drejtshkrimi i homoformave me semantikë leksikore të lidhur (sikurse u përmendën më lart: *klas/ë,-a* // *klas,-i, rregull,-i* // *rregull,-a, rrjet/ë,-a* // *rrjet,-i, trup,-i* // *trup/ë,-a* etj.), si dhe disa raste të rralla që dallohen nga theksi (*flámur* – *flámuj* // *flamúr* – *flamúrë*)), ose i homoformave pa semantikë të lidhur (*at/ë,-i* “baba” // *at,-i* “kalë” etj.).

Ka dallime fonetike që pasqyrohen në drejtshkrim për fjalë, le të themi, pa ndonjë kundërvënie a dallim semantik, si disa fjalë që nisin me *c* a me *ç*, ose i kanë këta tinguj në trup (*cakërroj* // *çakërroj, capë* // *çapë, capit* // *çapit, cek* // *çek, cërre* // *çërre, cik* // *çik, cikërrimë* // *çikërrimë* ..., po edhe fjalë të huazuara nga latinishtja ose nga gjuhët neolatine: *cefalopodë* // *çefalopodë, celebroy* // *çelebroy, celulozë* // *çelulozë, censurë* // *çensurë, centimetër* // *çentimetër, central* // *çentral, centrist* // *çentrist, ceremoni* // *çeremoni, cerebral*

⁶ Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1973, Parathënie.

⁷ Po aty, Parathënie.

⁸ Rezoluta e Kongresit të Drejtshkrimit, në “Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe”, I, Tiranë, 1973, f.194.

⁹ Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe, Tiranë, 1976.

// *çerebral, certifikatë // çertifikatë, ciklon // çiklon...*; *cist // çist, cisternë // çisternë, citadelë // çitadelë ...*; *çuk // cuk, çikërrimë // cikërrimë, çimento // cemento* etj.); po përmendim alternimin funksionalisht i ngjashëm *e // ë* (*argjend // argjënd, brenda // brënda, i dendur // i dëndur, dhen // dhën, femër // fëmër, fle // flë, gjemb // gjëmb, gjendje // gjëndje, kuvend // kuvënd, pendë // pëndë, qen // qën, qendër // qëndër, qengj // qëngj, kam qenë // kam qënë, shemb // shëmb, shembull // shëmbull, i shenjtë // i shënjtë, i shtrembër // i shtrëmbër, thembër // thëmbër, vend // vënd, i vrenjtur // i vrënjtur* etj.); po ashtu alternimi *l // ll* (*ambulancë // ambullancë, analogji // anallogji, atlas // atllas, balonë // ballonë, balsam // ballsam, biologji // biollogji, bulon // bullon, diplomë // dipllomë, celofan // cellofan, flotë // fllotë, gjeolog // gjeollog, holandez // hollandez, ideologji // ideollogji, kolonë // kollonë, kolos // kollos, logjikë // llogjikë, lotari // llotari, luks // lluks, lustër // llustër, psalm // psallm, spekuloj // spekulloj* etj.); i tillë është edhe alternimi *â // ë* (*kâmbë // këmbë, nânë // nënë, mân // mën, i mâjtë // i mënjtë, zâni // zëri* etj.). Në këto raste shkrimi me *c a ç*, me *ll a l*, me *e a ë*, me *â a ë* është thjesht konvencional, nuk dallon njësi semantikisht me kuptime të ndryshme, mjafton të jetë drejtshkrim i njësuar, mund të lidhet ose jo me shqiptimin më të përgjithshëm, gjithsesi nuk ka kushtëzime semantike. Ndërkaq, edhe brenda këtyre dukurive të rregullta, kategoriale, ka raste të dallimit semantik e për rrjedhim drejtshkrimi është i ndryshëm (*mend* “mendje” < > *mënd* “vë të voglin e një kafshe të pijë sisë tek e ëma”; *nënë* “grua kundrejt fëmijës së vet” < > *nenë* “lakër e egër me kërcell të gjatë e me gjethe të gjera...”; *dhëmb* “secila nga eshtrat e vogla të ngulura në nofullat e njeriut e të kafshëve...” < > *dhemb* “ndiej në trup diçka që më mundon, më ther...”; *zemër* “organ qendror i qarkullimit të gjakut te njeriu e te kafshët...” < > *zëmër* “koha midis drekës dhe darkës; e ngrënë e lehtë në këtë kohë”; *atë* “baba” < > *at* “kalë”; *ndiej* (me *i*) “provoj në trup një ngacmim a një gjendje fizike të caktuar...” dhe *ndjej* (me *j*) “i fal me dashamirësi një faj a një gabim diku...” etj. Kështu, drejtshkrimi i ndryshëm kushtëzohet nga semantika e ndryshme e njësive leksikore (që mund të kenë edhe etimologji të ndryshme ose vijnë nga zbërthimi i polisemisë, sikurse shembujt më sipër *rrjet/ë,-a // rrjet,-i* etj.) dhe bëhet formë dalluese grafike e tyre, përveç shumë rasteve të tjera, të njohura si opozicione të pastra fonologjike (*mel* < > *mol* < > *mal* < > *mall* < > *marr* etj.); me këto nuk do të merremi më tej këtu, pasi në “Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe”¹⁰ janë trajtuar sipas kriterit fonetik dhe dallimi semantik e drejtshkrimit është i qartë.

Semantika leksikore kushtëzon disa zgjidhje drejtshkrimore. Le të përmendim këtu shkrimin e fjalëve ndaras, bashkë dhe me vizë në mes: “nuk e kam fjalën për këtë herë, por për *atë herë* që s’erdhe” // “meqë nuk po vjen, *atëherë* unë po kthehem në shtëpi”; “*që kur* erdhe ti...” // “e ka njohur *qëkur*”; “lejohej vetëm *një herë* në ditë” // “na ishte *njëherë* një plak.”; “kjo punë ka *që kur* (*qysh kur*) ra shi” // “kam *qëkur* (*qyshkur*) që po pres”; “për se është fjala?” // “përse nuk erdhi?”; “nga se bëhet letra?” // “nuk erdhi *ngase* nuk kish kohë”; “në se qëndron ndryshimi midis A-së dhe B-së?” // “nëse nuk vjen, më shkruaj”; “ndër sa e sa çështje që u shqyrtuan, vetëm dy ishin të rëndësishme” // “ndërsa po bisedonim, e lajmëruan të nisej”; “s’di se sa do të vazhdojë kjo kohë e keqe” // “më mirë fitues sesa humbës” etj.

¹⁰ Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe, Tiranë, 1973, si edhe Fjalor drejtshkrimit i gjuhës shqipe, Tiranë, 1976.

Përkundrejt kushtëzimeve leksiko-semantike të drejtshkrimit të fjalëve, qëndrojnë kushtëzimet gramatikore, si trajta e mbaresave (p.sh. *j // nj: punoj // punonj; e // a: grushte // grushta; ua // ue: punuar // punue-*; paskajorja: *me punue* e shumë të tjera, me të cilat gjithashtu nuk do të merremi këtu).

Ky realitet shkencor motivoi edhe mbajtjen e disa kumtesave e të diskutimeve për çështje të leksikut, të frazeologjisë e të semantikës leksikore të shqipes së sotme në një seksion të veçantë të Kongresit, në shërbim të argumentimit shkencor të zgjidhjeve e të vendimeve të Kongresit.

Punimet e Kongresit, referatat, kumtesat e diskutimet, krijuan një sistem të plotë e të rregullt rezultatesh shkencore, që mbështeteshin në një përgatitje serioze organizative e shkencore dhe që i bënë të sigurt zgjidhjet e vendimet e tij. Këtu përfshihen gjithë nënsistemet e gjuhës shqipe, të vështuara në dritën e arritjeve më të mira të gjuhësisë shqiptare dhe të teorisë së gjuhëve standarde në Evropë. Grupin e parë të materialeve të Kongresit e përbëjnë referatat e seancave plenare dhe një pjesë e kumtesave që trajtuan çështje të përgjithshme të “gjuhës letrare të njësuar shqipe”, të historisë së formimit e të zhvillimit të saj, të bazës dialektore e të bashkëveprimit ndërdialektor, të tipareve themelore, të përdorimit në praktikën gjuhësore etj.¹¹ Grupin e dytë të materialeve të Kongresit e përbëjnë kumtesat e diskutimet që u kushtohen çështjeve të drejtshkrimit në aspektin fonetiko-fonologjik, si problemeve të drejtshkrimit të zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve në tipe të ndryshme fjalësh e rrokjesh dhe në pozicione të ndryshme lidhur me theksin, me tinguj të tjerë etj.¹² Grupin e tretë të materialeve të Kongresit e përbëjnë kumtesat e diskutimet për çështje të drejtshkrimit në aspektin gramatikor, kryesisht morfologjik¹³. Të lidhura me këto materiale, por në një grup më vete janë kumtesat e diskutimet për çështje të drejtshkrimit në njësi leksikore, kategori leksiko-gramatikore e klasa fjalësh të caktuara, që dallohen për veçori të fushës konceptore ose të semantikës së tyre. Këtu mund të ndajmë disa nëngrupe: a) Fjalë sipas burimit, si fjalë të huazuara nga latinishtja, nga gjuhët romane, nga greqishtja, nga gjuhët sllave, nga gjermanishtja e nga anglishtja, përfshirë këtu edhe emrat e përveçëm prej këtyre gjuhëve, si edhe emrat e përveçëm të vetë gjuhës shqipe¹⁴. Edhe pse nuk trajtohet veçan e drejtpërdrejt çështja e normës gjuhësore në leksik, nga parimet e pranuar dhe nga shembujt e përzgjedhur kuptohet tërthorazi se cilat janë fjalët a klasat e fjalëve të përvetësuara tashmë nga shqipja. Për këtë qëllim janë shfrytëzuar jo vetëm “Rregullat e drejtshkrimit...”, 1967, por edhe burime të tjera, që nga autorët e vjetër, nga letërsia artistike në shekuj, nga tekstet shkollore, nga fjalorët, nga ligjërimet e folura popullore etj. (sipas burimit të Kartotekës së leksikut të gjuhës shqipe në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë). Krahasset ndërmjet shqipes e gjuhëve huazuese japin gjithashtu ndihmesa të rëndësishme

¹¹ Këto materiale përfshihen në vëllimin e parë të botimit “Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe”, I, Tiranë, 1973.

¹² Vep. e cit., vëll. II, Tiranë, 1973, f. 5-235.

¹³ Po aty, f. 323-351.

¹⁴ Pashko Geci, *Mbi shkrimin e fjalëve të huazuara nga latinishtja*, në “Kongresi i Drejtshkrimit...”, II, f. 247-254; Kolë Ashta, *Mbi shkrimin e fjalëve të burimit latin, që kanë një ct (=kt) të ndjekur nga -io*, po aty, f. 263-270; Fadil Podgorica, *Mbi disa çështje kryesore të drejtshkrimit të fjalëve të huazuara nga gjuhët romane*, po aty, f. 255-262; Stefan Prifti, *Mbi shkrimin e fjalëve të huazuara nga greqishtja*, po aty, f. 271-282; Xhevat Lloshi, *Emrat e përveçëm të gjuhëve sllave në drejtshkrimin e shqipes*, po aty, f. 283-298; Josif Kole, *Mbi drejtshkrimin e fjalëve të prejardhura nga gjermanishtja dhe të emrave të përveçëm gjermanë*, po aty, f. 299-308; Thanas Shkurti, *Mbi drejtshkrimin e fjalëve të huazuara nga anglishtja*, po aty, f. 309-316.

shkencore për zbulimin e aftësive asimiluese të shqipes dhe për proceset që ndodhin gjatë këtij asimilimi. b) Fjalë të kategorive leksiko-gramatikore, si përemrat, parafjalët, lidhëzat, numërorët, pjesëzat, pasthirrmat, përfshirë edhe nyjat¹⁵. Duke u marrë me drejtshkrimin e këtyre kategorive, në kumtesa ndriçohen disa veçori të strukturës morfematike e fjalëfomuesë të fjalëve dhe formulohen madje kritere ku mbështeten zgjidhjet drejtshkimore, si kriteri semantik, kriteri strukturor-fjalëfomues dhe kriteri i formësimit gramatikor, - dy të parat kritere të fushës leksikore¹⁶. c) Fjalë e togfjalësha analogjike me emrat e përveçëm, që i bashkon shkrimi me shkronjë të madhe, si emërtimet e institucioneve shtetërore dhe të organizatave shoqërore, titujt e librave, të gazetave, të revistave dhe emërtimet e veprave të artit e të monumenteve historike, emërtimet gjeografike, të periudhave e të dokumenteve historike¹⁷. E natyrës leksiko-semantike mendoj se duhet pranuar këtu edhe përbërësja kuptimore (sema) që i referohet kuptimit të përveçëm të këtyre fjalëve a të togfjalëshave, semë, sipas meje, jo vetëm e thjesht gramatikore. ç) Fjalë e togfjalësha të karakterizuar sipas formimit e strukturës së tyre, si kufijtë e njësisë leksikore, fjalët e përbëra, lokucionet ndajfoljore e parafjalore, shkurtesat, rrokjezimi i fjalëve (ndarja në fund të rreshtit)¹⁸. Këtu dallohen rastet e përngjitjes (*ndonëse, megjithëse, meqenëse, gjithmonë...; tungjatjeta, lamtumirë...*) nga format analitike të tipit lokucion (*që nga, duke qenë se, në qoftë se, për së gjeri...; udha e mbarë, mirë se erdhët...*). Duke mbajtur gjithnjë si njësi bazë fjalën, janë vënë në dukje tiparet e saj themelore, që kushtëzojnë edhe disa zgjidhje drejtshkimore, si *kuptimi leksikor i mëvetësishëm e tërësor* (krhs. *sy i zi dhe syzi*), *struktura e mbyllur* (krhs. *e lulediellit, e vajgurit, pesëkatësh-e, aktakuz/ë-a, i pasluftës, hyrjedaljet, tiktaku...*, por: *lule dielli, vaj guri, qytet-muze, vinç-urë...*), *shkuptimësimi i gjymtyrëve* (*nëqoftëse, meqenëse, tungjatjeta, besëtyt ...*), *humbja ose zbehja e lidhjeve të brendshme leksiko-gramatikore ndërmjet gjymtyrëve përbërëse* (krhs. *qysh kur dhe qyshkur, për se dhe përse...*) dhe *faktori akcentologjik* (krhs. *krahëhapur dhe shkel e shko*)¹⁹.

Të lidhura mjaft ngushtë me aspektin leksiko-semantik të fjalëve dhe të disa njësive të tjera gjuhësore (togfjalësha a sintagma) janë disa shenja konvencionale në drejtshkrim, si viza

¹⁵ Mikel Zavalani, *Disa çështje të drejtshkrimit të përemrave pronorë*, në “Kongresi i Drejtshkrimit...”, II, f. 337-342; Xhemal Meçaj, *Mbi përdorimin e shkronjave të mëdha tek disa përemra vetorë dhe pronorë*, po aty, f. 461-464; Sefedin Trungu, *Mbi përsëritjen e nyjeve, të parafjalëve e të pjesëzave para gjymtyrëve të bashkerenditura*, po aty, f. 401-406; Spiro Floqi, *Drejtshkrimi i lidhëzave bashkë ose ndaras*, po aty, f. 377-384; Çelik Petriti, *Çështje të drejtshkrimit të numërorëve*, po aty, f. 351-356; Engjëll Angoni, *Disa çështje të drejtshkrimit të pjesëzave dhe të pasthirrmave*, po aty, f. 385-394; Kristaq Shtëmbari, *Rreth shkrimit të nyjës së përparme*, po aty, f. 343-350.

¹⁶ Miço Samara, *Mbi shkrimin e fjalëve me vizë lidhëse*, në “Kongresi i drejtshkrimit...”, II, f. 369.

¹⁷ Remzi Pernaska, *Përdorimi i shkronjave të mëdha në emërtimet e institucioneve shtetërore dhe të organizatave shoqërore*, në “Kongresi i drejtshkrimit...”, II, f. 407-416; Dhori Qirjazi, *Mbi përdorimin e shkronjave të mëdha në titujt e librave, të gazetave, të revistave dhe në emërtimet e veprave të artit e të monumenteve historike*, po aty, f. 417-422; Sofika Morcka, *Përdorimi i shkronjave të mëdha në emërtimet gjeografike të përbëra*, po aty, f. 423-430; Nesti Bellovoda, *Mbi drejtshkrimin e njësuar të emrave gjeografikë të vendit tonë*, f. 431-436; Kolë Luka, *Rreth drejtshkrimit të emrave të përbërë të makro- dhe të mikrotoponimisë*, po aty, f. 437-448; Gaqo Peci, *Mbi drejtshkrimin e emërtimeve të periudhave dhe të dokumenteve historike*, po aty, f. 449-454.

¹⁸ Jani Thomai, *Mbi kufijtë e fjalës në gjuhën shqipe*, në “Kongresi i drejtshkrimit...”, II, f. 357-366; Miço Samara, *art. i cit.*, f. 367-376; Sofika Morcka, *art. i cit.*; Kolë Luka, *art. i cit.*; Bajram Hajrullaj, *Rreth drejtshkrimit të lokucioneve ndajfoljore dhe parafjalore*, po aty, f. 395-400; Drita Garuci, *Mbi drejtshkrimin e shkurtimeve*, po aty, f. 475-484; Zhaneta Nova, *Mbi ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit*, po aty, f. 485-490; Lajde Staku, *Mbi disa çështje të ndarjes së fjalëve në fund të rreshtit*, po aty, f. 491-496.

¹⁹ Jani Thomai, *art. i cit.*, po aty, f. 358-365.

lidhëse, apostrofi dhe shkronja e madhe. Kongresi i Drejtshkrimit orientoi drejt përdorimit vetëm funksional të tyre. Kështu, viza lidhëse dallon fjalët e përbëra me bashkërenditje nga ato me nënrenditje, nga togfjalëshat e ngjashëm dhe nga lidhja e dy fjalëve që nuk formojnë kompozitë (krhs. *kryeqytet, zemërgur, qafëgjatë.../ pjesë-pjesë, pikë-pikë.../ vajtje-ardhje, kuaj-fuqi, tekniko-shkencor.../ veri-jug, Tiranë-Durrës...*). Shembulli më domethënës i kushtëzimit semantik për zgjidhjen drejtshkrimore të pranuar është te “marrëdhëniet *italo-shqiptare*” - marrëdhëniet ndërmjet Italisë e Shqipërisë // “letërsia *italoshqiptare*” - letërsia e arbëreshëve të Italisë, e *italoshqiptarëve*. Apostrofi, më parë i përdorur në më shumë raste, tashti, sido që i rrallë, dallon fjalët nga formantet ose dy njësi ndërmjet tyre (krhs. *ç*’do këtu? / *ç*do njeri...; *ç*’ka për t’u çuditur? / *ç*ka, s’është keq..., çrregullim; *s*’vij / shkronja *s*; do *t*’i them... / *ti* e *di* ...). Shkronja e madhe dallon fjalët shënuese relative (emrat e përveçëm) nga fjalët shënuese kuptimplota (krhs. *agim / Agim, petrit / Petrit* ...).

Ky grupim mëton të sjellë këndin e vështrimit leksikologjik të shprehur në trajtimin e çështjeve drejtshkrimore, duke e vënë fjalën nën lentin e analizave shkencore në Kongresin e Drejtshkrimit. “Çështja e fjalës – kam shkruar atëherë – lidhet me shumë rregulla të drejtshkrimit. Edhe rregulla të tjera drejtshkrimore për çështje të veçanta fonetike, si për zanoret e bashkëtingëlloret, i shqyrtojnë këta tinguj jo të shkëputur, por si elemente të fjalës, në trup të saj dhe në funksion të saj... Por më drejtpërdrejt me këtë njësi lidhen rregullat për shkrimin e fjalëve bashkë, ndaras ose me vizë në mes”²⁰. Kumtesat e diskutimet rreth tyre sollën arsyetime e shembuj për kategoritë, klasat e fushat leksikore e leksiko-gramatikore, që krijuan bindjet shkencore për zgjidhjet drejtshkrimore në hartimin përfundimtar të rregullave të drejtshkrimit të gjuhës letrare shqipe të njësuar, e cila tashmë e ka fituar statusin e gjuhës standarde.

Kështu, Kongresi i Drejtshkrimit i ka mbështetur zgjidhjet drejtshkrimore në pajtim me natyrën, tiparet e veçoritë e njësive leksikore e semantike të gjuhës shqipe.

²⁰ Jani Thomai, *art. i cit.*, po aty, f. 357.

GJUHA STANDARDE SHQIPE DHE NJËSIA KOMBËTARE

Në jetën e secilit komb, në planin e ruajtjes së njësisë kombëtare, njëkohshëm ndikojnë faktorë konvergjentë dhe divergjentë. Të parët e ushqejnë njësinë e kombit, duke e mbajtur si një strukturë homogjene, ndërsa të dytët e vënë në sprovë strukturën e përbashkët kombëtare duke bërë që, në jo pak raste, të krijohen edhe kombe të veçanta. Shqiptarët, ndonëse të përballur me mjaft faktorë divergjentë, sikurse janë përkatësitë e ndryshme fetare, krahinore, me një trashëgimi të theksuar të organizimit parcializues feudal, me pamundësinë e komunikimit të lirshëm ndërmjet viseve shqiptare që rëndom ishin nën sisteme qeverisëse të huaja, ia dolën të ruajnë në pjesën më të madhe të pacenuar njësinë e tyre kombëtare. Kur them se e kanë ruajtur nënkuptoj faktin se nuk u krijuan asnjëherë dy kombe, ndonëse pati raste të asimilimit të shqiptarëve nën ndikimin e elementëve të kombeve fqinje. Si rezultat i kësaj vetëm gjatë shekullit XX kemi një numër të konsiderueshëm shqiptarësh të boshnjakëzuar në trevat shqiptare të Malit të Zi (Tivar, Ulqin, Plavë, Guci) të Sanxhakut (Rrafshnalta e Peshterit e deri te Novi Varoshi), janë sllavizuar shqiptarët ortodoksë të Rekës në Maqedoninë e sotme dhe janë greqizuar një numër i konsiderueshëm shqiptarësh, po ashtu ortodoksë, në trojet etnike të Shqipërisë Jugore.

Pa u ndalur në sqarimin e këtyre faktorëve që historikisht e kanë cenuar unitetin e njësisë kombëtare, shto këtu edhe veprimet e planifikuara të dhunës së pushtuesve, duhet thënë se njëkohësisht kanë ndikuar fuqishëm edhe faktorët përbashkues, të cilët kanë përcaktuar këtë strukturë kombëtare të shqiptarëve si një realitet i veçantë në tërësinë e popujve të Evropës. Gjuha shqipe ka qenë faktori më përcaktues për ruajtjen e veçantive të shqiptarëve dhe madje vendimtar në fazën para krijimit të vetëdijes kombëtare. Shqipja i bënte të dallueshëm folësit e saj nga të gjithë pjesëtarët e popujve përreth tyre. Pavarësisht dallimeve të theksuara, dialektet e shqipes nuk afroheshin me gjuhët e popujve të tjerë më shumë se ç'largoheshin nga njëri-tjetri dhe ky ka qenë faktori thelbësor i kohezionit tonë kombëtar. Nëse gjuha shqipe ka qenë faktori mbrojtës përballë identifikimit etnik dhe shkrirjes me të tjerët, gjuha standarde shqipe në stadin tonë kombëtar, përkatësisht në stadin e krijimit të vetëdijes kombëtare, shfaqet si domosdoshmëri për zhvillimin modern krahas kombeve të tjera të Evropës. Megjithatë, gjuha standarde shqipe, për shqiptarët e mbetur jashtë kufijve të shtetit amë, ka vijuar të luajë rolin identifikues të pjesës së shkëputur nga tërësia, me amën e saj, duke pasur për një kohë, krahas përmasës të zhvillimit kulturor e shoqëror, edhe funksionin e mbrojtjes së veçorive kombëtare. Shqipja standarde këtë funksion vijon ta ushtrojë madje edhe sot për pjesët tona kombëtare që kanë mbetur jashtë strukturave shtetërore shqiptare. Prandaj, gjuha standarde e krijuar para 40 vjetësh, përveçse arritja më e madhe kombëtare në fushën e kulturës dhe komunikimit gjithëkombëtar, është hapi i parë, pas një varg procesesh të përimitësimit të qenies sonë kombëtare, në drejtim të konsolidimit të njësisë kombëtare në përmasën e saj objektive. Ndonëse ishte edhe shfaqje e vullnetit për të konsoliduar identitetin e cenuar kombëtar, Kongresi i Drejtshkrimit, në rend të parë, ishte produkt i nevojës që kërkonte niveli i zhvillimit të njërit prej kombeve më të lashta të Evropës.

Madje, nevoja për standardizimin e shqipes ishte shfaqur paralelisht me krijimin e vetëdijes kombëtare te ne. Rilindësit tanë e kishin të qartë se për të krijuar njësinë funksionale kombëtare ishte e domosdoshme që të përdorej një alfabet unik dhe një gjuhë letrare a standarde për komunikimin efektiv në mbarë hapësirën etnike shqiptare. Duke qenë një komb i veçantë, pa afrime të ndjeshme kulturore e gjuhësore me popuj të tjerë, ishte e natyrshme që në rastin e shqiptarëve të zbatohet formula një komb – një gjuhë standarde, duke marrë parasysh faktin që kemi edhe formulën tjetër, kur një gjuhë standarde përdoret nga disa kombe të veçanta, ose kur si gjuhë standarde te disa popuj me zhvillim të vonuar shoqëror shërben ndonjëra nga gjuhët botërore, përkatësisht gjuha e kolonizatorëve të dikurshëm.

Standardizimi i shqipes, përtej faktit se siguronte një funksion komunikues për mbarë hapësirën etnike shqiptare, pati edhe dimensionin e theksuar si simbol i identitetit kombëtar, sikurse edhe të rikonstruktimit të njësisë së cenuar kombëtare. Gjuha standarde shqipe, e njohur më shumë në të kaluarën me togfjalëshin *gjuhë letrare shqipe*, në mesin e shqiptarëve të papërfshirë brenda shtetit amë jo në pak raste do të shërbente si një vlerë identiteti kompensues për mohimin e simboleve të identitetit kombëtar, sikundër ishin flamuri dhe himni kombëtar shqiptar. Zbatimi i gjuhës standarde shqipe në të gjitha hapësirat tona etnike dhe përgjithësisht në komunikimin publik të përdoruesve të shqipes ishte dhe mbetet njëra ndër format më të rëndësishme të ruajtjes dhe të zhvillimit të mëtejshëm të njësisë kombëtare shqiptare, pa mohuar faktin se mbetet një kusht i domosdoshëm për zhvillimin e të gjitha mundësive kulturore e shoqërore në botën shqiptare. Gjuha standarde shqipe është forma më e pranueshme edhe për komunikimin ndërkulturor të shqiptarëve me kombet e tjera.

Ideali kombëtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit para 100 vjetësh u realizua pjesërisht jo për faktin se shqiptarëve u mungonte vullneti dhe projekti që të realizonin shtetin e tyre në kufijtë etnikë, por ishin interesat e Fuqive të Mëdha ato që e cenuan njësinë territoriale, etnike e kulturore të shqiptarëve, që nuk e morën parasysh vullnetin e tyre për të jetuar të pavarur dhe në një shtet të përbashkët. Ky vullnet dhe kjo aspiratë u rishfaq fuqishëm në përpjekjet për të krijuar një trajtë bashkimi funksional gjuhësor, i cili do të mbajë gjallë idenë më të fuqishme në jetën e shqiptarëve – idenë e bashkimit kombëtar.

GJUHA SHQIPE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Qëllimi kryesor i kësaj kumtese është të paraqitim gjendjen e gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë, si nga aspekti i statusit, ashtu edhe nga aspekti i përdorimit. Në fillim, fare shkurtimisht do të themi diçka për atë se ku dhe cilat të folme shqipe fliten në Maqedoni, si dhe diçka për shqipen e shkruar.

Të folmet shqipe në Maqedoni shtrihen në një hapësirë mjaft të madhe: në perëndim nga vija kufitare me Shqipërinë (Ohri, Struga, Dibra duke vazhduar më në jug deri në Prespë), kurse në veri me Kosovën dhe Serbinë, në lindje depërtojnë deri në Maqedoninë Qendrore (rrethi i Prilepit, i Krushevës dhe i Velesit). Në pjesën veriperëndimore, përkatësisht në rrethin e Strugës në 5 lokalitete (Ladorisht, Frëngovë, Shum, Kalisht dhe Zagraçan), si dhe në disa lokalitete të rrethit të Manastirit si në Nizho Pole, Kishavë etj., flitet toskërisht. Toskërisht flitet edhe në të gjitha fshatrat e Prespës. Të gjitha të folmet e zonave të tjera i përkasin dialektit të gegërishtes. Një pjesë e këtyre të folmeve i takojnë të ashtuquajturës gegërishte qendrore, kurse disa gegërishte verilindore. Me këtë rast vlen të theksohet se në Maqedoni flitet edhe një e folme gegërishte e një tipi të veçantë. Këtu hyjnë e folmja e Rekës, ku përfshihen edhe disa fshatra të rrethit të Gostivarit, Shkupit dhe Velesit (Jabollçisht). Si tipar më karakteristik i kësaj së folmeje është evoluimi i mëtejshëm i tingujve **q** dhe **gj** (*qyqe* > në të folmet e rrethit të Tetovës *çiçe*, kurse në të folmen e Rekës > *shyshe*). Ndërkaq karakteristikë e të folmeve të Maqedonisë Veriperëndimore është diftongimi i zanoreve **i** dhe **u** të theksuara në diftongjet **au**, **ai**, **ei** dhe rrallë **oi** (*rrush* > *rraush*, *mirë* > *mair*, *mëir* etj.).

Gjuha shqipe e shkruar në Maqedoni fillon të përdoret gjatë viteve 40 të shekullit të kaluar, kur u hapën shkollat e para në gjuhën shqipe dhe kur kjo gjuhë u bë gjuhë e administratës në Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Dibër dhe Strugë. Pas Luftës së Dytë Botërore shkollat shqipe u hapën thuajse në të gjitha vendbanimet e banuara me shqiptarë. Atëherë fillojnë të botohen edhe tekste shkollore, fillon të dalë gazeta *Flaka e vëllazërimit*, transmetohen në radio emisione në gjuhën shqipe. Në fakt nëpër institucionet në fjalë përdorej gjuha e trashëguar, ajo që u përdor edhe gjatë luftës dhe menjëherë pas saj. Bëhet fjalë për gegërishten e mesme të bazuar në të folmen e Elbasanit. Sa i përket gjuhës së shkruar, duhet theksuar se në Maqedoni, në mungesë të institucioneve përkatëse, ku trajtohen çështjet e gjuhës zyrtare, gjithnjë është ndjekur parimi të përdoret gjuha që përdoret në shtetin amë. Kështu në Maqedoni pas botimit të Projektit të rregullave të drejtshkrimit të shqipes, dy vjet para se të mbahej Konsulta Gjuhësore në Prishtinë, *Flaka e vëllazërimit* kishte filluar të dalë në gjuhën e sotme. Pas Kongresit të Drejtshkrimit nëpër të gjitha institucionet përdoret shqipja letrare apo standarde. Shqiptarët tanimë në të gjitha nivelet e arsimit mësojnë dhe studiojnë në gjuhën shqipe. Gjuha dhe letërsia shqiptare, si program studimor, studiohen në tre universitete, kurse në rrethanat e reja shoqërore (nevoja për përkthyes), sollën krijimin e një programi studimor për drejtimin e përkthimit nga shqipja në maqedonisht dhe anasjelltas (Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe - Fakulteti i Filologjisë “Bllazhe Koneski” - Shkup), ku përveç shqiptarëve studiojnë edhe studentë që gjuhën shqipe nuk e kanë gjuhë

amtare. Një ngjarje e rëndësishme lidhur me gjuhën shqipe në Republikën e Maqedonisë, ishte themelimi i Institutit të Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore të shqiptarëve në vitin 2007.

Sot në Maqedoni çështja e gjuhës shqipe si nga aspekti juridik, ashtu edhe nga ai linguistik paraqet si një çështje mjaft delikate. Edhe pse viteve të fundit u shënuan përparime në sferën e përdorimit të shqipes, nga aspekti juridik mbetet i paqartë statusi i saj. Të flasësh për statusin e gjuhës shqipe në Maqedoni, patjetër duhet t'i referohesh statistikës. Përcaktimi i numrit të saktë të popullsisë së Maqedonisë paraqet një problem mjaft serioz, si statistikor, ashtu edhe shoqëror. Themi problem, sepse në Maqedoni realizimi i procesit të regjistrimit të popullsisë vite me radhë nuk është më çështje e statistikës, por problem politik dhe shoqëror. Regjistrimi nuk mund të realizohet për shkak se faktorët politikë nuk mund të merren vesh se kush duhet të përfshihet në regjistrimin e popullsisë. Dhe këtu përsëri problemi paraqitet kryesisht te popullata shqiptare – një pjesë e shqiptarëve të Maqedonisë jetojnë dhe punojnë jashtë vendit, por lidhjet e tyre me vendlindjen janë shumë të forta dhe të dendura (ata janë shtetas të Maqedonisë, shtëpitë i ndërtojnë në vendlindje, vendlindjen e vizitojnë relativisht shpesh, gjatë pushimeve rregullisht qëndrojnë në vendlindje). Për këtë arsye, si edhe për disa të tjera (p.sh. mosbesimi i shqiptarëve ndaj institucioneve shtetërore), procesi i regjistrimit po anulohet në vijimësi. Kështu, nxjerrja e të dhënave për numrin e shqiptarëve në Maqedoni mbetet në kuadër të përllogaritjeve të tërthorta. Edhe pse tashmë flitet se në Maqedoni shqiptarët përbëjnë 25% të popullsisë, ky numër mund edhe të jetë ndryshe (nga të dhënat e Entit të Statistikës së Republikës së Maqedonisë kuptojmë se në vitin shkollor 2010-2011 nga numri i përgjithshëm 201.914 i nxënësve në shkollat fillore, 130.200 nxënës mësimin e kanë ndjekur në maqedonisht, 65.121 në shqip, 6.043 në turqisht dhe 550 në serbisht. Nga kjo statistikë del se 32% e nxënësve mësojnë në gjuhën shqipe. Në shkollat e mesme, po në atë vit shkollor, nga gjithsej 24.846 nxënës, e kanë ndjekur mësimin në maqedonisht 17.650 nxënës, në shqip 6.601, në turqisht 329 dhe në anglisht 266 - pra del se rreth 26% e nxënësve mësojnë në gjuhën shqipe). Me ndryshimet e fundit pas Marrëveshjes së Ohrit, që u bënë në Kushtetutën e R. së Maqedonisë, statusin e gjuhës shqipe do ta kërkojmë duke deshifruar përqindjet në formulimin e nenit 7 të kësaj kushtetute: *Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj cirilik. Gjuhë tjetër të cilën e flasin së paku 20% e shtetasve, gjithashtu është gjuhë zyrtare dhe shkrimi i saj, siç është përcaktuar me këtë nen.* Emërtimi *gjuhë tjetër të cilën e flasin së paku 20% e shtetasve...* dhe shkrimi i saj në fakt i referohen gjuhës shqipe dhe shkrimit latin. Cilat janë shkaqet që gjuha shqipe të emërtohet në mënyrë kaq implicite, mbetet një enigmë. Siç shihet, nga neni i përmendur, duhet të kuptojmë se shqipja, meqë flitet nga përqindja e kërkuar, i plotëson kushtet për të qenë gjuhë zyrtare. Kështu, për ne shqiptarët e Maqedonisë mbetet disi i paqartë zyrtarizimi i shqipes. Gjuha shqipe në formë zyrtare, krahas asaj maqedonase, përdoret në kuadër të pushtetit vendor, ku shqiptarët përbëjnë shumicën e popullsisë, nëpër institucionet shtetërore, kur drejtohen nga shqiptarë (në ato ministri që drejtohen nga joshqiptarë, përdorimi i shqipes çdo herë pengohet për shkaqe banale), në foltoren e Parlamentit dhe së fundi me ndryshimet më të reja edhe në fjalimet e funksionarëve të zgjedhur nga Kuvendi.

Aspekti juridik i përdorimit të shqipes lidhet me dy momente. Nga njëra anë, gjuha shqipe në asnjë akt ligjor nuk përkufizohet në mënyrë eksplicite si gjuhë zyrtare. Nga ana tjetër edhe në përdorimin praktik zyrtarizimi nuk ndihet i plotë. Komunikimi zyrtar i qytetarit

të rëndomtë me shtetin vazhdon të bëhet në maqedonisht. Madje edhe kur zbatohet dygjuhësia, kjo reflekton probleme të natyrave të ndryshme. Terminologjia në gjuhën e veprimtarisë shtetërore e administrative është shumë e paharmonizuar; gjatë nxjerrjes së dokumenteve, si: certifikata e lindjes, letërnjoftimi, pasaporta, patenta e shoferit etj. Shqiptarët në çdo rast formularët e kërkesës nuk i plotësojnë vetëm në shqip, por në të dyja gjuhët. Gjatë transkriptimit në maqedonisht bëhen edhe gabime, kurse kur transkriptimi bëhet edhe në anglisht, për bazë merret forma në maqedonisht (p.sh. emri *Valon* në transkriptimin në anglisht del *Valjon* ngaqë *л*-ja cirilike në anglisht transkribohet *lj*).

Moszgjidhja e çështjeve juridike të gjuhës shqipe reflektohet edhe në fushën e përdorimit të saj. Themi kështu, pasi po të ishte gjuha shqipe në mënyrë të mirëfilltë gjuhë zyrtare, përdorimi i saj të do të rregullohej me një ligj të veçantë, ashtu siç është vepruar me gjuhën maqedonase, për të cilën në vitin 1998 është miratuar një ligj i posaçëm (*Ligj për përdorimin e gjuhës maqedonase*) dhe, më vonë më vitet 2008 dhe 2010, ky ligj ka pësuar ndryshime dhe plotësime. Ligji në fjalë rregullon mënyrën e përdorimit të maqedonishtes, siguron mbrojtjen e saj me ligj, parasheh formimin e një Këshilli për Mbrojtjen e Gjuhës Maqedonase, rregullon statusin e lektorit zyrtar të maqedonishtes si dhe parasheh sanksionimin edhe me gjobë për përdorimin e gabuar të gjuhës maqedonase, për botimin e teksteve të paredaktuara. Në rrethanat tona, gjuha shqipe, si një gjuhë e standardizuar, që ka rregulla të përcaktuara të përdorimit, është lënë në mëshirën e ndërgjegjes së folësve se sa këto rregulla do të respektohen. Sikur gjuha shqipe të ishte e mbrojtur me ligj dhe moszbatimi i normës të sanksionohej, sot me siguri gjuha shqipe në Maqedoni do të ishte në gjendje më të mirë sa i takon respektimit të normës. Kështu p.sh. mediat do të detyroheshin të kishin lektorë, të cilët nuk do të lejonin aq shumë shmangie nga norma. Edhe pse dinamika e dhënies së lajmit nuk lejon përkushtim hiperkorrekt në çështjet e normës, nuk duhet të lejohet që gjuha të nëpërkëmbet deri në degjenerim, siç ndodh p.sh. kur botohet diçka e përkthyer nga ndonjë makinë përkthimi.

Sot, në sajë të globalizimit dhe informatizimit të përgjithshëm, gjuha angleze ushtron ndikim të vijueshëm mbi gjuhët e tjera, por edhe mbi gjuhën shqipe. Ky ndikim veçanërisht bie në sy në sociolektet e grupeve të moshave dhe të profesioneve të caktuara (te të rinjtë, te ata që punojnë në fushën e informatikës e të marketingut). Diskursi i mediave, që supozohet të jetë i hapur, këto karakteristika stilistike i pranon shumë lehtë, qoftë në strategjinë e marketingut (reklamat), qoftë në atë populiste. Disa fjalë diku i tingëllojnë më me efekt po të thuhet në anglisht, prandaj tani edhe ne jemi mësuar që ngjarjen të na e paraqitin si *event*. Nga ana tjetër e dimë se shqipja nuk arrin të emërtojë çdo gjë të re dhe atëherë, si dhe shumë gjuhë të tjera të formatit të saj, zgjidhjen e gjen tek anglishtja. Po të shtojmë faktin se shqipja në Maqedoni ndikohet shumë edhe nga maqedonishtja, atëherë “ndotja” e shqipes bëhet më se brengosëse. Po i përsërisim disa nga ndikimet më të shpeshta: përdorimi si në maqedonisht (por në kundërshtim me normën e shqipes) i disa fjalëve si: *univerzitet*, *bazen*, *konzervativ*, *çokolladë*, *fudball*, *finans* *bilans* në vend *universitet*, *basen*, *konservativ*, *çokollatë*, *futboll*, *financa*, *bilanc* etj. Në leksikonin e shqiptarëve të Maqedonisë jo vetëm që dëgjojmë fjalë maqedonase në komunikimin e përditshëm (*dërzhava* për *shteti*, *bolnica* për *spitali*, *izvodi* për *certifikata*, *benzinska* për *pompa e benzinës* e shumë të tjera), por duke u nisur nga maqedonishtja edhe në kuadër të fjalëve shqipe, bëhen kalime të drejtpërdrejta të nocioneve, pa pasur parasysh çfarë kuptimi ka ai nocion në gjuhën shqipe, si p.sh. *dëshiroj* nga *posakuva*

(dua, kam dëshirë) në vend të *uroj*; *përcjell emisionin* nga *ja pratam emisijata* në vend të *ndjek emisionin*; përdorimi i disa emrave (kryesisht të huaj) në atë gjini që përdoren në gjuhën maqedonase e jo ashtu si përdoren në shqipen letrare: *ekipa, leksika, plazha, revolti, sindikati* në vend *ekipi, leksiku, plazhi, revolta, sindikata*; përdorimi i disa ndërtimeve, të cilat merren fjalë për fjale: *gjatë kohë* nga *dolgo vreme*, *edhe atë* nga *i toa*, *udhëheq me* nga *rakovodi so*, *disponon me* nga *raspolaga so*, *deri te* nga *do* (kur i adresohet dikujt), *me fillim në orën* nga *so poçetik vo*, *për dallim nga* nga *za razlika od* etj.; në emërtimin e institucioneve të ndryshme, kur në vend të gjinorës së shqipes përdoren format ndajshesore si në maqedonishte: *Fakulteti Filologjik* nga *Filllolloshki fakultet* në vend *Fakulteti i Filologjisë*; *Akademia Maqedonase e Shkencave dhe e Arteve* nga *Makedonska akademija na naukite i umetnostite* në vend *Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Maqedonisë*; etj.; kopjimi i strukturave maqedonase: *oborr shkollor* nga *shkollski dvor* në vend të *oborri i shkollës*, *lista zgjedhore* nga *izbirački spisok* në vend të *lista e zgjedhësve*, *Ministria për Arsim* nga *Ministerstvo za obrazovanie* në vend të *Ministria e Arsimit*; *Enti për Shëndetësi* nga *Zavod za zdravstvo* në vend të *Enti i Shëndetësisë*.

Shtrohet pyetja: si të reagojmë ndaj gjithë këtyre ndikimeve? Depërtimi aq i madh i fjalëve dhe shprehjeve të huaja e dëmton shumë gjuhën tonë, prandaj duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Shoqëria shqiptare, në radhë të parë intelektualët, duhet të kujdesen që nëpër institucione të përdoret gjuha e standardizuar. Në Maqedoni shmangie të shumta nga norma bëhen si në mediat, ashtu edhe në tekstet shkollore, apo të themi më saktë nëpër të gjitha institucionet.

Përderisa nuk kemi mbrojtje institucionale të gjuhës, në Maqedoni të gjithë duhet të mobilizohemi për mbrojtjen e gjuhës sonë, sepse kështu do të mbrojmë edhe kulturën dhe identitetin tonë.

KONGRESI I DREJTSHKRIMIT DHE JEHONA E TIJ SOT

Jemi në pragun e dy jubileve të mëdhenj të kombit: të 100-vjetorit të Pavarësisë së shtetit shqiptar dhe të 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit. Derisa jubileu i parë shënon 100 vitet e kaluara të një vendi të vogël e me sfida të mëdha, me shumë arritje, por dhe me gjysmën e popullsisë së tij jashtë kufijve të vet, jubileu i dytë, ai për të cilin edhe jemi mbledhur sot këtu, në këtë Akademi Solemne, shënon një datë tjetër të shqiptarëve dhe për shqiptarët, atë të drejtshkrimit të përbashkët për të gjithë shqipfolësit, kudo që ata jetojnë. Andaj, Kongresi i Drejtshkrimit (1972) ishte dhe mbetet, padyshim, një ngjarje e madhe, jo vetëm në jetën shkencore e kulturore, por edhe historike, të bashkimit shpirtëror e kulturor të gjithë kombit tonë. Është kongres i një rëndësie të veçantë, ku 87 delegatë nga të gjitha trojet shqiptare dhe jashtë tyre, në vitet jo edhe aq të favorshme, me bekimin e tyre dhanë “vizën” për një gjuhë të njësuar, të përbashkët për të gjithë ata që flasin dhe shkruajnë shqip. Me këtë u dëshmuar dhe një herë se shqiptarët, ashtu si dhe popujt e tjerë të Europës, kanë historinë, gjuhën dhe kulturën e tyre dhe se *nuk janë një konglomerat primitivësh që i flasin 100 dialekte e nuk merren vesh njëri me tjetrin*.²¹

Rruga deri te Kongresi i vitit 1972 nuk ishte rrugë pa leqe e pa pragje të mëdhenj, kur dihen faktorët gjuhësorë e jashtëgjuhësorë që e karakterizojnë atë kohë. Vetëm puna vetëmohuese e patriotëve, shkrimtarëve dhe dijetarëve tanë, pena të shquara të kombit, bëri që ato vështirësi e pengesa të përballohen, jo edhe pa sakrifica, herë-herë edhe me flijim të jetës së tyre. Një numër veprash e ngjarjesh arsimore, shkencore e kulturore, atëherë, ishin sihariq i mirë për një gjuhë të përbashkët shqipe në të ardhmen, e që si të tilla, pa shkuar tutje në histori, duhen përmendur: “Evëtari” (1844-1845) i Naum Vaqilharxhit; “Shoqata e të Shtypurit Shkronja Shqip” (1879), “Shkronjëtorë e gjuhës shqip” (një gramatikë toskërisht me vërejtje për të dy dialektet) dhe “Abetare e gjuhës shqipe” (1886) të Sami Frashërit; “Fjalori i Gjuhës Shqipe” (1904) i Konstandin Kristoforidhit, i botuar pas vdekjes së autorit; mbajtja e Kongresit të Manastirit (14-22 Nëntor 1908); nxjerrja e vendimeve të Komisionit Letrare të Shkodrës (1916-1918), për përdorimin e dialektit të Elbasanit si bazë për shqipen e përbashkët letrare; miratimi i vendimeve të Komisionit Letrare nga Kongresi Arsimor i Lushnjës (1920); diskutimet e ndryshme mbi bazën e përbashkët të gjuhës letrare gjatë viteve 1935-1944; hartimi i Ortografisë së gjuhës shqipe (1948) në dy variante, nga Xhuvani, Cipo, Çabej; botimi në Tiranë i një Ortografie tjetër të gjuhës shqipe (1951) e afërt me atë të vitit 1948; mbajtja e konsultave të radhës: 1956, 1964 dhe Konsulta Gjuhësore e Prishtinës (1968) në të cilën u vendos që rregullat e botuara për diskutim të merreshin si i vetmi variant i gjuhës letrare të njësuar, me të cilën edhe përfundimisht u hap rruga për mbajtjen e Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972²².

Rëndësinë e Kongresit të Drejtshkrimit dhe të vendimeve të tij, të nxjerra para 40 vjetësh, e dëshmojnë, edhe sot e tërë ditën, arritjet e pakontestueshme në ngulitjen dhe

²¹ Pandeli Majko, *Gjuhëtarët e prekur nga virusi i politikës, po tallen me gjuhën shqipe*, gazeta “Shekulli”, Tiranë, 16 korrik 2012.

²² Rexhep Ismajli, *Drejtshkrimet e shqipes*, ASHAK, Prishtinë, 2005, faqe 15-16.

zbatimin e normës gjuhësore, sidomos të normës së shkruar, gjithandej ku jetojnë shqiptarët. Përdorimi i këtij standardi: në administratë, në shkollë, në universitete, në mjetet elektronike të informimit, në botimet e dhjetëra e dhjetëra gazetave e revistave, të dhjetëra e qindra librave etj., është një fakt që dëshmon për rrënjët e thella që ka lëshuar ky standard në truallin e shqipes. Edhe shkollimi i mijëra e mijëra nxënësve, studentëve e kuadrove të tjera, i dhjetëra e qindra të huajve që edhe sot ngarendin ta mësojnë e përvetësojnë standardin e kësaj gjuhe, nuk mund të mos merren si argumente të fuqishme për statusin që gëzon shqipja dhe jehonën që ka standardi i saj, si dje ashtu dhe sot. Vendimet e drejta të Kongresit të Drejtshkrimit, në fundvitin që e lamë pas, i vulosi edhe marrëveshja ndërshtetërore mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, për fat të keq jo edhe me trojet e tjera shqiptare, për një abetare të përbashkët. *Ky do të jetë libri i parë në marrëveshjen që do të pasohet me libra të tjerë*²³, kanë sqaruar specialistët e dy ministrive të arsimit. Të kujtojmë pra, se ky libër e shumë të tjerë, si dhe këta libra “që do të pasohen” janë shkruar e do të shkruhen me këtë gjuhë e me këtë standard.

Debatet e zhvilluara, sidomos në këta dy dhjetëvjeçarët e fundit, përkitazi me vendimet e Kongresit të Drejtshkrimit, duke anashkaluar konceptet dhe qëndrimet nihiliste të ndonjë fanatiku, duhen parë si një shtytje përpara për standardin gjuhësor. Nuk na ka takuar të gjejmë në përfundimet e ndonjë tubimi shkencor, ku temë diskutimi të ketë qenë gjuha, standardi i saj, e të kërkohej një pluricentrizëm: dy, tre apo më shumë standarde të shqipes (me përjashtim të ndonjë “analisti të pavarur”, kryesisht në media, i tipit “migjenomatoshian” i cili, krahas konvertimit të popullsisë së Kosovës në “komb kosovar”, shpik dhe një gjuhë tjetër, “gjuhën kosovare”, që na kujton “zbulimet” e dikurshme të dijes serbe për “albanski jezik” në Shqipëri dhe “shiptarski a shiftarski jezik” në Kosovë dhe në trojet e tjera shqiptare që dikur ishin nën Jugosllavi, apo dhe formim standardesh në baza dialektore).

Emërues i përbashkët i të gjitha diskutimeve në nivelet më të larta shkencore, gjithnjë ka qenë mbështetja e një standardi gjuhësor për të gjithë shqiptarët, me mundësi plotësimi e përmirësimi të tij. Në këtë hulli ishte dhe mbajtja e Konferencës shkencore “*Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot*” (Tiranë, 1992); Konferenca për 25-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit (Tiranë, 1997), Konferenca e Tiranës e vitit 2002 etj.

Edhe Konferenca e Durrësit e dhjetorit 2010, një takim ndoshta më seriozi që nga viti ‘72, kushtuar normës gjuhësore, për mbajtjen e së cilës pati edhe dilema e dyshime, me pjesëmarrjen e atyre 40 specialistëve, nuk kontestoi rëndësinë dhe nuk kërkoi ndarje të standardit të shqipes. Këtë e argumenton edhe ndonjëra nga 12 pikat e përfundimeve të Konferencës, sidomos aty ku thuhet se: *...standardi gjatë gjithë këtyre viteve e ka dëshmuar vlefshmërinë e tij*, porse *...shqipja, ashtu si të gjitha gjuhët e lëvruara, ka nevojë që t’i nënshtrohet periodikisht një shqyrtimi shkencor lidhur me funksionimin e sistemit në të gjitha segmentet e saj*²⁴ - thuhet në vazhdim.

Megjithatë, frika dhe dyshimi për shthurjen e standardit të sotëm në këtë Konferencë, kishin turbulluar mendjet edhe të gjuhëtarëve e letrarëve më të shquar shqiptarë. Jo vetëm para, por edhe në kulmin e punës së Konferencës (më 16 dhjetor 2010), në mediat e shkruara

²³ Abetare e njëjtë për Shqipërinë e Kosovën, gazeta “Panorama”, Tiranë, 23.10.2011.

²⁴ Konferenca shkencore, *Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*, Durrës, më 15, 16 dhe 17 dhjetor 2010, *Përfundimet*, pika 2.

dhe ato elektronike, u publikua madje edhe një promemorie e nënshkruar nga 40 vetë: gjuhëtarë, letrarë, historianë, publicistë e artistë më të dalluar të Shqipërisë, në mesin e të cilëve edhe akademik Shaban Demiraj, Ismail Kadare²⁵ etj.

Që frika e zhbërjes së standardit të shqipes është aktuale dhe sot, me punën që po bën edhe Këshilli Ndërakademik, ndihet edhe te disa personalitete të jetës shoqërore e politike. Me një reagim të para disa ditëve, zoti Pandeli Majko, iu drejtua me këto fjalë gjuhëtarëve dhe pasardhësve të Testamentit të Kongresit të Manastirit: “Në shkencën tuaj unike “gabimi” nuk ekziston. Ka vetëm “bekim” ose “mallkim” i cili do t’ju ndjekë edhe pas vdekjes”.

Një reagim të ngjashëm këtë verë pati edhe profesori i shquar, Rami Memushaj, i cili, duke vlerësuar punën e Këshillit Ndërakademik të datës 26-28 qershor të këtij viti, përkitazi me standardin gjuhësor, ka thënë: “Ndryshimet e miratuara nga Këshilli Ndërakademik shkojnë larg. Ato ... gërryejnë themelet e drejtshkrimit, të drejtshqiptimit e të morfologjisë së gjuhës standarde...”²⁶.

Ndaj këtij Këshilli, në mënyrën më të ashpër ka reaguar edhe njëri ndër ekspertët më të njohur të drejtshkrimit të shqipes, nismëtari i Këshillit Kombëtar (tani Këshilli Ndërakademik), profesor Emil Lafe, i cili u drejttoi edhe dy promemorie: Akademisë së Shkencave dhe Këshillit Ndërakademik, saqë në një shkrim, ai shprehej: “Këshilli Ndërakademik është një sajësë me synime të paracaktuara, për të realizuar “orientimet” e ASHAK-ut për gjuhën standarde, që çojnë deri në përçarje gjuhësore”.

Edhe në një njoftim të ShGjSh të Kosovës dhe të Institutit Albanologjik të Prishtinës, dërguar studiuesve të shqipes para pak ditësh, për pjesëmarrje në një Konferencë shkencore kushtuar Kongresit të Drejtshkrimit (23-24 nëntor 2012), duke ndjerë një shqetësim të arsyeshëm për fatin e vendimeve të këtij Kongresi, me të drejtë thuhet:

...bëhet fjalë për një çështje mjaft të mprehtë dhe për shqetësime të mëdha që sa vijnë e shtohen, madje sikur është krijuar një huti se si duhet vepruar në këto kushte “demokratizimi të shoqërisë” – duhen bërë përpjekje për pasurimin dhe zgjerimin e standardit të vitit 1972, apo duhen kërkuar hapësira të tjera për një “standard gjithëpërfshirës”, për një si “këmishë që do t’u bjerë tamam” të gjithë shqipfolësve(!)...”²⁷

Analizuar më hollësisht, del qartë se ka kohë që debatet kanë përvijuar dy kampe, më të mëdha ose më të vogla, të angazhuara, madje, edhe politikisht deri diku.

Një palë, jo edhe aq e përfillshme, mendësisht më radikale, me frymë haxhiqamiliste, kërkon madje edhe anulimin e vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimit (prof. Arshi Pipa, David Luka, në Kosovë Migjen Kelmendi etj.) dhe e gjithë kjo, na thotë mendja, në dobi të një variantizimi shumëgjuhësor.

Nga ana tjetër shfaqet pala e dytë, specialistë-gjuhëtarë, që shohin një rrugë tjetër: zgjidhje të arsyeshme të standardit, me disa përmirësime të tij, siç thuhet edhe në “Rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe”²⁸, siç kanë theksuar edhe akademik Idriz Ajeti

²⁵ Listën e plotë të firmosjeve shih te vepra “Shqipja e sotme – këndvështrim teorikë-praktik” i Dr. Bahtijar Kryeziut, Libri shkollor, Prishtinë, 2011, faqe .

²⁶ Prof.dr.Rami Memushaj, *Një kumt i keq për shqipen standarde* (opinion), “Shekulli”, Tiranë, 7.7.2012, faqe 9.

²⁷ Nga ftesa e përbashkët e ShGjSh të Kosovës dhe IAP për mbajtjen e Konferencës shkencore me temën bosht: “Dyzet vjet të shqipes standarde – arritje dhe probleme aktuale”, Prishtinë, 5 nëntor, 2012.

²⁸ *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, IAP, Prishtinë, 1974, faqe 27.

e profesor Emil Lafe në Konferencën e Tiranës të vitit 1997²⁹, siç ka nënvizuar edhe akademik Luan Starova, këtu e para 6 vjetësh, kur thotë se *ndërhyrjet janë të mundshme, por të cilat duhet të jenë si makiazh për gjuhën dhe jo operacione, që ndajnë*, siç ndodhi rasti i ndarjes, bie fjala, me serbokroatishten në katër gjuhë, apo siç është shprehur këto ditë te gazeta “Shekulli” dhe studiuesja jonë e njohur, Anila Omari³⁰ e të tjerë.

Edhe politikani e intelektual i shquar shqiptar nga Maqedonia, Arbën Xhaferi, pak ditë para se të ndahej nga kjo botë, në një përgjigje në pyetjen e Oliverta Lilës se, ç’mendon për dy promemorie të profesor Emil Lafes, dërguar Akademisë së Shkencave dhe deklaratën e tij “për një përçarje gjuhësore (Shqipëri e Kosovë)”, ishte shprehur se: “Ka qenë dhe ashtu do të mbetet: standardi gjuhësor që luan rolin e indit ndërlidhës kombëtar”³¹.

Edhe anëtarët e Këshilli Ndërkademi, me gjithë kritikën që po i bëhen këtij Këshilli, mohojnë shembjen e standardit aktual. Akademik Jani Thomai, me rastin e takimit të Këshillit më 26-28 qershor, shprehet se *si organ me autoritet shkencor, ky Këshill, diskuton në rrafshin shkencor çështjet që ai mendon se duhen diskutuar, porse s’mund të “përmbysë” vendimet e Kongresit të Drejtshkrimit (1972)*³²; qëndrim të cilin e mban dhe akademiku tjetër, Kolec Topalli, i cili, për punën e këtij Këshilli thotë se *nuk bëhet fjalë për të ndryshuar standardin, nuk bëhet fjalë për të krijuar një standard të ri, nuk bëhet fjalë që të ketë Kosova një standard e ne një tjetër. Jo! Ky do të ishte gabimi më i madh*³³.

Sikurse shoqëria jonë që ka ndryshuar shumë në harkun kohor 40-vjeçar, edhe gjuha ka ndryshuar mjaft, kështu që ndonjë përmirësim i vogël e plotësim që nuk do të lëkundte bazën e saj të miratuar në Kongresin e vitit 1972, mund të bëhet. Akademik Shaban Demiraj nuk e ka thënë me kot se *edhe për gjuhët që kanë tradita më të vjetra, shtrohet kërkesa për përmirësim*³⁴, por *këtë gjë nuk duhet ta bëjnë diletantët, ata që janë pa kulturë të mirëfilltë filologjike, ata që kanë mastera e tituj shkencorë false* - siç thotë gjeniu i letrave shqipe, Ismail Kadare³⁵, në një intervistë për gazetën “Tirana observer”. Fundja, edhe në *Parathënien* e botimit të parë të *Fjalorit drejtshkrimor*, thuhet se: “studiuesit e shqipes standarde do të kenë për detyrë që të përcaktojnë prirjet e zhvillimit në ndërthurje të varieteteve të gjuhës së folur mbi bazën e gjuhës së shkruar unike dhe të mundësojnë që të përfshihen në normë ato elemente që ndihmojnë që gjuha standarde të fitojë gjithnjë në spontanitet e t’i pasurojë mundësitë e saj shprehëse”³⁶.

Në këtë rrafsh, ne mendojmë se duhen bërë përmirësime të caktuara në pika të veçanta, por jo ndryshime rrënjësore sikundër propozojnë disa. Përveç disa propozimeve që i kemi paraqitur në Konferencën e Durrësit, ne e shohim si punë të arsyeshme, të kihen parasysh edhe:

²⁹ Idriz Ajeti – Emil Lafe, *Njëzet e pesë vjet nga Kongresi i Drejtshkrimit*, “Studime filologjike”, nr.1-2, Tiranë, 1998, faqe 12.

³⁰ Anila Omari, *Standardi: Sa të nevojshme janë ndryshimet*, gazeta “Shekulli”, Tiranë, 16 korrik 2012.

³¹ Shih: Oliverta Lila në bisedën me Arbën Xhaferi, *Militantët e ndryshimit të standardit po rrënojnë identitetin*, “Gazeta shqip”, Tiranë, 17 korrik 2012.

³² Jani Thomai, *Nuk po përmbysim Kongresin e drejtshkrimit*, “Gazeta shqip”, Tiranë, 16.7.201

³³ Mustafa Nano, *Debatë mbi shqipen: Shumë zhurmë për asgjë*, (www.shqiperia.com “Opinione”, 6 korrik 2012).

³⁴ Shaban Demiraj, në “Seminarin XVII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Tiranë, 1995, f. 740.

³⁵ Ismail Kadare, *“Ndryshimi i shqipes, jo në dorë të diletantëve”*, “Tirana observer”, Tiranë, 18.12.2010, faqe 8-9.

³⁶ *Drejtshkrimi ...*, faqe 27.

- normëzimi i njërës trajtë të emrave të rasës emërore: *kroi, ftoi, thoi, përroi...* në vend të *kroni, ftoni, thoni, përroni*;
- normëzimi i emrave të kallëzores së shquar: *babai, vëllai, xhaxhai* (siç i ndeshim në *Morfologjinë e gjuhës standarde shqipe* të vitit 2002), e jo: *babanë, vëllanë, xhaxhanë* (siç janë përdorur më parë);
- kodifikimi i fjalës *trandafil* (në gegërishte kënga: *drandafili i kuq si gjaku...*), siç e ndeshim edhe në Berat in toskë, në vend të *trëndafil*;
- mënjanimi i emrit dhe mbiemrit *punonjës* për *punues*;
- shkrimi i fjalëve që fillojnë me *eu-*, si te shembulli *Europë* për *Evropë* etj.;
- shkrimi emrave sllavë me *ll* ose me *l*, varësisht si përdoren në gjuhët përkatëse, si: *Millan, Sllobodan...*, analogjikisht me *sllav, Jugosllavi* etj., por edhe *Ludmilla* e jo *Lludmilla*;
- përdorimi me *-s* i foljeve që kanë në temë *-t* (rreth 200 sosh) e që dalin me *-t* dhe me *-s* etj., janë disa nga fjalët (trajta e forma fjalësh), që mund të normëzohen me qëllim të mënjimit të dysorëve normativë, të thjeshtimit e të funksionalizimit të gjuhës sonë.

Një propozim i gjuhëtarëve i shfaqur këto ditë edhe në KNGjSh për mënjanimin e zanores *ë* te disa fjalë të lakimit III, duhet medituuar esëll. Nëse te fjalët *gjuhëtar, gojëtar, pjesëtar, anëtar, këngëtar* ruhet *ë*-ja e rrënjës së fjalës, ndërsa tek: *lojtar, rojtar, furrta* etj., ajo nuk ruhet, nuk mendojmë që njësimi duhet të bëhet me heqjen e tingullit siç ka nënvizuar me të drejtë studiuesi Shpëtim Çuça, te gazeta “Telegraf” e datës 18.7.2012

P ë r m b y l l j e

Në fund, në vitin jubilar, atë të 40-vjetorit të jetësimit të vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimit, i cili përkon edhe me 100-vjetorin e Pavarësisë së shtetit shqiptar, disa nga gjuhëtarët tanë dhe disa intelektualë, para se të shpenzojnë energjinë e tyre në përpjekjet e pareshtura për variantizimin e gjuhës letrare, të standardit të saj, mbështetur në idenë se “me këtë standard sui generis, të ngurtësuar, i është bërë aparteid jo vetëm dialektit verior, por edhe shqipes në tërësi”, do të ishte më mirë:

- të shohin arritjet e pakontestueshme me këtë standard në të gjitha fushat e përdorimit të tij;
- të luftojnë shkeljet e tij, futjen pa kriter të fjalëve të huaja në gjuhën shqipe, imponimin pa kriter të gjuhës së mediave dhe të gjuhës bisedore;
- të analizojnë e studiojnë kurrikulat shkollore, vendin e gjuhës në planet dhe programet e shkollave tona, siç e theksoi para pak ditësh edhe Kryeministri i Shqipërisë, i përkrahur edhe nga akademikë e profesorë të njohur;
- të analizojnë tekstet dhe metodat më bashkëkohore në mësimdhënie, e pse jo, të punojnë edhe për përmirësime e plotësime të nevojshme të normës gjuhësore, me prurjet e reja nga dialektet dhe nga të gjitha të folmet shqipe, me qëllim avancimin e standardit e të funksionalizimit të gjuhës sonë të përbashkët.

Standardi i shqipes, të cilin e kemi zënë në gojë dhe një herë tjetër, duhet të jetë një mjet mësimi, mjet njësimi, mjet bashkimi për kombin dhe kulturën tonë, mendim të cilin më së miri e përlligj një thënie e shkurtër por e peshuar mirë e mirë e akademik Idriz Ajetit : “Gjuha letrare s’është vetëm thesar i kulturës sonë, por edhe mjet i fortë për mbrojtjen

e etnisë sonë”, mendim i cili, në këtë kohë dhe për këtë kohë, duhet të merret edhe si moto e punës sonë në shkencat e albanologjisë. Ndryshe, qëndrimi i keq për të ardhmen e shqipes, është në thelb kumt i keq për të ardhmen e shqiptarisë. Jo pa të drejtë edhe Kadare thotë: “Gjuha më mirë se gjithçka tjetër jep shpesh dritën ose mjerimin e një kohe”.

Korçë, 16-17 nëntor 2012

NORMATIVITETI NË FJALORËT SHPJEGUES TË SHQIPES

Kongresi i Drejtshkrimit përfaqëson në të vërtetë një veprimtari shkencore shumë më të gjerë nga çfarë shënon ky emërtim; figurativisht do të thoshim se ka përmbajtjen e një sinekdoke, sepse ky forum i lartë shkencor, mbështetur në referatin, në kumtesat e në diskutimet, jo vetëm miratoi njësimin e drejtshkrimit, si një nga çështjet themelore të gjuhës letrare shqipe, por edhe pohoi njësimin dhe kristalizimin e kësaj gjuhe letrare. "Shqipja letrare e kohës sonë, - shkruhet në rezolutën e këtij Kongresi, - ka hyrë tashmë në fazën më të lartë të zhvillimit të saj, në fazën e kristalizimit të plotë e përfundimtar. Ajo funksionon si një gjuhë letrare e përbashkët dhe e njësuar në të gjitha sferat e veprimtarisë shoqërore"³⁷.

Mirëpo dihet fort mirë se krahas me zhvillimin dhe kristalizimin e gjuhës letrare shkon edhe hartimi i veprave themelore përfaqësuese e kodifikuese të saj e ndër këto vepra një vend të rëndësishëm zënë edhe fjalorët shpjegues kombëtarë.

Ndërsa leksikografia shqipe shënon me "Fjalorin latinisht-shqip"³⁸ të Frang Bardhit të vitit 1635 një periudhë të gjatë shtrirjeje, afër katër shekuj, fjalorët shpjegues të shqipes zënë brenda këtij harku kohor një periudhë njëqindvjeçare, që nis me "Fjalorin e gjuhës shqipe"³⁹ të Kostandin Kristoforidhit, i cili, edhe pse nuk arriti deri te fjalori shpjegues i mirëfilltë, hodhi hapat e parë të një fjalori të tillë. "Veçoritë më të rëndësishme që e dallojnë fjalorin e Kristoforidhit nga fjalorët e tjerë të paraqirimit, - vë në dukje A. Kostallari, - janë pikërisht dy - nga njëra anë, karakteri i tij jo njëdialektor, por gjithëdialektor, gjithëshqiptar dhe, nga ana tjetër, synimi për të qenë një fjalor *i gjuhës shqipe*, një fjalor shpjegues *sui generis* për shqiptarët, por jo një fjalor dygjuhësh për nevojat praktike të të huajve. Ndërrimi i titullit në "Fjalor greqisht-shqip", ndërrim që me sa dimë është bërë me kërkesën e shtëpisë botuese të Pragës për qëllime tregtare, përbën një gabim thelbësor, sepse ja mohon fjalorit të Kristoforidhit të dyja veçoritë dalluese, që i japin atij një vend të veçantë e të vetëm në historinë e leksikografisë. Të gjitha këto na japin të drejtë të pohojmë se hapat e parë për krijimin e fjalorit shpjegues të shqipes janë bërë që në vitet 60-70 të shekullit të kaluar (të shekullit XIX, shënim ynë Th.F.) nga Kristoforidhi, i cili e kuptoi thellë rëndësinë që kishte fjalori dhe gramatika e shqipes, për formimin e gjuhës letrare kombëtare"⁴⁰.

Hartimi i fjalorëve shpjegues të mirëfilltë kombëtarë të shqipes nis me botimin e "Fjalorit të gjuhës shqipe" (1954), për të vijuar më tej me "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe" (1980), me "Fjalorin e shqipes së sotme" (1984 dhe botimin e ripunuar 2002) dhe me "Fjalorin e gjuhës shqipe" (2006).

Dihej që fjalorët shpjegues kombëtarë kanë në bazë të tyre dy funksione: funksionin normativ dhe atë informues. Por normativiteti në këta fjalorë ka një përmbajtje tepër të gjerë dhe të ndërlikuar, sepse është i lidhur jo vetëm me leksikun e semantikën, por edhe me fonetikën, gramatikën, stilistikën gjuhësore, me drejtshkrimin e drejtshqiptimin, duke

³⁷ Shih Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, I, Tiranë 1973, f. 185.

³⁸ Frang Bardhi, *Dictionarium latino-epirotichum*, Romë, 1635.

³⁹ Kostandin Kristoforidhi, *Leksikon tis allvaniqis gllossis*, Athinë, 1904.

⁴⁰ Shih A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe"*, në "Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhë shqipe", II, 1972, f. 7

përfshirë kështu normën leksikore e semantike, gramatikore, stilistikore, drejtshkrimore e drejtshqiptimore. Më konkretisht, hartimi i këtyre fjalorëve kërkon të zgjidhen drejt fjalët që do të futen në fjalësin e fjalorit; të ndahen, të renditen e të shpjegohen drejt kuptimet; të përcaktohen drejt kufijtë dhe sfera e përdorimit të fjalëve e të kuptimeve të ndryshme; të pasqyrohen veçoritë stilistike; të jepen karakteristikat gramatikore; të tregohet në çfarë lidhjesh e kombinimesh përdoret fjala në kuptimet e saj të veçanta, duke dhënë thënie, shprehje a citate; të jepet drejtshkrimi i çdo fjale dhe të vendoset theksi i saj⁴¹.

Mund të themi se elemente të normës vihen re që te Fjalori i Kristoforidhit. Tri pohime: ai i A. Kostallarit, lidhur me “karakterin e tij jo njëdialektor, por gjithëdialektor, gjithëshqiptar”⁴², i J. Thomait se Kristoforidhi “zbatoi në disa vija një shtresim të brendshëm të leksikut në fjalor duke ndarë të përgjithshmen nga krahinorja, shqipen nga e huaja, fjalët e vjetra (të autorëve) nga leksiku i sotëm etj.”⁴³ dhe pohimi i A. Xhuvanit se “në Fjalort të tij prej njëmbëdhjetë e sa mijë fjalësh nuk ka shtime asnjë fjale turqishte”⁴⁴, flasin qartë për një gjë të tillë.

Normativiteti ka qenë njëri nga synimet më kryesore në hartimin e fjalorëve shpjegues të mirëfilltë kombëtarë të shqipes, por shkalla e realizimit të tij nuk është e njëjtë në këta fjalorë. Si paraqitet ai? Këtë do ta shtjellojmë më poshtë nën një vëzhgim përshkruar nga njëri fjalor te tjetri, duke u ndalur më tepër në “Fjalorin e gjuhës shqipe” (1954), në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” (1980) dhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe” (2006), të cilët pasqyrojnë edhe gjendjen dhe shkallët e zhvillimit të gjuhës letrare në faza të ndryshme, që kapin hapësira kohore një çerek shekulli nga njëra-tjetra.

Për shkallën e normativitetit të “Fjalorit të gjuhës shqipe” (1954) gjykojmë se na duket më mirë të citojmë së pari mendimin e autorëve të shprehur në parathënie: “Fjalori në këtë botim të parë të tij s’arrin të jetë një udhëzues i prerë i normave të gjuhës letrare. Po ai shënon patjetër një hap të mirë përpara drejt kodifikimit të materialit leksikor.”⁴⁵ Dhe kjo është e kuptueshme po të kemi parasysh kohën në të cilën u hartua ky fjalor, kur vetë gjuha letrare shqipe ishte në kristalizim e sipër dhe norma si kategori historike do të pasqyronte këtë gjendje të saj. Për më tepër, lënda leksikore e frazeologjike mbi të cilën u mbështet hartimi i kësaj vepre leksikografike ishte e pamjaftueshme për të gjykuar objektivisht për mjaft çështje konkrete të normës letrare në fjalor. Puna përgatitore për hartimin e tij nuk ishte gjithashtu e mjaftueshme; hartuesit shfrytëzuan burimet e mundshme të asaj kohe, si: fjalorët e botuar, materiale të arkivit të Seksionit të gjuhësisë dhe të letërsisë të Institutit të Shkencave, burimet popullore, veprat e rilindësve, tekstet shkencore, shtypin, por mungesa e një kartoteke do të krijonte kufizimet e veta edhe në drejtim të normativitetit.

Në leksikografinë shqipe të deriatëhershme nuk ka pasur një traditë për hartimin e fjalorëve shpjegues të mirëfilltë kombëtarë; në rrafshin teorik thuajse mungonin studimet me karakter leksikologjik e leksikografik, të cilat do të ndihmonin mjaft në zgjidhjen e shumë

⁴¹ Shih A. Kostallari, *Në rrugën e hartimit të fjalorit normative të shqipes*, në “*Studime mbi leksikun...*”, II, f. 82.

⁴² Shih A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”*, në “*Studime mbi leksikun...*”, II, 1972, f. 7.

⁴³ J. Thomai, *Zhvillimi i teorisë dhe i praktikës leksikografike pas Çlirimit*, në “*Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*”, II, f. 370.

⁴⁴ A. Xhuvani, *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*, 1956, f. 4.

⁴⁵ Instituti i Shkencave, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1954, f. IV.

çështjeve konkrete që kanë të bëjnë me normën në fjalorët shpjegues dhe, për më tepër, as që bëhet për një teori të leksikografisë.

Kritika shkencore ka vlerësuar arritjet e kësaj vepre, duke e cilësuar si një fjalor i cili shënoi shkallën më të lartë që kishte arritur leksikografia shqipe deri në atë kohë dhe që hapi një etapë të re për leksikografinë tonë – etapën e fjalorëve shpjegues të mirëfilltë kombëtarë. Lidhur me normativitetin, u vu në dukje se ky fjalor ka prirje normative ose i ndihmoi mjaft normës letrare në leksik, si në zgjedhjen e fjalëve e të frazeologjisë, në sistemin kuptimor, në shpjegime, në disa vlerësime stilistike dhe, në një shkallë më të madhe, në trajtat gramatikore e në theksin e fjalëve.⁴⁶

Por nuk kanë munguar për këtë fjalor edhe vërejtjet; pjesa më e madhe e tyre lidheshin me zbatimin e normës në përcaktimin e fjalësit, zgjedhja e të cilit përbën një problem kyç e tepër të vështirë për një fjalor normativ dhe që përcakton kryesisht gjithë profilin e një fjalori të tillë, si edhe shkallën e normativitetit të këtij fjalori. Në këtë aspekt gjykimi i drejtë për vlerat reale të fjalëve, të frazeologjisë e të kuptimeve; për nevojën, shkallën e prirjet e përdorimit të tyre; për ruajtjen e simetrisë së brendshme lidhur me pasqyrimin në fjalor të klasave të ndryshme të fjalëve; si edhe për shtresimi i lëndës leksikore që përfshihet në fjalor çojnë në rritjen e shkallës së normativitetit.

Tipi i vogël i këtij fjalori, me rreth 25 mijë fjalë kërkon veçanërisht një zbatim shumë të kujdesshëm të normës për të përzgjedhur e përfshirë në fjalës atë lëndë leksikore të domosdoshme, që është në përputhje me prerjen e këtij fjalori, por pa ia cenuar atij edhe nevojën e informimit.

Duke u ndalur më konkretisht në kritikën e bëra lidhur me rastet e moszbatimit të normës, të cilat kanë cenuar shkallën e normativitetit në fjalor, përmendim: pasqyrimin në mënyrë të kufizuar dhe josistimore të ndryshimeve që kishin ndodhur në leksik, duke kufizuar përfshirjen në fjalor të disa klasave fjalësh, si mosfutja e shumicës së emrave foljorë me prapashtesat *-im* dhe *-je*, që kanë kuptimin abstrakt të veprimit ose të rezultatit të tij; p.sh. *dystim*, *mbizotërim*, *mënjanim*, *endje*, *mbështetje*, *ndrydhje*, *prashitje*, *shirje* etj.; mospërfshirjen e një pjese të madhe të emrave abstraktë të formuar me prapashtesat *-(ë)si*, *-(ë)ri*, *-i* që tregojnë një gjendje cilësore, një cilësi a veti, një mundësi a pamundësi për të kryer një veprim ose për t'iu nënshtruar një veprimi, p.sh. *domosdoshmëri*, *kaltërsi*, *krijimtari*, *mëndjemadhësi*, *partishmëri*, *pashmangësi*, *pathyeshmëri*, *pjekuri*, *shpirtmadhësi*, *vazhdimësi*, *zemërgjerësi* etj., funksionet komunikuese të të cilëve bëhen çdo ditë e më të rëndësishëm, veçanërisht në disa stile të caktuara, si në atë të letërsisë politiko-publicistike, shkencore etj.

Në të kundërt, normën në këtë fjalor e ka dëmtuar gjithashtu pasqyrimi i një pjese të madhe të varianteve fonetiko-dialektore, gramatikore e drejtshkrimore, edhe kur mbizotëron në mënyrë të padiskutueshme një trajtë e caktuar letrare, si p.sh. *andëj-atej*, *badër-bardhër-bathër*, *çfarë-çar-çare*, *dhjam-vjam*, *gjer-ndjer*, *skifter-sqifter-skyfter*, *sqyfter*, *ujti-ulti-ylti* etj.

Po ashtu, në raport me prerjen e fjalorit, për hir të informimit, është tepruar me pasqyrimin e shumë turqizmeve a të fjalëve me burim nga persishtja e arabishtja të futura nëpërmjet turqishtes, të cilat deri atëherë nuk kishin zënë vend në gjuhën letrare, sepse ajo kishte për to në fondin e vet leksikor, jo rrallë, edhe më shumë se një gjegjëse, si *adet-zakon*,

⁴⁶ Shih J. Thomai, *Zhvillimi i teorisë...*, në “*Studime mbi leksikun...*”, II, f. 374.

*doke, ves; hallk-njerëzia, bota; hapsanë-burg; hazine-thesar, visar; nobet-shërbim roje, radhë, rend; sall-vetëm; sallgam-akacie etj.*⁴⁷

Megjithatë, duhet thënë se për të gjykuar më objektivisht për shkallën e normativitetit të këtij fjalori, nuk mjaftojnë vërejtjet e bëra kryesisht për fjalësin, edhe pse ai është një nga problemet më të rëndësishme të një fjalori shpjegues; duhet në këtë rast një “vlerësim i fjalorit në të gjithë përbërësit e tij; në zgjidhjet që jepen për strukturimin e shpjegimit e kuptimeve leksikore, për shkallën e pasqyrit të vlerave semantike, fjalëformuese, paradigmatiske, sintagmatike shprehëse-emocionuese, stilistike etj. të fjalëve, për simetrinë e shtresave e të fushave leksikore, të klasave të ndryshme ose dhe për përbërës të tjerë që lidhen me të ashtuquajturën ‘teknologji’ e brendshme e fjalorit.”⁴⁸

“Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980) shënon arritjen më të madhe në leksikografinë e gjuhës shqipe në tërësi dhe në hartimin e fjalorëve shpjegues të mirëfilltë kombëtarë në veçanti. Ky fjalor i tipit të mesëm dallohej jo vetëm për pasurinë leksikore, frazeologjike e kuptimore (me rreth 41000 fjalë, rreth 7000 njësi frazeologjike dhe me mbi 180000 kuptime), por edhe për një shkallë të lartë normativiteti të arritur nëpërmjet përpunimit shkencor dhe kodifikimit të kësaj pasurie, duke u mbështetur tashmë në parime⁴⁹ teorike e kritere leksikografike bashkëkohore.

Për të arritur këtë shkallë normativiteti në përcaktimin dhe hartimin e fjalësit është zbatuar drejt parimi më i përgjithshëm për zgjedhjen e fjalëve, në të cilin thuhet se ky fjalor “duhet t’i shohë të gjitha fjalët e fondit leksikor të shqipes së sotme, pavarësisht nga burimi i tyre, si pasuri të përbashkët kulturore të popullit shqiptar. Në ‘Fjalor’ do të përfshihet si leksiku i qëndrueshëm ashtu edhe ai i lëvizshëm i gjithë truallit gjuhësor të shqipes që nga Rilindja e këtej. Vlerësimi i çdo fjale-leksikore (për ta futur ose jo në Fjalor) duhet të bëhet, në radhë të parë, jo sipas burimit dialektor, as sipas burimit letrar, por sipas vlerës së saj objektive në strukturën leksikore të shqipes së sotme letrare, duke marrë parasysh dy aspekte, të lidhura organikisht midis tyre: a) a i sjell fjala leksikut të sotëm letrar, të marrë në larminë e shtresave të tij stilistikore-shprehëse të sferave të tij të përdorimit, ndonjë pasurim, zhvillim të mëtejshëm (p.sh. a shënon ajo nocione të reja ose a sjell nuanca të reja kuptimore, a ndihmon ajo për thellimin e pastërtisë së gjuhës shqipe, për diferencimet kuptimore e stilistikore, për zhvillimin e terminologjisë, për larminë aktive të mjeteve leksikore sinonimike e antonimike, për prirjet e dehomonizimit etj.);

b) në ç’raport është ajo me tendencat e gjalla të zhvillimit të leksikut- lidhet me shtresa që rriten e zhvillohen apo me ato që rrëgjohen e shuhën, lidhet me tipa fjalëformues produktivë apo jo produktivë; bën pjesë në leksikun aktiv apo pasiv.”⁵⁰

Zbatimi i normës leksikore në këtë fjalor i është nënshtruar këtij parimi të përgjithshëm, duke mbajtur parasysh edhe veçoritë që e karakterizojnë këtë normë, si: a) gjerësia relative e veprimit të saj në krahasim me atë të sistemeve të tjera të gjuhës letrare, që lejon praninë e dysorëve normativë e madje të vargjeve normative, duke vënë në vend të parë dominanten më të përgjithshme, më asnjansë, më të zhvilluar sistematikisht e më të ngulitur

⁴⁷ Shih A. Kostallari, *Në rrugën e hartimit...*, në “*Studime mbi leksikun...*”, II, 1972, f. 85, 87, 95.”

⁴⁸ Shih referatin e J. Thomait në “*Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë*”, 2005, f. 20.

⁴⁹ Shih A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe"*, në “*Studime mbi leksikun...*”, II, 1972, f. 3-49.

⁵⁰ Po aty, f. 17, 18.

në përdorim; b) perspektiva e saj e hapur, lëvizja dhe zhvillimi i saj i pandërprerë, ndryshe nga sistemi fonetik e struktura gramatikore, që, pas një precipitimi normativ, stabilizohen, fiksohen, duke u pakësuar variantet e dysorët, ndërkohë që në sistemin leksikor variantet nuk pakësohen, madje edhe mund të shtohen, pasi gjuha letrare kërkon një leksik të pasur e të larmishëm, me shumë sinonime; c) përshtatja me kërkesat e stileve në një shkallë më të gjerë se mjetet e nënsistemeve të tjera, e cila lejon që edhe në fjalorin shpjegues kombëtar me karakter normativ leksiku dialektor të zërë vend më të gjerë, shumë herë jo si normë e përgjithshme, por me vlera stilistike të veçanta dhe me prirje drejt ngulitjes së normës stilistike.⁵¹

Gjithë lënda e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” (1980), e përzgjedhur sipas kërkesave të mësipërme, dallohet edhe për karakterin sistemor dhe simetrinë në pasqyrimin e klasave dhe grupeve paradigmatiche të fjalëve që përfshihen në këtë fjalor. Kështu p.sh., janë dhënë gjerësisht rezultatet e fjalëformimit, duke pasqyruar në mënyrë sistemore e simetrike grupet paradigmatiche të fjalëve sipas ndërtimit e kuptimit:

1. emrat abstrakte të veprimit me prapashtesat *-im* dhe *-je* (*gjunjëzim, harkim, inventarizim, kapërcim, përdorim, joshje, mbushje* etj.);
2. emrat e vepruesit dhe mbiemrat foljorë që japin karakteristikën cilësore sipas veprimit dhe gjendjes, të formuar drejtpërdrejt nga tema foljore, me prapashtesën *-(ë)s* (*dëmtues, drejtues, djegës* etj.);
3. emrat abstraktë të cilësisë me prapashtesat *-i, -(ë)si, -(ë)ri* (*pkjuri, freski, gjallëri, domosdoshmëri, rrezikshmëri, bardhësi, vazhdimësi* etj.);
4. mbiemrat e formuar me prapashtesat *-or (tor), -sor, -shëm, -t(ë)* etj. (*bërthamor, fundor, kokrrizor, mishtor, rrokjesor, thelbësor, i lëvizshëm, i punueshëm, i sjellshëm, i dylltë, i gaztë, i hirtë, i pushtë* etj.);
5. mbiemrat prejpjesorë (*i edukuar, i heshtur, i mbrojtur, i përpunuar* etj.);
6. foljet prejemërore prapashtesore (*fuqizoj, imtësoj, shqipëroj* etj.) ose parashtesoprapashtesore (*përfaqësoj, përgënjeshtroj, përjetësoj* etj.);
7. ndajfoljet me prapashtesat *-(i)sht, -as (-azi), -thi* (*fatmirësisht, gjerësisht, gjallërisht, përfundimisht, haptas, përkitazi, kalimthi* etj.);
8. formimet parashtesore emërore me parashtesën *mos-* si dhe emrat e mbiemrat me parashtesë *pa-* (*mosarritje, mosmiratim, mosveprim, moszbatim; pabarazi, pafundësi, pamaturi, i pakuptimtë, i paqetë* etj.);
9. fjalët e përbëra të tipave të ndryshëm semantiko-fjalëformues, si: *flakëhedhës, hekurpunues, vargmal, fletëhyrje, letërnjoftim, vendburim, afro-aziatik, ekonomiko-shoqëror, kokëshkëmb, lëkurëtrashë, buzëplasur* etj.

Një vlerë e veçantë dhe e rëndësishme e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” (1980) është pasuria e madhe e kuptimeve, e cila ka ardhur nga zbërthimi i imët i përmbajtjes kuptimore të fjalëve shumëkuptimëshe; në këtë aspekt ai tejkalon dukshëm kufirin e kërkesave që duhet të ketë një fjalor i tipit të mesëm. Por, lidhur me këtë, duhet theksuar se në ndërtimin e strukturave kuptimore të fjalëve shumëkuptimëshe; në këtë aspekt ai e tejkalon dukshëm kufirin e kërkesave që duhet të ketë një fjalor i tipit të mesëm. Por, lidhur me këtë, duhet theksuar se në ndërtimin e strukturave kuptimore të fjalëve shumëkuptimëshe,

⁵¹ Shih J. Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, 2001, f. 187.

mbështetur në tipologjinë e kuptimeve, është zbatuar sistematikisht edhe norma semantike, si një element i rëndësishëm i normativitetit të fjalorit, duke na dhënë kështu një hierarki shkencore të renditjes së kuptimeve, që pasqyron drejt si shkallën e përdorimit të secilit kuptim, ashtu edhe prejardhjen semantike të këtyre kuptimeve nga njëri tek tjetri brenda strukturës kuptimore të fjalës shumëkuptimëshe. Kjo ka bërë që në çdo fjalë të tillë të jenë vendosur drejt e në vendin e duhur kuptimi historikisht fillestar dhe ai kryesor, kuptimet e parme dhe të prejardhura, konkrete dhe abstrakte, të drejtpërdrejta e të figurshme etj.

Norma semantike është zbatuar edhe në shpjegimet e kuptimeve të fjalëve, duke vënë në krye të çdo shpjegimi atë fjalë të parë shënuese e cila, me përmbajtjen e vet leksiko-gramatikore e përfshin fjalën që shpjegohet në gjininë më të afërt për nga kuptimi leksikor dhe në kategorinë gramatikore përkatëse për nga kuptimi kategorial.

Kjo pasuri kuptimesh e fjalëve shumëkuptimëshe është ilustruar sistematikisht me thënie të shumta më të përdorshme, që dëshmojnë përdorimin real të kuptimeve dhe të nuancave kuptimore dhe përgjithësisht ato janë renditur në strukturën kuptimore të fjalës shumëkuptimëshe në mënyrë të tillë që t'u përgjigjen besnikërisht përkatësisë me kuptimet dhe nuancat semantike të zbërthyera në këtë strukturë kuptimore.

Shtresimi që i është bërë lëndës leksikore sipas kërkesave të normës gjuhësore e stilistike është një tregues tjetër i normativitetit të këtij fjalori; janë mbi 100 shënime të posaçme që cilësojnë fjalët e kuptimet që kanë kufizime sipas fushës, sipas ligjërit, sipas hapësirës a kohës së përdorimit, sipas ngjyrymeve të veçanta stilistike-emocionale dhe sipas kufizimesh të tjera. Përfshirja e tyre në fjalor me shënimet cilësuese përkatëse ka bërë të mundur që të mos cenohet edhe funksioni informues i tij.

“Fjalori i gjuhës shqipe” (2006) me 48000 fjalë ka ruajtur dhe ka çuar më tej të gjitha vlerat e fjalorëve të mëparshëm, si në drejtim të informimit, ashtu edhe në atë të normativitetit.

Lënda leksikore e tij ka arritur t'i përgjigjet zhvillimit të shqipes letrare (për aq sa ia lejon prerja e një fjalori të tipit të mesëm), duke pasqyruar prurje të reja në leksikun e saj, veçanërisht në periudhën e 10-15 vjetëve të fundit, në të cilën kanë ndodhur ndryshime të thella të karakterit ekonomik, shoqëror e politik.

Në 7000 fjalët e reja të shtuara në fjalësin e këtij fjalori në krahasim me atë të “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” (1980), një pjesë e mirë e tyre i përkasin leksikut dituror, ku janë përfshirë si të tilla edhe mjaft terma të fushave të reja për shqipen, si ato të ekonomisë së tregut, të kompjuterizimit e të digjitalizimit etj.

Këto kanë zënë vend në fjalor duke mënjанuar shpesh mjaft etnografizma e fjalë të vjetruara me një përdorim tepër të rrallë, duke përmirësuar kështu cilësinë e fjalësit e duke e bërë fjalorin më bashkëkohor.

Si një fjalor leksikor me elemente çerdhore, ka pasqyruar në mënyrë sistemore çerdhet e fjalëve me prejardhje të drejtpërdrejtë fjalëformuese, si ato që kanë në përbërje të tyre foljet dhe emrat foljorë e mbiemrat prejpjesorë që vijnë prej këtyre foljeve; mbiemrat dhe emërzimet e tyre; mbiemrat me prapashtesën –*shëm* dhe ndajfoljet me të njëjtën prapashtesë; emrat e banorëve sipas vendit dhe mbiemrat e ardhur prej tyre; emërtime të gjuhëve dhe ndajfoljet përkatëse.

Hartimi i një fjalori të madh është tashmë një nevojë e ngutshme për ta pasqyruar më gjerësisht pasurinë leksikore e frazeologjike të shqipes si dhe huazimet e nevojshme, veçanërisht në fushë të terminologjisë, të cilat çojnë në rritjen e shkallës së informimit.

**KONGRESI I DREJTSHKRIMIT – NGJARJE EPOKALE E HISTORISË DHE
E KULTURËS KOMBËTARE**

Ndonëse shekulli që lamë pas, pra shekulli XX, shqiptarëve u shkaktoi mjaft dhembje dhe u hapi shumë plagë, për shkak të copëtimit të trojeve etnike, megjithatë, pikërisht në këtë shekull, veç Shpalljes së Pavarësisë, ndodhën edhe dy ngjarje të mëdha, që lirisht mund të quhen epokale për historinë e kulturën tonë: Kongresi i Alfabetit më 1908 në Manastir, dhe Kongresi i Drejtshkrimit i vitit 1972 në Tiranë. Të gjitha këto ngjarje të shënuara, sikurse edhe ngritja e Flamurit në Vlorë, ndodhën pikërisht në këtë muaj, prandaj nëntori mund të quhet dhe muaj i arritjeve kombëtare. Pa këto arritje, kombi ynë nuk do të mund të radhitej në familjen e madhe të kombeve të qytetëruara.

Ndonëse gjuha, përgjithësisht, mundëson komunikimin nëpërmjet formimit të përmbajtjeve mendore dhe transmetimit të tyre, megjithatë ajo nuk është vetëm një mjet i thjeshtë i komunikimit ndërmjet njerëzve. Ajo është më shumë se kaq. Para së gjithash, është pasqyrë e personalitetit të atij që e flet ose e shkruan dhe, rrjedhimisht, pasqyrë edhe e nivelit të kolektivitetit që i përket folësi a shkruesi.

Shkencëtari amerikan, Eruin Çargaf (Erwin Chargaff), (11 gusht 1905 - 20 qershor 2002) me të drejtë thekson tri veçori si shenja të qytetërimit të një populli:

1. si kujdeset ai për drurët e tij,
2. si kujdeset ai për fëmijët dhe për pleqtë,
3. si sillet ai me gjuhën e tij. Por, pohon ai, gjuha është më e rëndësishme. Është detyrë e tij, e popullit, pra, që ta ruajë dhe ta kultivojë atë si vlerë kulturore dhe si tipar identiteti.

Si rrjedhim, çdo bashkësi shoqërore që mëton të jetë e qytetëruar, synon të ketë një standard gjuhësor, domethënë të ketë një gjuhë standarde, e cila është një formë normale e gjuhës, që shërben për komunikim publik në bashkësitë e qytetëruara; është gjuhë e arsimit, e kulturës, e shkencës, e masmedias, e administratës dhe e fushave të tjera të jetës publike.

Ndërtimi i një tipi të tillë të gjuhës është një ndër faktorët themelorë të funksionimit normal të një shoqërie komplekse në botën bashkëkohore. Ky proces nënkupton normimin e vetëdijshëm që e bëjnë ekspertët e gjuhës, prandaj gjuha standarde domosdo duhet të jetë mbi dialektet në një bashkësi, duke përfaqësuar një mjet dukshëm më të gjerë dhe më të përgjithshëm sesa janë të folmet popullore. Çështje të tilla i përkasin fushës së planifikimit gjuhësor ose politikës gjuhësore.

Standardi gjuhësor, ndërkaq, nuk e pengon gjuhën që të zhvillohet, të përsoset, të pasurohet. Proceset gjuhësore veprojnë gjithnjë. Së këndejmi, zërat e aty-këtushëm për kinse standardizimin e dialekteve, meqë “qenkan diskriminuar”, jo vetëm që janë të papranueshëm, por janë edhe tejet shkatërrues dhe nuk shpien drejt rrjedhave qytetëruese botërore. Fundja, po të krahasohen dy dialektet e gjuhës shqipe dhe të folmet përbrenda tyre, madje edhe vetëm sipërfaqësisht, fare lehtë mund të konstatohet se as dialektet, as të folmet nuk kanë ndonjë dallim aq të madh, sa të paraqitin problem në zotërimin e standardit, siç i dramatizojnë disa.

Standardi, si gjithçka që dëshirohet të zotërohet, duhet mësuar. E për një kultivim të drejtë të gjuhës standarde, si në të folur, ashtu edhe në të shkruar, barra kryesore bie mbi institucionet edukativo-arsimore, duke filluar nga kopshtet, deri te universiteti dhe mbi masmediat (gazetat, revistat dhe radiot e televizionet). Natyrisht, këtu nuk duhen përjashtuar as faktorët e tjerë që ndikojnë në gjuhën e një individi, siç janë familja, mjedisi etj.

Për t'u kujdesur për gjuhën, kanë detyrim të gjithë, por gjuha e përdorur në libra, në një shkrim gazete a në një emision radioje ose televizioni, ka ndikim më të madh sesa çdo fjalë e thënë gjetkë. Për këtë arsye detyrimi i atyre që komunikojnë me publikun në çfarëdo forme është shumë më i madh ndaj gjuhës, meqë ndikimi i fjalës publike është më i fuqishëm dhe më gjithëpërfshirës. Njeriu ynë sot e gjithë ditën, kur do të të bindë për diçka, do të të thotë: e kam lexuar në libër a në gazetë, e kam dëgjuar në radio a në televizion. Po kështu ndodh edhe kur bëhet fjalë për gjuhën.

Nisur nga fakti se kultura gjuhësore është një pasqyrë e personalitetit të çdo individi, ndaj të folurit dhe ndaj të shkruarit, përgjithësisht, e ndaj gabimeve në të folur e në të shkruar, posaçërisht, në vazhdimësi duhet të mbahet qëndrim i cili do të ndikonte që të folurit dhe të shkruarit të jetë në trajta të drejta gjuhësore. Këtë mund ta bëjnë mësuesit, gazetarët dhe institucionet publike duke qenë kritike ndaj gabimeve që janë rrjedhojë e të folmeve të ngulitura dialektore, të cilat reflektohen pastaj jo vetëm në të folur, por edhe në të shkruar.

Gjithçka në gjuhë vërtet ndërtohet me elemente të gjuhës së rëndomtë, porse vetëm në atë mënyrë që kur ka përdorim publik, ajo të shndërrohet në gjuhë të një shkalle më të lartë. Për këtë arsye mjetet gjuhësore të masmedias e të librit nuk duhet të shihen vetëm nga këndvështrimi i funksionit të tyre informativ, por edhe nga funksioni i tyre gjuhësor, sepse këto elemente gjuhësore nuk janë më vetëm bartëse të thjeshta të informacionit, nuk janë më vetëm mjete të komunikimit të rëndomtë, por janë edhe pjesë përbërëse e formimit gjuhësor, janë vlera estetike etj.

Gjuhësisht, dihet se asnjë dialekt dhe asnjë variant nuk mund të quhet më i mirë për të sjellë vlera artistikisht e stilistikisht të dëshmueshme. Natyrisht, është çështje e vetëdijes së një autori (gazetari a shkrimtari), a do t'i drejtohet një opinionimi më të gjerë apo më të ngushtë. Megjithatë, një gjë është e sigurt: një stil gjuhësor vërtet i lartë nuk mund të qëndrojë në kundërshtim serioz me modelet e formave themelore të gjuhës standarde. Ai jo vetëm që duhet t'i përfillë, por edhe duhet të ndërtohet mbi ato modele.

Struktura nuk duhet të imponohet e të ndikohet nga modele të huaja dhe nga gjuhë të tjera, sepse do të dilet nga natyra e gjuhës komunikuese. Gjuha, duke ecur udhës së saj të natyrshme të zhvillimit, me veçantitë e saj, i mundëson dhe i lejon secilit të krijojë vlera të bukura, po që do të dukeshin të shëmtuara për ndonjë gjuhë me strukturë e sistem tjetër gjuhësor, sepse çdo gjuhë ka natyrën e vet specifike. Dhe, po s'u përfill ajo natyrë, ligjërata jo vetëm që humb në bukuri, por edhe në qartësi, domethënë ajo nuk është më e zonja të bartë tërë mesazhin që mëtojmë t'ia ngarkojmë (Këtu kalimthi do të mund të përmendnim vetëm disa kalke, p.sh.: *Për dallim; Në dallim, Është në pyetje; Leje për vozitje etj.*). Për secilën nga këto do të mund të flitej në veçanti, por ndoshta në ndonjë rast tjetër.

Kalke të tilla, mjerisht, ndeshim edhe në gazeta e në revista tonat, por edhe në materiale të ndryshme të institucioneve administrative. Administrata jonë, fjala vjen, sot e gjithë ditën nuk denjon ta shkruajë drejt emrin e dokumentit që tash e dyzet vjet është *certifikatë*, por e shkruan

çertifikatë, shpesh madje as pa **ë** në fund! Për formulime të ndryshme, materiale të përkthyer, shpesh fare të paqarta e konfuze, problematikat janë edhe më të mëdha.

Ndonëse kanë kaluar dyzet vjet nga normimi i gjuhës sonë, ndër ne sot e gjithë ditën edhe në të shkruar edhe në të folur, ndeshim trajta në kundërshtim me normat standarde, madje as vetë fjala standard nuk përdoret drejt, por në trajtën standart, siç përdoret po me *t* në vend që të *d*, fjala pedagog (petagog). Janë një dorë fjalësh (të të gjitha pjesëve të ligjëratës) që sot e gjithë ditën, sidomos në mediat e Shqipërisë londineze, përdoren në trajtë të gabuar: *mëndje*, *vënd*, *brënda*, *llogjikë*, *Hollandë*, *genocid*, *gen*. Në shumë raste nuk denjohet të përdoren në trajtë të drejtë as emrat e vendeve e të qyteteve të njohura, si: *Kopenhagen* (për Kopenhagë), *Vienë* (për Vjenë) etj. Po kështu, kur bëhet fjalë për sistemin foljor, foljet në kohën e ardhme të dëftores dhe foljet në mënyrën kushtore pothuajse gjithmonë ndeshen pa pjesëzën trajtëformuese të, p.sh.: *do punoj*, *do punoja*, *do kisha punuar*; *do shkoj*, *do shkoja*, *do kisha shkuar* (*do të punoj*, *do të punoja*, *do të kisha punuar*, *do të shkoj*, *do të shkoja*, *do të kisha shkuar*), siç ndeshet në trajtë të gabuar edhe folja e parregullt *them* në të pakryerën e mënyrës dëftore (mbase sipas analogjisë) *thoja*, në vend të *thosha*.

Një çështje më vete, që në të parë duket cikërrimë, por që është me peshë, është përdorimi i alfabetit në shkrimin me kompjuter. Siç dihet, alfabeti i gjuhës sonë ka 36 shkronja, porse në këto shkrime përdoren vetëm 34, domethënë dy shkronjat që kanë përdorim të gjerë, *ë* dhe *ç*, nuk përdoren fare, pa marrë parasysh se në raste të tilla edhe mund t'i ndërrohet kuptimi ligjëratës. Dhe, arsyetimi (gjithsesi i paarsyeshëm) është se kompjuteri nuk i paska këto. E pikërisht, ky shfaqësëm është i paqendrueshëm, ngaqë çdo kompjuter, krahas gjuhëve të tjera, ka të instaluar edhe gjuhën shqipe. Fakti që ne nuk e përdorim atë, kur është e programuar, nuk qëndron as te kompjuteri, as teknologjia bashkëkohore. Të tjerët duket kanë menduar më shumë për ne e për gjuhën tonë, sesa ne për vete dhe për këtë dhunti tonën. Për internetin, as të mos flasim, sepsen aty, mjerisht, kultura jonë gjuhësore jo që lë për të dëshiruar, por është nën çdo nivel.

Veç këtyre shkarjeve, fjalësi ynë jo rrallë pa nevojë përshkohet nga fjalë të huaja. Pra, duhet ta kemi të qartë se fjala e huaj nuk ka as peshë, as fuqi më të madhe se fjala e gjuhës amtare. “Dikush i përdor fjalët e huaja edhe kur nuk e ndien mungesën e fjalëve të gjuhës së tij amnore vetëm e vetëm që ta bëjë mendimin më të rëndë, ose, si thonë, më “intelektual”⁵²,- shkruan studiuesi ynë, akademik Rexhep Qosja.

Paqartësia nuk është pasojë e varfërisë së gjuhës sonë, por është pasojë e mungesës së kulturës së gjuhës si dhe e mentalitetit primitiv, sipas të cilit gjithçka e huaj është më e vlefshme, më e çmueshme dhe më e qartë. Këtë, gjithsesi, duhet ta ketë parasysh çdo shqipfolës, posaçërisht ata që merren me punë publike. “Ithtarët e shprehjes së paqartë harrojnë se gjuha e një populli, gjuha letrare e atij populli, nuk pasurohet me fjalë të huaja, të qëmtuara nëpër fjalorë të ndryshëm...”⁵³,- pohon me të drejtë akademik Qosja.

Jo vetëm këta, por shembuj të shumtë flasin për një shpërfillje, për një mungesë kujdesi ndaj gjuhës. Për shembull, në media vazhdimisht ngatërrohen fjalët *zgjidhje* e *zgjedhje* (të cilat populli nuk i ka ngatërruar kurrë), që janë fjalët të përdorura shpesh në shkrime gazetash e revistash dhe në emisione radiotelevizive. Është për t'u habitur se, sipas shembullit të gjuhëve

⁵² Paqartësia dhe qartësia, në *Letërsi e sotme shqipe, Kritikë dhe ese*, Rilindja, Prishtinë, 1971, f. 265.

⁵³ Paqartësia dhe qartësia, në *Letërsi e sotme shqipe, Kritikë dhe ese*, Rilindja, Prishtinë, 1971, f. 266.

sllave, pareshtur dhunohet natyra e gjuhës shqipe, po edhe ngatërrohet kuptimi i mesazhit për dëgjuesit ose teleshikuesit duke përdorur fjalët *gjegjësisht, respektivisht dhe përkatësisht*. Për shembull: *Prindërit janë profesororeshë, përkatësisht jurist (?)*. Pse një formulim i këtillë që bie ndesh me natyrën e gjuhës sonë!? Fjalët *gjegjësisht, respektivisht* etj. në të shumtën e rasteve përdoren pa nevojë. Në një gazetë, f. v., një shpallje ishte me këtë tekst: *Shes banesën në katin e tretë, përkatësisht në katin e tetë (?)*. Ç'mund të thuhet për këtë përdorim?! Shpesh po mendohet se është e mjaftueshme të mos përdoren fjalët *gjegjësisht, respektivisht* etj. (si në radiotelevizion), po në vend të tyre të përdoret fjala *përkatësisht*, pa e vrarë mendjen se kjo fjalë përkatësisht ka kuptim krejt tjetër.

Po ashtu, emrat e huaj, nuk transkriptohen, duke pretenduar se ata po jepen në origjinal. Dhe çfarë ndodh: “originalë” na qenkan të gjithë emrat e huaj të transkriptuar në gjuhën angleze. S’ka si shpjegohet ndryshe, kur emrat rusë, kinezë, japonezë, arabë etj. jepen në variantin anglez.

Gjatë emisioneve kontaktuese, në radiot e televizionet tona (madje jo vetëm në to) pothuajse gjithnjë ngatërrohen fjalët *kontest e kontekst, ofroj e afro, status e statut* etj. Trajatat e shkurtra të përemrave vetorë në këto medie kryesisht përdoren gabimisht. Për shembull: *U falënderoj që erdhët...* në vend të *Ju falënderoj që erdhët...*, *I kthehem materialeve...*, në vend të *U kthehem materialeve* etj.

Një fushë tjetër gjithsesi janë trajtat e gabuara të foljeve, qoftë në të shkruar, qoftë në të folur, duke ngatërruar kohë, mënyra e veta. Nuk po përmendim shembuj, sepse, për fat të keq, janë të shumtë, ndaj këto do të duhej të trajtoheshin në veçanti.

Në raport me gjuhët e tjera, ndërkaq, gjykimi do të dilte mbase paksa më i ndritshëm, së paku për sa i përket kujdesit, përfilljes. Secili nga ne përpiket me mish e me shpirt që një a më shumë gjuhë të huaja t’i zotërojë sa më mirë, t’i mësojë rregullat drejtshkrimore, të përvetësojë normën e asaj a të atyre gjuhëve etj. Edhe atë që madje vetëm “e belbëzon” një gjuhë të huaj, e lavdërojmë tej mase. Çështje më vete mbetet fakti se në ç’shikallë mund ta zotërojë i rrituri një gjuhë të huaj, nëse nuk e zotëron gjuhën amtare, pasi dihet se i rrituri një gjuhë të huaj mund ta mësojë më mirë nëpërmjet krahasimit. Në këtë kontekst, si ilustrim do të mund të shërbente një mendim i Filip Shirokës: “Kurrë nuk kemi të drejtë të quhemi komb i qytetëruar, sado që të mësojmë gjuhë të huaja, sepse kombi nuk qytetërohet vetëm me mësimin e gjuhëve të huaja, por me mësimin e gjuhës së vet.” Pra, një fjalë e urtë thotë: “Duaje veten, që të mund të duash dhe të tjerët”

Kundruall gjuhës sonë nuk jemi korrektë. Mundohemi të gjejmë një mijë e një “argumente” për të arsyetuar mungesën e kulturës elementare gjuhësore. Madje gjithkënd që sadopak përpiket të shprehet me një kulturë gjuhësore, e vëmë në bisht të lahutës.

Në televizionet tona, pothuajse vetëm kur bëhet humor përdoret standardi gjuhësor, natyrisht duke u karikaturuar në mënyrën më të shëmtuar. Shkojmë aq larg, sa alfabetin dhe standardin i njëjtësojmë, pa menduar se janë dy tregues elementarë se një kolektivitet mund të hyjë në radhën e popujve të qytetëruar dhe që ka identitet. Po identiteti ynë, vallë, cili është, kundruar nga ky këndvështrim? Gjykuar sipas fjalës së urtë të së Xhonatan Suiftit, i cili thotë: *Ashtu siç mund ta njohësh njeriun nga shoqëria me të cilën rri, po ashtu mund të gjykosësh për të sipas gjuhës që përdor*, për ne ky gjykim nuk do të ishte aq i lëvdueshëm. Ne duket sikur bëjmë një lloj gare absurdi se kush do ta stërkejë më shumë standardin gjuhësor, duke mos menduar se në këtë mënyrë vetëm sa tregojmë hapur nivelin tonë të përgjithshëm,

sa stërkeqim identitetin tonë, jo të lagjes a të krahinës, se atë nuk na e mohon kush, por identitetin kombëtar, ndaj të cilit fqinjët tanë janë të gatshëm të investojnë e të investojnë.

Vaji për dialekte e të folme (e ato i njohim pak ose s'i njohim fare) nuk ka të ndalur. Dhe pikërisht ata që derdhin lot krokodili, nuk lodhen fare për të parë se askush, askujt nuk ia ndalon fjalësin, domethënë leksikun nga dialektet, nga të folmet. Mirëpo, ç't'i bësh varfërisë sonë kulturore e intelektuale, horizontit tonë tejet të kufizuar. Ç't'i bësh këmbënguljes sonë që të mos ecim përtej së folmes së prindërve (shpesh) analfabetë (por, gjithsesi, me sintaksë qindra herë më të mirë se ne), duke këmbëngulur se qenkemi toskë, gegë, kosovarë etj. dhe se u dashka të flasim toskërisht, gegnisht, kosovarisht... E cila na qenkan këto gjuhë?! Nëse, po e zëmë, kosovar e kosovarisht na qenkan identitet etnik dhe identitet gjuhësor i shqiptarëve të deridjeshëm të Kosovës, cili na qenka identiteti etnik e gjuhësor i joshqiptarëve në Kosovë?! Dhe, ç'identitet paskan shqiptarët jashtë Kosovës e jashtë Shqipërisë!?

Jo rrallë, për t'u argumentuar kinse diskriminimi dialektor, si shembull ilustrues merret *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, i cili nuk paska përfshirë shumë fjalë. Ne themi se jo shumë fjalë, por aty është vetëm një pjesë shumë e vogël e fjalësit të të dy dialekteve e të të gjitha të folmeve shqipe, që do të duhej të përfshiheshin jo në një, por në vëllime e vëllime të shumta të fjalorëve, të cilët gjithsesi do të duhej t'i nxirrnin institutet profesionale e akademitë tona shkencore. Për to natyrisht që duhet mbështetje e gjithanshme. Mirëpo, askush, askujt nuk ia kufizon fjalësin vetëm përbrenda kornizave të këtij vëllimi të Fjalorit. Dhe, për të gjitha gabimet tona, fajin pa të drejtë ia lëmë standardit, pra normës gjuhësore. Sipas kësaj logjike, që shumë njerëz ende nuk kanë marrë mundin t'i mësojnë t'i shkruajnë dhe t'i thonë drejt ditët e javës, për këtë nuk e paskan fajin ata vetë, por gjuha, edhe pse përdorin trajta pa marrë parasysh asnjë kriter! Fjala vjen, dita e diel, sipas prirjes anarkiste, mund të jetë herë *e dielë*, herë *e djelë*, herë *e diell*, herë *e diellë* etj., por jo siç do të duhej, vetëm *e diel* ! Kjo shpërfillje e skajshme ndeshet madje edhe në ballina gazetash. Ose, mos e ka fajin standardi gjuhësor, pse disa njerëz, që merren me veprimtari të ndryshme publike, ende nuk e dallojnë *statusin* nga *statuti*, *kontestin* nga *konteksti*, *zgjedhjen* nga *zgjidhja*, *barnat* nga *barërat*, *pulsin* nga *impulsi* etj?! Nga gojë e tyre mund të dëgjohen trajta të përçudnuara foljesh e emrash: *ta dho* (për *ta jap*), *ta japa* (për *ta dhashë*), *fëmiu* (për *fëmija*), *grupa* (për *grupi*), *kontrolla* (për *kontrolli*), *garazha* (për *garazhi*), *plazha* (për *plazhi*) etj. dhe jo trajtat e drejta të tyre. Dhe, natyrisht, për këtë nuk i paskan fajet ata, horizonti i dijeve të tyre të kufizuara, qëndrimi i tyre shpërfillës, por fajet i paska gjuha, domethënë standardi gjuhësor.

Të gjithë ata që kanë ca një moshë, e mbajnë mend fare mirë fushatën e viteve '50 - '60 të shekullit të kaluar që të krijohej një identitet i veçantë "kosovar", me gjuhë të veçantë, ndryshe, duke qenë ne "shiptari", të cilët folkemi "shiptarski", kurse banorët e Shqipërisë londineze "allbanci" që flasin "allbanski". A nuk kanë ngjashmëri tezat e atëhershme me disa që shfaqen sot?!

Po e përmbyllim me një citat nga parathënia e Fjalorit frëngjisht-shqip të pedagogut, shkrimtarit, përkthyesit dhe hartuesit të fjalorëve, eruditit Vedat Kokona (1913-1998): "Në moshën djaloshare, kur fillova të merresha me përkthimin e vargjeve të poezisë frënge, ia hidhja fajin shqipes që nuk ishte e zonja të shprehte ato që më thoshin poetët... Për çudi, edhe kur u mundova, një ditë, të përktheja në frëngjisht disa vargje të "Bagëti e Bujqësi" ngeca dhe i rashë më qafë frëngjishtes duke thënë se ajo s'qenkësh një gjuhë edhe aq e pasur sa ç'e

bënin! Ishte koha kur në lice, i ulur në bankën e fundit të klasës, nuk shquaja mirë shkrimin e profesorit në dërrasën e zezë dhe e qortoja me vete për shkrimin e tij të keq. Pak më vonë e kuptova se vuaja nga miopia dhe, kur shkova në bankën e parë, fillova të shoh mirë nga sytë dhe të kuptoj se fajin s'ma kishte shkrimi i profesorit, por miopia ime. Çuditërisht, edhe në punën e përkthimit, vështirësitë nuk rridhnin nga varfëria e gjuhës, por nga paaftësia ime që e kishte burimin në mosnjohjen e saj. Bëra, si të thuash, dy zbulime laplasiane. Atëherë vendosa t'i përvishem punës së gjuhës...”

Kjo, mbase, nuk do koment!

STANDARDI PËRBASHKUES I DIALEKTEVE TË SHQIPES DHE I VETË SHQIPTARËVE

Standardi është njëra nga ngjarjet më të rëndësishme të kulturës mbarëkombëtare. Me të janë shënuar hapa përparimi në kulturën e shkrimit të shqipes. Përmes tij u përbashkuan dialektet e shqipes, u përbashkuan shqiptarët.

Në hapat e parë të tij standardi në Kosovë ishte përqafuar me entuziazëm gati nga të gjitha shtresat shoqërore. Shkolla, në të gjitha nivelet e saj, i pati prirë kësaj valleje. Atëherë edhe Enti i Teksteve Mësimore luajti rol të rëndësishëm në hartimin e teksteve në frymën e standardit. Shtypi i përditshëm, bashkë me revistat e tjera që dilnin në Kosovë, ecnin nëpër të njëjtën rrugë. Të njëjtën gjë e bënte edhe RTK-ja. Me fjalë të tjera, standardi përvetësohej përditë e më mirë nga brezi në brez.

Shtysën kryesore për njohjen në thellësi dhe në gjerësi të standardit e dhanë veprat “Drejtshkrimi gjuhës shqipe” dhe “Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe”, hartuar prej një dore të fortë shkencëtarësh. Këto dhe vepra të tjera që dilnin në frymën e standardit ndihmuan që ai të ecte përpara, të gjente zbatim të sigurt në nivele të ndryshme të dijes. Gramatika e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe shumë fjalorë (1980, 2002, 2006) e edhe disa fjalorë dygjuhësh bënë që standardi të pajiset me rregulla gramatikore e leksikore, të cilat e trupëzuan atë në mënyrë shkencore.

Paslufta në Kosovë solli shumëçka të re. Për fat të keq leksiku i shqipes u vërshua me plot fjalë të huaja, veçmas me anglisticizma, të sjella nga ndërkombëtarët. Me daljen në shesh të radiove e televizioneve private, standardi filloi të çstandardizohet. Ato nuk kanë lektorë as redaktorë gjuhe. Drejtues të këtyre emisioneve veprojnë kështu, sepse nuk përgatiten fare dhe flasin pa kurrfarë kriteri, duke kaluar kështu gati në një gjuhë vulgare, me një gjuhë, që s’i vjen era shqip. Të këtillë e të atillë e shpien gjuhën shqipe, këtë shqipen tonë të bukur, në theqafje. Sa mjerim, sa keq të mos e ruash gjuhën tënde. Për mendimin tonë nuk ka gjë më të mirë se kur e dëgjon dhe shkruan shqipen në standard, në të gjitha mjetet e informacionit në Tiranë e në Prishtinë, në Shkup e në Ulqin dhe kudo tjetër në diasporë, sepse, siç e ka zakon të thotë prof. Bajçinca “Ai që e shkruan dhe e flet bukur standardin, është privilegj për të”.

Standardi duhet pajisur me vepra shkencore, të shkruara në frymën e tij, duke e çuar atë në shkallët e arritjeve të përparuara. Sikur të mos ishte standardi, atëherë shqipja do të bëhej mishmash, s’do ta kuptonte kush. Merreni me mend, a do të kuptoheshin ndërmjet vete llapjani me dibrinin, ose gostivarsi me drenicakun? Mbase disi po, por Zoti e di. Prandaj standardi pikërisht në këso rrethanash bashkon jo vetëm nëndialekte e dialekte, por edhe shqiptarët midis tyre. Pra, ai bashkon njerëz, bashkon kultura siç po bashkon sot Udhë e Kombit “Ibrahim Rugova”.

Kohët e fundit janë çuar peshë disa zëra të çjerrë, duke rrëzuar gurë mbi dhe për standadin, pa e ditur dhe matur mirë se shqipja standarde e ka krijuar shtratin e saj për dyzet vjet me radhë. Atëherë do të pyesnim a ka kthim mbrapa? Në asnjë mënyrë - jo, sepse këtyre brezave nuk u duhet tjetër standard, nuk e duan çstandardizimin, nuk e duan prapakthimin, por ecjen përpara të kësaj shqipeje standarde.

Ne e dimë se standardi nuk është temë e paprekshme, nuk është temë tabu. Ai ka mundësi prekjeje e pykimi në anësoret e tij, por pa i lëvizur e as ngucur sistemet, sepse atëherë do të shkohej kah shkatërrimi i shqipes mbarë. Për mendimin tonë disa shumësa emrash, veçmas mashkullorësh, duhet parë për ndonjë ndryshim të tyre në të ardhmen.

Ne nuk e dimë dhe as nuk mund ta dimë se kujt po ia zë udhën standardi. Kur ai i përket së kaluarës, është temë që është kryer dyzet vjet më parë. Është temë që ka marrë fund në një të kaluar bukur të largët. Atëherë, sipas këtyre zërave, duhet të rishikohet edhe alfabeti i gjuhës shqipe.

Me sa duket, këto zëra do të pushojnë së çjerri në të ardhmen, sepse tani është vonë, tepër vonë, të merresh me tema të cilat i takojnë së kaluarës, së djeshmes. Gjuhëtari ynë, kujtojmë ne, ka me se të merret. Atë e presin detyra të mëdha për hartimin e veprave të ndryshme shkencore, në mënyrë që me to ta shpien shkencën shqiptare, Shqipen standarde, në nivele të lakmueshme të këtij horizonti. Me to ecet përpara. Nga kjo del se plangprishësit nuk kanë vend askund, në asnjë skaj të shoqërisë, aq më pak në fushën e shqipes standarde.

E mira është, mendojmë ne, se shqipja standarde duhet mbrojtur me ligj, duke vendosur kështu në Kuvendin e Shqipërisë dhe në Kuvendin e Kosovës, në mënyrë që të marrë fund njëherë e mirë kjo çështje dhe ngjarje me rëndësi shoqërore e mbarëkombëtare, sepse kjo çështje është me rëndësi të dorës së parë për të gjithë ne.

Nuk duhet harruar mundi dhe përpjekjet e rilindësve tanë, të cilët patën punuar rreth kësaj çështjeje gjatë gjithë jetës së tyre të përgjakshme të shumëvujtur, duke e harruar edhe vetveten për shqipen standarde. Dëshira dhe ëndrra e tyre e porealizuar ka mbetur pikërisht shqipja standarde. Ata mbeten rrahësit e udhës së gjatë të standardit të sotëm. Ata, për jetë të jetëve, do të mbeten prijësit e shqipes standarde. Ashtu qoftë dhe ashtu mbettë!

PROBLEME TË DIFERENCIMIT KUPTIMOR NË SHQIPEN STANDARDE

Çdo njësi gjuhësore e secilit nivel të gjuhës të cilit i përket, duke filluar qysh nga niveli i ulët (fonema) e deri tek më i larti (togfjalëshi, fjalia) ka dy tipare të qënësishme: ajo është e diferencueshme, e perceptueshme nga gjuhëpërdoruesi, por edhe diferencuese në formën e folur e të shkruar si në ligjërim (në rrjedhën ligjërimore), ashtu edhe në gjuhë, e pranuar kjo si sistem sipas konceptit sosyrian.

Dhe këto dy veti të njësisë për të qenë e diferencueshme dhe për të diferencuar ia japin asaj funksionet që ajo kryen në çdo rast (si njësi leksikore ose si njësi gramatikore). Në këtë mënyrë kryerja prej saj e një funksioni të caktuar (si p.sh funksionet kuptimdalluese të një foneme përmes tipareve diferencuese të saj, ashtu edhe i një kuptimi të caktuar (morfema, fjala, lokucioni, togfjalëshi), të cilat kushtëzojnë diferencimin si nevojë, si domosdoshmëri, e bën atë njësi përmbajtësore e jo njësi boshe (siç mund të zbulohen tek *nxënës-i* (n-si fonemë) *nxë* (n), -ës (si morfemë), *nxënës-i* (si fjalë) etj.

Vlera e diferencimit si prirje themelore gjuhësore mund të vërehet edhe në përmasa ndërgjuhësore. Kështu, p.sh. nevoja për diferencim nga ana e shkronjë-fonemës *h* të italishtes tek “*ho fatto, hai fatto*” çoi Duçen për të hequr dorë nga qëllimi i tij për heqjen e saj të tepërt, meqë ajo nuk shqiptohet në të folur, ndonëse përdoret në të shkruar. Duçja pasi u bind nga argumentimi i gjuhëtarëve për përplasjen e disa *o-ve* italiane në të shkruar, hoqi dorë nga qëllimi i tij, duke ua lënë gjuhëtarëve ta zgjidhin. Po kështu diferencimi ulet tek heqja e *të-së* në shqipe në kohën e ardhshme të foljes, ku në vend të “*do të punoj*” po përdoret “*do punoj*”. E njëjta gjë mund të thuhet për heqjen e *ë-së* shqipe në disa pozicione që si ç’mund të ndodhë prej kësaj, prof. Xh. Lloshi bie si shembull metamorfozën e fjalës *kotësi* në *kotsi*, që mund të perceptohet si *koci*.

Në të kundërt me këtë, panevoja e diferencimit çoi në heqjen lehtë prej një gjuhe të ish-tingull-fonemës ruse (*tjerdij znak*), e cila është kthyer në njësi boshe nga humbja prej saj e aftësisë diferencuese dhe që si rrjedhojë u përfshi në një ndër reformat për gjuhën pas Revolucionit të Tetorit në Rusi.

Duke mos u futur në përsiatje teoriko-shkencore, por edhe teoriko-praktike rreth trajtimit të shfaqjes së diferencimit në gjuhë (language), si në rrafshin e ligjërimin (parole), ashtu edhe të gjuhës si sistem (lingua) (sipas konceptit sosyrian), ne do theksonim disa anë themelore që lidhen me realizimet e kësaj dukurie universale, që del si prirje e zhvillimit gjuhësor që karakterizon çdo njësi gjuhësore, e vështuar edhe si njësi me funksione aktualizuese në gjuhë (në rrafsh sintagmatik), ashtu edhe si njësi e veçuar, e shkëputur nga akti ligjërimor, por e analizueshme në sistemin e lidhjeve të saj me të gjitha njësitë e tjera (në rrafsh paradigmatic).

Një pohim i tillë e përforcon më tepër konceptimin e diferencimit në gjuhë si një prirje universale e saj, si një ligjësi që lidhet drejtpërdrejt jo vetëm me funksionimin e njësisë gjuhësore në gjuhë (në të dyja rrafshet), por edhe me shfaqjet e lindjes dhe të formimit të saj si njësi, ku anët e diferencimit dhe të identifikimit nisin qysh nga dalja në jetë (ku vihet re synimi i krijuesit për të futur në gjuhë një formim të diferencueshëm dhe identifikues), nga funksionet që duhet të kryejë në ligjërim, nga futja në lidhjet në sistem me njësitë e tjera etj.

Në mënyrë të veçantë, vështruar nga kjo pikpamje, interes do të përbënin problemet e diferencimit të njësive leksikore të trajtuara në rrafshin kuptimor dhe në atë kuptimor - leksikor, ku anët e diferencimit dhe të identifikimit të tyre kalojnë përmes filtrit të marrëdhënieve mjaft komplekse të fjalës si njësia qendrore e gjuhës dhe, meqë ajo paraqitet si njësi përfshirëse (përfshin fonemat, morfemat) dhe njësi e përfshirë (përfshihet në togfjalëshat, fjalitë), tek ajo përmbidhen të sintetizuara e të përqëndruara të gjitha anët e diferencimit dhe të identifikimit të saj në rrafshin e formës (si anë e përceptuar) dhe në rrafshin e përmbajtjes (si anë jo e drejtpërdrejtë e perceptueshme), por si anë e kuptimësuar përmes formës tingullore ose shkrimore).

Duke vijuar më tej me problemin e diferencimit të njësisë leksikore (të fjalës) qysh me lindjen e saj si formim i ri (strukturë e re), mund të pohohet se vetia e diferencueshmërisë e ngjizur edhe në atë identifikuese lidhet me një rrethanë shumë të fuqishme jashtëgjuhësore, që shërben si stimul për lindjen e saj, siç është nevoja që ka ligjëruesi (po themi si krijues), për të veshur me këtë njësi (si mjet) konceptin (kuptimor) e ri, prandaj diferencimi e identifikimi i këtij kuptimi të ri, krahas mijëra (për të mos thënë qindra mijëra të tjerë) del si nevojë e dytë gjatë funksionimit të njësisë në përdorimin gjuhësor (në ligjërime) dhe në gjuhën si sistem. Si rrjedhim edhe diferencimi si prirje (ligjësi) “futet në lojë” përsëri, si në ligjërime, ashtu edhe në sistem.

Më poshtë po japim disa shembuj se si shfaqen këto anët të diferencimit qysh nga lindja e njësisë, në funksionimin e saj në të dyja rrafshet, si edhe problemet që lindin prej këtej. Meqë lindja e njësive të reja kushtëzohet në mënyrë të theksuar nga hopet zhvillimore të shoqërisë që e flet gjuhën e dhënë (në rastin tonë gjuhën standarde shqipe), atëherë kjo dukuri duhet vështruar në lidhje të ngushtë me problemin që na intereson, siç është diferencimi i fjalës si njësi leksikore. Duhet nënvizuar se shfaqjet e diferencimit mund të vërehen rast pas rasti në lidhjet sipas njësive të veçanta ose grupeve të njësive të përcaktuara fjalësore.

a- Fjala si njësi e vetëdiferencueshme dhe diferencuese.

Qysh pas vitit 90-të, me vendosjen e shoqërisë pluraliste, rivlerësimi i një personi që kishte vuajtur në diktaturë në kontekstin e të gjithë të tjerëve u quajt *bashkëvuajtës-i*; kjo njësi edhe deri ditët e sotme nga secili identifikohet si në ligjërime dhe në sistem (në lidhjet sistemore) me kuptimin e vet dhe mund të quhet si njësi e vetëdiferencueshme dhe diferencuese. Po kështu në ditët e sotme përdoret *bashkëjetues* (që s’mund të jetë *bashkëshort*, *burrë*), në një bashkëjetesë të krijuar nga dukuria e re e marrëdhënieve burrë/grua, krahas bashkëshort që mund të mos jetë *bashkëjetues* (sepse është lidhur ligjërisht). Si fenomen i ri sigurisht njësia futet në marrëdhënie në sistem dhe në grupin paradigmatic ajo i kundërvihet një njësie tjetër, një grupi njësish, por edhe të gjithë sistemit, si p.sh., *bashkëvuajtës* në kundërvënie me çdo njësi, që nuk ka një kuptim të tillë. Meqë kuptimet e njësive lidhen me njëra-tjetrën, kjo lidhje leksikore ose leksikore-kuptimore përbën atë që quhet paradigmë e jashtme.

b- Fjala del si njësi, është e diferencueshme, si një masë që përfshin brenda vetes një varg njësish kuptimore që lidhen me njëra tjetrën, ku secili prej tyre diferencohet dhe identifikohet vetëm përmes një shenje (njësie). Siç duket në këtë rast, ky diferencim i tyre që, si të thuash, realizohet përmes përsëritjes së shenjës (shënjuesit) sa herë që del kuptimi përkatës në aktin e ligjërit bëhet përmes situatës, lidhjeve leksiko-sintaksore etj., siç mund të diferencohen disa kuptime të shenjës *brez* në lidhjet sintagmatike: 1. “Iron *brezin*

nga mesi”; 2. “ ky i përket një brezi të ri punonjësish” etj. Meqë në këtë rast kemi lidhje njësisht kuptimore të diferencuara, ne e kemi quajtur paradigme të brendshme⁵⁴, pra lidhen në mikrosistem: brez₁-brez₂-brez₃ etj.

c- Ndonjëherë diferencimi brenda një shenje bëhet për llogari të futjes në sistemin e lidhjeve kuptimore të kuptimit që e bart nga fjala e huaj, për të cilën sipas kuptimit të afërt që ka me njësinë shqipe, vishet me shenjën e kësaj të fundit, siç mund të themi “skuadra jonë luan në shtëpi (= në vendin e vet” nga anglishtja = “Our team plays *at home* (angl.) = (it) La nostra squadra gioca *in casa*”

Duke i vështruar tre rastet e mësipërme mund të vërejmë se diferencimi në gjuhë paradoksalisht kalon përmes dy rrugëve:

1. Diferencimi ecën drejt shtimit të njërive të gjuhës, e pasuron atë, pra, diferencimi realisht çon në zhvillimin e gjuhës: *bashkëvuajtës/bashkëjetues (bashkëshort/burrë, i martuar)* etj.

2. Diferencimi ecën drejt frenimit të zhvillimit, meqë tashmë shkohet drejt kufizimit të shenjave të reja dhe kuptimet mblidhen në një njësi, pra kemi dukurinë e kondesimit. Nëse do të supozonim se njësia do të merrte shumë kuptime mbi vete, ajo, si të thuash do të konsumohej, do të desemantizohej, siç kemi foljet *bëj, jap, marr* etj.

Për të gjykuar rreth këtij zhvillimi para-prapavajtës të gjuhës, që gjithsesi është zhvillim do të mbështetemi në argumentimin e prof. J. Thomait⁵⁵, i cili, duke sjellë si shembull kuptimet e fjalës *këmbë* (*këmbë* e njeriut, *këmbë* e tryezës) pohon se “sintetizimi në këtë rast pajtohet me rregullsitë e gjuhës e si i tillë përbën zhvillim. Kështu kuptimi i fjalës është në lëvizje të përhershme, ndryshimet e tij çojnë në lidhje të reja sintagmatike, kurse në strukturën kuptimore sjellin rigrupime përbërësish që pasqyrojnë ndryshimet në vetë realien e realitetin. Duke u thelluar më tej në argumentimin e J. Thomait, do të pohojmë se ky zhvillim kushtëzohet, nga njëra anë, me detyrën funksionale që kryen gjuha për të shprehur gjithë tërësinë e grimcave të përvojës së pafundësisë njerëzore me njësi relativisht të fundme sidomos në nivelin e leksikut. Nga ana tjetër, ka një rrethanë tjetër që lidhet me aftësinë e trurit të njeriut. Në ndërgjegjen e tij gjuhësore, që sot jepet me termin kompetencë, janë të diferencuara si njësitë gjuhësore, ashtu edhe kuptimet. Këto të fundit, po të mos ishin të tilla, s’do të na lejonin ta aktualizonim në ligjërim çdo kuptim që shënohet nga njësia gjuhësore. Ndërsa në kompetencë njësinë e kemi “të gatshme” dhe duhet ta kemi të tillë, kjo është garancia që të realizojmë në performancë. Unë mund ta veçoj “shkëpus” nga koka ime, ndërgjegjja gjuhësore kuptimin që shënon *shtëpi*, për të ndërtuar frazën: “Skuadra luan në shtëpi, meqë unë këtë e kam mësuar tashmë nga një gjuhë e huaj që ka shërbyer si bazë për të futur këtë fjalë në sistemin tim kuptimor. Brenda këtij motivimi në kuptojmë frazën “Banori i eliminuar i shtëpisë të Big Brother-it po përgatit plaçkat për të shkuar në *shtëpi*”. Dhe kjo është arsyeja që kjo paradigme e brendshme jepet e diferencuar në Fjalorin shpjegues të gjuhës, siç jepen për shembull për *shtëpi* kuptimet 1. “vetë shtëpia”, 2. “familja” “ (Doli *shtëpia* të priste) 3. “plaçkat” (Iu dogj shtëpia etj.), ... 6. “në vendin e vet” (Skuadra luajti në *shtëpi*).

⁵⁴ A. Duro, “Grupet paradigmatisht të fjalëve dhe të termave”, “Studime filologjike” 1989/4

⁵⁵ J. Thomai, Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe EDFA, Tiranë, 2009, f. 290

Meqë në të dyja rastet kemi diferencime, d.m.th. edhe në paradigmën leksikore (diferencim leksikor) edhe në paradigmën kuptimore (diferencim kuptimor) dhe, meqë të dyja rastet lidhen me zhvillimin e gjuhës (pra në të dyja rastet gjuha zhvillohet), atëherë problemet duhet të dalin nga raportet që krijohen ndërmjet këtyre lidhjeve (realisht diferencuese, në rastin e parë, dhe realisht kundërdiferencuese, në rastin e dytë).

Duke u mbështetur në raportet që vendosen ndërmjet këtyre dy rrafshëve (lidhjeve kuptimore) dhe lidhjeve leksikore, duhet theksuar se kondesimi (që pasqyrohet në prejardhje kuptimore) zhvillohet më shpejt se diferencimi (që pasqyrohet në prejardhjen fjalëformuese), prandaj problemi themelor lidhet me “luftën” që kryen brenda vetes, duke e bërë këtë zhvillim të vetvetishëm, por të rregulluar siaps ligjeve të brendshme të saj dhe me “luftën” që bën subjekti, duke e bërë këtë zhvillim të detyruar, të sforcuar, me ndërhyrje nga jashtë. Sido që të ndodhë, si në rastin e parë, ashtu edhe në të dytën këto ‘luftëra’ çojnë në zhvillimin e baraspeshuar të gjuhës, duke dhënë njësi që kërkohen të jenë të kondensuara, por në atë masë sa të mos cënohet kërkesa për njësi me kuptime të diferencuara në nivelin e ulët të ligjërit, në atë libror, që paraqitet si nivel i intelektualizuar. Në këtë rast mund të kemi kundërvënie në nivel regjistri gjuhësor pavarësisht se fjalët mund të shfaqen si sinonime, si: “Ku rri ti?” (për “Ku banon ti?”) dhe “Ku *banon* ti?” dhe jo : “Ku rri ti?” (p.sh gjatë regjistrimit në një hotel: “Më thuaj *ditëlindjen* (dhe jo: *datëlindjen*) dhe më thuaj *datëlindjen* (dhe jo *ditëlindjen*) (p.sh., për të nxjerrë një pasaportë).

Si rregull regjistri shkon nga i ulëti në të lartin, por mund të kalojë nga i larti në të ultin, siç dëgjohet në thjeshtligjërim: “Kjo nuk *funksionon*” “Duhet të *integrohesh* që të përballosh vështirësitë”.

Siç u theksuar më sipër, ndërmjet kondensimit (si diferencim i brendshëm, dhe që nga ana e zhvillimit real të gjuhës mund të quhet kundërdiferencim) dhe diferencimit real (si diferencim i jashtëm që pasqyrohet në lidhjet leksikore), zhvillohet një luftë si brenda njësisë, ashtu edhe jashtë saj për të arritur pikërisht në një baraspeshim të këtyre dy prirjeve, luftë e cila intensifikohet më shumë kur kondensimi i njësisë rritet pa masë, çka çon në atë që quhet konsumim kuptimor⁵⁶ dhe në uljen e diferencimit të formimeve të reja. Rezultati i luftës së këtyre dy prirjeve pasqyrohet edhe në fjalorët shpjegues, në strukturat semantike të fjalëve, por edhe në ligjërim, si edhe në ndërhyrjet që bëhen në këto procese nga studiuesit dhe lëvruarit e gjuhës në mënyrë të veçantë në nivelet e specializuara të leksikut, sidomos në leksikun terminologjik, ku ndërhyrjet në proceset e përpunimit të leksikut, të sistemit e të njësimin të tij janë pjesë përbërëse e politikës dhe e planifikimit gjuhësor në fushën e terminologjisë.

Rastet e rritjes së shkallës së diferencimit të njësive vihen re jo vetëm në rrafshin e prejardhjes fjalëformuese, ku synohet që më mjetet fjalformuese të formohen gjithnjë e më shumë njësi të huaja, por edhe duke u përpjekur që të “thyhen” strukturat kuptimore të njësive të shumëkuptimshme (polisematike), duke e drejtuar tashmë e ndryshimeve në kuptimet me prirje shprehëse nga struktura kuptimore e fjalës së mbingarkuar me kuptime, sidomos me kuptime, të cilat nga zhvillimet e vullshme të kuptimeve të fjalëve, largohen nga njëra tjetra e si të tilla ndihen si homonime. Kjo vërehet sidomos në fushën e leksikut

⁵⁶ E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e Ismaili Kadaresë*, SHBLU, Tiranë 1998

terminologjik, i cili priret drejt njësive të njëkuptimshme dhe ku, polisemia ndihet si homonimi⁴.

Duke mos u zgjatur në këtë çështje që kërkon trajtim më të thellë teoriko-praktik ne do të përqëndrohemi në disa raste më tipike të shfaqjeve të “thyerjes” së prirjeve kondesuese të njësive leksikore, sidomos të atyreve që lidhen me shtimin e kuptimeve që kanë formuar brenda strukturës semantike të fjalës boshte kuptimore më vete, dhe kur veshja e saj me një njësi tjetër që ta diferencojë kuptimin shenjësisht është e mundshme dhe e realizueshme. Si të tilla këto njësi mund të gjenden në gjuhë, kur janë të njëjta kuptimisht me njësinë me bosht kuptimor më vete, mund të krijohen si të reja mbi bazën e kuptimit që bart njësia kuptimore që kërkon të shkëputet, por kjo mund të bëhet në mënyrë të vetvetishme dhe brendapërbrenda strukturës semantike të shenjës, duke u ndryshuar si rrjedhojë e veprimit të ligjeve semantiko-shenjuese të vetë gjuhës.

1. Rasti i diferencimeve më të natyrshme lidhet me “çarjen” e strukturës semantiko-leksikore të fjalës, e cila mund të ndahet për dy kuptimet e larguara nga njëra-tjetra në dy njësi relativisht të dallueshme, të cilat, si të tilla, diferencojnë realisht kuptimet, duke e çliruar fjalën nga kuptimi e duke e marrë këtë përsipër njësia që lidhet strukturalisht me fjalën bazë. Kështu sot në gjuhën shqipe në nivelin e leksikut vërehet një diferencim i tillë. Kjo pasqyrohet edhe në fjalorët shpjegues ose në përdorim në praktikën ligjërimore, si p.sh.: *rregull/rregull-a* e lidhur me *rregull-i*, *trup-i/trupë*, $\leftarrow$ *trup*, *dru-ri/ dru-ja*, $\leftarrow$ *dru-ri*, *klasë-a/ klas-i* $\leftarrow$ *klasë*, *atë-i/ at-i* $\leftarrow$ *atë*, *rrip-i/ rryp-i* $\leftarrow$ *rrip*, *frut/fryt/frutë* $\leftarrow$ *frut*.

2. Në njësitë me kuptime me kufij pak a shumë të dallueshëm njëri nga tjetri, d.m.th., me një shkallë diferencimi pak a shumë të lartë, njëra nga kuptimet më të diferencuara mund të shënohet prej një fjale tjetër, e cila e mbulon këtë plotësisht nga ana kuptimore. Duke marrë mbi vete këtë kuptim, ajo si njësi e perceptueshme, i kundërvihet tashmë shenjës së parë dhe e diferencon atë shenjërisht. Kështu ka ndodhur dikur me *kohë* dhe *mot*. Dikur thuhej *parashikimi i kohës*, madje *proгноza e kohës*, ku kuptimi që përmbante *kohë* e mori mbi vete *mot* dhe kështu njësia *kohë* u shkarkua nga ai kuptim që iu ngarkua njësisë *mot*, çka bëri që të rritet shkalla e diferencimit të fjalës *kohë*. Një diferencim i tillë mund të realizohet në një nga kuptimet e fjalës *pikë*, që ka krijuar bosht kuptimor me vetë “masë lëngu rruzullor e vogël” me anën e fjalës *pikël*, e cila ka marrë mbi vete kuptimin e fjalës *pikë* të dhënë më sipër. Kështu *pikë* (lëngu) është diferencuar me *pikël* (lëngu), çka ka bërë ky diferencim të kalojë edhe tek folja, duke dhënë kështu në vend “ lëngu *pikon/ lëngu pikëlon*”. Këtë diferencim e shohim edhe ndërmjet *qëndrueshmëri* dhe *qëndresë*, *qëndrim* dhe *ndalesë*, *ndalesë* dhe *stacion*, të cilat japin në mënyrë të diferencuar : *qëndrim* (në këmbë) *ndalesë* (e përkohshme autobusi)/*stacion* (i përhershëm autobusi, treni).

3. Ndonjëherë diferencimi mund të kryhet me anën e një njësie, që “thyhen” dy ose tre kuptime të largëta të një fjale, të cilat e ngrenë shenjën që shpreh 2-3 kuptime në nivel homonimesh. Kjo e bën më të lehtë shprehjen e një ose dy kuptimeve të shkëputura me një ose dy shenja të tjera. Ky rast ndodh p.sh. kur kuptimet shprehin raporte ndërmjet veprimit dhe rezulttit, veprimit dhe objektit, veglës dhe makinës, të tërës dhe pjesës etj., të cilat ua kalojnë këto kuptime dy shenjave të ndryshme, duke i dhënë ato të diferencuara shenjërisht, si *prodhim* (proces) dhe *produkt* (rezultat) për *prodhim₁- prodhim₂*; *sharrë* dhe *sharruese* (për *sharrë₁* (vegël) - *sharrë₂* (makinë)).

4. Në disa raste diferencimi mund të realizohet me anën e formimeve të reja, të

cilat, duke marrë mbi vete shprehjen e një kuptimi të largët të fjalës, rritin shkallën e diferencimit të saj, duke e shkarkuar nga ai kuptim. Ky është kryesisht diferencim plotësisht i drejtuar, meqë futja e një njësie të formuar posaçërisht për kuptimin e dhënë, shihet si ndërhyrje nga jashtë, çka vërehet më shumë në gjuhën e shkencës dhe të teknikës, në të cilën diferencimi i lartë kushtëzohet nga kërkesat e kësaj gjuhe për saktësi dhe motivim të lartë të termave, çka bën që një ndërhyrje e tillë të jetë e pranueshme. Kjo është realizuar në ndonjë fjalor terminologjik edhe nga nevoja për zëvendësimin e termave të huaja. Kështu p.sh., për *prerje*₁(veprim) - *prerje*₂ (rezultat) → *prerje/premë*, *pikë*₁ – *pikë*₂ → *pikë/ pikëz*, *kokë*₁-*kokë*₂ → *kokë/ kokë*₂ (p.sh. *kokë* (njeriu) *kokë*₂ (organi) (anat.), *rrënjë*₁ – *rrënjë*₂ → *rrënjë/rrënjor* (p.sh. *rrënjë* (mat.)/*rrënjor* (kim. për radikal), *mi*₁-*mi*₂ → *mi*₁/ *miush* (inform.).(Për këtë diferencim shih Fj.2006). Formime të këtij lloji krijohen me qëllim që të zëvendësohen me ta termat e huaj, si në informatikë: *miush* (në vend të *mi*) për *maus*, *premë* për *seksion*, *rrënjor* për *radikal*, *breznë* (në vend të *brez*) për *gjeneratë*.

5. Ndonjëherë nevoja për diferencim, e motivuar edhe nga prirja për shqipërim të çdo termi të huaj, ka çuar në cenimin e diferencimit në ndonjë fushë terminologjike. Kjo bën që për hir të ruajtjes të saktësisë së shprehjes së koncepteve nga termat, të kthehemi përsëri tek termat e huaj. Kështu, p.sh. ky rikthim tek gjendja e kaluar mund të shihet tek një varg termash shqip me strukturë kuptimore me kondesim të lartë, të cilët kanë çuar në uljen e shkallës së diferencimit të termave. Kështu, p.sh. termi *lloj* në shqipe ka marrë përsipër shprehjen e koncepteve të dhëna dikur nga *specie* (bot.) dhe *zhanër* (letër); po kështu *gërryerje* për *abrasion* dhe *korrozion*.

Siç del nga parashtesa e mësipërme problemet e diferencimit kuptimor në gjuhë janë të shumta dhe komplekse. Ato janë prekur pak në studimet gjuhësore rreth leksikut. Në këtë parashtesë vetëm sa hapet rruga për studime të mëtejshme e më të thelluara në këtë fushë.

TRADITA ELBASANASE DHE GJUHA LETRARE SHQIPE

Që në vitet '70-'80 të shek. XIX u shtrua si kërkesë e domosdoshme lëvrimi i gjuhës kombëtare. Kërkesat në plan gjuhësor të Shoqërisë së Stambollit (1879), që shqipja të shpallej gjuhë zyrtare dhe të krijohej një gjuhë letrare e përbashkët u mbështetën nga shoqëri të tjera, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë kufijve. Pas 7 marsit 1887 krahas Tiranës, Dibrës, Beratit, Kolonjës dhe Gjirokastrës hapi shkollën shqipe edhe Elbasani, qyteti që do të nxirrte atdhetarë dhe gjuhëtarë, të cilët me lëvrimin që do t'i bënin shqipes do të ndihmonin në formimin e gjuhës standarde.

Në fillimshkullin e kaluar, më 14 gusht 1901 konsullit rus, A. Rostkovskij, i dërgonte Ministrisë së Jashtme ruse nga Manastiri, këtë informacion: "...qarku i Elbasanit është qendër e propagandës nacionale Shqiptare dhe se atje ka ngulur rrënjë të thella ideja e propagandës prej komiteteve të ndryshme të jashtme shqiptare, se të gjithë shqiptarët pa dallim feje, janë vëllezër dhe e kanë për detyrë të ndihmojnë njeri-tjetrin në çdo rast". (Marrë nga dokumentacioni i Arkivit Qendror.)

Ngjarjet e mëdha si: Kongresi i Manastirit (1908); Kongresi i Elbasanit (1909); Shkolla Normale e Elbasanit (1909) do të shënonin nisjen e një rruge të re, kur dihet "që në gjysmën e parë të shek. XX ishin kristalizuar objektivat, si: njësimi i alfabetit; njësimi i drejtshkrimit; njësimi i gjuhës letrare; njësimi i terminologjisë; hartimi i teksteve për mësimin e shqipes në shkollë; botimi i veprave të thelluara në fushë të shqipes."⁵⁷

Kur u çel "Shkolla Normale" gazeta "Korça" e quajti "Universitet shqiptar". Aty u pranuan nxënës nga të gjitha krahinat e vendit, pa përjashtuar edhe Kosovën e Çamërinë. Drejtori i Normales, Luigj Gurakuqi në ditën e hapjes tha : "Këtu kadundari me qytetarin, malësori me fusharakun do të bashkëtrajtohen e do të bahen një; këtu toska me gegën do të derdhen, do të treten, do të përzihen bashkë...këtu gjuha shqype... do të marrë një trajtë e një fytyrë të përbashkme, këndeje do të dalin shqyptarë, vetëm shqyptarë!"

Në këtë kohë, Aleksandër Xhuvani, Simon Shuteriqi, Kostaq Cipo punuan paralelisht për gjuhën shqipe dhe për arsimin kombëtar, ashtu si paraardhësi i tyre Kristoforidhi.

Kristoforidhi, me hartimin e Memorandumit për gjuhën shqipe, me përkthimet shqipe në dy variante letrare: më 1860 *Dhjata e re*, toskërisht e gegërisht; më 1866 në gegërisht *Katër Ungjijtë dhe punët e Apostujve*; *Psallmet* (1868 toskërisht, 1869 gegërisht), *Dhjata e re* (gegërisht 1869, toskërisht 1879), *Të bërët dhe të dalët* (toskërisht 1880), *Nomi i dytë* (toskërisht 1882) *Fjalët e urta të Solomonit* dhe *Vivla e Isaisë* (toskërisht 1884). Me botimin: më 1867 e *Abetares* në gegërisht, më 1868 toskërisht dhe libra të vegjël për nxënësit; me *Gramatikën e gjuhës shqipe* sipas dialektit toskë më 1882; me dorëshkrimet me shënime gjuhësore dhe me veprën themelore për të cilën punoi gjithë jetën, me *Fjalorin e gjuhës shqipe*, që nxori në dritë vlera të shumta të gjuhës së popullit; me përpjekjet për të dhënë fshehurazi mësimet për shqipen, deri sa u nda nga jeta kishte fituar statusin e pararendësit, e prijësit të "shkollës së Elbasanit", që do të kapërcente kufijtë e e këtij qyteti dhe do t'i përkiste mbarë Shqipërisë.

⁵⁷ Mehmet Çeliku, *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë, 2006, f.15.

Aleksandër Xhuvani, kërkonte “shpëtimin e kombit”. Ai shkruante në një artikull të revistës “ALBANIA” të Konicës se gjuha e vetme letrare duhet t’i ketë bazat në dialektin e toskërishtes, Më 1921, ai doli me një program pune për mbledhjen e të folmeve të leksikut popullor. Për përcaktimin e drejtshkrimit ai mendonte se duheshin zbatuar disa rregulla, si: zbulimi gjuhës popullore; studimi i gjuhës popullore dhe gjuhës së shkrimtarëve të vjetër dhe të shkrimtarëve të rinj *që shkruajnë një shqipe të kthjellët*; studimi i kësaj lënde në pikëpamje fonetike, morfologjike, semasiologjike, sintaksore dhe etimologjike. Ai besonte se gjuha e njësuar do të formohej pasi të plotësoheshin këto kushte. Për gjuhën standarde, Xhuvani përdori termat: *gjuhë letrare; gjuhë letrare shkrimtare; gjuhë e përbashkme kombëtare*.

Me përkushtim drejtoi hartimin e udhëzuesve drejtshkrimorë të (1949-ës, 1951-it, 1954-ës, 1956-ës) që zgjeruan gjithnjë e më shumë rrethin e çështjeve dhe çelën rrugën për njësimin e plotë të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Nga janari 1947 deri në shtator 1953, A. Xhuvani drejtoi seksionin e Gjuhës e të Letërsisë në Institutin e Studimeve. Ai u përpoq që shqipja të ishte e pastër (më 1956 me librin “*Për pastërtinë e gjuhës shqipe*” dha një ndihmesë të çmuar për pasurimin e gjuhës sonë letrare, sidomos për përpunimin e terminologjisë të mjaft degëve të dijes, sidomos, të gramatikës, të letërsisë dhe të shkencave pedagogjike.) Po këtë vit ai deklaroi: “Më duket se edhe gjuha shkrimtare letëre, qi duem me krijue nga një ligjëronjë ka me dalë, nga toskërishtja.”⁵⁸

E frytshme ishte veprimtaria e tij kërkimore në fushat e fjalëformimit, morfologjisë dhe sintaksës, që u kurorëzua me punimet për pjesoren e paskajoren, monografinë “*Parafjalët*”, si dhe hartimin, në bashkëpunim me profesor E. Çabej, të dy trajtesave: “*Parashtesat*” (1956) dhe “*Prapashtesat e gjuhës shqipe*” (1962), të cilat karakterizohen nga vështrimi i gjerë, sinkronik e diakronik.

Gjithashtu, një nga të parët gjuhëtarë që e përqëndroi vëmendjen në problemet e normës drejtshkrimore dhe morfologjike ishte S. Shuteriqi. Si njohës i mirë i vlerave historike dhe linguistike perëndimore, kapi çështjet problemore, në “*Ortografia e gjuhës shqipe*”, e cila shërbeu për ortografinë e mëvonëshme. Për rregullat që lidhen me drejtshkrimin e të gjitha kategorive gramatikore për pjesë të ndryshme të ligjëratës, ai sjell edhe arsyet dhe shpjegimet përkatëse që mbështetin këto rregulla. Kërkesat themelore për ortografinë e gjuhës shqipe, sipas S. Shuteriqit janë: ortografi e njësuar, e thjeshtë, fonetike. Qëllimi kryesor i tij ishte që gegërishtja dhe toskërishtja të afroheshin: në drejtshkrim, në fonetikë dhe në morfologji.

Përfaqësuesi tjetër, Kostaq Cipo, ish- ministër i arsimit, nga janari i vitit 1945 deri në prill të 1946; nismëtari i hapjes së Institutit Pedagogjik Dyvjeçar; drejtori i Institutit të Studimeve, anëtari i këtij instituti, dhe specialist i gjuhës shqipe në këtë institut, ishte autor i veprave: *Morfologjia historike e shqipes* (1947); *Fonetika* (1947); *Rreth disa kompozitave* (1948); *Kompozitat determinative* (1948); *Gramatika për klasat e V,VI e të VII të shkollës shtatëvjeçare* (1948); *Gramatika (fonetika dhe morfologjia)* 1949.

Ai së bashku me Xhuvanin dhe Çabejn mori pjesë në hartimin e Udhëzuesit të Parë

⁵⁸ A. Xhuvani, *Studime gjuhësore*, Tiranë, 1956, f. 5-8.

Drejtshkrimor të gjuhës letrare (1948- 1950). Vepra e tij e rëndësishme ishte *Gramatika e gjuhës shqipe*, në dy vëllime, për sintaksën, madje u vlerësua edhe me “Çmimin e Republikës”. “*Gramatika shqipe*” ishte gramatika e parë e karakterit shkencor. Gjithashtu, punimet e tij: *Vërejtje fonetike, morfologjike e sintaktike mbi “Doktrinën e Krishtenë”* të Budit (1618); *Fillimet e stilistikës e letërsisë* (si bashkautor, botuar më 1930) *Shënime e shpjegime të veprës “Historia e Skënderbeut”* (1953), botuar pas vdekjes, si dhe *Fjalori i gjuhës shqipe* (si bashkautor , botuar më 1954) dëshmuar për njohësin e mirë të stileve dhe të leksikut.

Fusha e sintaksës, morfologjisë, dialektologjisë, historisë së gjuhës, gramatika historike, historia e gjuhës së shkruar dhe e gjuhës letrare, historia e albanologjisë, onomastika, leksikografia, natyrisht edhe drejtshkrimi, dhe kultura e gjuhës ndien dorën e mjeshtrit, filologut Mahir Domi. i cili do të kujtohet edhe si një drejtues i Kongresit të Drejtshkrimit. Vepra e tij kryesore mbetet “*Morfologjia historike e gjuhës shqipe*” (vepra e parë e këtij lloji e botuar në Shqipëri). Ai drejtoi dhe organizoi punën shkencore për “*Gramatikën e gjuhës shqipe*”, në botimin e së cilës pati funksionin e kryeredaktorit.

Një tjetër pausë i kësaj tradite është edhe Lirak Dodbiba, i cili dha një kontribut të çmuar në fushën e leksikografisë. Ai arriti të drejtojë me sukses punën dhe të bashkëpunojë në hartimin e 26 fjalorëve të terminologjisë tekniko-shkencore, si: *Fjalori i termave të statistikës; Fjalori i termave të së drejtës; Fjalori i termave të gjuhësisë* etj., duke e vënë shqipen përballë gjuhëve të tilla të zhvilluara e të kodifikuara, si: rusishtja, frëngjishtja, anglishtja dhe gjermanishtja, duke parë mundësinë e zgjerimit të kuptimit të fjalëve, tipat më prodhues të fjalëformimit si dhe shqipërimin e termave shkencore të gjuhëve të huaja.

Së fundmi, mund të themi se një vend të nderuar në këtë shkollë zë edhe prof. M. Çeliku, që e vazhdoi dhe po e pasuron ende traditën e paraardhësve.

Ai kontribuoi me studimet: “*Disa vërejtje e sugjerime për rregullat e drejtshkrimit të shqipes*” (projekt) 1967; *Probleme të diskutueshme rreth drejtshkrimit të gjuhës shqipe*” të vitit 1973, është bashkautor në veprën “*Gramatika e gjuhës shqipe*”, konkretisht, autor i krerëve: gjymtyrët e veçuara, fjalët dhe togjet e fjalëve jashtë lidhjeve sintaksore me gjymtyrët e fjalisë, fjalitë njëkryegjymtyrëshe, fjalitë e paplota, fjalitë e pagjymtyrëzueshme, fjalitë e ndërmjetme dhe fjalitë e ndërkallura. Vëllimi “*Probleme të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*” dëshmon punën e tij si studiues edhe në fushën e morfologjisë. Si një botim me vlerë për gjuhësinë shqiptare klasifikohet edhe monografia e tij “*Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*”. Duke qenë një njohës i mirë i letërsisë artistike ai trajton çështje të normës morfologjike në letërsinë e pasluftës apo në media, duke përcaktuar shmangiet në sistemin emëror, foljor, ku një rëndësi të veçantë i kushton problemit të paskajores në shqipen standarde. Gjithashtu objekt i trajtesave të tij bëhen edhe sistemi leksikor dhe ai terminologjik, trajtesa në të cilat ai përcakton edhe detyra për leksikografinë e sotme shqipe. Të gjitha këto të përmbledhura në “*Çështje të shqipes standarde*”.

Një punë e tillë e këtyre atdhetarëve dhe gjuhëtarëve, krahas punës së gjuhëtarëve të tjerë, bëri që veçoritë strukturore të shqipes në fushën gramatikore dhe leksikore, të kodifikohen në vepra si “*Gramatika e gjuhës shqipe*,” “*Fjalori i gjuhës shqipe*”, ku natyrisht, përfshihet dhe aspekti fonetik dhe fjalëformues.

Shqipja standarde u ngrit në nivelin mbidialektor, u krijuan premiset që ajo të vazhdojë të përsoset stilistikisht, duke funksionuar, gjithashtu, si një faktor i konsolidimit, i

bashkimit të njësisë etnokulturore shqiptare.

Këtu do të ishte mirë të theksonim se ashtu si edhe gjuhëtarë të tjerë të traditës, apo gjuhëtarë më të rinj, edhe përfaqësuesit e kësaj shkolle e mbështetnin zhvillimin e normës letrare.

Profesor Çeliku, sot në kuadër të diskutimeve, shpreh mendimin se mund të përmirësohet “*Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*” (1973) kur është fjala për gjuhën standarde, në “*Gjuha e sotme letrare shqipe dhe shkolla*” shkruan: “Zotërimi i gjuhës standarde në shkollë duhet vlerësuar si një detyrë parësore dhe atdhetare; nga mësuesit dhe nxënësit kërkohet punë me përkushtim, me atdhetarizëm dhe passion; kërkohet kualifikimi sistematik i mësuesve...Të mësohet kultura gjuhësore e shqipes si lëndë e veçantë në të gjithë nivelet e shkollave, ...shkollat e larta, veçanërisht ato të mësuesisë, duhen t’u afrohen në shumë drejtime universiteteve perëndimore, ato duhet të shtojnë kërkesat ndaj mësimdhënësve dhe ndaj studentëve; fiktiviteti dëmton jashtëzakonisht brezat e ardhshëm dhe shoqërinë shqiptare.”;⁵⁹ “...shkencat gjuhësore duhet t’u përgjigjen më mirë nevojave të ditës: hartimi i rregullave drejtshqiptimore dhe shpallja e tyre si e detyruar për zbatim...” “Për ta përsosur më tej, standardin, ai është i mendimit se duhet të luftohen fjalët dhe termat që kanë hyrë kohët e fundit dhe që nuk janë ndërkombëtarizma, se duhet të pasurohet fjalori me fjalët e reja që janë në qarkullim dhe se shqipja letrare mund të pasurohet me fjalë dhe shprehje nga veriu, sidomos me fjalë dhe shprehje nga Kosova.”⁶⁰

Në këtë 40-vjetor të Kongresit të Drejtshkrimit, duke e trajtuar në mënyrë të detajuar traditën elbasanase jo vetëm po i kujtojmë këto personalitete, por edhe duhet të vlerësojmë: se sa i madh madh është rezultati, i punës së tyre; se gjuha standarde shqipe ka në themele edhe këtë vepër madhore të “Shkollës së Elbasanit”.

Si e tillë, gjuha standarde shqipe, s’mund të pranojë një “ex novo”, ajo duhet vlerësuar, duhet mbrojtur në mënyrë institucionale, duhet pasuruar, duhet zhvilluar.

Referime

Ajeti, I. *Alfabeti i K.Kristoforidhit dhe çështja gjuhësore në veprën e tij*, “Gjuha jonë”, 1 - 4, 1995.

ASHSH, *Gramatika e shqipes së sotme*, I, II, 2002.

Çeliku, M. *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë, 2006.

Demiraj, Sh. *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, 1989.

Demiraj, Sh – Prifti, K. *Kongresi i Manastirit*, 1978.

Domi, M. *Dukuri të zhvillimit të strukturës gramatikore*, SF, 1984/4.

Haxhi, A.- Topalli, T. *Historia e gjuhës së shkruar*, 1998.

Kongresi i Drejtshkrimit, I, II, 1973.

Raka, F. *Historia e shqipes letrare*, 1997.

Samara, M. *Histori e gjuhës letrare shqipe*, 2005.

Shkurtaj, Gj. *Shqipja standarde dhe shoqëria sot*, 2003.

Xhuvani, A. *Vepra*, I, 1980.

⁵⁹ Mehmet Çeliku, *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë, 2006, f. 390.

⁶⁰ Po aty, f. 391.

RRETH TË ASHTUQUAJTURËS “GJUHË E DRUNJTË” NË FUSHËN E PUBLICISTIKËS

Në këto vitet e fundit, gjithnjë e më shumë, vëmendja e gjuhësisë botërore dhe asaj shqiptare (pas vitit 2000) është përqendruar në studimin e gjuhës standarde nga pikëpamja e polivalencës ose e funksioneve të saj shoqërore. Kjo do të thotë që po merr më shumë rëndësi studimi i gjuhëve letrare kombëtare, duke përfshirë edhe shqipen, në aspektin e mënyrës se si përdoren mjetet gjuhësore në ligjërimin e përditshëm.

Ky aspekt i shqipes letrare ka dalë më në pah në epokën e sotme, kur ajo po arrin shkallën më të lartë të zhvillimit të saj strukturor e normativ, d.m.th. në kohën kur bëhet grumbullimi dhe shtresëzimi i mjeteve më të zgjedhura gjuhësore nga pikëpamja e *normës stilistike* ose nga ana e përdorimit të saj sipas fushave të veprimtarisë shoqërore, ku futet edhe publicistika.

1. Një ndër termat më të përdorura me këtë rast nga gjuhëtarët është termi “*gjuhë e drunjtë*”, për të cilin mendoj se ende nuk ka një koncept të qartë se ç’është kjo gjuhë, si e kur dhe pse përdoret?

Kjo është edhe çështja e parë që synojmë të sqarojmë në këtë kumtim të përmbledhur, me aq sa kemi pasur mundësi të vëzhgojmë përdorimin e kësaj gjuhe në mjetet tona të informimit (në shtyp e televizion), ku vijnë të botohen me shumicë fjalime dhe intervista për probleme me karakter politik, ekonomik, kulturor etj.

Për përdorimin e gjuhës letrare shqipe në mjetet e informimit është shkruar edhe më parë nga disa gjuhëtarë, ndër të cilët mund të përmendim: Xh. Lloshi, E. Lafe, J. Thomai, Sh. Islamaj, Gj. Shkurtaç, A. Vehbiu etj.⁶¹ Por, në këto shkrime vëmendja është përqendruar më tepër në përdorimin e drejtë të normës letrare shqipe (d.m.th. si duhet të përdoret ajo) nga ana drejtshkrimore, gramatikore e leksikore; ndërsa mendoj që vetë termi *gjuhë e drunjtë* nuk është sqaruar mirë. Prandaj pyetja e parë që shtrohet dhe që duhet sqaruar është: çfarë kuptohet me *gjuhë të drunjtë*?

a) Si term, *gjuhë e drunjtë* (fr. *langue de bois*), është përdorur më shumë në gjuhësinë e huaj për të karakterizuar mënyrën e të shprehurit në gjuhët sllave të vendeve të Lindjes, si p.sh. në rusishte, në polonishte etj., në kohën e regjimeve totalitare. Mjafton të shihet për këtë studimi i prof. Patrick Seriot me titull *Langue de bois*⁶², ku ai, si specialist i këtyre gjuhëve, u bën atyre një analizë të hollësishme nga pikëpamja funksionale, sidomos rusishtes në kohën e regjimit sovjetik. Në studime të tjera të këtij lloji thuhet se për të emërtuar ligjërimin burokratik në kohën e Rusisë cariste është përdorur termi “*gjuhë lisi*” a “*gjuhë dushku*” (fr. *langue de chêne*), për kinezishten është përdorur termi “*gjuhë plumbi*” (fr. *langue de plomb*), kurse për gjermanishten në ish-Gjermaninë Lindore është përdorur termi “*gjuhë betoni*” etj.

Theksojmë se në këtë rast nuk duhet menduar aspak sikur kemi të bëjmë me ndonjë kod tjetër të veçantë “*prej druri*” a “*prej lisi*” (në vend të *gjuhës njerëzore* si “sistem shenjash e komunikimi”), por me mënyrën “e ngurtë” (fr. *rigide*) a “të ngurtësuar” (fr. *figé*) të ligjërimin

⁶¹ Shih për këtë shkrimet e këtyre autorëve, si dhe ato të mjaft të tjerëve (që për arsye kohe a vendi nuk janë përmendur këtu) në revistat shkencore *Studime filologjike* e *Gjuha jonë* (Tiranë), *Gjuha Shqipe* (Prishtinë) ose në shtyp dhe në botime të veçanta.

⁶² Shih P. Seriot, *Cahiers de l'ISP*, Lausanne, 1991

– ashtu siç shpjegohet ky term në «*Grand Dictionnaire Encyclopédique*» ose në «*Petit Robert*» me synimin: “për të bërë propagandë politike”⁶³. Kështu, e ashtuquajtura gjuhë e drunjte del si një farëgjuhe tepër specifike, me karakter “demagogjik” (për të mos thënë të vërtetën) ose me karakter “diplomatik” (për të mos mbajtur qëndrim të prerë për një çështje); si p.sh., është bërë zakon që në median tonë të shkruar dhe elektronike të jepen njoftime të tilla, se dikushi vrau dikë “për motive të dobëta” ose që krimineli a vrasësi “u largua në drejtim të paditur” (!), pa dhënë asgjë të qartë e të saktë se ç’janë këto “motive të dobëta” ose ç’është ky “drejtim i paditur”.

Në një *Simposium* shkencor, të mbajtur në Universitetin e Lozanës (në v. 2003), është folur dhe diskutuar gjatë për ligjërimin (fr. *le discours*) në ish- vendet socialiste, me regjim autoritar e totalitar, ku, midis të tjerash, është theksuar se “një dukuri e tillë, si një shfaqje e *gjuhës së druntje*, është vënë re dhe në shqipen letrare gjatë regjimit monist”⁶⁴.

Por, fatkeqësisht, e mbushur me shumë mënyra të tilla shprehjeje, të ashtuquajtura “*të drunjta*”, karakterizohet mjaft herë edhe gjuha e sotme politike me shprehje të tilla si “e kemi në konsideratë *kërkesën* tuaj” ose “do ta shqyrtojmë në mbledhjen më të afërt” (pa përmendur asnjë datë se kur do të shqyrtohet kjo *kërkesë*). Për ilustrime të tjera, mjafton të vëzhgohet sot mënyra e dhënies me ironi të lajmeve në emisionin e posaçëm *POP-Channel*.

b) Vetvetiu lind një pyetje tjetër: kush janë ata që e përdorin më shpesh dhe pse u nevojitet atyre kjo lloj *gjuhe*?

Kjo lloj *gjuhe* përdoret më shpesh në fjalime propagandistike për të shpalosur “me bujë” programin e partive të shumta gjatë fushatave zgjedhore, si dhe në diskutimet e përgatitura me shkrim të disa deputetëve në parlament, kur ndonjërit prej tyre i duhet t’i bëjë elektoratit premtime “me bollëk”. Prandaj gjuhëtarët vërejnë se gjatë këtyre fushatave kjo lloj *gjuhe* është “në kulmin e lulëzimit” të saj.

2. a) Mjetet gjuhësore që përdoren në këtë rast janë jo vetëm leksikore dhe gramatikore, por edhe sintaksore, d.m.th. fraza stereotipe, kallëp a shabllon (fr. *clichés*), si dhe formula e “slogane” dogmatike, që shkaktojnë mërzë, sepse janë dhe larg realitetit jetësor.⁶⁵ Në këtë rast “oratori” folës ose referues nuk dëshiron të thotë drejtpërdrejt atë që duhet thënë më shkurt dhe më qartë, sepse atij i intereson të “gëlltitë një sekret”, prandaj përsërit të njëjtat fjalë në një mënyrë tjetër ose e merr dëgjuesin “me të mirë”, duke i shfaqur atij një dashuri a miqësi të rreme, “të shtirë” e jo të sinqertë. Kjo lloj *gjuhe* përdoret gjithashtu kur dikujt i duhet t’i bëjë dëgjuesit e lexuesit njëfarë “psikoterapie” ose të tërheqë vëmendjen e tyre, duke përdorur *afeksionin* si mjet “për t’ua prekur” zemrën, për të zbutur efektin negativ të një të keqeje (si p.sh.: praninë e një krize ose të një gjendjeje të padëshirueshme në parti etj.), dhe, më në fund, për të treguar dhe njëfarë “intelektualizmi” a “pushteti inelektual” ndaj të tjerëve.

b) E ashtuquajtura *gjuhë e druntje* karakterizohet nga zbatimi i rregullt i normës letrare gramatikore e drejtshkrimore, por, nga ana sintaksore, fraza zgjatet dhe arrin gati një faqe libri, ku mungojnë jo vetëm pikat, por edhe presjet e pikëpresjet. Përdoren fjali zakonisht në trajtën pavetore, ku kuptimi i tyre ndonjëherë është i vështirë të merret vesh, prandaj edhe *përmbajtja* e thënies nuk del e qartë për lexuesin ose dëgjuesin e thjeshtë.

⁶³ Shih Petit Robert (2010), f. 270

⁶⁴ Shih Cahiers de l’ISL, Lausanne, 2004

⁶⁵ Shih Gille Gullieron, Langue de bois, Paris, 2010, f. 16

c) Gjithashtu, prania në këtë rast e *metaforave* dhe e *alegorive* të tepruara, e *eufemizmeve*, *tautologjive* dhe e *proliksitetit* (si psh. “Unë dua t’ju bëj të ditur juve atë gjë që ne e dimë, por ju nuk e dini” etj.), si dhe prania e *oksimoronëve* (të tipit “*çorgaizim i organizuar*”, “*padrejtësi e organit të drejtësisë*”) etj., krijojnë nganjëherë një “bollëk” figurash stilistike ose shprehjesh me karakter letraro-poetik, të cilat “riqarkullojnë” fakte të njohura e të përgjithshme ose më saktë krijojnë “një situatë verbale”. Në këtë mënyrë kjo lloj gjuhe tingëllon si një retorikë “e bukur” (në thonjëza), por boshe dhe abstrakte. Prandaj, në vend të kësaj mënyre të shprehuri është mirë të përdoret ajo që është bërë zakon të quhet *gjuhë e popullit* (fr. *lingua franka*, si një term në kundërvënje me *gjuhën e drunjtë*).

Ndonjëherë, me anë të kësaj *gjuhe*, duke dashur “të fshihet” (të kamuflohet) e vërteta, në fakt “nxihet” realiteti, duke e paraqitur gjendjen gjoja sikur “vendi po bëhet një *superfuqi*”, sikur “peshqit janë shtuar aq shumë sa po mbyten në liqen”, në një kohë kur, tashmë, në një shoqëri të zhvilluar e demokratike, njerëzit janë zgjuar dhe i kuptojnë më shpejt e më mirë *falsitetin* dhe *informalitetin*, *retorikën false* dhe *fjalët bombastike*.

3. Nga ajo çka u trajtua më lart rreth të ashtuquajturës *gjuhë e drunjtë* mund të përfundohet se:

- *Së pari* janë pikërisht nëpunësit burokratë, por edhe disa nga publicistët (gazetarë, analistë, opinionistë, komentatorë etj.), të cilëve u nevojitet të stëmbushin faqet e gazetave “pa bukë” për t’i shitur ato. Në këtë mënyrë, lind përshtypja se disa njerëz duan të krijojnë një *kod të ri*, brenda gjuhës standarde, sikur të ishte kjo një *gjuhë e Kullës së Babelit*, që mund t’u shërbente vetëm plotësimit të dëshirave dhe interesave të tyre. Kështu, reklama dhe publiciteti, që sot po zënë një kohë (minutazh) të gjatë në radio e nëpër ekranet televizive, në internet (shihni *Wikipedi-në*) ose nëpër *fejzbuqe* (Facebook), janë vendet, ku e ashtuquajtura *gjuha e drunjtë* po “shtrohet këmbëkryq”, sepse atje ajo gjen “tempullin e saj të qetë”. Në këtë rast, nuk duhet kuptuar sikur kjo analizë e gjuhës në aspektin funksional dëshiron të ulë vlerat e *reklamës* (ose të *publicitetit*), që janë një mjet i rëndësishëm dhe i domosdoshëm në sistemin e sotëm të ekonomisë së tregut. Fjala është që *gjuha e reklamës* (e *publicitetit*) të përmirësohet, në mënyrë që të mos teprohet me stërzgjatje fjalish e frazash, aq sa ato të bëhen të mërzitshme (sikurse ndodh p.sh. për “dyshekun *Dormeo*”), sidomos kur shikuesi (telespektatori) është duke ndjekur me interes një film interesant, por ai ndërpritet shumë herë nga reklama.

- *Së dyti*, në fazën e sotme të zhvillimit të gjuhëve letrare kombëtare, shqipja standarde (që përdoret sot në Republikën e Shqipërisë, në Kosovë e në Maqedoni, si dhe në diasporë), ndodhet përpara sfidave të reja, që lidhen me zgjerimin gjithnjë e më të madh të funksioneve të saj shoqërore, me përsosjen e vazhdueshme nga ana strukturore dhe me njësimin e mëtejshëm të *normës së përgjithshme letrare*; prandaj ajo lipset të studiohet e të kodifikohet më mirë, të inkurajohet më tej në aspektin ligjërimor, veçanërisht për të zbuluar e përcaktuar kufijtë që ndajnë stilet funksionale (të veprimtarisë shoqërore), si dhe raportet që ekzistojnë ndërmjet aspektit të shkruar e të folur, realitetit praktik dhe mundësive të modelimit të saj.

- *Së treti*, ka ardhur koha që të njihet dhe të përdoret drejt *gjuha standarde shqipe*, përkundërt së ashtuquajturës *gjuhë e drunjtë* nga çdo njeri i kulturuar, qoftë gazetar ose diplomat, politikan, biznesmen, gjuhëtar, arsimtar etj. Në mënyrë të veçantë, duhet njohur e përvetësuar mirë *mjeshtëria* (a *arti i të folurit*) dhe *retorika* (me mjetet përkatëse gjuhësore), e cila lipset të zërë një vend të rëndësishëm dhe si lëndë në programet e shkollës sonë, sepse

nxënësit e studentit i nevojitet të mësojë krahas *gramatikës* e *drejtshkrimit* edhe *oratorinë*, të dijë se kur e si përdoret *intonacioni* dhe *melodika*, *sarkazma* e *ironia*, *alegoria*, si dhe format e tjera letraro-gjuhësore. Por, kjo nuk do të thotë se duhet të inkurajohet *sarkazma* e tepruar ose *retorika* tallëse e provokuese.

Dëshiroj me këtë rast ta përmbyll këtë kumtim me një këshillë: Kujdes me të ashtuquajturën *gjuhë e drunjtë* në mënyrë që të mos abuzohet me të! Kujdes me proliksitetin dhe me “inflacionin” e fjalëve e të frazave stereotipe! Kujdes me huazimet e panevojshme (leksikore e sintaksore), si p.sh. me termat e shprehjet *fizibilitet*, *linjë inerkonjeksioni*, *bëj prezent për publikun interpretimin tim lidhur me këtë apo atë çështje etj.* Për këtë qëllim duhet që klasa politike të çlirohet nga propaganda me të ashtuquajturën *gjuhë e drunjtë*.

Këtyre këshillave po u shtoj edhe porosinë e gjuhëtarit të shquar G. Guilleron:

“Le të përpiqemi të *dekodojmë* të ashtuquajturën *gjuhë e drunjtë*, në mënyrë që ajo të mos tingëllojë si një *kod i ri* a si një *gjuhë e re*, e cila mund të rrezikojë ose të zëvendësojë *ligjërimin* e thjeshtë *popullor* në komunikimin ose në marrëdhëniet korrekte me publikun”. Prandaj edhe gjuha e publicistikës duhet të bëhet model i përdorimit të *shqipes standarde* (mbarëkombëtare), pa ngarkesa të tepruara emfatike, pa shabllone e “slogane” të mërzitshme. Le të ketë gjuha e mjeteve të informimit në themel *lajmin* dhe jo *demagogjinë*. Le të jetë ajo gjithmonë një gjuhë e papolitizuar, një gjuhë paqeje, pajtimi e bashkimi ndërmjet shqiptarëve! Shkurt, le të mbetet ajo – siç i këndonte Naimi – *e pastër* dhe *e dliër*, sikurse është me të vërtetë *gjuha jonë amtare*!

Tiranë, Nëntor, 2012

KONGRESI I DREJTSHKRIMIT DHE ÇËSHTJE TË DREJTSHKRIMIT SOT

Gjuha si një organizëm i gjallë nuk mjaftohet me atë që shkruhet dhe thuhet rreth saj. Rregullat dhe normat gramatikore janë mekanizma që në kontekste të caktuara shoqërore organizojnë gjuhën si mjet komunikimi. E megjithatë, në mënyrë krejt të natyrshme, gjuha dhe zhvillimi i saj nuk “pyet” për ato që thuhet në konferenca e simpoziume. Ajo ndjek rrjedhën e saj, edhe për vetë faktin se në gjuhë ka vetëm ndryshime. Një gjuhë ekziston në një numër varietetesh dhe në një lloj kuptimi jomatematik, ajo është shuma e këtyre varieteteve. Studimi i varieteteve gjuhësore ka qenë gjithnjë një pikë interesante në studimet gjuhësore, kështu p.sh., klasifikimi i një idiome nuk varet vetëm nga ndryshime në nivelin fonetik, semantik dhe morfosintaksor me idiomat e tjera, por edhe nga vullneti folës i institucioneve apo popullsisë folëse. Kësaj i shtojmë faktin që statusi i një gjuhe mund të ndryshojë në kohë, si pasojë e ndryshimeve gjeopolitike, sociale dhe kulturore.

“Që të shkruash gjuhën shqipe, - thoshte Asdreni - s’është punë e rëndë, por s’është as e lehtë”⁶⁶. Në ditët e sotme, disa dhjetëvjeçarë pas Kongresit të Drejtshkrimit, kur kontekstet gjuhësore dhe shoqërore nuk janë më të njëjtat, nevoja e përpunimit të një politike gjuhësore është bërë fjala e ditës për përmirësimin e standardit të gjuhës dhe veshjes gjuhësore, në përputhje me kushtet e reja që janë krijuar.

Gjithësesi, ndryshimet duhet të jenë të matura, deri në atë masë që mos të krijojnë probleme në përvetësimin e tyre nga ana folësve dhe të shkruesve të gjuhës shqipe. “Drejtshkrimi nuk është vetëm një çështje shkencore, por edhe një problem i rëndësishëm shoqëror, sepse është shprehje e drejtpërdrejtë e njësimin të gjuhës letrare kombëtare, e cila luan një rol të dorës së parë në forcimin e vetëdijes kombëtare, në zhvillimin e jetës mendore”⁶⁷. Kjo është vetëm një nga pikat e dala nga Kongresi i Drejtshkrimit që u mbajt nga datat 20 -25 nëntor 1972 në Tiranë, ku ishin të pranishëm 87 delegatë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, si dhe arbëreshë nga Italia.

Duke qenë se Kongresi i Drejtshkrimit ka qenë një ngjarje e rëndësishme që ka kristalizuar normën letrare kombëtare, në të gjitha hallkat kryesore të strukturës fonetike, gramatikore, fjalëformuese e leksikore dhe ka shënuar fillimin e një etape të rëndësishme për historinë e gjuhës shqipe, na duket me vend, që në këtë vështrim modest, të paraqesim disa prirje të gjuhës sot dhe të interpretojmë ndryshimet, apo edhe ndonjë dukuri të re, që ka zënë vend në repertorin gjuhësor të këtyre viteve të fundit. Duke iu referuar parimeve të drejtshkrimit, po sjellim vëzhgime rreth disa çështjeve të diskutuara kohët e fundit, natyrisht, duke mbështetur që në fillim të punës sonë, idenë e përmirësimit të standardit dhe pranimin e bollëkut të prurjeve në leksik.

Çështje që lidhen me zanoren “ë”, apo me togje zanoresh, shqiptimet e tipit: *vënd*, *zëmër*, *fëmër*, *ëmër* etj, ndonjë përmirësim që e lejon sistemi morfologjik, si p.sh. problemi i mosshkruarjes së ë-së fundore te emrat e tipit *ballë*, *lumë*, etj, drejtshkrimi i emrave të përvecëm të huaj⁶⁸, huazimet dhe terminologjia, janë disa nga pikat e diskutimeve të

⁶⁶ Asdreni, *Reze dielli* (parathënie) Bukuresht 1904, f.5

⁶⁷ *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave të RP të Shqipërisë, Tiranë 1973

⁶⁸ Gj.Shkurtaj, *Kultura e gjuhës*, shblu, Tiranë, f.141-146

gjuhëtarëve këto vitet e fundit. Nuk është rastësi dhe as e papritur. Përderisa kemi të bëjmë me një organizëm të gjallë me të cilin marrim e japim çdo ditë. “Gjuha pasqyron një kombësi, ajo është pasqyra më e qartë e një kombësie dhe e strukturës së saj. Shkalla e pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës është një tregues i nivelit të kësaj kulture”⁶⁹, - ka thënë Çabej, duke e shtuar kështu përgjegjësinë e studiuesve përballë prurjeve dhe situatave gjuhësore që janë krijuar.

Siç dihet, parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes është parimi fonetik: në përgjithësi fjalët dhe pjesët e tyre të kuptimshme shkruhen ashtu siç shqiptohen. Thelbi i parimit fonetik në drejtshkrimin e shqipes, që mbështetet në një sistem grafik, ku ka një lidhje të drejtpërdrejtë midis shkronjës dhe tingullit-fonemë, është aspekti fonologjik, domethënë përdorimi social i tingujve të gjuhës në procesin e marrëdhënieve midis njerëzve.

Në sistemin e gjuhës shqipe, duket se çështjet që kanë të bëjnë me zanoren *ë* të patheksuar dhe togjet zanore, si në disa fjalë që kanë zanore *ë* të patheksuar a të theksuar, togje zanoresh :oo, ii ,uu, bashkëtingëllore j/nj dhe zanore i, bashkëtingëllore r/rr, l/ll, bashkëtingëllore të shurdhëta a të zëshme, bashkëtingëllore dyshe dh, th, sh, xh, zh, nj, gj; kanë krijuar një situatë të re, ndryshimi i të cilave do të prekë edhe strukturën morfologjike. Po sjellim vetëm një nga pikat e diskutimeve të shumta lidhur me heqjen e zanores “ë”: Sipas emrave: *shkaktar, shqiptar, tregtar, falltar*, të shkruhet *lajmtar* e jo *lajmëtar, harktar* e jo *harkëtar*, etj. Në këto raste zanorja *ë* nuk është e nevojshme, meqenëse grupet bashkëtingëllore ndahen në dy rrokje të ndryshme, duke shmangur vështirësinë e shqiptimit të tyre. Në emrat e gjinisë femërore me prapashtesa, në disa prej të cilëve rënia e zanores *ë* është një fakt gjuhësor i standardit. Pra, sipas rasteve *lojtar, rojtar, nevojtari* të shkruhet edhe *gojtar* e jo *gojëtar*; sipas *amtar* të shkruhet edhe *antar* e jo *anëtar etj.*

Krahas parimit fonetik, drejtshkrimi i njëzuar i shqipes mbështetet gjerësisht edhe në parimin morfologjik, i cili kërkon që, fjalët dhe pjesët e tyre përbërëse të sistemit trajtëformues e fjalëformues të shkruhen njësoj, pavarësisht nga ndryshimet tingullore të shkaktuara prej ligjeve fonetike që veprojnë sot në gjuhën tonë.

Një dukuri e re është edhe vërshimi i fjalëve të huaja, në kushtet e reja që janë krijuar. Rëndësi të madhe teorike dhe praktike ka studimi i proceseve të gjalla që po zhvillohen sidomos në fushën leksikore, si rezultat i pasurimit të leksikut dhe i bashkëveprimit të madh edhe me terminologjinë, pesha specifike e së cilës është rritur ndjeshëm kohët e fundit. Dhe kjo është normale, pasi zhvillimi i terminologjisë ndjek hap pas hapi zhvillimin ekonomik, shoqëror, kulturor të shoqërisë. Mjafton të sjellim këtu shembullin e prof.Shkurtajt, sipas të cilit :“për ndonjë gjë të vogël, kryesisht të pjesshme dhe që vetë praktika e shkrimore dhe botuese ka treguar (e po tregon) se masivisht nuk zbatohet norma, si p.sh. në rastin e *Europë, european,-e* (në vend të *Evropë, evropian,-e*)”⁷⁰, duhet pranuar ndryshimi.

Studiuesja Islamaj thekson se: *Kontaktet gjuhësore janë ndër faktorët kryesorë të huazimit leksikor. Njohja e ligjësisë të kontakteve gjuhësore dhe të sistemeve leksikore, sidomos të fjalësit terminologjik ,ndihmon vlerësimin bazë të huazimeve në gjuhën tonë, sqaron karakterin e paraqitjes së tyre dhe në të njëjtën kohë ndihmon përcaktimin e ngjashmërive të*

⁶⁹ Për më shumë shih E. Çabej , *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*,në “Gjuha jonë“ 1, 1981. F36-47

⁷⁰ Gj.Shkurtaj, *Kultura e gjuhës*, shblu,Tiranë, f.141-146

*sistemeve leksikore të shqipes dhe të gjuhëve me të cilat ka bashkëtakime ajo.*⁷¹ Edhe pse leksiku terminologjik është më i lëvizshëm, sidomos me termat ndërkombëtarë që kanë hyrë në gjuhë bashkë elementin që ato emërtojnë, në disa raste janë huazuar fjalë edhe për shkak të prirjes së disa të folmeve profesionale për të qenë “sa më të përgjithshme, sa më ndërkombëtare”.

Pra, si përfundim mund të themi:

Nga Kongresi i Drejtshkrimit deri më sot, koha fizike ka qenë e mbushur me prurje edhe në fushën gjuhësore duke krijuar një situatë të re, e cila ka nevojë për interpretime dhe përmirësime. Le të rendisim disa:

- Leksiku, sidomos ai aktiv dhe shtresëzimi i tij, duhet riparë dhe duhet riorganizuar , bashkë me terminologjinë dhe fjalët e huaja , një pjesë e të cilave kanë hyrë në gjuhën shqipe e ndoshta kanë hyrë pa kthim.

- Drejtshkrimi dhe çështje që lidhen me të duhen trajtuar si pjesë e një procesi përbashkues që i shërben gjuhës dhe u binden rregullave të zhvillimit të saj , duke pasur gjithnjë parasysh që ajo është gjuhë e hapur dhe dinamike.

- Ndjekja nga afër e dinamikës gjuhësore dhe vëzhgimi i vëmendshëm i proceseve të saj, rishikimi i hërëpashershëm, në bazë të studimit të këtyre proceseve për ta plotësuar e për ta përshtatur atë me ritmet e zhvillimit të kulturës në përgjithësi dhe asaj gjuhësore në veçanti.

- Shpejtimi i përpunimit të terminologjisë së re tekniko-shkencore, shoqërore-politike dhe vendosja e kësaj pune mbi kritere shkencore që formësojnë një realitet gjuhësor në përputhje me kontekstin e ri shoqëror të bashkësisë folëse.

Në këtë epokë të trysnisë së globalizmit ndiet nevoja e një koncepti të ri për gjuhën dhe një interpretim i ri për rregulla e dukuri që e pasurojnë shqipen dhe i japin asaj të tjera vlera përballë vetes dhe përballë gjuhëve të tjera.

“Detyra e gjuhëtarëve kërkon qëndrim aktiv: të ndjekin pa ndërprerje zhvillimet e gjuhës së shkruar, të shpjegojnë pa u lodhur natyrën e fjalëve , të tregojnë burimet e gabimeve dhe të nxjerrin në dukje pasurinë e shqipes.Vazhdimisht. Pa ndërprerje. Dhe vetëm kur të jenë të bindur shkencërisht se ia kanë arritur t’i plotësojnë kërkesat për fjalët e reja, që dëshirojnë t’i vënë në qarkullim për të mirën e shqipes,atëherë le të paraqesin edhe ndonjë propozim apo neologjizëm”⁷²,- nënënvizon me të drejtë studiuesi Lloshi, duke e lënë të hapur rrugën për të qëmtuar me kujdes fjalën shqipe dhe vlerat e saj në sistemin e gjuhës shqipe.

⁷¹ Sh.Islamaj, *Shqipja në kontakt dhe huazimi gjuhësor*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 2010, f.451

⁷² Xh.Lloshi, *Shqipja, gjuhë e hapur dhe dinamike*, Onufri, 2011, f.168

GJUHA STANDARDE SI MAKROSISTEM

1. Në gjuhësinë shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, ndihmesat kryesore në trajtimin e problemit të gjuhës standarde i takojnë pa dyshim A. Kostallarit, i cili jo vetëm ka përpunuar e përkufizuar një varg konceptesh që lidhen me planifikimin gjuhësor të shqipes, po edhe ka luajtur një rol udhëheqës në organizimin e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, që u mbajt 40 vjet më parë në Tiranë.

Një ndër çështjet së cilës ai i ka kushtuar një pjesë të mirë të veprimtarisë krijuese dhe të jetës së tij, është ajo e gjuhës standarde, të cilën, në përputhje me terminologjinë e kohës, ai e quan “gjuhë letrare kombëtare”. Duke folur për të, ai që më 1970 do të shprehej: “Gjuha letrare e sotme ka krijuar tashmë një sistem të vetin mbidialektor, i cili ka lidhje të shumanshme me dialektet, me gjysmëdialektet e me gjuhën e folur të qyteteve, buron prej tyre, por bën një jetë të mëvetësishme, si një sistem i një tipi të ri, si sistemi më sistemor, më i përparuar e më i lartë.”⁷³ Në Kongresin e Drejtshkrimit, në përputhje me konceptin e tij për gjuhën standarde “si një koine letrare sui generis”, ai e sheh këtë si një *makrokoine* letrare kombëtare, që përbëhet nga dy *mikrokoine* letrare, varianti jugor dhe varianti verior, të paraqitur grafikisht me skemën e qortuar sidomos prej A. Pipës të dy rrathëve që nuk priten⁷⁴, të cilët mbulohen pjesërisht dhe në shkallë të ndryshme nga rrethi i *makrokoinesë*⁷⁵.

Këtë “sistem mbidialektor”, “sistem më sistemor” apo “makrokoine”, ne parapëlqejmë ta quajmë *makrosistem*, duke u nisur nga struktura, funksionet dhe shtrirja e gjuhës standarde në raport me sistemet e të folmeve dialektore, të cilat janë *mikrosisteme*. Kuptimi i këtyre tri përmasave të gjuhës standarde shqipe dhe sqarimi i marrëdhënieve të saj me sistemet dialektore nuk mund të bëhet pa iu referuar veprës së A. Kostallarit, këtij gjuhëtari emri i të cilit në këtë 40-vjetor të Kongresit të Drejtshkrimit sikur është harruar. Pikërisht, në këtë kumtim do të ndalemi në këto tri përmasa për të kuptuar më mirë veçoritë e gjuhës standarde dhe për të sqaruar disa çështje që lidhen me raportet e saj me sistemet dialektore.

2. Termi “strukturë e gjuhës standarde” mund të merret në dy kuptime: në kuptimin se si është ndërtuar ky sistem, d.m.th. në aspektin historik, diakronik; por edhe në kuptimin e organizimit të brendshëm të këtij makrosistemi, pavarësisht nga prejardhja e elementeve përbërëse të nënsistemeve të tij. Duke e quajtur aspektin e parë të shteruar prej Kostallarit, që e ka ilustruar edhe grafikisht me disa skema,

⁷³ A. Kostallari, *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë*, SF, 1970, 2, f. 27.

⁷⁴ Duke komentuar këtë skemë, në të cilën dialektet nuk priten, A. Pipa thotë se, sipas A. Kostallarit, “gegërishtja dhe toskërishtja nuk janë dy dialekte të së njëjtës gjuhë, por dy gjuhë të ndryshme” (*The Politics of Language in Socialist Albania*, East European Monographs, Boulder, Neë York, 1989, f. 33). Vërejtje kësaj skeme i ishin bërë gojarisht edhe në Shqipëri, prandaj Kostallari më pas heq dorë prej saj, duke e zëvendësuar me një skemë tjetër në të cilën dialektet priten.

⁷⁵ A. Kostallari, *Gjuha e sotme letrare kombëtare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj në “Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (20–25 nëntor 1972)”*, vëll. I, Tiranë, 1973, f. 89.

në të cilat pjesa e përbashkët e dialekteve përbën bërthamën qendrore të gjuhës standarde⁷⁶, do të ndalemi në aspektin e dytë, në organizmin e brendshëm të këtij sistemi.

Shkalla e organizimit të një sistemi duket në atë se sa u përgjigjet struktura e nënsistemeve të tij nevojave komunikative të shoqërisë dhe se sa zhvillohen këto nënsisteme për t'iu përgjigjur hap pas hapi këtyre nevojave. Kjo vlen sidomos për ato nënsisteme a pjesë nënsistemesh që janë më të ndjeshme ndaj nevojave komunikative të shoqërisë, siç janë sistemi leksikor dhe semantika leksikore, morfologjike e sintaksore. Duke nisur me leksikun, ajo që vërehet është se fjalori i shqipes standarde ka ardhur duke u pasuruar me njësi leksikore të reja, por është pasuruar edhe struktura semantike e fjalëve me sema e kuptime leksikore të reja. Për të krijuar një ide më të plotë, mjafton të themi se nga fjalori me 25 mijë fjalë i vitit 1954, sot leksiku i shqipes standarde i pasqyruar në fjalorë ka arritur në mbi 70 mijë fjalë (në “Fjalor drejtshkrimor” të Dhrimo–Memushajt). Mbështetur në këtë shkallë të pasqyrimin të leksikut, që mendojmë se ende nuk i përgjigjet rezervës reale të fjalëve të cilat duhet të përfshihen në fjalorët, na del se leksiku i shqipes standarde është pasuruar mesatarisht me 2,2 fjalë në ditë, ritëm që për periudhën 1980–2011 arrin në 2,65 fjalë/ditë. Nuk është pasuruar vetëm leksiku, por dhe struktura kuptimore e fjalëve si rrjedhim i shtimit të përbërësve të rinj kuptimorë. Kështu, është llogaritur se rreth 320 fjalë në fjalorin e vitit 2006 dalin me kuptime të reja të cilat nuk i kanë në fjalorin e vitit 1980, pa llogaritur semat e reja që u janë shtuar kuptimeve ekzistuese.

Ndryshime ka edhe në fushën e semantikës morfologjike, ku vërehet se fjalë që në fjalorë paraqiten me paradigmë jo të plotë, janë duke i mbushur pozicionet e zbrazëta të saj. Po sjellim sa për ilustrim emrat *duf*, *kthjellim*, që në fjalorët normativë jepen vetëm në njëjës, dhe *thashetheme*, që fjalorët e japin vetëm në shumës. Dy të parët në ligjërim hasen edhe në shumës, p.sh.: *dufet* e shpirtit, mot me vranësira e *kthjellime* etj.; kurse *thashetheme* del edhe në njëjës: *thashethem* i ri, ky *thashethem* të burgosurish etj. E njëjta dukuri vërehet edhe te foljet. Kështu, ka disa folje që në pësore jepen vetëm me formën e vetës së tretë, por që në ligjërim përdoren edhe në vetën e parë. P.sh., pësorja e foljes *transmetoj* në fjalorë jepet vetëm në formën e vetës së tretë: *transmetohet*. Por folësit televizivë thonë: *Transmetohemi* të hënën, çka do të thotë se në pësore kjo folje ka fituar edhe kuptimin vetës së parë. Raste të tilla në ligjërim vërehen shumë, ndonëse kjo nuk do të thotë që leksikografët çdo fakt të ligjërimin ta regjistrojnë në fjalor, megjithatë, kur fakte të tilla janë bërë të përgjithshme, nuk duhen kapërcyer.

Dukuri të ngjashme ka pa dyshim edhe në fushën e sintaksës, ku krijohen mundësi të reja lidhjesh të foljeve si rrjedhim i pasurimit të valencës së tyre, apo ndërtime të reja sintaksore. Pra, çdo nënsistem përpunon mjete të reja për t'iu përgjigjur nevojave të reja të komunikimit. Nëse mund të shprehemi në mënyrë të figurshme, gjuha standarde i ngjan një organizimi të ri, organet e të cilit rriten nga dita në ditë, falë procesit permanent të shumimit të qelizave të tyre.

Për sa u përket funksioneve të gjuhës standarde, sikundër është vlerësuar prej kohësh gjuha shqipe është një gjuhë kombëtare e maturuar, që do të thotë se sot ajo i ka të lëvruara të gjitha funksionet, duke arritur një polivalencë simetrike funksionesh. Krahasuar me fazat e mëparshme, statusi i shqipes ka ardhur duke u rritur, si horizontalisht, edhe vertikalisht. Në

⁷⁶ Shih: A. Kostallari, *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*, art. i cit., f. 27.

shtrirje horizontale, deri në fund të shekullit që shkoi, gjuha standarde gëzonte statuse të ndryshme: në Shqipërinë politike ajo ishte gjuhë e vetme zyrtare; në Kosovë gjuhë zyrtare krahinore dhe në Maqedoni e Mal të Zi gjuhë e inkurajuar⁷⁷. Ndërsa me pavarësinë e Kosovës dhe me nënshkrimin e Marrëveshjes së Ohrit, në Kosovë shqipja është gjuhë e parë zyrtare dhe në Maqedoni, të paktën *de jure*, është gjuhë zyrtare paralele. Për sa i përket shtrirjes në thellësi, para vitit 2000 gjuha standarde nuk lëvrohej në mënyrë të barabartë në të gjitha funksionet: në Maqedoni funksioni administrativ mungonte; po të shkojmë pak më prapa, në Shqipërinë komuniste lëvrimi i funksionit fetar ishte penguar, ndërkohë që në trojet jashtë kufijve ky funksion lëvrohej si gjithë funksionet e tjera. Pra, pas vitit 2000 polivalenca asimetrike është kapërcyer.

Gjuha shqipe e ditëve tona i ka të gjitha funksionet shoqërore të një gjuhe të zhvilluar, ajo lëvrohet me shkrim në të gjitha stilet (letrar, administrativ, publicistik, shkencor, fetar) dhe përdoret në të folur në të gjithë nivelet e ligjërimit (libror, bisedor e thjeshtligjërimit). Ndryshe nga më parë, kur këto stile për shkaqe politike apo ideologjike nuk lëvroheshin në shkallë të njëjtë, d.m.th. kishte asimetri në lëvrimin e tyre, tashmë është arritur simetria e stileve.

Lidhur me përmasën e tretë, shtrirjen hapësinore të gjuhës standarde në raport me dialektet, na duhet që më parë të sqarojmë thelbin e marrëdhënieve gjuhë standarde – dialekt dhe përmbajtjen e shprehjeve “ndërveprim dialektor” e “shkrimje dialektore”, të cilat përbëjnë tema shumë të rrahura që nga Rilindja e këndej dhe që u kanë shërbyer si argumente përkrahësve të teorisë së pritjes pa fund në krijimin e gjuhës letrare të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Konica flet për shkrimje të dialekteve “leur fusion”, kurse Samiu thotë se “gjithë djalektatë do të gjenden të gjitha të bashkuara e të përzjera”⁷⁸. Ideja e shkrirjes apo e konvergjencës së dialekteve del edhe te Xhuvani kur thotë se gjuha letrare do të krijohet në një kohë kur “të piqu vetvetiu dialektet në një gjuhë të përgjithshme”⁷⁹, ose kur thotë se të dy dialektet “do të bien në një konvergjencë e do të mbërrijnë në një gjuhë të përbashkët shkrimi”⁸⁰. Të këtij mendimi qenë në seminarin e vitit 1952 ajo pjesë e gjuhëtarëve që iu kundërvu mendimit të Dh. Shuteriqit se gjuha letrare kombëtare ishte krijuar qysh atëherë, ndër ta edhe E. Çabej, sipas të cilit “gjuha ka për të marrë edhe më shumë një zhvillim tjetër, një zhvillim konvergjent të dialekteve”⁸¹. Në ditët tona flitet kryesisht për bashkëveprim të gjuhës standarde me dialektet, për pasurim të saj nga dialektet etj., ndonëse ende kundërshtarë të gjuhës standarde i mbahen idesë së konvertimit.

Po a mund të shkrihen a të konvergojnë dialektet? Mund të themi me siguri se, në kushtet e mungesës së një zhvillimi urban dhe të politikave që pengojnë lëvizjen e lirë të njerëzve, dialektet territoriale nuk mund të konvergojnë, të përzihen a të shkrihen. Ato kanë kufij të përcaktuar qartë dhe, si rrjedhim, nuk mund të flitet as për ndërveprim dialektor.

⁷⁷ R. Ismajli, *Mbi statusin e shqipes standarde në RSF të Jugosllavisë* në “Gjuhë dhe etni”, Prishtinë, 1991, f. 366–367; R. Memushaj, *Shqipja në kontakt dhe çështje të politikave gjuhësore*, “Studi in onore di Luigi Marlekaj”, a cura di Matteo Mandalà, Adriatica Editrice, Bari, 1999, f. 352.

⁷⁸ S. Frashëri, *Letër drejtuar Jeronim de Radës*, Vepra, II, Tiranë, 1988, f. 375.

⁷⁹ A. Xhuvani, *Përmi themelim të një gjuhe letrëtare shqipe* (1906), Vepra, I, Tiranë, 1980, f. 9.

⁸⁰ Po ai, *Vështrim i shkurtër historik mbi gjuhën shqipe*, Vepra, II, 1990, f. 394; shih edhe *Gjuha e letërsia shqipe*, Vepra, II, f. 415.

⁸¹ E. Çabej, *Detyra e gjuhësisë shqiptare në lidhje me gjuhën letrare kombëtare e probleme të tjera*, BSHSH, 1952, IV, f. 119.

Mirëpo, me ndryshimet politike që kanë ndodhur në hapësirat shqiptare, kufijtë dialektorë janë shpërthyer. Si rrjedhim i migrimit të brendshëm, në Tiranë, në Durrës dhe në qytetet e tjera të zonës fushore e bregdetare, por edhe në Prishtinë etj., kemi një, dy e shumëfishim të numrit të banorëve të ardhur prej krahinash të ndryshme. Si rrjedhim, “lëvizja e lirë, ka vënë në dyshim konceptet klasike të të folmeve dhe të dialekteve”⁸² dhe ka krijuar kushte për përzierjen e të folmeve të banorëve prej krahinash të ndryshme që në të ardhmen mund të rezultojë në krijimin e të folmeve të reja. Pra, vetëm në rrethanat e reja të krijuara pas viteve ‘90 të shekullit të kaluar, mund të flitet për konvergjim, ndonëse edhe ky është në shkallë rajonale. Më e saktë do të ishte të pranonim se në këto qendra me popullsi shumë të përzier ligjërimi “ka marrë tiparet e njëfarë ndërdialekti”⁸³, po të pranojmë këtë term të A. Kostallarit. Pra, për konvergjim mund të flitet vetëm pas ndryshimeve demokratike, ndonëse edhe ky nuk është ende një realitet i matshëm.

3. Pyetja tjetër është se cilat janë marrëdhëniet e gjuhës standarde me variantet e tjera. Përgjigjen më të argumentuar kësaj pyetjeje ia ka dhënë qysh më 1984 A. Kostallari, i cili të gjitha të folmet e trojeve etnike gjuhësore e të ngulimeve të diasporës i sheh si “forma të ekzistencës së një etnolekti të vetëm”, që përfshin sistemet dialektore dhe gjuhën letrare. Sipas tij, nga ana teorike *sistemet e dialekteve* mund të përquasen si tërësi të sintetizuara *me sistemin mbidialektor* të gjuhës letrare, por “në rrafshin konkret, real, ballafaqohet me këtë gjuhë vetëm çdo e folme e veçantë. Ky ballafaqim sot bëhet drejtpërdrejt dhe jo nëpërmjet dialektit dhe as nëpërmjet variantit dialektor që tashmë është shuar, sepse realisht ka bartës të një të folmeje të caktuar dhe jo bartës të një dialekti, domethënë të një grupi tërësor të folmesh në përgjithësi”⁸⁴.

Kjo do të thotë që dialektet dhe nëndialektet, si degëzime kryesore të gjuhës nuk janë entitete reale, po konstrukte mendore, koncepte teorike të ndërtuara falë abstraktimit të veçorive të përbashkëta të një grupi të madh të folmesh lokale fqinje të një territori të caktuar. Edhe pse themi: “Ai/ajo flet toskërisht” apo “Ai/ajo flet gegërisht”, në të vërtetë, asnjë jugor nuk flet një toskërishte të përgjithshme, apo në një gegërishte të përgjithshme; madje as në një labërishte, çamërishte, gegërishte qendrore, veriperëndimore apo verilindore të përgjithshme. Në qoftë se nuk flasin në gjuhën standarde, si jugori edhe veriori do të flasin në të folmen e vendlindjes së tyre, që mund t’i takojë vetëm një fshati, një grupi fshatrash ose një qyteti të vetëm me popullsi të papërzier. Pra, entitete reale janë vetëm të folmet lokale dhe gjuha standarde, që kanë lidhje të pandërmjetuara mes tyre.

“Po ta shohim në tërësinë e saj gjuhën e sotme shqipe si një sistem variantesh, – shkruan A. Kostallari, – mund të themi se në krye të tyre qëndron gjuha letrare kombëtare me trajtën e saj të shkruar, që ka edhe zbatim gojor pothuajse të njëjtë”. Ky kuptim i gjuhës prej tij si sistem variantesh përputhet me atë të sociolinguistit të njohur gjerman Ulrich Ammon, që është marrë me shtjellimin e përmbajtjes së koncepteve *varietet*, *variant* dhe *variabël*

⁸² Sh. Rrokaj, *Roli i dialekteve në shtrirjen dhe zgjerimin e standardit*, Studime albanologjike, 2011/1, viti XVI, f. 9.

⁸³ A. Kostallari, *Gjuha letrare kombëtare shqipe...*, art. i cit., f. 29.

⁸⁴ A. Kostallari, *po aty*, f. 23–24.

(angl. variety, variant, variable) dhe me shpjegimin e marrëdhënieve midis tyre⁸⁵. Sipas Ammon-it, “një gjuhë si tërësi (L) është një sistem varietetesh (V): $L1 = \{V1a, \dots, V1n\}$ ”⁸⁶. Po, nga sa kemi lexuar, nuk na rezulton që Ammon-i ose ndonjë sociolinguist tjetër të jetë ndalur në shpjegimin e marrëdhënieve të varietetit standard me varietetet e tjera ashtu si e ka bërë këtë A. Kostallari, i cili, duke folur për këto raporte, thotë se ballafaqimi i çdo të folmeje me gjuhën letrare “sot bëhet *drejtpërdrejt* dhe jo nëpërmjet dialektit dhe as nëpërmjet variantit dialektor që tashmë është shuar, sepse realisht ka bartës të një të folmeje të caktuar dhe jo bartës të një dialekti, domethënë të një grupi tërësor të folmesh në përgjithësi”⁸⁷.

Ky ballafaqim midis të gjitha varianteve jostandard dhe variantit standard është asimetrik, në kuptimin që ndikimi i këtij të fundit mbi të parat është shumë i fuqishëm. Është i fuqishëm, sepse duke prekur të gjitha nënsistemet e tyre, sidomos leksikun e gramatikën dhe më pak sistemin fonetik, varianti standard “shpejton procesin e shthurjes së tyre shkallëzore”⁸⁸. Lidhur me kahun e ndërveprimit midis gjuhës si makrosistem dhe të folmeve krahinore si mikrosisteme, ndonëse thuhet se është i ndërsjellë, ne jemi të mendimit se marrëdhënia midis tyre ka, në thelb, vetëm një kahe: gjuha standarde ndikon fuqishëm mbi të folmet. Ndikimi i varianteve dialektore “ushtrohet mbi ligjërimin bisedor-letrar, ku norma nuk vepron në tërë gjerësinë e saj”⁸⁹. Dhe i vetmi ndikim i qenësishëm i varianteve jostandarde mbi standardin mendojmë se është në planin e ekzekutimit të njësive gjuhësore, që, me ndryshimin e brezave, në një periudhë të largët do të shpjerë në një shqiptim të ndryshëm. Kurse gjuha standarde si makrosistem doemos që ushtron një trysni të fortë mbi të folmet. Këtë trysni ajo e ushtron jo vetëm nëpërmjet formës së shkruar, e cila është bërë mjeti vetëm i komunikimit midis institucioneve dhe i qytetarit me institucionet e anasjelltas, po edhe forma e folur e saj nëpërmjet ligjërit libror e bisedor si dhe teatrit, radios e televizionit etj.

Në dritën e këtij kuptimi të gjuhës si sistem variantesh, nga të cilët të paktën njëri është variant standard, mund të shpjegojmë dallimin midis gjuhës standarde shqipe dhe varianteve të tjera, si dhe të kuptojmë më mirë raportet e tyre.

Duke e krahasuar gjuhën standarde me variantet dialektore, kuptohet më mirë pse gjuha standarde është një makrosistem, sasiorisht dhe cilësisht shumë i ndryshëm prej të folmeve. Gjuha standarde është sistemi më i plotë dhe më i pasur në mjete, ajo karakterizohet nga norma në të gjitha nënsistemet e saj, ka formën e shkruar dhe të folur. Asnjë nga variantet e tjera të shqipes, përfshirë këtu edhe variantet e shuara letrare të saj, nuk i gëzojnë këto cilësi: ato kanë një inventar më të varfër ose shumë të varfër mjetesësh leksikore (më pak

⁸⁵ U. Ammon, *Language – variety / standard variety – dialect* in “Sociolinguistik/Sociolinguistics”, vol. I, Ammon, U./Dittmar, N./Mattheier, K. J. (eds.), Berlin/New York, 1987, f. 316–335; po ai, *Die deutsche Sprache in Deutschland, Österreich und der Schweiz. Das Problem der nationalen Varietäten*, Berlin/New York, 1995, f. 61–73.

⁸⁶ U. Ammon, *Standard variety* në U. Ammon, N. Dittmar, K. J. Mattheier, P. Trudgill (eds.), “Sociolinguistics”, vol. 1, de Gruyter, Walter de Gruyter · Berlin · New York, 2004, f. 274. Ammon-i, *variant* e përdor me kuptimin e një elementi a të një forme gjuhësore që konkurron me një a më shumë forma të ngjashme, me të cilat formojnë një *variabël*. P.sh., *lorry – truck* (i pari në Angli, i dyti në ShBA e Australi) janë dy variante të *variablit* {lorry – truck – ...} (po aty). Në citimet, ne kemi ruajtur termin e tij *varietet*, që i përgjigjet fjalës *variant* të Kostallarit.

⁸⁷ A. Kostallari, *Gjuha e sotme letrare kombëtare shqipe...*, f. 24.

⁸⁸ A. Kostallari, *Gjuha e sotme letrare kombëtare shqipe dhe disa probleme themelore...*, art. i cit., f. 87.

⁸⁹ A. Kostallari, *Gjuha e sotme letrare kombëtare shqipe...*, f. 30.

mjete e mënyra fjalëformimi, një leksik shumë të varfër; nënsistemet e tyre nuk janë të normëzuara dhe, së fundi, nuk përdoren në të dy format: variantet letrare përdoren vetëm në formën e shkruar, kurse variantet e tjera vetëm në formën e folur. Kjo pasqyrohet edhe në funksionet e këtyre varianteve: gjuha standarde është variant me prestigj të lartë, me funksion identifikues e diferencues, funksione që u mungojnë të folmeve; gjuha standarde karakterizohet nga “gjithanshmëria simetrike e funksioneve”⁹⁰, ajo ka të gjitha stilet funksionale dhe regjistrat e ligjërimit të një gjuhe standarde të maturuar, ndërsa të folmet, sikurse thekson Xh. Lloshi “dalohen vetëm në nivelin e organizimit parësor gjuhësor”, pa variacione funksionale⁹¹.

Dallimi tjetër ka të bëjë me shtrirjen hapësinore dhe me bartësit e saj. Variantet dialektore mbulojnë territore tepër të ngushta, ndërsa gjuha standarde ka shtrirje mbarëkombëtare, jo vetëm në trojet etnike, po edhe në diasporë. Në këto hapësira, ajo funksionon si një sistem i njëjtë, pa variante normative territoriale, për shkak se normat e saj zbatohen në të gjitha këto hapësira njëjloj, pavarësisht nga kontekstet e ndryshme politiko-gjeografike në të cilat gjëllin. Ajo që ka rëndësi të madhe në këtë mes, është edhe numri i bartësve. Gjuha standarde shërben si gjuhë e vetme për zona e shtresa të tëra të popullsisë në të gjitha hapësirat ku flitet; për një masë tjetër folësish ajo është L1, si në ligjërimin e folur dhe të shkruar të tyre, ndonëse në ligjërimin e thjeshtë këta përdorin si L2 të folmen e zonës a të qytetit të vendlindjes; ka edhe një masë folësish, që si L1 kanë të folmen lokale, por jashtë rrethit të së folmes gjuhën standarde e kanë L2, të cilën e përdorin në komunikimin me bartës të standardit, me bartës të të folmeve të tjera dhe në përballjen me institucionet e organizatat shtetërore apo shoqërore, sidomos në formën e shkruar të saj. Më në fund, ka edhe folës që kanë si gjuhë të vetme të folmen e vendlindjes. Këtu përfshihen përgjithësisht njerëzit e pashkolluar ose me shkollim të ulët, që banojnë në fshat, por edhe në qytete, kur bëjnë një jetë të mbyllur. Mirëpo edhe këta ndodhen nën trysinë e përditshme të mjeteve të shkruara dhe elektronike të komunikimit: të gazetës, librit, radios dhe sidomos të televizionit. Lidhur me këtë kategori folësish, A. Kostallari vinte në dukje se nën ndikimin e fuqishëm të gjuhës letrare, “edhe në zonat e thella fshatare brezat aktivë të popullsisë nuk përdorin më në bisedat e përditshme të folmen e kulluar vendësore (lokale), por e përziejnë atë me elemente të gjuhës letrare”, duke arritur në përfundimin se “në kohën tonë gjuha letrare i ka lëkundur në shkallë të ndryshme strukturat e të folmeve dhe se sistemet arkaike dialektore kanë filluar të shthuren”⁹².

4. Nën dritën e sa shtjelluam deri tani, mund të arrijmë në dy përfundime. Së pari, pohimet për bashkëveprimin e dialekteve me gjuhën standarde dhe për dialektet si burim pasurimi për standardin etj., që përbëjnë objektin e shumë kumtimeve që mbahen në tubime gjuhësore e shkrimesh të botuara në revistat tona gjuhësore, janë të një natyre romantike, të paktën për situatën e sotme gjuhësore. Ato nuk mbështeten në teorinë sociolinguistike për marrëdhëniet e variantit standard me variantet jostandarde, nuk provohen as në praktikën e sotme ligjërimore. Madje, nuk qëndrojnë edhe nga pikëpamja e historisë së formimit të

⁹⁰ A. Kostallari, *Gjuha e sotme letrare kombëtare shqipe...*, f. 12.

⁹¹ Xh. Lloshi, *Roli i sistemit stilistik në shqipen e sotme letrare*, Gjuha jonë, 1985, 1, f. 89.

⁹² A. Kostallari, *Gjuha e sotme letrare kombëtare shqipe...*, f. 29–30.

gjuhës standarde shqipe, e cila u krijua mbi bazën dhe me lëndën gjuhësore të varianteve letrare, gjatë një procesi shndërrimesh cilësore që shpuri në shuarjen e këtyre të fundit.

Së dyti, në lidhje me rolin e dialekteve në pasurimin e gjuhës standarde, vërejmë se në literaturën tonë gjuhësore ende nuk bëhet dallimi midis të folmeve, si variante gojore, dhe varianteve letrare dialektore. Me mungesën e këtij dallimi, mendojmë se shpjegohen edhe pohimet për ndërveprimin dhe zhvillimin konvergjent të dialekteve apo për rolin e dialekteve në pasurimin e gjuhës standarde. Ndërkaq nga leximi i vëmendshëm i shkrimeve të A. Kostallarit për gjuhën letrare para viteve '80 të shekullit të kaluar, del se ai është i vetëdijshëm për këtë dallim. Kështu, në punimin "Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë", ai bën fjalë për mbizotërimin e zhvillimit konvergjent dhe të ndërveprimit, bashkëveprimit "midis varianteve letrare, ku pasqyrohet evolucioni konvergjent i dy dialekteve të shqipes", për përqendrimin e "bazës dialektore rreth dy boshteve kryesore"⁹³. Siç shihet, ai e vë në spikamë traditat letrare dialektore të periudhës para standardizimit dhe i sheh këto dy traditat letrare si "dy boshte kryesore" rreth të cilave përqendrohen e konvergojnë dialektet. Edhe në analizën e përbërësve të gjuhës letrare në të gjitha nënsistemet e saj ai arrin në përfundimin se "gjuha e sotme letrare shqipe... qëndron mbi një bazë të gjerë që përfshin elementet themelore të përbashkëta të shqipes dhe elemente të veçanta e të rëndësishme dalluese të të dy dialekteve e të varianteve letrare përkatëse..."⁹⁴. Nuk ka si të mos vihet re se këtu ai flet për elemente të marra nga njëri ose tjetri variant letrar dialektor.

Pra, të folmet nuk mund të shërbejnë si burim pasurimi për gjuhën standarde, përkundrazi ato janë të varura prej saj, sidomos për sa i përket leksikut. Siç vë re gjuhëtari gjerman A. Hecer, "nuk është e mundur të flitet as në toskërishten korçare, as në gegërishten shkodrane mbi të gjitha çështjet e shkencës dhe teknikës, pa bërë huazime leksikore prej gjuhës së njësuar letrare".⁹⁵ Gjuha standarde mund të pasurohet ose duke rivlerësuar variantet gramatikore e leksikore që gjatë fazës së standardizimit janë mënjanuar, ose me lëndë leksikore të vjelë nga ligjërimi i shkruar i të gjitha stileve dhe i të gjitha kohëve, duke filluar që me autorët e vjetër, ose nga fjalorët shqip – gjuhë e huaj, ose nëpërmjet huazimit prej gjuhëve të tjera. Do të ishte një ndihmesë e madhe e instituteve dhe e departamenteve të gjuhës shqipe, nëse do të krijonin korpusë elektronike të veprave të autorëve shqiptarë dhe të ndërmerrnin studimin me metoda kompjuterike të këtyre korpusëve elektronike, duke tërhequr në këtë projekt të madh sidomos doktorantët. Këto prurje do t'u shërbenin leksikografëve për të hartuar fjalorë sa më të pasur të gjuhës sonë. Në të kundërt, përsëritja e pohimit se dialektet shërbejnë si burim pasurimi për standardin, do të vijojë të pengojë si deri tani punën për studimin dhe mbledhjen e pasurisë leksikore që është e shpërndarë në gazeta, revista, libra, botime zyrtare etj.

5. Gjuha standarde shqipe zotëron të gjitha cilësitë e një mjeti mbarëkombëtar komunikimi. Ajo është e aftë për të përmbushur të gjitha funksionet e një gjuhe moderne dhe po shfaqet si e barabartë me gjuhët më të zhvilluara të Evropës. Zotërimi, lëvrimi, pasurimi

⁹³ A. Kostallari, *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare...*, art. i cit., f. 4.

⁹⁴ *Po aty*, f. 41.

⁹⁵ A. Hetzer, *Gjuha letrare e njësuar shqipe pas kthesës politike*, Hylli i Dritës, 3, 2010, vjeti XXIX, Shkodër, f. 84.

dhe mbrojtja e saj janë detyra të shenjta për këdo që e ka shqipen gjuhë amtare. Lidhur me termin “gjuhë standarde”, jemi të mendimit që epiteti “standard” të përdoret vetëm kur vjen puna për krahasimin e gjuhës standarde me variantet dialektore, meqenëse gjuha jonë standarde i përfaqëson në mënyrën më të plotë të gjitha variantet dialektore, si një emërues i përbashkët i të gjitha të folmeve të shqipes. Pra, përderisa gjuha standarde është sistemi më i plotë gjuhësor, makrosistem që funksionon në shkallë kombëtare, mund të themi thjesht gjuha shqipe, pa e përdorur epitetin. Kjo është një praktikë që e hasim në të gjitha gjuhët e zhvilluara të Europës, por edhe tek ne në emërtimet e veprave normative: “Fjalor i gjuhës shqipe”, “Gramatika e gjuhës shqipe”, “Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe” etj.

KONGRESI I DREJTSHKRIMIT DHE ÇËSHTJE TË LEKSIKUT

Nëse drejtshkrimi është fusha e normuar më me rreptësi e gjuhës standarde, leksiku është fusha më së lirshmi “e normuar” brenda sistemit gjuhësor. E nisëm kështu për të përmbushur tezën që do të përvijohet në këtë kumtesë e cila jo vetëm vërteton një fakt të gjithënjohur, por lejon edhe mundësinë për t’iu kundërvënë atyre që thonë se Kongresi i Drejtshkrimit i bëri një padrejtësi të madhe e të palejueshme leksikut të dialektit verior, dialektit gegë dhe, se kjo u bë për qëllime thjesht politike dhe të tjera.

Sot pas 40 vjetëve nga Kongresi i Drejtshkrimit, i cilësuar nga mendjendriturit si ngjarja më e madhe kulturore në jetën e shqiptarëve përgjatë shekullit XX, diskutimi për vlefshmërinë e standardit për shqiptarët, diskutimi për vlefshmërinë e rrugës që është ndjekur për këtë standardizim dhe më në fund, edhe diskutimi për përmbushjen a mospërmbushjen e funksioneve komunikuese në të gjitha rrafshet nga ana e këtij standardi, parë nga perspektiva e së tashmes dhe e së ardhmes së shqiptarëve, duket jo vetëm prapakthyese, por, më shumë se kaq, verbëri dhe mospasje vizioni për ecjen e shqiptarëve bashkë në kohën që po vjen. Duke ndjekur tezën e ngritur për diskutim në fillim shtrohet pyetja: a e ka normuar Kongresi i Drejtshkrimit leksikun, në të vërtetë a e ka sanksionuar përdorimin a mospërdorimin e një pjesë të leksikut të shqipes? A ka qenë e mundur kjo? E para që duhet të thuhet është: shumëfunksionaliteti dhe shtresëzimi i gjuhës standarde janë kriteret më të rëndësishme për “normimin” e leksikut. Këto dy kriteret nuk janë marrë dhe as nuk po merren parasysh në mënyrë kritike në debatet shkencore e joshkencore. Kjo ka sjellë gjykime jo të drejta dhe argumentime të pambështetura shkencërisht për normën tonë gjuhësore, rrjedhimisht edhe për normën leksikore.

Brenda këtyre diskutimeve, më së shumti u debatuan e po debatohen *drejtshkrimi*, *paskajorja* dhe *leksiku*. Nëse i pari, pra *drejtshkrimi*, “përfitoi” nga ky debatim e aktualizim edhe disa propozime konkrete, në të shumtën e herës të paarsyetuara shkencërisht dhe praktikisht, në Këshillin Ndërkademiç të Gjuhës, i cili u krijua këtu e tetë vjet më parë, në rend të parë, si rrjedhojë dhe si presion pikërisht i këtyre debateve, e dyta, *paskajorja*, pret në radhë për t’u bërë çështje e “nxehhtë” po në këtë Këshill. Mund të thuhet, madje, se ende nuk janë hapur të gjitha çështjet që pretendohen të hapen e të “zgjidhen” dhe për më tepër priten edhe rrjedhoja të tjera të këtyre debatimeve, jo vetëm në rrafshin e drejtshkrimit, po sidomos edhe në rrafshin morfo-sintaksor.

Çështja e tretë, *leksiku*, nga këto debate mund të duket se do të kalojë më së lehti, pikërisht pse çështja e leksikut nuk mund të krahasohet me çështjet e fonetikës dhe gramatikës, ndërsa paragjykimet për këtë të fundit rrëzohen lehtësisht. Çështja e leksikut i takon më shumë dijes së linguistikës njohëse a konjitive dhe vetëm ajo mund të sqarojë më së qarti lidhjet e leksikut me normësinë, rrjedhimisht edhe me drejtshkrimin dhe, për arsye kjo çështje nuk ka të bëjë me asnjë lloj normësie të caktuar a të paracaktuar në Kongresin e Drejtshkrimit.

Si e tillë kjo çështje kërkon diskutim e jo debatim dhe gjithsesi në nivele profesionale-gjuhësore me platforma që do ta shohin problemin realisht e jo me argumentime joshkencore, paragjykime politike, ideologjike, krahinore, e të tjera.

Se cilat janë problemet e leksikut të shqipes lidhur edhe me çështje të normës leksikore na e sqaron drejt e qartë, përveç të tjerëve, leksikologu ynë i shquar, prof. Jani Thomai në referatin e paraqitur po në këtë Këshill për çështje aktuale të leksikut të shqipes, në të cilin midis të tjerash thotë: “Problemet e leksikut në shqipen e sotme standarde janë shumë më të veçanta sesa në nënsistemet e tjera të gjuhës, si fonetika, gramatika e fjalëformimi, së paku për katër arsye themelore: a) për shkak të veçantisë së normës leksikore; b) për shkak të raporteve të leksikut të standardit me leksikun e gjuhës në përgjithësi; c) për shkak të dinamikës dhe të lëvizjeve të mëdha e të shpejta në leksik me gjithë qëndrueshmërinë e normës drejtshkrimore e gramatikore dhe ç) për shkak të ndikimit të drejtpërdrejtë e të menjëhershëm të zhvillimeve e të ndryshimeve historike, ekonomike, shoqërore, madje edhe politike ose të politikave të zbatuara në planifikimin gjuhësor”.⁹⁶

E trajtuar kështu, çështja e leksikut të shqipes ligjëson edhe moskodifikimin e asnjë rregulle të ngurtë e të rreptë për leksikun e shqipes në Kongresin e Drejtshkrimit dhe konfirmon absurditetin e diskutimeve për “lënien anash”, si thuhet qëllimisht, të leksikut të gegërishtes për rrjedhojë edhe “varfërimin substancial” të shqipes pa këtë leksik. Me këtë rast po tumir një mendim të Ardian Vehbiut, i cili u silltet shpesh këtyre debateve. “Fakti më i dukshëm, më absolutisht i rëndësishëm, që u shpëton – nga padija ose nga mendja e keqe – ithtarëve të “pasurimit” të standardit me fjalë geqe të lëna deri më sot jashtë, është se dy kryedialektet e shqipes dallojnë mes tyre sidomos në fonetikë dhe gramatikë, por jo dhe aq në leksik dhe, se këto dialekte i kanë shumë fjalë, me qindra në mos mijëra, të përbashkëta mes tyre – duke filluar nga fjalë të rëndomta, si *pishë, dorë, mend, gjej, shkoj, i mirë, kot, dje*, etj.; pa përmendur pastaj që variacioni leksikor brenda një kryedialekti ose dallimet leksikore midis të folmeve (të themi, e folmja e Zadrimës dhe e folmja e Drenicës), shpesh është po aq i theksuar, në mos më tepër, se variacioni leksikor midis kryedialekteve.” Dhe se “dallimet leksikore ndërdialektore luajnë rol të parëndësishëm në mënyrën si strukturohet dhe si funksionon leksiku i sotëm normativ i shqipes; para së gjithash, ngaqë folësi përgjithësisht nuk mund ta dijë se nga ç’dialekt ka hyrë një fjalë e caktuar në standard, përveçse po të jetë specialist dialektolog.”⁹⁷ Në linguistikë, siç thotë Dejvid Kristal vlen aksioma që të gjitha gjuhët përzihen dhe ecin në hap me shoqërinë dhe njëra nga rrjedhojat e kësaj përzierjeje është lindja e fjalëve të reja, e mënyrave të reja të shqiptimit, e gjedheve të reja gramatikore, e kodeve dhe e varianteve regjionale dhe shoqërore, krahas zhdukjes së shkallëshkallshme të mënyrave të moçme të shprehjes.⁹⁸ Kjo vlen edhe për shqipen, prandaj përcaktimi i kufijve gjuhësorë diakronikë dhe sinkronikë, për më tepër përcaktimi i kufijve rajonalë - dialektorë, krahinorë e lektalë, është shumë i vështirë. Më tutje, po përpiqem ta plotësoj mendimin e drejtë të Vehbiut, të shprehur me lart, se leksiku i shqipes është përfutur në kontekstin mbidialektor të shqipes dhe paraqitet si një sistem që po zhvillohet përmes burimeve të ndryshme: krijimit, huazimit, shfrytëzimit të burimeve dhe të mjeteve fjalëformuese të shqipes të të dyja dialekteve dhe të folmeve të tyre. Standardi i shqipes nga aspekti leksikor shpreh mundësi për zgjerim e zhvillim e jo mbyllje e frenim. Ja dhe një arsye që vërteton vështirësinë e kodifikimit të një norme të rreptë leksikore.

⁹⁶ J. Thomai, *Probleme të leksikut në shqipen standarde*, material i përgatitur për Këshillin Ndërkademiç të Gjuhës, shkurt 2012.

⁹⁷ A. Vehbiu, *Mistifikimet e fjalës geqe*, blogu *Peizazhet e fjalës*, internet.

⁹⁸ D. Kristal, *Smrt jezika*, Beograd, 2003, f. 208.

Natyra e standardizimit dhe e asnjësisë në fushën e leksikut, ashtu si edhe mundësitë e gjuhës standarde shqipe në rrafshin e leksikut, më së miri shfaqen në prodhimin letrar, në prodhimin publicistik, në prodhimin shkencor, në prodhimin leksikografik, shkurt në punën e shkrimtarit, të publicistit, të gazetarit, të shkencëtarit, të përkthyesit, të leksikografit, të terminologut, të redaktorit gjuhësor e kështu me radhë, me një fjalë të të gjithë atyre që me gjuhën shënojnë, krijojnë dhe zhvillojnë botën tonë. Përpjekja për ta normuar leksikun në kuptimin e përjashtimit, siç parakupton koncepti “normë”, në të vërtetë do të thotë përpjekje për të vënë në kallëpe dhe për të modeluar përvojën e një bashkësie gjuhësore, prandaj është e gjykuar të dështojë para se të fillojë të zbatohet. Kjo ndodh edhe në rastin e përpjekjes për zbatim të dhunshëm të një “norme” leksikore. Hartuesit e rregullave të drejtshkrimit të shqipes e kanë ditur mirë këtë fakt.

Në debatet për leksikun shkohet edhe me tutje. Edhe fjalori i gjuhës së sotme shqipe, bashkë me plotësimet që ka njohur deri në vitin 2006, cilësohet si përjashtues i një pjese të madhe të leksikut të Veriut. Nuk është gjuha standarde fjalori i vitit 1980, as plotësimet e tij të mëvonshme, sepse nuk është e mundur të paraqitet e gjithë pasuria e saj në një fjalor. Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, i quajtur si “Fjalori i Kongresit” nga kundërshtuesit e standardit, pos fjalësit të përbashkët të të dyja dialekteve, që është pjesa e kryesore e fjalorit, pjesa më e madhe absolute, ka përfshirë edhe mjaft njësi leksikore me përcaktues dialektizma të ngushta, që shpesh janë të burimit të huaj, turk, grek e sllav, e që i gjejmë në të dyja dialektet. Fjalori ka përfshirë gjerësisht materialet gjuhësore të gegërishtes nga vepra e Fishtës dhe nga veprat e autorëve të tjerë gegë, nga fjalori i Bashkimit e nga fjalorë të tjerë të arealit gegë. Një hetim më i hollë në këtë rrafsh e dëshmon fare mirë këtë pohim.

Mund të shtrohet pyetja se a kanë mbetur jashtë këtij fjalori fjalë të gegërishtes? Natyrisht që kanë mbetur. Dhe kanë mbetur jo vetëm të gegërishtes, po edhe të toskërishtes, edhe të të folmeve të tjera të të gjithë arealit shqipfolës, deri edhe të atyre të arbëreshëve të Greqisë, të arbëreshëve të Italisë e të Zarës dhe më gjerë, sepse nuk ka qenë dhe nuk është e mundur as të përfshihen të gjitha dhe as të mblidhen të gjitha fjalët a shprehjet. Por duhet të thuhet me këtë rast se gjuha standarde është e hapur posaçërisht ndaj fjalëve me burim popullor (dialektor a krahinor), sepse “për arsye historike që dihen, ka një mospërputhje midis pasurisë së madhe leksikore (fjalësore) të gjuhës së folur që rron në dialekte dhe në të folme të

shqipes dhe pasqyrimin të kufizuar të kësaj pasurie në botime të ndryshme.”⁹⁹

Nuk është leksiku i gjuhës standarde tërësia e fjalëve të një fjalori sado i madh e përfshirës të jetë ai, sepse kjo është pamundur të realizohet. Edhe kriteret e përzgjedhjes gjithmonë mënjanojnë numër të caktuar të fjalëve, siç ka ndodhur edhe me fjalorët që kemi: u është dhënë përparësi fjalëve vendëse para fjalëve të huaja, fjalëve me shtrirje më të gjerë para atyre me përdorim shumë të rrudhur, neologjizmave para huazimeve e kështu me radhë. Konsideroj se ky nuk është problemi që duhet të na shqetësojë. Ka probleme të tjera që lidhen me leksikun e leksikografinë shqipe që mund të konsiderohen të ngutshme dhe jo lehtë të zgjidhshme.

⁹⁹ H. Shehu, *Androkli Kostallari, pse fle sirtarëve puna e tij kolosale?*, “Gazeta shqiptare”, Tiranë, 23.3.2011

Për dallim nga gjuha si sistem, çdo gjuhë si standard, ashtu si edhe shqipja, është e lidhur në mënyrë të pandashme me kombin që e flet, si njëri ndër përbërësit më thelbësorë në procesin e shndërrimit dhe të ngritjes së tij nga aspekti thjesht i tërësisë etnike në bashkësinë shoqërore globale me shkallë të lartë të lidhjes ekonomike, politike, kulturore e institucionale. Në këtë kontekst leksiku, si bartësi themelor i kuptimit në gjuhë dhe si thesar i përvojës kulturore - qytetëruese është mjeti më i fuqishëm ndikues brenda këtyre shndërrimeve e ngritjeve. Në rrethanat shoqërore - gjuhësore, në të cilat gjendet këtu e më shumë se dy dhjetëvjeçarë edhe gjuha shqipe, çështjet e leksikut, më në fund edhe vetë çështja thjesht pragmatike e “normësisë” leksikore, që lidhet me përzgjedhjen e fjalëve në situata të ndryshme komunikuese, nuk paraqet vetëm faktin e përcaktimit gjuhësor, por bëhet edhe një si “gjysmë gjuhë”, pikërisht për arsye të politizimeve dhe mistifikimeve edhe në këtë rrafsh gjuhësor. Po u nisëm nga konteksti dhe nga kuptimi, mikro dhe makrostilet përkatësisht shumëfunksionaliteti dhe shtresëzimi i gjuhës standarde si kriteret më të rëndësishme për “normimin” e leksikut nga pikëpamja e standardizimit bashkëkohor, mund të thuhet se sot hetohen prirje negative, në të vërtetë ndikime negative të rrethanave politike, shoqërore e kulturore në përgjithësi në leksikun dhe në të ashtuquajturën “normë leksikore”, ndikime të cilat viteve të fundit janë shprehur, pos të tjerash, edhe përmes aspektit negativ të përzierjes së stileve dhe, rrjedhimisht, edhe të mosmarrjes parasysh të shtresëzimit funksional të leksikut, duke shpërdorur kështu edhe kriteret e epshmërisë së normës leksikore dhe të traditës tashmë të qëndrueshme standardologjike në shqipen, e cila gjedhen e normësisë vazhdon ta kërkojë në gjuhën e shkrimtarëve të mëdhenj. Prandaj mund të thuhet se më parë se për një normë leksikore sot duhet të flitet për parime normative që ndërtohen mbi aktualizimin dhe kontekstin gjuhësor, rrjedhimisht edhe konteksti i përdorimit të shenjës gjuhësore – fjalës. Ky kriter duhet të jetë përcaktuesi i vetëm i rëndësishëm për përzgjedhjen e leksikut dhe jo përkatësia e tij dialektore a krahinore. Dija mbi gjuhën, përkatësisht standardizimi si pjesë e saj, është e detyruar ta kërkojë vendin dhe rolin e tij sot në një situatë tejet të përbërë shoqërore, politike kulturore, madje edhe gjuhësore, në hapësirën shqiptare.

Në këtë përvjetor të Kongresit të Drejtshkrimit, kur po shënohet dyzetvjetori i tij, gjerësia e problematikës që mund të shtrohet e të diskutohet sot i kalon kufijtë e çdo konference shkencore të organizuar për të. Kjo problematikë do të mund të përfshinte trajtime që lidhen jo vetëm me aspektin e normës dhe të normësisë, të rregullave të drejtshkrimit, të rëndësisë dhe të kuptimit të këtij Kongresi për shqiptarët në perspektivën e sotme e të mëtejshme gjuhësore, për njohjen dhe zbatimin e rregullave të drejtshkrimit, por edhe trajtime që lidhen posaçërisht me leksikun (tërësinë e fjalëve) dhe fjalëformimin e shqipes, me leksikografinë shqipe (teorinë dhe praktikën e hartimit të fjalorëve të tipave të ndryshëm), me përfshirjen e leksikut popullor (dialektor e krahinor) me vlerë letrare potenciale në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980) dhe në fjalorë të tjerë të shqipes a me shqipen, me pasurimin e mëtejshëm të leksikut të saj, me terminologjitë e shqipes, me sfidat në kontekstin e ri shoqëror-politik, me letërsinë artistike, me prirjet e reja zhvilluese në gjitha rrafshet e stilet e gjuhës, e kështu me radhë.

Mund të sjellim përfundimin se gjuha standarde për këto afro 40 vjet ka dëshmuar se i përmbush mirë funksionet e një gjuhe të përbashkët mbarëkombëtare dhe se ajo nuk mund të identifikohet me idiomën mbi bazën e së cilës është ndërtuar. Si e tillë ajo paraqet pasurinë e përbashkët gjuhësore, brenda së cilës janë mbujtur forma, struktura, morfema, leksema,

frazologji e ndërtime të mbarë shqipes në vertikalen e horizontalen e saj. Dhe, në këtë pasuri kanë kontributin e tyre të gjithë shqiptarët, sepse ajo është krijuar përgjatë historisë së tyre të përbashkët dhe në proceset e sotme të zhvillimit të tyre dinamik në të gjitha fushat e jetës dhe pse ajo është pasuruar dhe po pasurohet edhe përmes lëvizjeve dhe komunikimit ndërshtetërisht shumë të dendur dhe shumë domethënës sot.

SHQIPJA STANDARDE DHE FJALORËT SHQIP – GJUHË E HUAJ

1. Shqipja standarde vjen në këtë 40-vjetor të saj si një nga arritjet më të mëdha të kombit shqiptar, duke u shërbyer kërkesave të komunikimit të bashkësisë shqipfolëse, por duke u bërë edhe shprehëse e njësimi dhe e identifikimit kombëtar. Ashtu si simotrat e saj të standardizuara, ajo, tashmë, ka një sistem të normëzuar dhe të kodifikuar kënaqshëm, çka nënkupton një normë fonetike (drejtshkrimore, madje mund të flitet edhe për normë drejtshqiptimore), një normë gramatikore (morfologjike e sintaksore) një normë leksikore e semantike dhe stilistikore. Normëzimi dhe kodifikimi kanë ndihmuar jo pak që shqipja e ditëve tona të tregojë, ndër të tjera, edhe jetësi, aftësi e mundësi të mëdha për t'iu përgjigjur zhvillimeve që kanë ndodhur në jetën e shqiptarëve. Kjo duket dy dhjetëvjeçarët e fundit kur ajo u gjend në një proces hapjeje, të paimagjinueshëm më parë, ndaj gjuhëve me status të fuqishëm ndërkombëtar. Ajo, duke vendosur bashkëmarrëdhënie krejt të çlirëta me këto gjuhë, arriti të përballëte me to suksesshëm, megjithëse ndjeu dhe po ndien prej tyre ndikime e trysni gjithnjë në rritje në të gjitha nënsistemet e veta.

Procesi gjallërues i shqipes vërtetësohet në leksik dhe në fjalorë e saj, i cili bëhet shprehës i drejtpërdrejtë i funksionimit, i zhvillimit dhe i pasurimit. Shqipja e ditëve të sotme e ka organizuar leksikun përgjithësisht në *fjalorët shpjegues kombëtarë*, edhe pse ajo nuk ka ende një fjalor të tipit të madh. Këta fjalorë janë hartuar nga leksikografë të mirëfilltë, profesionistë, që kanë synuar kryekrejt të realizojnë vepra normative, edhe pse norma leksikore e semantike është shumë e diskutueshme. A. Kostallari, në artikullin *Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme*, pohon se normativiteti në një fjalor shpjegues arrihet: nga zgjedhja e fjalëve që do të përfshihen në fjalësin (glosarin) e fjalorit; nga zgjedhja e frazeologjisë gjuhësore...; nga zberthimi dhe përcaktimi i kuptimeve të fjalëve dhe i ngjyimeve (nuancave) të tyre...; nga shënimet stilistikore që do të përcaktojnë sferën dhe kufijtë e përdorimit të një fjale të caktuar, si dhe të këtij apo atij kuptimi të saj; nga shoqërimi i përkufizimeve, shpjegimeve të kuptimit ose të kuptimeve të fjalëve me një material të pasur ilustrues...; nga dhënia e shënimeve gramatikore duke u mbështetur në normën e gjallë të sotme gramatikore dhe në prirjet themelore të evolucionit të saj; nga përcaktimi i drejtshkrimit sipas rregullave të drejtshkrimit të sotëm; nga vendosje e theksit sipas normave të sotme të drejtshqiptimit¹⁰⁰.

Duhet të ripohojmë se gjuha jonë, duke u mbështetur përgjithësisht në këto parime hartuese, vjen në të dyzetin vit të standardizimit të saj me disa fjalorë normativë, si *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, 1980; *Fjalori i shqipes së sotme*, 1984 / 2002; *Fjalori i gjuhës shqipe*, 2006; *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, 1999 / 2009 (J. Thomai); *Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe* (2004), *Fjalor antonimik i gjuhës shqipe*, 1999, (M. Samara) etj., të cilët, së bashku me veprat normative në fushën e gramatikës e të fonetikës, luajnë rol të pazëvendësueshëm për kodifikim e normëzim, si dhe për nxënien e standardit.

¹⁰⁰ Shih më gjerë A. Kostallari, *Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme*, në "Studime për leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", 2, Tiranë, 1972, f. 90

Fjalorët janë veprat që kontaktojnë me përdoruesit e shqipes standarde më dendurisht se çdo vepër tjetër. Të hartuar duke mbajtur parasysh katër faktorë përcaktues: *informimin, funksionin pragmatik* (nënkupton që informacioni leksikografik të ofrohet në një format të kapshëm e të kuptueshëm shkencor, por edhe teknik); *përdoruesin dhe kontekstin e përdorimit*, ata shërbejnë si minierë (dhe si depozitë) njohurish dhe luajnë rolin e arbitrit në çështjet e standardit. Këta fjalorë informojnë, por edhe edukojnë normën leksiko-semantike, si dhe atë të nënsistemeve të tjera gjuhësore, përmes treguesve fonetikë, gramatikorë, fjalëformues, elementeve plotësuese me të cilët ndërtohet një zë leksikografik.

2. Por shqipja standarde, në moshën e saj 40-vjeçare, ka në fondin e vet, veç fjalorëve shpjegues, edhe dhjetëra fjalorë dygjuhësh, në të cilët ajo del si gjuhë e parë apo e dytë. Kjo është një nga arritjet më të vlerësuara, edhe pse vështirësitë hartuese kanë qenë nga më të shumtat. Shqipja numëron qindra vepra të tilla. Me fjalorë me tipologji të ndryshme, ajo e vendos leksikun e saj (sidomos atë të përgjithshmin) në përqasje me gjuhë me spektër gjeografik shumë të larmishëm, gati me të gjitha gjuhët kryesore të botës¹⁰¹. Nga këta fjalorë

¹⁰¹ Po japim në vijim disa nga këta fjalorë, duke ruajtur pak a shumë kronologjinë e botimit pas vitit 1972: Mikel Ndreca, *Fjalor shqip-serbokroatisht [Albansko-srpskohrvatski rečnik]*, Prishtinë, 1976, 377 f. (1980, 377 f.; 2004, 507 f.); Vedat Kokona, *Fjalor shqip-frëngjisht [Dictionnaire albanais-français]* (25 000 fjalë), Tiranë, 1977, 591 f.; *Fjalor i shkurtër shqip-kinezisht*, 1979, 718 f.; Ilo Duro, Ramazan Hysa, *Fjalor shqip-anglisht* (20 000 fjalë), Tiranë, 1981, 510 f. (Tiranë, 1988, 511 f., Prishtinë, 1988, 511 f.; Tiranë, 1996, 466+XI f.; botim i përmirësuar; Tiranë, 1999, 466+XI f.); Abdullah Zajmi, Mehdi Bardhi, Sulejman Drini, Latif Mulaku, Gani Luboteni, Sitki Imami, *Fjalor shqip-serbokroatisht*, Prishtinë, 1981, 1065 f. (Prishtinë, 1982); Gaspër Kiqi, Hysni Aliko, *Albanian-English Dictionary [Fjalor shqip - anglisht]*, Romë, 1991; Armin Hetzer *Albanisch-Deutsch und Deutsch-Albanisches Taschenwörterbuch [Fjalor shqip-gjermanisht dhe gjermanisht-shqip]*, Hamburg, 1991, -XIX f., 682 f.; Marek Jeziorski, Jerzy Wisniewski, *Fjalor shqip-polonisht, polonisht-shqip*, Varshavë, 1992, 231 f.; C. B. Massolini, U. Buttafava, *Vocabolario albanese-italiano [Fjalor shqip-italisht]* (25 000 fjalë), Itali, 1979 (1992, 2001); Oda Buchholz, Eilfried Fiedler, Gerda Uhlich, *Wörterbuch Albanisch-Deutsch [Fjalor shqip-gjermanisht]*, Leipzig, 1977, 739 f. (1992); Fatmir Toçi, *Fjalor italisht-shqip, shqip-italisht*, Tiranë, 1993, 350 f.; Paola Guerra, Alberto Spagnoli, *Fjalor italisht-shqip, shqip-italisht*, (12 000 fjalë), Milano, 1993, 221 f.; Ramazan Hysa, *Fjalor shqip-anglisht [Albanian-English Dictionary]*, Nju Jork, 1993, 510 f.; Kristofor Nočka, Spiro Filo, *Fjalor shqip-greqisht (me shkronja latine)*, Tiranë, 1993, 200 f.; Rian Disçi, *Fjalor shqip-turqisht-anglisht*, Stamboll, 1994, 520 f.; Liliana S. Verdha, *Fjalor shqip-finlandisht, finlandisht -shqip*, Helsinki, 1995, 357 f.; Ramazan Çadri, *Fjalor shqip-maqedonisht [Albansko-makedonski razgovornik]*, Tiranë, 1995, 152 f.; Haki Ymeri, Petar Astanasov, Zihni Osmani, *Fjalor maqedonisht-shqip dhe shqip-maqedonisht*, Kumanovë, 1996; Ilo Stefanllari, *Fjalor shqip-anglisht dhe anglisht-shqip*, Tiranë, 1996, 235 f.; Olimbi Vito, *Fjalor shqip-gjermanisht* (mbi 20 mijë fjalë dhe shprehje), Tiranë, 1996, 460 f.; Abedin Preza *Fjalor shqip-italisht* (27 mijë fjalë), Tiranë, 1996, 532 f. (botim i ripunuar, 2000, 548 f.); Adnan Agai, Kimete Agai, *Fjalor shqip-maqedonisht* (me 40 000 fjalë), Shkup, 1996; Serban Tabacu, *Fjalor shqip-rumanisht, rumanisht-shqip*, Bukuresht, 1996, 367 f.; K. Παπαφύλη, *Λεξικό Αλβανο - Ελληνικό (Fjalor shqip - greqisht)*, Αθήνα, 1997 489 f.; Bislim Pireva, *Fjalor shqip-gjermanisht*, Prishtinë, 1997, 326 f. Niyazi Sulça, *Fjalor shqip-turqisht*, Ankara, 1997, 160 f.; Vedat Kokona, *Fjalor shqip-anglisht*, Tiranë, 1998, 312 f. (2004); Vedat Kokona, *Fjalor shqip-frëngjisht [Dictionnaire albanais-français]* (rreth 35 000 fjalë), Tiranë, 1998, 876 f. Myzafer Kallajxhi, Nimete Karamani, *Fjalor shqip-italisht*, Tiranë, 1998, 488 f.; Leonard Newmark, *Oxford Albanian-English Dictionary (Fjalor shqip-anglisht i Oksfordit)*, Oxford, 1998; Niko Gjini, *Fjalor shqip greqisht*, Janinë, 1998, 1262 f.; Ramazan Çadri, *Fjalor bisedimor shqip-bullgarisht*, Tiranë, 1999, 134 f.; Enzo Shijaku, *Fjalor finlandisht-shqip dhe shqip-finlandisht*, Helsinki, 1999, 540 f.; Jani Thomai, Xhevat Lloshi, Rusana Hristova, Kosta Qiriazati, Ana Melonashi, *Fjalor frazeologjik ballkanik* (me rreth 5 000 njësi në 5 gjuhë), Tiranë, 1999, 352 f.; Ilo Duro, Ramazan Hysa, *Fjalor shqip-anglisht*, Tiranë, 1999, 466+XI f. (ribotim i përmirësuar i vitit 1981), Pavli Qesku, *Fjalor shqip-anglisht* (45. 500 fjalë), Tiranë, 1999, 1062 f. (2002); Abedin Preza, *Fjalor shqip-italisht* (40 000 fjalë), Tiranë, 1999, 828 f.; Pablo Nieto, *Fjalor shqip-spanjisht dhe anasjelltas*, Barcelonë, 1999, 317 f.; Abedin Preza, *Fjalor shqip-italisht* (27 mijë fjalë) (botim i ripunuar), Tiranë, 2000, 548 f.; *Oxford Albanian-English Dictionary (Fjalor shqip-anglisht i Oksfordit)*, Tiranë, 2000, 982 f.; Ali Ekmekçi, Nazmie Behushi, *Fjalor shqip-gjermanisht [Albanisch-Deutsches Wörterbuch]* (25 mijë fjalë), Tiranë, 2001, 648 f.; Fatmir Toçi, *Fjalor shqip-italisht*, Tiranë, 2001, 412 f.; Gani Hoxha, *Fjalor shqip-italisht* (fjalor xhepi), Prishtinë, 2001, 310 f.; Vedat Kokona, *Fjalor shqip-frëngjisht [Dictionnaire albanais-français]*

dygjuhësh, përfitimi është i shumëfishtë, sepse ata kanë ndihmuar e ndihmojnë “për të mësuar shqiptarët gjuhë të huaja dhe të huajt gjuhën shqipe, por kanë ndihmuar, pa mëdyshje drejtpërsëdrejti, edhe për pasurimin e shqipes e të fjalorëve të saj njëgjuhësh me shumë fjalë dhe shprehje që janë mbledhur me mundim dhe janë pasqyruar në ta për t’iu përgjigjur fjalëve dhe shprehjeve të gjuhëve të huaja”¹⁰².

Nëse fjalorët, ku shqipja është gjuhë e dytë, e përballin atë me gjuhët e huaja, *fjalorët shqip - gjuhë e huaj* kanë meritën e padiskutueshme se burimin kryesor të lëndës leksikore e semantike e marrin nga pasuria e shqipes standarde. Ndaj roli i këtyre fjalorëve në ngritjen e prestigjit ndërkombëtar të këtij standardi, në pranimin e pohimin e vlerave të tij, është i pazëvendësueshëm dhe shumë i rëndësishëm. Dhe misionar në këtë drejtim u bë *Fjalori shqip – serbokroatisht*, i hartuar institucionalisht (i vetmi fjalor shqip-gjuhë e huaj i hartuar kështu) nga punonjësit shkencorë në Institutin Alabanologjik të Prishtinës: Abdullah Zajmi, Mehdi Bardhi, Sulejman Drini, Latif Mulaku, Gani Luboteni dhe Sitki Imami. Fjalori pa dritën e botimit më 1981, gati 10 vjet pas Kongresit të Drejtshkrimit dhe, vetëm një vit pas botimit të *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe* (1980), të cilin, sipas gjithë gjasash dhe siç pohohet në parathënie, nuk e ka shfrytëzuar, sepse puna hartuese rroku periudhën 1974-1979¹⁰³. *Fjalori shqip – serbokroatisht*, me një vëllim me 1065 faqe, ka rreth 50.000 fjalë në fjalësin shqip, duke e bërë atë fjalorin më të madh dhe më të plotë dygjuhësh, që pasqyron përgjithësisht normën leksikore e gramatikore të shqipes standarde. Fjalori ka më shumë fjalë se çdo vepër e hartuar më parë, qoftë kjo edhe njëgjuhëshe, madje ai ka rreth 9.000 njësi lema më shumë se *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* (1980). Mjafton një shembull për ilustrim: nëse ky fjalori shpjegues ka 72 zëra që lidhen me fjalën *bashkë*, *Fjalori shqip - serbokroatisht* ka 247 të tillë pra rreth 2.5 herë më shumë. Ky fjalor dygjuhësh përveçohet, jo vetëm se sendërton prej hartuesve kosovarë parimin *një komb, një gjuhë të njësuar*, por edhe se me elementet gramatikore të shumta edukon dukshëm variantin standard të shqipes. Ai, ndonëse nuk është fjalor shpjegues jep paradigma të hollësishme normative. Fjala vjen, ai paradigmon, përmes trajtave normative supletive, foljet si *vij, bie (rashë, rënë), rri* apo ato me alomorfe si *vë, lë, them* etj. Ndaj ne pohojmë se *Fjalori shqip – serbokroatisht* nuk është thjesht dygjuhësh, ku fjalës shqipe i gjendet gjegjësjë në serbokroatisht. Ai është në kapërcyell të një fjalori shpjegues për fjalësin e shqipes. Jo rrallë, për fjalë të ndryshme jepen edhe shpjegime kuptimore (sidomos me perifrazime të ngjeshura e sinonime), jepen fjalë me struktura të gjera kuptimore, si folja *bie* me 21 kuptime, *dal* me 11 kuptime etj.; jepen shumë terma, emërtime të pathjeshta, njësi frazeologjike etj.

3. Me një vështrim, edhe të sipërfaqshëm, vëren se *fjalorët shqip - gjuhë e huaj*, përgjithësisht, kanë ndjekur hap pas hapi botimet leksikografike njëgjuhëshe të shqipes standarde, sidomos atë të fjalorëve shpjegues normativë të hartuar nga Departamenti i

(rreth 43 000 fjalë e shprehje), Tiranë, 2002, 654 f.; Pavli Qesku, *Fjalor shqip-anglisht* (35 000 fjalë), Tiranë, 2003, 800 f.; Ferdinand Leka, Zef Simoni, *Fjalor shqip-italisht* (40 mijë fjalë), Tiranë, 2003, XXI+878 f. (botim i përmirësuar i vitit 1996); Renata Topçiu, Ana Mellonashi, Luan Topçiu, *Fjalor shqip-rumanisht*, Bukuresht, 2003, 1245 f.; Hysen Voci, *Fjalor shqip – turqisht* (15 fjalë e shprehje), Tiranë, 2003, 426 f.; Ali Dhrimo, *Fjalor gjermanisht – shqip* (50.000), Tiranë, 2005, 1766 f.; Abedin Preza, Ervin Preza, *Fjalor shqip – italisht* (50.000 fjalë), Tiranë, 2005, 1803 f., etj.

¹⁰² A. Dhrimo, *Probleme teorike dhe praktike për hartimin e fjalorëve dygjuhësh*, në “Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005, f. 236

¹⁰³ *Fjalor shqip-serbokroatisht*, Prishtinë, 1981, f. V

leksikologjisë dhe i leksikografisë pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë. Hartuesit e fjalorëve dygjuhësh kanë gjetur te fjalorët shpjegues, sidomos tek ata kombëtarë (të hartuar institucionalisht nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë) lëndë të gatshme dhe ky është shkaku kryesor përse ata janë mbështetur drejtpërdrejt tek këto vepra. Sepse, siç pohon me të drejtë J. Thomai, “një fjalor është në radhë të parë pasqyrë e fjalëve, e frazeologjisë dhe e kuptimeve të tyre leksikore. Por çdo fjalor, për më tepër çdo fjalor shpjegues kombëtar, është në shumë elemente të tij edhe pasqyrë fonetike e gjuhës (që nga tingujt, drejtshkrimi, drejtshqiptimi e deri te theksi i fjalëve); është pasqyrë (e pjesshme) gramatikore (sepse jep edhe kuptimet gramatikore themelore e mjetet e shprehjes së tyre, temat bazë të fjalëve të eptueshme, kuptimet leksiko-gramatikore, si dhe sintagmatikën a leksematikën më të përgjithshme etj.); është pasqyrë semantike në vështirim më të gjerë se leksiku; po ashtu është pasqyrë stilistike e përgjithësisht e kulturës së gjuhës, lidhur edhe me ruajtjen e pastërtisë së leksikut e të normës leksikore në përgjithësi, sikundër, në disa elemente e sipas rastit, mund të jetë edhe pasqyrë etimologjike, historiko-gjuhësore, etnokulturore etj”.¹⁰⁴

Ndaj fjalorët kryesorë *shqip – gjuhë e huaj* dalin me një funksion të dyfishtë: së pari, pasqyrojnë e tregojnë gjendjen e standardit të shqipes në nënsistemin leksikor, frazeologjik e semantik, si dhe funksionimin, konsolidimin, zhvillimin dhe shtrirjen e këtij standardi; së dyti bëjnë që përdoruesi i fjalorëve, ai që mëson a përsos zotërimin e shqipes, të jetë në kontakt jo me çfarëdo varianti të shqipes, por me atë të normëzuar, me standardin.

4. Fjalorët dygjuhësh *shqip – gjuhë e huaj* janë ose të tipit të vogël, ose të tipit të mesëm, e lidhur kjo drejtpërdrejt me fjalorët e tipit të mesëm shpjegues të shqipes standarde. Ky kushtëzim bie në sy kur fjalorë të këtij lloji bëhet përqasen me *fjalorë gjuhë e huaj- shqip* të autorëve shqiptarë. Këta autorë, duke iu referuar fjalorëve të mëdhenj të gjuhëve ku referohen, kanë hartuar fjalorë edhe të tipit të madh. Përmendim këtu: A. Dhrimo, *Fjalor gjermanisht - shqip*, 2 vëllime (rreth 3700 faqe, me 82.000 fjalë), Wiesbaden, 1996; P. Qesku, *Fjalor anglisht - shqip*, 2002, me 120.000 fjalë, Abedin Preza, Ervin Preza, *Fjalor italisht – shqip*, Tiranë, 75.000 fjalë etj.

5. Fjalorët *shqip – gjuhë e huaj* mund të vështrohen e të vlerësohen për fjalësin e shqipes që ndërton makrostrukturën e tyre. Është fakt se, me ndonjë përjashtim, në vitet 70 - 80 të shekullit të kaluar, mbizotërojnë fjalorët e tipit të vogël, që variojnë me një fjalë nga 10 - 35.000 lema, kurse në dy dhjetëvjetëshat e fundit janë hartuar fjalorë deri në 50.000 lema, duke zgjeruar shtresat leksikore të fjalëve me përdorim të ngushtë, si atë krahinorizmave, të terminologjisë, të neologjizmave leksikore e semantike, por sidomos të huazimeve që kanë zënë në leksikun e shqipes në këtë periudhë etj. Autorët profesionistë kanë ditur që në veprat e hartuara të ruajnë karakterin sistemor dhe simetrinë për grupet paradigmatiche leksikore e deri diku frazeologjike të pasurisë së shqipes. E dëshmojnë “fjalorët e vëllimshëm e cilësorë të shqipes me gjuhë të tilla si anglishtja, italishtja, gjermanishtja, frëngjishtja, greqishtja e serbokroatishtja, që kanë dalë 2-3 dhjetëvjeçarët e fundit.”¹⁰⁵

Vitet e fundit, një nga zhvillimet parimore në leksikografi ka qenë fokusimi te perspektiva e përdoruesit, që nënkupton hartimin e një vepre që ndjek nevojat, kërkesat dhe pragmatizmin e përdoruesit (përdorues të ndryshëm kanë arsye të ndryshme për shfrytëzimin

¹⁰⁴ J. Thomai, *Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë*, në “Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005, f. 13

¹⁰⁵ J. Thomai, *Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë*, Tiranë, 2005, f. 13

e një fjalori dhe që fjalori mund dhe duhet t'u përgjigjet atyre)¹⁰⁶. Por duhet të pohojmë këtu se edhe te ndonjë fjalor, që ka lëndë leksikore më të shumtë se ajo e fjalorëve të tipit të mesëm të shqipes standarde, leksikun e pjesës shtesë gati e kanë jonormativ. Përmendim këtu *Fjalorin shqip - anglisht* të L. Njumarkut¹⁰⁷, i cili edhe pse ka 85.000 fjalë dhe shprehje nga shqipja, fjalësi normativ i tij është rreth 50.000 njësi. Fjala vjen, vetëm te shkronja A fjalori ka të shenjuar me asterisk 669 njësi që nuk i takojnë standardit, duke qenë përgjithësisht variante fonetike dialektore të fjalëve përfaqësuese e normative.

6. Shumë fjalorë shqip - gjuhë e huaj, përgjithësisht ata të tipit të vogël, përveçohen nga një pragmatizëm leksikor, duke synuar që çdo fjale të shqipes t'i gjejnë barasvlerësin në gjuhën e huaj, ndaj edhe pse mund të jenë të vëllimshëm, janë në thelb lista fjalësh. Kjo ka sjellë cenim të strukturave semantike të fjalëve (ose të mikrostrukturave), duke çuar në mangësi të theksuara të karakterit referencial të fjalës, kur dihet që shqipja është gjuhë polisemike. Kjo anë e shqipes duket jo vetëm në përdorimin e fjalëve, të cilat dalin shpesh edhe me dykuptimësi, por edhe në gjendje leksikore të fiksuara. Fjala vjen në FGjSSh, 1980 (fjalor i tipit të mesëm, por me shumë tregues, një fjalor i tipit të madh) bie në sy se 80 % e fjalëve dalin me më shumë se një kuptim. Në disa vepra të fundit, sidomos në ato të hartuara nga gjuhëtarë të mirëfilltë, procesi i paraqitjes në fjalor i një çifti të thjeshtë fjalësh shqip – gjuhë e huaj është kapërcyer dhe mund të pranohet se një nga arritjet më cilësore dhe më të vlerësuara të këtyre veprave është se autorët kanë ditur të përballin fjalën shqipe jo vetëm në kuptimin kryesor, të mirëfilltë, por dhe me kuptimet e tyre dytësore normative. Sot në përdorim ka fjalorë që veçohen për përzgjedhjen e kuptimeve dhe riformimin e saktë të strukturave kuptimore të fjalës shqipe, në përputhje tipologjinë e fjalorit. Do të veçonim këtu vepra të tilla si, *Fjalori shqip – gjermanisht*, hartuar nga Ali Dhrimo, *Fjalorin shqip – italisht*, hartuar nga Abedin Preza, Ervin Preza etj.

Po ilustrujmë pohimin me fjalorin *Αλβανο-Ελληνικο Λεξικό* (*Fjalor shqip – greqisht*), hartuar nga Niko Gjini dhe botuar në vitin 1998. Fjalori është vepra leksikografike shqip - greqisht më e arrirë deri sot. Ai ka gati fjalësin e *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe* (1980) mbi të cilin është mbështetur dhe *e gjithë lënda leksikore, semantike, thëniat ilustruese etj. i përkasin shqipes standarde*. Ai jep në mënyrë të zgjeruar strukturat kuptimore të fjalëve, duke e bërë fjalorin gati - gati shpjegues: Janë me mijëra fjalët që janë dhënë me struktura kuptimore me më shumë se një kuptim, madje kemi shumë fjalë me mbi 5 kuptime që janë në përgjithësi fjalë emërtuese (kuptimplota). P.sh., folja *bie* (*rashë, rënë*) ka 20 kuptime, mbiemri *i rëndë* në fjalor ka 14 kuptime, folja *vë* ka 12 kuptime, folja *ha* ka 11 kuptime, folja *shkoj* ka 10 kuptime, emri *botë* ka 9 kuptime, mbiemri *i lehtë* ka 9 kuptime, emri *fuqi* ka 9 kuptime, emri *nyjë* ka 9 kuptime, folja *shoh* ka 8 kuptime, emri *mend* ka 8 kuptime, folja *rroj* ka 8 kuptime, mbiemri *i hollë* ka 8 kuptime, folja *ndjek* ka 7 kuptime, ndajfolja *drejt* ka 7 kuptime, emri *dorë* ka 7 kuptime, mbiemri *i shenjtë* ka 6 kuptime, folja *vdes* ka 6 kuptime, emri *qetësi* ka 5 kuptime, emri *shpinë* ka 5 kuptime etj). Fjalori pasqyron me mijëra njësi frazeologjike, në të cilat jo vetëm duken veçoritë dalluese të secilës gjuhë, por për së shumti bëhen treguese edhe të pasurisë etno-linguistike të greqishtes dhe të shqipes etj. Në fjalor vetëm me fjalën *zemër* kemi rreth 20 njësi frazeologjike, ku do të veçonim: *mori zemër* / πήρε

¹⁰⁶ Shih më gjerë R. R. K. Hartmann, *Dictionary of Lexicography*, Beijing, China, 2000, f. 18

¹⁰⁷ L. Newmark, *Albanian – english dictionary*, Oxford, 1999

θάρος, *me gjithë zemër* / μ'όλη την καρδιά, πρόθυμα *e kam në zemër* / τον έχω στην καρδιά, *zemër e thjeshtë* / αηλή καρδιά, *e pastër* / καθαρή καρδιά, *zemër e madhe* / μεγάλη καρδιά, *zemër fisnike* / ευγενική καρδιά, *zemër e mirë* / καλήκαρδιά, *zemër e artë* / χρυσή καρδιά; me fjalën *mend* ka rreth 30 njësi frazeologjike, kurse me fjalën *mendje* ka mbi 20, ndër të cilat do të veçonim: *kam ndër mend* / έχω κατά νουν, *e lanë mendtë* / ξεκούτιανε, αποβλκώθηκε από τα γεράματα, *ia mori mendtë* / τον ξετρέλανε, του μήρε τα μυαλά, τον πάγεψε, me fjalën *gojë* ka mbi 20 njësi frazeologjike etj. Në vepër kanë zënë vend shumë thënie për të ilustruar kuptimin a kuptimet e fjalëve. Përzgjedhja e tyre ia ka rritur ndjeshëm vlerat veprës. Ilustrimet janë togfjalësha të thjeshtë (sintagma dygjymtyrëshe), fjali të zakonshme, por edhe shumë fjalë fluturake.

7. Fjalorët dygjuhësh përveçohen gjithashtu se procesi i zgjerimit të fjalësit dhe i strukturave kuptimore nga fjalori në fjalor dhe nga dhjetëvjetëshi në dhjetëvjetësh, është shoqëruar edhe me përpjekjet për të pasqyruar në vepër sa më shumë vlera të tjera të fjalëve, edhe ato “të mbishtresuara”, si vlerat shprehëse-emocionuese, stilistike, paradigmatiche e sintagmatike etj. Nga hartuesit e fjalorëve është ndier e nevojshme të jepet më gjerë jo vetëm çka është fjala, por edhe jeta e saj në ligjërimin e gjallë.

8. Një problem i rëndësishëm që lidhet me fjalorët shqip – gjuhë e huaj, është dhe ai i autorësisë. Duhet të pohohet se fjalorët e këtij lloji, vetëm me një përjashtim të *Fjalorit shqip – serbokroatisht*, përmendur më lart, nuk janë vepra të hartuara në rrugë institucionale dhe, më drejtpërdrejt, nuk janë vepra të hartuara nga ata që janë marrë me leksikografi dhe që kanë peshë në vetë procesin e kristalizimit, të konsolidimit, të pasurimit dhe të përhapjes së standardit. Puna e filluar nga IAP (Instituti Albanologjik i Prishtinës), me veprën *Fjalor shqip – serbokroatisht*, nuk vazhdoi më tej. Madje në Republikën e Shqipërisë, hartimi i këtyre veprave nuk ka qenë kurrë pjesë e projekteve të punës të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë, institucioni i specializuar për hartimin e veprave leksikografike. Disa herë është kërkuar që pranë tij të ngrihej një qendër e hartimit të fjalorëve, jo vetëm të atyre shpjegues, por edhe dy- e shumëgjuhësh, por deri tani nuk është arritur asgjë. Fjalorët shqip – gjuhë e huaj përgjithësisht janë hartuar nga persona që e kanë pasur shqipen gjuhë amtare, edhe pse përgjithësisht janë a kanë qenë punonjës akademikë pranë universiteteve ku ka fakultete të gjuhëve të huaja. Veprat fillimisht kanë lindur nga nevojat e shkollave të larta, kurse sot ato ndjekin zhvillimet e fuqishme e të gjithanshme të shoqërisë sonë dhe të zhvillimeve në botë. Kjo duket në veprat leksikografike që lidhen me anglishten, italishten, gjermanishten, frëngjishten etj. Është përsëri fakt i vlerësueshëm që veprat më të arrira, janë fjalorët e hartuar nga autorë shqiptarë, të cilët e njohin fjalën shqipe, vlerat e saj shënuese e shprehëse.

Por këtu të tërheq vëmendjen dukuria se shpesh me hartimin e fjalorëve të këtij lloji merren njerëz që nuk kanë asgjë të përbashkët me leksikografinë, duke hartuar “vepra”, që paraqesin probleme në të gjitha rrafshet. Ky është shkaku që në tregun leksikografik ka dhe vepra me mangësi. Me të drejtë A. Dhrimo, pohonte se “ka shumë autorë fjalorësh dygjuhësh, të cilët fatkeqësisht nuk kanë asnjë formim gjuhësor dhe, gjithë duke u dërmuar në punë e gjithë duke dhënë njëfarë ndihmese për njohjen e gjuhëve të huaja ndër ne, nuk bëjnë kurrfarë pune kërkimore a krijuese, por bëjnë thjesht përkthim, disa herë edhe të keq, fjalorësh të gatshëm. Duke mos pasur njohuri filologjike as për shqipen, as për gjuhën e huaj përkatëse, duke mos njohur fare teorinë, as të gjuhës e të gjuhësisë në përgjithësi, as të leksikografisë në veçanti, duke mos dalluar dot, fjala vjen, deri edhe kufirin midis sinonimeve dhe kuptimeve

të tjera të fjalës, ose përdorimin e drejtpërdrejtë të fjalës nga përdorimi figurativ i saj, shprehjet e qëndrueshme nga ndërtimet e lira, duke mos dalluar dot madje ndajfoljet nga mbiemrat etj.”¹⁰⁸

Si përfundim, fjalorët a arrirë *shqip – gjuhë e huaj* dalin me një funksion të dyfishtë: së pari, pasqyrojnë e tregojnë gjendjen e standardit, funksionimin, konsolidimin, zhvillimin dhe shtrirjen e tij; së dyti bëjnë që përdoruesi i tyre, ai që mëson a përsos zotërimin e shqipes, të jetë në kontakt jo me çfarëdo varianti të shqipes por me atë të normëzuar të shqipes, me standardin. Dhe roli i tyre për nxënien e standardit nga përdoruesi dhe edukimin tek ata të normës gjuhësore të shqipes është i pazëvendësueshëm.

¹⁰⁸ A. Dhimo, *Probleme teorike dhe praktike për hartimin e fjalorëve dygjuhësh*, në “Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005, f. 235

NORMA SHQIPTIMORE DHE PROBLEME TË SAJ

U bënë 40 vjet nga zhvillimi i Kongresit të Drejtshkrimit dhe shumë prej çështjeve që u trajtuan aty ende nuk kanë marrë përgjigje përfundimtare. Sigurisht që diskutimi i problemeve që lidhen me standardin në gjuhë nuk përfundojnë, sepse gjuha është një sistem në ndryshim për shkaqe brenda e jashtëgjuhësore.

Duke marrë shkas nga paragrafi i fundit i rezolutës së këtij Kongresi në të cilin është theksuar se për të përcaktuar standardin si në të shkruar dhe në të folur brenda vitit 1975 duhet të hartoheshin “Rregullat e drejtshqiptimit” dhe “Rregullat e pikësimit të gjuhës shqipe.”¹⁰⁹ Hartimi, botimi, përhapja dhe zbatimi i këtyre rregullave vazhdon të ndjekë një rrugë të papërfunduar.

Dialektet e shqipes përgjithësisht janë konsideruar si dialekte që janë të përafërta dhe nuk ka vështirësi të moskuptimit të folësve përkatës. F. Konica në gazetën “Albania” shkruante se: “Duke studiuar, qoftë edhe shkurtimisht, natyrën e gegërishtes e të toskërishtes, menjëherë bie në sy se ndryshimi që i ndanë nuk është më i madh se ai që shquan mënyrën e të folurit të një Normandi nga ajo e një Gaskoni. Don të thotë se në thelb ky ndryshim kufizohet në disa ngjyime shqiptimi. Por në një vend ku mungon një traditë shkollore, këto ndryshime shqiptimi më tepër janë theksuar se sa janë zbutur; dhe shqiptarët, duke mos pasur si udhëheqës drejtshkrimorë as fjalorë, as akademi, ka rrjedhë që - kur ua ka marrë mendja të lëvrojnë gjuhën e vet - nuk kanë ndjekur rregulla të tjera drejtshkrimore përveç atyre të transkriptimit të fjalëve ashtu si shqiptohen.”¹¹⁰

Sot nuk mund të flasim për mungesën e një tradite arsimore, shkencore e akademike. Megjithatë drejtpërdorimi i gjuhës është bërë edhe më e mundimshëm. Pas viteve '90 lëvizjet migratore janë rritur ndjeshëm dhe sigurisht, kjo lëvizje projektohet edhe në gjuhë. Në një anë njerëzit mësojnë fjalë të reja, përshtaten sipas vendit, punës dhe njerëzve që i rrethojnë. Por nga ana tjetër ata e kanë të vështirë të ndryshojnë mënyrën e shqiptimit të tingujve që e kanë të ngulitur që nga fëmijëria. Duke u nisur nga kjo mund të vëmë në dukje se më shumë se në rrafshet e tjera gjuhësore, në rrafshin fonetik përcaktimi dhe zbatimi i rregullave të drejtshqiptimit është shumë i vështirë.

Dihet se norma dhe statusi ontologjik i një konvencioni shoqëror, siç është gjuha, është gjysmë i ndërgjegjshëm. Ai ekziston në formën e një bashkimi rregullash që përvetësohen nga individët në mënyrë individuale dhe praktikohen në jetën e përditshme nga një grup folësish pak a shumë i madh në një mënyrë pak a shumë homogjene. Është gjysmë i ndërgjegjshëm sepse kjo normë funksionon normalisht pa u menduar në procesin e komunikimit, por statusi dhe problemet që dalin prej përdorimit të saj patjetër që janë dhe duhet të jenë objekt i një të menduari të ndërgjegjshëm të folësit, pavarësisht çastit kur e përdor. Ky pohim është aq i vërtetë për aq kohë sa në komunikim secili individ ka mënyrën e vet të nyjëtimin të tingujve, është pjesëtar i një bashkësie gjuhësore që përdor një të folme me karakteristika të caktuara fonetiko-gramatikore, e folme që bën pjesë në një grupim dialektor.

¹⁰⁹ *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, ASHSH, IGJL, 1973.

¹¹⁰ F. Konica, *Dialektet shqipe dhe nevoja e një shkrirjeje të tyre*, përkth. nga frëngjishtja, Willy Kamsi Albania, Bruxelles, Vol. A, II/1898, nr. 10, f. 173-174

Duke u nisur nga përkufizimi se: “Me fjalën drejtshqiptim ose fonetikë normative kuptojmë normat e gjuhës së folur që sigurojnë shqiptimin e njëjtë në gjuhën letrare”¹¹¹, ky përdorim i pandërgjegjshëm i nënshtrohet ndikimit të modeleve shqiptimore pak a shumë normative të mediave elektronike, të shkollës e më tej të intitucioneve. Në këtë rast individ i nënshtrohet me hir a pahir këtyre modeleve.

Shkrimi në përgjithësi u jep fund pak nga pak gjithë përafrimeve, përjashtimeve që i shfaq dhe i rishfaq gjuha e folur, është pikërisht shkrimi ai që vendos qëndrueshmërinë. Të folurit spontan i beson vetes pikërisht në çastin kur krijohet, vendoset norma e të shkruarit nga arbitrariteti i një vendimi vullnetar. Të folurit zhvillohet e ndryshon si një detyrim ndaj ligjeve të natyrës, deri në çastin kur shkrimi e kthen në një qëndrueshmëri të një zgjedhjeje të ndërgjegjshme. Njeriu i nënshtrohet ndryshueshmërisë të të folurit pa kuptuar ligjet e saj, deri sa vë në lojë qëndrueshmërinë përmes normës së drejtshkrimit. Pikërisht këtu mund të shprehemi për atë që mund ta quajmë “konflikt normativ”, i cili shfaqet kaq shpesh në fushën e të shkruarit. Këtu ka zgjedhje të ndërgjegjshme dhe vendime për t’u marrë. Në këtë çast evolucioni i pandërgjegjshëm dhe natyral nuk është ende gati. Të folurit nuk e ka të lehtë t’u nënshtrohet rregullave të shkrimit. Si rrjedhim duhen vënë në lëvizje modelet

Në këtë pikë është e rëndësishme të kuptojmë si veprojnë modelet sot?

Modeli i ofruar nga shkolla

Së pari ky model përqendrohet në mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhës si lëndë e formimit të përgjithshëm të nxënësit. Objektivi i të mësuarit të gjuhës në shkollë është: “Ta përdorë dhe ta analizojë sistemin gjuhësor të shqipes, në nivelet e veta përfaqësuese: drejtshqiptim, drejtshkrim, fjalëformim, morfosintaksë etj.”¹¹² Ndërkohë, çfarë ofron kurrikula e gjuhës në këtë drejtim; objektiva të përcaktuara për pritshmëri të paarrtshme (nëse i referohemi kurrikulës së gjuhës që zhvillohet në arsimin bazë, në klasën e gjashtë të shkollës 9-vjeçare përcaktohet si objektivi specifik “...të shqiptojë saktë fjalët dhe me theksin e duhur” dhe pritshmëria është “...të shqiptojë saktë të gjitha fjalët e gjuhës shqipe”¹¹³ - (teorikisht dhe praktikisht e përealizueshme).

Ndërkohë vërejtja e A. Klosit se “... parimi një shkronjë = një fonemë nuk na mjafton për ta shqiptuar drejt edhe vetëm shqipen standarde, atë që mësohet në shkollë dhe përdoret në shtyp, administratë etj., pale për të lexuar tekstet tona letrare, sidomos ato të traditës. Dhe është krejt e qartë që nxënësit shqiptarë do ta kishin merituar prej vitesh një “Drejtshqiptim të gjuhës shqipe”, sikundër u premtua në vitet ’70-’80 të shekullit të kaluar nga akademia jonë, por që nuk u realizua asnjëherë deri më sot.”¹¹⁴ Kjo gjen shprehjen e vet në mënyrën e përdorimit të gjuhës në të folur e në të shkruar për qëllime profesionale. Nxënësit, madje edhe studentët ruajnë në shqiptimin e tyre karakteristika fonetike të theksuara dialektore dhe kur u kërkohet të lexojnë një shkrim profesional. Ndërkohë tekstet ofrojnë ushtrime praktike vetëm në fushën e drejtshkrimit, duke anashkaluar ushtrimin praktik të drejtshqiptimit.

¹¹¹ A. Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, ASHSH, IGJL, 2004.

¹¹² M. Gjokutaj, *Didaktika e gjuhës shqipe*, shblu, Tiranë, 2009: 46

¹¹³ IZHA, *Kurrikula e gjuhës amtare* (klasa I-VIII), Tiranë, 2003, 2004, 2007, 2009

¹¹⁴ Klosi, A., *Një gjuhë pa drejtshqiptim*, në “Dukuri të shqipes bashkëkohore” (përmbledhje aktesh të takimit shkencor me prof. Tullio De Mauro : Tiranë, 5-8 tetor 2005), Çabej, Tiranë, 2006

Së dyti, modeli i mësuesit është po aq rëndësishëm. Formimi gjuhësor i tyre nuk vlen vetëm në atë se si dinë të shkruajnë, por mbi të gjitha se si dinë të flasnin në mënyrë korrekte. Janë të kuptueshme karakteristikat fonetike që janë të vështira të ndryshojnë (p.sh. hundorësia e zanoreve apo përdorimi i ë-së së hapur), por kjo nuk i jep të drejtën mësuesit të cungojë inventarin e fonemave.

Modeli mediatik

Modeli mediatik është një nga modelet më ndikuese të përdoruesit të një gjuhe. Në Shqipëri televizioni ka ndikim edhe më të madh, fëmijët shohin filma vizatimorë, kryesisht të dubluar, nxënësit e shkollave shohin spektakle, emisione që lidhen me botën, shkencën, jetën, moshat e rritura dëgjojnë në stacione televizive emisionet e lajmeve, debatet politike. Gjithë kjo sasi informacioni, zbavitjeje, tifozllëku lë gjurmë të dëgjuesit, duke u ndikuar prej modeleve televizive të preferuar.

Sigurisht ka vend për përcaktime të qarta rregullash (p.sh. që folësit e TV-së të mos ndryshojnë theksin e toponimeve duke krijuar një lloj konflikti me ata që e dinë dhe duke deformuar toponimin për ata që nuk e njohin).

Modeli administrativ

Përcaktimi i normave shqiptimore i ka bërë gjuhët, gjuhë të civilizimit në epokën moderne përmes një kodifikimi fonetik efektiv, d.m.th. nëpërmjet institucionalizimit të një norme reale – etalon, të ndjekur nga kodifikimi grafik dhe jo në të kundërt. Nga kjo pikëpamje shqipja jo vetëm është e vonuar, por ndoshta dhe një amulli e tillë mendimesh kundërtëuese për problemet e drejtshkrimit që vijnë si rrjedhim i papërcaktimit normativ–institucional të shqiptimit. Kjo do të arrihej nëse zëdhënësit e institucioneve, ata që merren me marrëdhëniet me publikun do vlerësoheshin pikërisht nga aftësitë e tyre gjuhësore, sidomos në të folur, duke pasur parasysh këto rregulla të sanksionura.

Për shqipen, si një gjuhë monocentrike, realisht mund të përcaktohej si një normë shqiptimi modeli kryeqytetas, duke marrë si modele gjuhë monocentrike të tjera (si p.sh. frëngjishtja). Por për kryeqytetin, Tiranën, ky është një mision i pamundur. Qoftë gjuha e administratës, qoftë gjuha që përdoret në shkolla është një përzierje e madhe dialektesh e nëndialektesh nga të dy anët e Shkumbinit.

Nëse do të përzgjedhnim një prej modeleve të sipërpërmendura mund të mendonim si më të përshtatshëm modelin mediatik, sepse tashmë ka TV me nivel shumë të lartë, jo vetëm në gazetarinë e mirëfilltë, por dhe në kujdesin që tregojnë në përdorimin e gjuhës. Nëse i referohemi pikërisht modelit të anglishtes ku norma shqiptimore e folësve të BBC është pranuar si varianti zyrtar i asaj që quhet *received pronunciation*.¹¹⁵, mundësia për një përhapje të shqiptimit normativ përmes kësaj mënyre është më e shpejtë. Fëmijët, më shumë se kushdo, mund të nxiten të ndjekin emisione gjuhësore që krijohen enkas për ta dhe përvojat e mira nuk mungojnë. Mund të thuhet se ato që sot përcaktohen si televizionet më të rëndësishme në Shqipëri dhe që kanë shikueshmëri të lartë mund të shërbejnë për konsolidimin e një norme-etalon të shqiptimit.

Si pasojë e kësaj gjendjeje, për më tepër në një situatë të ndezur debatesh për drejtshkrimin, 40 vjet pas Kongresit mund të themi se ka ardhur koha të vihet një sistem orientimi për shqiptimin. Sipas E. Lafes “... për fazën e sotme të shqipes standarde, timbret

¹¹⁵ Trudgill, P., W. Hannah, J., *International English*. 4th ed. London: Arnold 2002

dialektore në realizimin e fonemave (infleksionet dialektore) do të cilësohen të tolerueshme, ndërsa mungesa e fonemave të caktuara është e papranueshme.”¹¹⁶

Çdo gjë në natyrë e shoqëri vepron sipas ligjësisë, të cilat rregullojnë funksionimin e tyre. Dhe gjuha nuk bën përjashtime. Ndoshta më në fund ka ardhur koha të plotësohet detyra që u la në këtë kongres, duke marrë parasysh dhe situatën e sotme gjuhësore.

REFERENCA

- Dodi, A., *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, ASHSH, IGJL, 2004.
- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, ASHSH, IGJL, 1973.
- Gjokutaj, M., *Didaktika e gjuhës shqipe*, shblu, Tiranë, 2009: 46
- IZHA, *Kurrikula e gjuhës amtare* (klasa I-VIII), Tiranë, 2003, 2004, 2007, 2009.
- Klosi, A., *Një gjuhë pa drejtshkrim*, në “Dukuri të shqipes bashkëkohore” (përmbledhje aktesh të takimit shkencor me prof. Tullio De Mauro : Tiranë, 5-8 tetor 2005), Çabej, Tiranë, 2006
- Konica, F., *Dialektet shqipe dhe nevoja e një shkrirjeje të tyre*, përkth. nga frëngjishtja, Willy Kamsi Albania, Bruxelles, Vol. A, II/1898, nr. 10, f. 173-174 (Revista Phoenix - Bashkimi Katolik i Publicistëve Shqiptarë).
- Lafe, E., *Shqipja standarde në vështrim strukturor dhe funksional*, Konf. shkencore “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, Shkenca, Tiranë, 2003.
- Trudgill, P. W Hannah, J., *International English*. 4th ed. London: Arnold 2002

¹¹⁶ Lafe, E., *Shqipja standarde në vështrim strukturor dhe funksional*, Konf. shkencore “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, Shkenca, Tiranë, 2003.

MBI DISA NGECJE TË SHQIPES STANDARDE NË ADMINISTRA-TËN PUBLIKE DHE SHKRESAT ZYRTARE NË KOSOVË

Kujdesi për ruajtjen, zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës standarde shqipe është edhe kujdesi ndaj vetvetes, ndaj kulturës sonë kombëtare e shtetërore.

Vetëm përmes arritjes së standardizimit të shqipes 40 vjet më parë, shqiptarët arritën të bëhen vërtet një popull i emancipuar dhe vetëm 36 vjet pas kësaj ngjarjeje, Kosova bëri histori, u bë shtet i pavarur dhe i njohur ndërkombëtarisht. Kjo tregon fuqinë e madhe vepruese dhe të mirat që solli vendosja e standardit gjuhësor të shqipes më 1972 në Tiranë. Krahës bërjes shtet, Kosova ka nevojë për funksionalizim dhe modernizim të shumë shërbimeve, natyrisht ndër kryesoret është administrata shtetërore, e cila as që mund të mendohet pa faktorin gjuhë. Këtë më shumë se një herë e ka theksuar edhe gjuhëtari Emil Lafa kur thotë: “Gjuha e njësuar për veprimtarinë e administratës, është një ndër kërkesat e para për një shtet”.¹¹⁷

Me të drejtë shekulli XX, por edhe shekulli XXI, mund të konsiderohen shekujt e shqiptarëve. Këtë e pohon edhe studiuesja Shefkije Islamaj kur thotë: “...shqiptarët në shekullin XX zgjidhën përfundimisht dy çështje me rëndësi jo vetëm gjuhësore, po edhe kulturore e historike: njësimin e alfabetit dhe njësimin e gjuhës”.¹¹⁸ Natyrisht këto arritje nuk kaluan nëpër rrugë të lehta e këto vështirësi më së miri na i kujton dijetari i madh Faik Konica kur thotë: “Kur zumë luftën për përparimin e gjuhës shqip, një hije mbuloj turinjt e armiqve shqiptar. E, në turbullime në frikë e sipër, që të gënjejnë vetveten, zunë e po qeshjin në mes tyre; thoshin Albania do të mbetet në mes t’ udhës, si gjithë punët kombiare të Shqipërisë...”¹¹⁹

Megjithatë, shqipja standarde në kohët tona ka shënuar arritje të mëdha ndonëse në administratën publike dhe në shkresat zyrtare në Kosovë, problemet vazhdojnë të jenë të theksuara. Këto probleme nuk janë të thjeshta, të paktën jo ashtu siç mund të duken në shikim të parë, përkundrazi, problemet janë shumë serioze dhe kërkojnë zgjidhje të menjëhershme. Në Kosovë sot kemi kryqëzime kulturash, që po lënë ndikimin e tyre edhe në gjuhë. Si rrjedhim i kësaj kemi një vërshim të paparë huazimesh, sidomos anglicizmash, por edhe fjalësh prej gjuhëve të huaja.¹²⁰

Përdorimi i barbarizmave të ndryshëm në vend të fjalëve shqipe, paraqet diçka të pakuptueshme dhe e cila s’duhet lejuar. Këto lloje barbarizmash hasen në jetën e përditshme tek ata nga të cilët pritet më së paku. E këta janë udhëheqësit më të lartë shtetërorë, pra parlamenti, qeveria, administrata publike, etj. Moskujdesin e duhur ndaj shqipes standarde në Kosovë asgjë nuk do ta paraqiste më mirë sikur këto dy thënie të njerëzve me zë të Kombit Shqiptar, rilindësit Naim Frashëri dhe disidentit Nonda Bulka.

¹¹⁷ Emil Lafa, *Nga liberalizmi gjuhësor te shqipja standarde* (vështrim i shkurtër), Botuar te “Gazeta shqiptare (Milosao)”, 05.12.2010.

¹¹⁸ Shefkije Islamaj, *Gjuha, ligjërimi dhe fjala*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2004, fq.23.

¹¹⁹ Faik Konica, *Mendime gjuhësore* (Mblodhi, transkriptoi, pajisi me shënime dhe me hyrje studimore, Kristina Jorgaqi), Ombra GVG, 2007.

¹²⁰ Xheladin Zymberaj, *Kumtesa nga konferenca vjetore kombëtare e shkencës*, “Java e Shkencës”, Prishtinë, korrik 2011, fq.207.

Rilindësi ynë i madh Naim Frashëri, thotë: “Fjala e huaj në gjuhë është si dhia ndër dhen”¹²¹, aktuale kjo edhe sot kur kemi të bëjmë me përdorimin e standardit gjuhësor shqip në Kosovë. Dhe i dyti, poeti i mirënjohur Nonda Bulka për të shprehur mospajtimin e tij ndaj të gjithë atyre që nëpërkëmbin shqipen e pastër, thotë: “Zot! Jepu shqiptarëve vullnet dhe logjikë që të flasin shqip të paktën kur janë në Shqipëri. Se, siç kanë zënë disa, shpejt a vonë do ta bëjnë atdheun Babiloni gjuhësh, ku s’do ta marrë vesh qeni të zonë”.¹²² Çështjen e huazimeve, dhe jo vetëm të tyre, por edhe përdorimin e gabuar të fjalëve shqipe e të formave të ndryshme gjuhësore, studiuesi Qemal Murati, e shpreh në këtë mënyrë: “Me fjalët e me shprehjet e përdorura gabim vlojnë... gjuha e administratës dhe e veprimtarive të tjera shoqërore e publike, saqë me një lëndë të tillë mund të hartohet dhe një “Fjalor i gabimeve gjuhësore.”¹²³ Nga ana tjetër, procesi apo proceset (po i quajmë në shumës), për vlerësimin e normës së shqipes standarde në Kosovë, pasurimin dhe zhvillimin e saj, nga disa të ashtuquajtur gjuhëtarë, shpjen në atë drejtim që çështja e huazimeve në shqipe duhet të jetë pjesë e liberalizimit gjuhësor, e që ky lloj “liberalizimi gjuhësor”, për ne nënkupton në masë të madhe heqjen e kriterit përzgjedhës për të kuptuar se cila është fjalë shqipe dhe cila jo.

Duhet të dihet fakti se çështja e liberalizimit gjuhësor është problem në vete, për njohjen e të cilit kërkohen analiza të thella nga njerëz përgjegjës të fushës, dhe jo të veprohet mbi baza të improvizimeve dhe nga njerëz jokompetentë. Gjuha shqipe duhet zhvilluar lirshëm dhe jo në bazë të tekeve të njërit apo tjetrit prej nesh. Shqipja bashkëkohore duhet të tregojë prirjet dhe aftësitë e saja dhënëse, por edhe të pranojë në gjirin e saj fjalë të reja të cilat lindin si pasojë e zhvillimeve dhe zbulimeve të shumta në fusha të ndryshme, por vetëm kur kjo është e nevojshme, e domosdoshme dhe e pakalueshme. Kjo nënkupton se gjuha nuk është statike. Ajo ndryshon dhe pëson zhvillime, të cilat sipas studiuesit Valter Memisha, në shikim të parë duken sikur janë me kahe të kundërta e që ai i quan demokratizim dhe intelektualizim¹²⁴ i gjuhës. Siç dihet zhvillimet gjuhësore janë dy llojesh: *zhvillimet nga burimet e brendshme dhe zhvillimet nga kontaktet me modele tjera gjuhësore*.

Sipas gjuhëtarit Seit Mansaku “zhvillimet nga burimet e brendshme shkojnë në të mirë të asaj që është quajtur prirje demokratizuese e gjuhës, që e mban atë afër gjuhës së popullit, ndërsa zhvillimet nga kontaktet me modele tjera gjuhësore forcojnë kahjen drejt modernizimit të saj, që ka të bëjë me mënyra më abstrakte të të shprehurit, me forma më të stërholluara të paraqitjes së mendimit, me specializimin e strukturave të veçanta për fusha të veçanta, pra me intelektualizmin e saj”.¹²⁵

Së këndejmi, kujdesi për pasurimin e gjuhës dhe pastrimin e saj nga huazimet e panevojshme ka mbetur i pandryshuar që nga Rilindja e deri në ditët tona”¹²⁶ edhe pse

¹²¹ Naim Frashëri, *Iliadhë e Omiritë*, Bukuresht, 1896. fq.13 (sipas: Historia e letërsisë shqipe, II, Tiranë,1960, fq.355.

¹²² <http://www.shekulli.com.al/2009/06/25/abetare.jpg>.

¹²³ Qemal Murati, *Gjuha e medie* (Fjalor i gabimeve gjuhësore), Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2008, fq.9.

¹²⁴ Valter Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike-Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2011, fq.115.

¹²⁵ Seit Mansaku, *Zhvillime të strukturës sintaksore të shqipes dhe norma*, në Konferenca shkencore “Shqipja Standarde dhe shoqëria sot”, Tiranë,2003,fq.117.

¹²⁶ Xheladin Zymberaj, *Kumtesa nga konferenca vjetore kombëtare e shkencës*, “Java e Shkencës”2011, Prishtinë, korrik 2011, fq.208.

shqipja vazhdimisht është përballur me vërshime fjalësh të huaja në rrethana historike-gjuhësore të caktuara.¹²⁷

Mirëpo rrethanat politike dhe ekonomike në Kosovë në këto 12 vjetët e fundit kanë bërë që vërtetë shumë fjalë të huaja të futen në shqipe, ashtu siç ka thënë Naimi ynë i madh “si dhia ndër dhentë”.

Duhet veçuar këtu periudhën kohore që nga viti 1999 kur ndodhi instalimi i Administratës së Përkohshme Ndërkombëtare në Kosovë (UNMIK-ut), me këtë rast, në komunikimin e përditshëm të të shprehurit dhe të të shkruarit profesional administrativ-juridik dhe politik, në gjuhën standarde shqipe, shpesh vërehet një regjistër i zakonshëm, i thjeshtë i fjalëve dhe kuptimeve të përdorura.

Nëse i analizojmë me vëmendje disa prej llojeve të këtyre komunikimeve, qoftë në shkresat e nivelit të lartë shtetëror, qoftë në ato të niveleve më të ulëta, do të vërejmë se ato i karakterizojnë shumë shkelje të normës gjuhësore; ka mjaft fjalë dhe struktura të huazuara sintaksore; zhvendosje të shprehura të rendit të fjalëve dhe fjalive; në kuptimin e tyre ndjehet qartë mungesa e një frymëzimi të përsiatur profesional; nocionet dhe frazat që e ndërtojnë tërësinë e këtyre akteve, shkresave dhe dokumenteve tjera zyrtare, nuk rrezatojnë fare ndjenjën e burimit të tyre të vërtetë nga një mendje krijuese ekspertësh të profilit të caktuar që mendojnë dhe flasin shqip, por thjesht, na shpalosen si përkthime të zbehta të bëra nga ndonjë gjuhë tjetër dhe nga ndonjë përkthyes joprofesional.

Në këtë kontekst, lirshëm mund të konstatojmë se deri më sot nuk ka asnjë ligj apo ndonjë akt tjetër normativ-juridik, të aprovuar në kohën e UNMIK-ut dhe tashti të EULEX-it, që nga aspekti gramatikor, terminologjik apo sintaksor, nuk është “masakruar” apo devijuar nga ana e përkthyesve joprofesionistë që punojnë në këto institucione ndërkombëtare. Nëse i analizojmë me vëmendje disa shkrime të publikuara në formën e dokumenteve dhe akteve tjera të përgjithshme të nivelit të lartë shtetëror (e mos të flasim për ato të niveleve më të ulëta komunale dhe të shoqatave tjera joqeveritare etj), do të bindemi se në institucionet tona qeverisëse-publike, nga shumë zyrtarë profesionistë nuk po kuptohet si duhet se ç’është rregullorja, vendimi, statuti, statusi, programi, raporti, udhëzimi, preferenca, plani.

Është tejet qesharake, kur shpeshherë gjatë paraqitjeve dhe debateve publike të disa politikanëve tanë të lartë, ndoshta nga mosdija apo si “lapsus”, ngatërrohet domethënia kuptimore e termave “*statut*” me “*status*”, “*kontekst*” me “*kontest*”, etj. Këto janë vetëm disa shmangie nga norma e shqipes standarde, por më e keqja është se, shpeshherë, zyrtarët tanë në zhargonin e tyre e bëjnë lëmsh dialektin me letraren, e kjo prodhon një mënyrë të foluri që tregon për mungesën e madhe jo vetëm të respektit ndaj vetes, por edhe ndaj atyre që i dëgjojnë¹²⁸.

Siç duket, mbase nga shumica e të punësuarve sot në administratën publike dhe shtetërore, nuk dihet se me çfarë dokumenti si akt formal, raportohet, planifikohet, përcaktohet, vendoset apo rregullohet. Edhe sikur të dihet, posa ta lexosh me vëmendje përmbajtjen e ndonjërit prej tyre, menjëherë aty do të vëshesh përplot gabime, jo vetëm estetike dhe gjuhësore, por edhe të mungesës konstruktive përmbajtjesore të paraqitjes

¹²⁷ Po aty, fq.207.

¹²⁸ Qemal Murati, *Gjuha dhe snobizmi gjuhësor: Struktura të huazuara dhe një “Shqipe trendy”*, në “Gjuha shqipe” 3/2011, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2011, fq.35.

kuptimore të lëndës, e cila nuk është aspak në harmoni me standardet e përgjithshme profesionale të parapara për atë dokument apo akt konkret.¹²⁹

Një dukuri edhe më shkatërruese e shëmtimit të rregullave të përgjithshme të gjuhës standarde shqipe e kemi në gjyqësor dhe institucionet e tjera të drejtësisë. Për procesverbale, që zakonisht diktohen dhe shkruhen gjatë seancave të rregullta gjyqësore dhe përfshihen në lëndët e shumta, as të mos flasim fare, por, mjafton që të lexojmë me vëmendje një AKTVENDIM apo AKTGJYKIM të pranuar gjyqësor, sa gabime estetike, ortografike, kuptimore, gramatikore dhe sintaksore do të vërejmë aty?!

Ja një listë e disa fjalëve jo shqipe të cilat i kemi hasur tek disa shkresa zyrtare shtetërore, e madje edhe tek profesorë universitarë e media të shkruara dhe elektronike, pra fjalë të cilat nuk ekzistojnë në fjalorin e gjuhës shqipe.

Barbarizmi (fjala e huazuar)	Fjala në shqip
Barrierë-----	Pengesë
Diskurs-----	Fjalim, ligjëratë
Ekspanzion-----	Zgjerim
Eksperiencë -----	Përvojë
Fleksibilitet-----	Lakueshmëri
Fundamental-----	Kryesorë, themelorë
Hendikep-----	Pengesë, e metë
Imediat-----	I menjëhershëm
Interaktiv -----	Bashkëveprues
Invadim-----	Pushtim
Invasion-----	Pushtim
Investigim-----	Hulumtim, hetim
Involvim-----	Përfshirje
Koincidence -----	Rastësi
Konfident -----	I sigurt, me besim në vete
Kontinuitet -----	Vazhdimësi
Koshiençë-----	Vetëdije, ndërgjegje
Kreativ -----	Krijues
Kualitet -----	Cilësi
Kuantitet -----	Sasi
Luku-----	Pamja, dukja
Narracion-----	Kallëzim, tregim, rrëfim
Perfekt -----	I përkryer, përsosur
Selektim-----	Përzgjedhje
Stopim-----	Ndalje
Verdikt-----	Vendim
Vokabularë-----	Fjalorë
Supportim-----	Ndihmesë, përkrahje, etj.

¹²⁹ Adnan Abrashi, *Shpirti i një populli është gjuha që e flet*, (Gjuha shqipe është e bukur edhe si gjuhë zyrtare administrative-shtetërore), Prizren, 05. 12. 2009.

”Shpirti i një populli është gjuha që e flet” (kuptohet edhe e shkruan mirë), ka thënë Sterjo Spasse ynë i madh, prandaj, këtë artikull do ta përfundoja me një këshillë dhe porosi drejtuar të gjithë “ekspertëve” të profileve të ndryshme që punojnë në administratën publike, në organet qeveritare, gjyqtarëve dhe punonjësve tjerë të administratës gjyqësore, deputetëve dhe politikanëve... se shqipja është e bukur edhe si gjuhë shtetërore dhe ajo ka rregullat e veta të ndërtimit dhe të përdorimit të saj në praktikë.

Mendoj se është koha dhe momenti i duhur që të tregojmë pjekuri dhe maturi të shtuar ndaj përdorimit të gjuhës standarde shqipe si elementi më i rëndësishëm i një kombi, si një element që tregon kulturë, traditë dhe identitet. Tek e fundit një komb nuk shuhet nëse humb një luftë. Një komb humb dhe shuhet nëse humb gjuhën. Këtë mund ta vërtetojë edhe thënia e ideologut tonë kombëtar Sami Frashërit, kur thotë: “Viktimat e gjuhës janë më të shumta se ato të shpatës”

Literatura

1. Adnan Abrashi, *Shpirti i një populli është gjuha që e flet*, (Gjuha shqipe është e bukur edhe si gjuhë zyrtare administrative-shtetërore), Prizren, 05. 12. 2009.
2. Emil Lafe, *Nga liberalizmi gjuhësor te shqipja standarde* (vështim i shkurtër), Botuar te “Gazeta shqiptare (Milosao)”, 05.12.2010
3. Faik Konica, *Mendime gjuhësore* (Mblodhi, transkriptoi, pajisi me shënime dhe me hyrje studimore, Kristina Jorgaqi), Ombra GVG, 2007.
4. <http://www.shekulli.com.al/2009/06/25/abetare.jpg>
5. Naim Frashëri, *Iliadhë e Omiritë*, Bukuresht, 1896. (sipas: Historia e letërsisë shqipe, II, Tiranë, 1960.
6. Qemal Murati, *Gjuha dhe snobizmi gjuhësor: Struktura të huazuara dhe një “Shqipe trendy”*, në “Gjuha shqipe” 3/2011, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2011.
7. Qemal Murati, *Gjuha e medieeve* (Fjalor i gabimeve gjuhësore), Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2008
8. Seit Mansaku, *Zhvillime të strukturës sintaksore të shqipes dhe norma*, në “Konferenca shkencore “Shqipja Standarde dhe shoqëria sot”, Tiranë, 2003.
9. Shefkije Islamaj, *Gjuha, ligjërimi dhe fjala*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2004
10. Valter Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Qendra e studimeve Albanologjike- Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë, Tiranë, 2011.
11. Xheladin Zymberaj, *Kumtesa nga konferenca vjetore kombëtare e shkencës*, “Java e Shkencës” 2011, Prishtinë, korrik 2011

DREJTSHKRIMORI I SHQIPES - PËRMIRËSIMI DHE PLOTËSIMI I TIJ

1. Ç'është programi për drejtshkrimin e një gjuhe?

Programi për drejtshkrimin e një gjuhe (ang. *spell checker*) është një program softuerik ose tipar i një programi i dizajnuar për të gjetur fjalët e shkruara gabim, për të sinjalizuar përdoruesin për këto fjalë dhe për të ofruar formën e saktë të fjalës. Për herë të parë ky program u përdor në kompjuterat personale në vitin 1980. Fillimisht ai mund të quhej më shumë verifikues sesa korrektues, sepse nuk jepte sugjerime për fjalët e shkruara gabim, por vetëm i sinjalizonte këto fjalë. Me kalimin e viteve, ky sistem u zëvendësua nga programe që gjeneronin një listë me fjalët e mundshme nga të cilat përdoruesi mund të zgjidhte të duhurën për të zëvendësuar fjalën e shkruar gabim.

Këto programe funksionojnë në bazë të një grupi rregullash për skanimin e tekstit dhe për nxjerrjen e fjalëve, si dhe të një algoritmi që krahason fjalët e nxjerra me listën e fjalëve të shkruara si duhet, pra me bazën e të dhënave, e cila mbështetet në drejtshkrimin e gjuhës standarde përkatëse.

Duhet vënë në dukje se programi për drejtshkrim nuk mund të zëvendësojë plotësisht 'dorën' njerëzore, por e ndihmon shumë përdoruesin për t'i kapur e korrigjuar gabimet drejtshkrimore.

2. Dy fjalë për drejtshkrimorin e gjuhës shqipe AS 2.0

Programi për drejtshkrimin e gjuhës shqipe AS 2.0 është një paketë profesionale softuerike, e dizajnuar në veçanti për gjuhën shqipe, e njëjtë me programet e gjuhëve të tjera në kuadër të *Microsoft Office*-it dhe në pajtim me programin operativ *Microsoft Windows*. Baza e tij e të dhënave është ngritur mbi normën e përcaktuar në Kongresin e Drejtshkrimit (1972) dhe të botuar në *Drejtshkrimin e gjuhës shqipe* (1973). Ky program jo vetëm nënvizon me të kuqe fjalët e shkruara gabim dhe bën korrigjimin automatik për shumë fjalë e trajta fjalësh, por ofron dhe mundësinë që përdoruesi të krijojë në kompjuterin e tij një fjalor të përshtatur me fjalët që nuk janë në program, por që ai i përdor shpesh (të cilat mund të jenë terma të fushave të veçanta, emra njerëzish ose vendesh, si dhe shkurtime të ndryshme etj.).

Me programin kompjuterik për drejtshkrim AS 2.0, që është në cilësi të njëjtë teknike dhe gjuhësore me programet e 50 gjuhëve të tjera në botë që e ofrojnë këtë program, gjuha shqipe ka hyrë në familjen e gjuhëve të kompjuterizuara, e gatshme për softuerë të tjerë gjuhësorë më të përparuar. Ashtu si dhe për gjuhë të tjera, tashmë është koha kur nuk vihet më në dyshim domosdoshmëria e këtij programi gjithkund ku shkruhet shqip: në shtypin e përditshëm, në tekstet shkollore e universitare, në botimet e ndryshme zyrtare e jozyrtare, në median elektronike dhe në faqet e ndryshme shqip që 'qarkullojnë' në internet.

3. Çfarë përmban programi?

Programi përmban një fjalës prej mbi 150 000 fjalësh, të cilat, në varësi të kategorisë së cilës i përkasin, arrijnë në mbi 2 300 000 trajta të papërsëritshme fjalësh.

Krahas trajtave dhe formave që dalin gjatë lakimit të emrave, mbiemrave, përemrave, numërorëve dhe zgjedhimit të foljeve, si dhe të pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës (ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat, pjesëzat e pasthirrmat), në program janë përfshirë dhe:

- Dhjetëra mijëra trajta me *ç'* të emrave dhe të mbiemrave në rasën emërore njëjës e shumës të pashquar, p.sh. *ç' detyra, ç' ditë, ç' fjalë, ç' muzikë* etj.

- Dhjetëra mijëra forma me *ç'* të foljeve në kohën e tashme, të pakryer e të kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore, p.sh. *ç' bëre, ç' flitet, ç' thua* etj. dhe në kohën e tashme e të pakryer të mënyrës habitore, p.sh. *ç' kërkuakam, ç' lexuakeni* etj.

- Qindra mijëra forma foljore me pjesëzën mohuese *s' në* të tashmen, të pakryerën dhe të kryerën e thjeshtë të mënyrës dëftore, p.sh. *s' kërkoj, s' flihet, s' merrej, s' arritën* etj. dhe në të tashmen e të pakryerën e mënyrës habitore, p.sh. *s' dëgjuakeni, s' kërkuakam, s' punuakështa, s' qëndruakan, s' vënkemi* etj.

- Qindra mijëra numërorë me trajtat që marrin kur lakohen si numërorë themelorë dhe rreshtorë në të dyja gjinitë, p.sh: *dy, të dy, të dyve, të dyja, të dyjave, i dytë, i dyti, e dyta, të dytët, të dytat* etj.

- Janë plotësuar gjithashtu ndërtimet e tipit: *dykatësh, pesëminutësh, njëzetekatërorësh, dhjetëditor, pesëshekullor, dydhomësh, dygjuhësh, njëmijëmetërsh, katërmuajsh, pesëshifror, tridhjetedybitësh, nëntëjavësh, dhjetinçësh, njëfletësh, dhjetëfish, nëntëfaqësh, pesëkëndësh, shtatërrokësh* etj.

4. Çfarë ofron programi?

Drejtshkrimori i shqipes, ashtu si në përgjithësi programe të tilla, bazohet në drejtshkrimin e standardizuar dhe operon me krahasimin e çdo fjale hyrëse me një bazë të dhënash. Nëse fjala nuk gjendet në këtë bazë të dhënash, ajo nuk është e shkruar mirë dhe nëpërmjet algoritmeve gjendet fjala që mendohet se dëshironte të shkruante përdoruesi.

Programet “Spellchecker” ofrojnë dy mënyra veprimi, nga të cilat është vetë përdoruesi ai që zgjedh: ose teksti kontrollohet i tëri njëkohësisht ose gjatë futjes graduale të tekstit, përdoruesi sinjalizohet (duke i nënvizuar me ngjyrë të kuqe) për fjalët e shkruara gabim.

Gabimet që mund të kapë ky program janë fjalë të shkruara gabim ose për shkak të njohurive jo të mira gjuhësore (*qëndër* për *qendër, coptoj* për *copëtoj, flutra* për *flutura, krymb* për *krimb, diplloma* për *diploma* etj.), ose për shkak të shpejtësisë së shkrimit (*vazdhojmë* për *vazhdojmë, dërrada* për *dërrasa, është* për *është, fleetë* për *fletë* etj.). Krahas sugjerimeve të ndryshme për një fjalë të shkruar jo mirë, programi bën mbi 5 milionë korrigjime automatike për gabime të llojeve të ndryshme, p.sh.:

- për përdorimin e gabuar të zanores ‘e’ të theksuar para hundoreve ‘m, n, nj’: *shëmbull* > *shembull, shënjtor* > *shenjtör*;

- për përdorimin e gabuar të zanores ‘ë’ të theksuar ose të patheksuar në pozicion para dhe pastheksor: *parathanie* > *parathënie, budallallik* > *budallallëk, coptoj* > *copëtoj, zvogloj* > *zvogëloj*;

- për mospërdorimin e zanores ‘u’ në emrat dhe mbiemrat që mbarojnë më -ull, -ur: *kumblla* > *kumbulla, barklepri* > *barklepuri*;

- për përdorimin e gabuar të zanoreve ‘u’ dhe ‘y’ në vend të njëra-tjetrës: *sfyngjer* > *sfungjer, virtut* > *virtyt*;

- për përdorimin e gabuar të zanores ‘y’ në vend të zanores ‘i’: *krymb* > *krimb, hydrogjen* > *hidrogjen*;

- për përdorimin e gabuar të grupeve të zanoreve ‘ie’ e ‘ue’: *qjellzor* > *qiellzor, adhursi* > *adhuruesi*;

- për përdorimin e gabuar të bashkëtingëlloreve: *mblihte* > *mblihte*, *batanie* > *batanije*, *agjensia* > *agjencia*, *diploma* > *diploma*;
- për trajtat e mbiemrave më -*shëm*: *(të) punueshëmve* > *(të) punueshmëve*, *(të) këndshëmve* > *(të) këndshmëve*;
- për trajtat e mbiemrave më -*ër* dhe -*ël*: *(të) pastërin* > *(të) pastrin*, *(të) ëmbëlin* > *(të) ëmblin*.

5. Përditësimi i drejtshkrimorit të shqipes

Megjithatë nuk mund të thuhet se puna me këtë softuer konsiderohet e përfunduar, ai është një softuer në zhvillim për sa kohë që ka në qendër gjuhën, e cila është gjithmonë në ndryshim, prandaj dhe rregullisht punohet për përmirësimin dhe përditësimin e këtij softueri, punë që mund të përmblihet në disa pika kryesore. I rëndësishëm dhe për rritjen e cilësisë së këtij programi është korrigjimi i gabimeve të hasura gjatë përdorimit disavjeçar të softuerit, të cilat mund të jenë ose gabime shpejtësie të bëra gjatë fazës së hedhjes së bazës së të dhënave, siç është rasti i emrit *fodullëk*, i cili në disa trajta del *fudullëk*, ose fjalë për të cilat janë dhënë dy variante shkrimi, si *smalt*, por edhe **zmalt*.

Në fjalësin e programit ka dhe shumë fjalë që i përkasin leksikut pasiv. Në një të ardhme, këto fjalë, sigurisht pas diskutimeve me specialistët përkatës, edhe mund të largohen, duke u lënë vendin kështu fjalëve të reja, ose mund të mbeten në bazën e të dhënave, por nuk do të ofrohen si sugjerime për fjalët e shkruara gabim.

Hap tjetër i rëndësishëm për programe të këtij lloji është pasurimi i bazës së të dhënave, proces ky që mund të realizohet me disa mënyra:

- Me anë të shtimit të fjalësit, duke pasur parasysh se që prej vitit 2005, kur është realizuar ky program, gjuha ka ndryshuar dhe është pasuruar, kanë hyrë fjalë të reja, janë krijuar terma të rinj, të cilët duhen përfshirë në program së bashku me format përkatëse. Për këtë mund të shfrytëzohen fjalorët shpjegues të shqipes të hartuar pas këtij viti, fjalorët dygjuhësh, si dhe fjalorët e ndryshëm terminologjikë, pa lënë mënjanë dhe fjalët e dërguara nga përdoruesit e programit, të cilat, pas përzgjedhjes së kujdesshme nga gjuhëtarët, mund të përfshihen në program. Të tilla fjalë mund të jenë: *alfabetizim*, *disapërmator*, *elektroshtëpiake*, *jodashamirës/e*, *joprofesional*, *qiellzorizoj* etj.

- Një mënyrë tjetër për pasurimin e këtij programi është dhe plotësimi i çerdhes së fjalëve të ndryshme ose plotësimi me forma të tjera gramatikore i disa njësive të veçanta, si shumësi i disa emrave, formave joveprore e disa foljeve, plotësimi me format vetore të vetës së parë e të dytë të disa foljeve, si p.sh. folja njëvetore *mbin*, e cila për shkak të zgjerimit kuptimor, e sidomos kuptimeve të saj të figurshme, përdoret gjerësisht në të tria vetat etj.

6. Pasurimi i drejtshkrimorit të shqipes me përbërës shtesë

Ashtu si dhe për gjuhët e tjera të përparuara në këtë drejtim puna nuk është kufizuar vetëm me saktësinë drejtshkrimore të fjalëve të shqipes, por ndërkohë është punuar dhe për disa aspekte të tjera plotësuese të këtij softueri, të cilat janë realizuar me sukses ose janë në proces. Të tilla janë:

- Aspekti sintaksor, i cili verifikon një tekst të shkruar vë në dukje pasaktësitë e zakonshme sintaksore të tij. Për këtë shfrytëzohet korpusi i fjalëve të gjuhës përkatëse jo thjesht si fjalës, por me të gjitha veçoritë morfosintaksore. Korrigjuesi sintaksor ndihmon në

shkrimin si duhet të gjuhëve në të cilat është realizuar: sugjeron korrigjimet e duhura për shumë gabime sintaksore, për gabime në pikësim, si dhe mund të ndikojë edhe në aspektin stilistikor të një teksti, si p.sh. mund të sinjalizojë e të sugjerojë për fjalitë shumë të gjata, për fjalitë mungesore, për fjalë e shprehje joformale që nuk tingëllojnë mirë në ligjërimin e shkruar, për zhargone etj. Programi krijohet sipas një baze të dhënash me rregulla gramatikore të fundme, prandaj është gjithmonë përdoruesi ai që bën zgjedhjen nga sugjerimet e ofruara.

- Aspekti sinonimik, i cili do të ndikonte në stilin e shkrimit të një teksti, duke i krijuar mundësinë përdoruesit të zgjedhë ndërmjet disa fjalëve për të shprehur po atë mendim, përmbajtje a kuptim.

- Tastiera e shqipes, ofron lehtësisht përdorimin e shenjave diakritike /ë/ dhe /ç/, duke shmangur kështu zgjidhje të ndryshme që përdoruesit kanë bërë në vend të tyre. Zgjidhja e këtij problemi përmes softuerit është menduar si më e përshtatshme, që rrit në këtë mënyrë cilësinë e shkrimit të shqipes, duke shmangur një sërë gabimesh që vijnë nga mospërdorimi i ë-së dhe ç-së, si dhe duke nxitur njësimin e shkrimit të shqipes bazuar në këtë radhitje të shkronjave.

-Programi për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit, ka të bëjë me copëzimin automatik të një fjale në fund të rreshtit në rrokjen më të afërt dhe vendosjen e një vize, që tregon se kemi të bëjmë me një pjesë fjale dhe jo me një fjalë të plotë. Sigurisht në realizimin e këtij softueri, përveç fjalësit të shqipes me format përkatëse, janë shfrytëzuar dhe rregullat për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit për gjuhën shqipe. Përdorimi i këtij programi, përveç rritjes së anës estetike të paraqitjes së teksteve, do të shmangte gabimet në ndarjen manuale të fjalëve, që do t'i shërbente rritjes së cilësisë së shkrimit të gjuhës.

Kjo bashkësi veglash gjuhësore e ofruar nga Qendra për Edukim dhe Përparim do ta lehtësonte shumë punën e shqipshkruesit, do të rriste nivelin gjuhësor të teksteve në gjuhën shqipe, si dhe do të ndihmonte në përvetësimin tërthorazi të shumë njohurive gjuhësore nga përdoruesit e zakonshëm.

**NDËRHYRJET NË STANDARD - PLOTËSIME TË VOGLA, JO
NDRYSHIME**

Tashmë u dëshmuar të suksesshme dyzet vjet të funksionimit dhe të zbatimit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe, qysh kur u sanksionua me Rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972. Kjo ngjarje ka rëndësi se vuri në përdorim një gjuhë letrare të përpunuar e të kristalizuar në një variant mbarëkombëtar. Në historinë e kombit tonë, Kongresi i Drejtshkrimit ka hapur një kapitull të veçantë me drejtshkrimin e njësuar në vend të varianteve dialektore të drejtshkrimit të deriatëhershëm. I gjithë ky sukses dihet që nuk është arritur lehtë e shpejt, por shkallë –shkallë e me përpjekje vetëmohuese të të gjitha brezave të intelektualëve e atdhetarëve të shquar të kombit tonë.

Nismat e para të përpjekjeve për të hequr dorë nga krahinorizmat e gjuhës shqipe e për të shkruar në një formë mbidialektore i gjejmë qysh te shkrimtarët e parë të vjetër shqiptarë, të cilat u vazhduan e morën trajtë edhe më të qartë në periudhën e ndritshme të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, veprimtarët e së cilës nuk kursyen asgjë nga mundi i tyre që gjuha shqipe të ruhet, të pasurohet me fjalë të reja dhe të pastrohet nga fjalët e huaja të panevojshme.

E gjithë ajo veprimtari dhe e pakursyer e figurave më të shquara të kombit tonë u kurorëzua në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, dyzetvjetorin e të cilit po e shënojmë në këtë ngjarje të rrallë shkencore.

Me këtë u mënjantuan dhe dyshimet më të vogla dhe mosbesimet e gjithë atyre që trumbetonin se gjoja gjuha shqipe s’është e mundur të standardizohet e të njësohet për shkak të dallimeve dialektore e nëndialektore që i ka. Hamendjet dhe mëdyshjet u hoqën kur u vu re se ishin standardizuar dhe gjuhë të tjera me dallime shumë më të mëdha dialektore të gjuhës sonë. Njësimi i gjuhës dhe i shkrimit të shqipes përbën jo vetëm vlerë shoqërore, por përbën edhe vlerë kombëtare, sepse është elementi më bashkues.

Ky vit jubilar i Kongresit të Drejtshkrimit, duke përkuar edhe me 100-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë, merr vlerë edhe më të madhe. Këto dy ngjarje historike e kombëtare, së bashku dhe me Kongresin e Alfabetit të Shqipes, përbëjnë tri vlerat kulmore të popullit tonë që u realizuan gjatë qindvjeçarit të kaluar, po përsëris, me punën e palodhshme dhe me mundin e pakursyer të disa brezave atdhetarësh dhe të elitës së intelektualëve shqiptarë.

Këto vendime madhore përbëjnë historinë dhe kulturën tonë më të lavdishme kombëtare të qindvjeçarit të kaluar, kështu që për nder të kujtimit të tyre gjatë gjithë këtij viti në mbarë trojet shqiptare po zhvillohen aktivitete festive, dhe i tillë është edhe ky sesion shkencor që po e mbajmë me rastin e dyzetvjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit.

Me gjithë vlerësimet e drejta, të arsyeshme e të qëndrueshme që u janë dhënë vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimit, si atëherë, si më vonë, pothuajse nga të gjithë pjesëmarrësit në tubimet jubilarë të 10-vjetorit, të 20-vjetorit e të manifestimeve të tjera të ngjashme, të organizuara në Tiranë, Prishtinë, Shkup dhe në qendrat e tjera shqiptare, në kahun tjetër shpërfaqen për fat të keq edhe individë e grupe të vogla që nuk i gëzohen as shënimit të asaj ngjarjeje kulturore e as vetë Kongresit të Drejtshkrimit.

Them pa asnjë dyshim se strumbullari i këtyre dashakeqëve (me përjashtim të akad. Idriz Ajetit) është sot e disa vite më parë Seksioni i Gjuhësisë i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, i cili ndër projektet parësore të vetat ka ndryshimin dhe zhbërjen e standardit të shqipes së sotme dhe në këtë punë e ka vënë në lajthitje edhe Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Për pasojë të kësaj, kohët e fundit bëhen debate për ndryshime të disa formave gjuhësore, apo hedhja poshtë e disa vendimeve të Kongresit. Në vazhden e këtyre përpjekjeve, gjatë këtij viti disa nga anëtarët e dy akademive tona shkencore kanë zënë të gërryejnë standardin gjuhësor të shqipes dhe me shumicë votash të pjesëmarrësve të dëgjueshëm e servilë të tyre ia kanë dalë të marrin vendime të njëanshme e anakronike. I tillë është dhe vendimi i tyre që me ngritje duarsh të hiqet së pari – ë-ja nga emrat e burimit asnjëanës: ujë, gjumë, drithë, mjaltë, ballë e të tjerë, si dhe nga të gjitha fjalëformimet me këta emra në gjuhën shqipe dhe pastaj kërkojnë gjithashtu të mos shënohet – ë-ja as në emrat burrë, djalë, kalë etj., duke rënë kështu ndesh dhe me parimin fonetik, si parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes, sipas të cilit fjalët dhe pjesët e tyre të kuptimshme duhet të shkruhen ashtu siç shqiptohen në ligjërimin letrar¹³⁰.

Përvjohen sot dhe individë, që për të mohuar gjithë punën që është bërë në standardizimin e shqipes, ftojnë lidërsipin politik të Tiranës, të Prishtinës dhe të Shkupit që të organizojë një kongres të shqipes... për të bërë një standard të ri gjuhësor... për të dy kombet tona (Shqipëri e Kosovë)¹³¹.

Mendoj se kjo ide, apo kjo nismë e tillë, është tejet e rrezikshme, sepse synon të shkaktojë ndarjen e kombit tonë në dysh. Me ide të njerëzve kokëkrisur e mendje- prishur nuk ia vlen të merremi, sepse ato nuk ndihmojnë fare në zhvillimin e gjuhës shqipe e as përafrimit të shqiptarëve, po përkundrazi e shkatërrojnë shqipen dhe e frenojnë zhvillimin e kulturës sonë. Të gjithë ata që përpiqen ta ndalin zhvillimin e gjuhës shqipe ose të na kthejnë në periudhën para njësimi të drejtshkrimit, duhet ta dinë se sistemi i gjuhës shqipe nuk është sikur ligjet apo rregulloret e kuvendarëve tanë, që me një ngritje dore mund ta ndryshojnë sa herë të duan.

Qëllimi i të gjithë atyre që këmbëngulin më së shumti të bëhen ndryshime të tilla në standardin tonë gjuhësor shihet qartë: jo të ndreqin diçka në punë të standardit, por përkundrazi të prishin, duke e nënvlerësuar gjithë ndihmesën e të tjerëve që kanë dhënë në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972 për të njësuar gjuhën shqipe. Ata në vend që të merren me projekte të tjera shkencore, i janë vardisur ndryshimit të standardit të shqipes, një punë që është zgjidhur në mënyrën më të mirë të mundshme tash e dyzet vjet më parë.

Sa i përket standardit të shqipes, mendoj se e mira e të mirës është ta lëmë standardin gjuhësor të shqipes ashtu si është bërë në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972, ta zotërojmë më mirë, ta zbatojmë si duhet, ta ruajmë e ta përhapim më shumë dhe t'i shtojmë përpjekjet për ta mbrojtur nga ndikimet e gjuhëve të tjera, jo vetëm në sferën e leksikut, që ka vërsuar gjuhën tonë, po edhe nga ndikimet e atyre gjuhëve, që kanë zënë të prekin edhe sintaksën e shqipes. Mund të bisedohet për mënjanimin nga përdorimi të njërës trajtë gjuhësore, ta zëmë format e shumsave të emrave: përronj apo përrenj, pastaj flamurë apo flamuj; mollë, dardhë, apo molla e dardha, në analogji me arra e ara, disa trajta të foljeve me – s apo me – t fundore

¹³⁰ *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974, f. 7.

¹³¹ Nexhmedi Spahiu : “Standardizimi i gjuhës shqipe – e trevat e vërteta” te gazeta e përditshme “Zëri”, 29 tetor 2011, f. 11.

në vetën e parë njëjës të kohës së tashme të dëftores: (unë) ujis, prashis, apo ujit, prashit, pra më çështje që nuk prekin shumë standardin gjuhësor që kemi. Synimi kryesor që kanë disa për të shtënë në përdorim në gjuhën standarde paskajoren e gegërishtes, *me punue*, e cila përbën tiparin kryesor dallues të dialektit të veriut nga dialekti toskë, pra të një makrosistemi tjetër dialektor, nuk do të gjejë përkrahje, sepse ajo formë e trazon gjithë sistemin e foljeve. Paskajorja *me punue* madje nuk është e mbarë gegërishtes, sepse një pjesë e ka nxjerrë prej përdorimit.

Andaj, duke u mbështetur në këto fakte që i përmenda dhe në shumë të tjera, që nuk ka mundësi të numërohen me këtë rast, po theksoj se ngjarja më e rëndësishme në historinë e popullit shqiptar, pas Pavarësisë së Shqipërisë, është Kongresi i Drejtshkrimit. Kësaj ngjarjeje kaq të rëndësishme për kulturën shqiptare e për kombin tonë, nuk duhet të lejojmë t'ia ulin vlerën me sulme e ndërhyrje shkatërruese të njerëzve. Përkundrazi, duhet të ndjekim rrugën e gjithë atyre që kanë ndihmuar në përafrimin e formave gjuhësore në variantin e normuar dhe rrugën e mbrojtjes së gjuhës sonë nga mendjet e krisura, që duan të injorojnë gjithë punën e vlefshme që kanë bërë brezat para nesh.

Po e përmbyll këtë kumtesë me vlerësimin e të gjithëve prej nesh dhe me bindjen se gjuha standarde shqipe kështu si është tash e dyzet vjet më parë, do të ketë të ardhme të ndritshme dhe të sigurt, veçse do përkujdesje më të madhe nga ana jonë, përkrahje të vendosura të institucioneve shtetërore e arsimore, të vihet në mbrojtjen e shtetit e të mos u lihet ta nëpërkëmbin të tjerët.

**KOMISIA LETRARE E SHKODRËS ZURI VEND MERITOR
NË KONGRESIN E DREJTSHKRIMIT**

Të nderuar pjesëmarrës,

Ndiej një kënaqësi të veçantë që më jepet rasti të flas për një përvjetor kaq të rëndësishëm, siç është 40-vjetori i Kongresit të Drejtshkrimit, madje në vendin e hapjes së shkollës së parë shqipe, në vigjilje të 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.

Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe i vitit 1972, ishte një kapak floriri që iu vu gjuhës shqipe. Aty u mor një vendim historik, që do të shënohet me shkronja të arta në historinë e popullit shqiptar. Tani e tutje shqiptarët, kudo qofshin ata, do të kenë një gjuhë të njësuar letrare kombëtare, ëndërr kjo që ua kishte zhuritur zemrat sa e sa brezave në të kaluarën. Ky Kongres ishte kurorëzim i përpjekjeve shekullore të popullit tonë, i cili, krahas pushkës, në gji mbante atë rroshkë malli për gjuhë amtare, për arsim e kulturë. Siç dihet, në punimet e Kongresi morën pjesë aktive edhe përfaqësuesit e shqiptarëve që jetojnë jashtë trungut arbëror, nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, si dhe nga arbëreshët e Italisë, të cilët dhanë një kontribut jashëzakonisht të madh me vërejtjet dhe sugjerimet e tyre. Aty kumboi fuqishëm uniteti në mendime për një ideal të përbashkët, për një gjuhë letrare shqipe.

Në referatin kryesor të prof. Androkli Kostallari *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, mbajtur në këtë kongres, si dhe në kumtesat e prof. E. Çabejt, docent Jup Kastratit, Xhevat Lloshit e Bahri Becit, një vend të veçantë zuri edhe Komisia Letrare e Shkodrës. Ajo zuri atë vend që i takonte në procesin e konsolidimit të gjuhës letrare shqipe. Por, natyrisht, aty nuk mund të flitej gjerësisht për tërë atë veprimtari të saj të bujshme.

Tashti të shohim se ç'u tha në Kongresin e Drejtshkrimit për Komisinë Letrare të Shkodrës.

Dhe nuk është e rastit - thotë Kostallari në referatin kryesor që e mbajti në Kongres¹³² - që Komisia Letrare e Shkodrës (1916-1917), e cila arriti të kodifikonte rezultatet kryesore të konvergjencës gjuhësore të Rilindjes e të zbatimit të alfabetit të njëjtë, çështjet e drejtshkrimit i trajtoi si pjesë përbërëse të problemit të madh të gjuhës letrare kombëtare. Komisia Letrare e Shkodrës ishte përmbushje e dëshirës së shprehur nga Kongresi i Manastirit që pas dy vjetësh të mbahej edhe një kongres "për orthografi e letraturë të gjuhës shqipe". Forcat demokratike e përparimtare të përfaqësuara në gjirin e Komissisë Letrare nga Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani, Sotir Peci etj., i bënë vendimet e saj një gur themeli për njësimin e drejtshkrimit të shqipes, pas Kongresit të Manastirit. Ata e konkretizuan dhe çuan më tej në drejtshkrim vijën e Rilindjes që shkrimi i shqipes t'i shërbente ngulitjes sa më të qartë të strukturës së fjalës dhe, mbi këtë bazë, të ruhej sa më shumë e përbashkëta, ajo që i afronte dialektet e variantet letrare dhe jo ajo që i dallonte e i largonte...

Duke përmendur në pika të shkurtra hallkat themelore në fushën e vokalizmit dhe në fushën e konsonantizmit, aty më poshtë thuhet: "Vendimet e Komissisë Letrare i afruan mjaft të dy variantet letrare në shkrim dhe, pasi u miratuan nga Kongresi Arsimor i Lushnjës më

¹³² Prof. A. Kostallari, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe ...*, KDGJSH, Prishtinë, 1974, f.50.

1920, u bënë baza e drejtshkrimit të shqipes në vitet '20-'40 të shekullit tonë. Ato krijuan një traditë të qëndrueshme për disa ortograme. Këto ortograme kanë zënë vend edhe në drejtshkrimin e sotëm. Por me gjithë afrimin, Komisia sanksionoi dy drejtshkrime, si shprehës të dy varianteve letrare. Detyra për të krijuar një gjuhë letrare të njësuar e një drejtshkrim të vetëm i mbeti epokës sonë”.

Prof. Eqrem Çabej, kumtesën e tij në Kongresin e Drejtshkrimit *Mbi disa çështje të traditës së shkrimit dhe të drejtshkrimit të shqipes*¹³³ e fillon pikërisht me Komisinë Letrare:

Kur Komisia Letrare e Shkodrës, në Parimet e rregullat që caktoi për drejtshkrimin e shqipes aty nga fillimi i vitit 1917, vendosi që zanorja ë e pathekse, grupet zanore ie, ue, ye dhe grupet bashkëtingëllore mb, nd, ngj do të shkruhen të plota ashtu si i ruan këto toskërishtja e pjesërisht dhe disa nëndialekte të gegërishtes, ajo mund të shtonte e të thoshte që ashtu të plota kanë ekzistuar ato dhe janë shkruar pak shekuj më parë në krejt truallin e gegërishtes dhe se janë të gjithmbarshme të gjuhës”.

Më poshtë, ai vazhdon: ... shqipja mori formë si gjuhë shkrimi me tendencë për njësim në të ardhmen, kryesisht që prej themelimit të një shteti shqiptar e këtej që kur ajo u bë shprehje e një njësie shtetërore të centralizuar. Kjo gjeti pasqyrimin e saj dhe në shkrim dhe në drejtshkrim, në fushën fonetike po aq sa në leksik dhe u zhvillua përherë e më shumë në këto fusha. U arrit me kohë në njësimin e disa trajtave fonetike e gramatikore, në ndjekje të Komissisë Letrare të Shkodrës (nënvizuar prej meje-Sh.K.) dhe të Kongresit të Lushnjës të vitit 1920”.

Docent Jup Kastrati, në kumtesën e tij *Vijat e përgjithshme të zhvillimit historik të drejtshkrimit të shqipes (deri në çlirim)*¹³⁴ ia kushton një faqe të tërë shtypi Komissisë Letrare të Shkodrës, duke vënë në pah, në pika të përgjithshme, rolin që kishte luajtur ajo në një kohë të caktuar, si dhe duke përmendur vendimet më kryesore që kishte marrë ajo:

Gjatë periudhës njëvjeçare, shtator 1916- shtator 1917, - shkruan J. Kastrati- veprimi në Shkodër Komisia letrare shqipe, në kohën kur ishte drejtor i arësimit L. Gurakuqi. Në Komisi bënë pjesë disa nga gjuhëtarët dhe shkrimtarët më të mirë të kohës. Ajo përcaktoi drejt parimin themelor të drejtshkrimit të shqipes. Komisia bëri një punë të vlefshme dhe me baza të shëndosha historiko-shkencore. Broshura- shkruante, ndër të tjera, Kastrati-“Rregulla mbi orthografinë e gjuhës shqipe të shkrueme” është kodifikimi i parë i drejtshkrimit tonë. Vendimet e Komissisë letrare, të miratuara më vonë nga Kongresi arësimesor i Lushnjës (1920), shërbyen si bazë

kryesore për drejtshkrimin e shqipes deri në çlirimin e Shqipërisë.

Këto vendime e lehtësuan mjaft zgjidhjen e problemit të drejtshkrimit, por nuk e zgjidhen këtë problem. Rregullat e Komissisë patën një rëndësi të veçantë për njësimin e shqipes së shkruar”.

Xhevat Lloshi, në kumtesën e tij *Emrat e përveçëm të gjuhëve sllave në drejtshkrimin e shqipes*, duke folur për Komisinë Letrare të Shkodrës, vëren me të drejt një kontradiktë brenda vendimeve që kishte marrë ajo. Për se është fjala në të vërtetë? Në *Rregullat mbi orthografinë e gjuhës shqipe të shkrueme* të Komissisë në paragrafin e parë thuhej :

¹³³ Prof. E. Çabej, *Mbi disa çështje të traditës së shkrimit dhe të drejtshkrimit të shqipes*, KDGJSH, Prishtinë, 1974, f. 119 dhe 122.

¹³⁴ Doc. Jup Kastrati, *Vijat e përgjithshme të zhvillimit historik të drejtshkrimit të shqipes (deri në çlirim)*, KDGJSH, 209.

*Orthografija e gjuhës do të jetë fonetike, d.m.th. gjuha do të shkruhet ashtu si flitet sot prej popullit. Menjëherë më poshtë aty thuhej: Si themel i orthografisë do të mirret djalekti i Elbasanit me disa ndryshime, kontradiktë objektivist e pakapërcyeshme në atë kohë*¹³⁵.

Prof. dr. Bahri Beci, në kumtesën e tij¹³⁶ zë ngoje Komisinë Letrare, duke thënë: Ato (*Rregullat e drejtshkrimit të shqipes*) (projekt) të 1967-ës-Sh.K.) kanë ruajtur dhe zhvilluar më tej në radhë të parë parimin themelor të drejtshkrimit të gjuhës shqipe të formuluar që më 1917 në “Rregullat mbi ortografinë e gjuhës shqipe të shkrueme të vendosuna prej Komisis Letrare”. Atje është shkruar që *Orthografija e gjuhës* (shqipe-B. Beci) *do të jetë fonetike, d.m.th. gjuha do të shkruhet ashtu si flitet prej popullit...*”

Ndërsa në Konferencën Shkencore, që u mbajt në Shkodër më 1997 kushtuar Komisisë Letrare të Shkodrës, prof. Beci do të nxjerrë këto katër konkluzione:

1. Ajo shënon përpjekjen e parë serioze dhe shkencore për normëzim të shqipes së shkruar.
2. Është pa dyshim normëzimi i parë i gegërishtes letrare mbi kritere e koncepte të drejta kombëtare.
3. Është hapi i parë i rëndësishëm drejt afrimit të gegërishtes letrare të shkruar me toskërishten letrare të shkruar.
4. Komisia Letrare Shqipe në fakt përgatiti terrenin që lehtësoi procesin e kalimit nga gegërishtja letrare standarde (deri më 1944) në toskërishten letrare standarde (1945-1946), pikërisht me rrugë zyrtare ose “fait accompli”. (KLSH, (1916-1996), *Studime shqiptare* 8, Shkodër, 1997, f.42).

Me të drejtë është konstatuar se gjuha letrare kombëtare luan një rol të dorës së parë në forcimin e vetëdijes kombëtare dhe ajo është një armë e fuqishme në zhvillimin e përparimin e shoqërisë. Krijimi i gjuhëve letrare shkon krahas me zgjimin e ndjenjës kombëtare. Ajo është një element i fuqishëm lidhës, është çimento e fortë që shtrëngon gurët e granitit të kompaktësisë kombëtare, është fuqia më e madhe e kohezionit të një populli. Ajo ka një mision historik në zhvillimin e kombit nga çdo aspekt dhe në çdo periudhë.

Krejt në fund, mund të konstatojmë se në punimet e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe të vitit 1972, në të cilin u vendos që shqiptarët, kudo qofshin ata, të kenë një gjuhë të njësuar letrare kombëtare, Komisia Letrare e Shkodrës zuri një vend të merituar.

¹³⁵ Xhevat Lloshi, *Emrat e përveçëm të gjuhëve sllave në drejtshkrimin e shqipes*, Po aty, f.157.

¹³⁶ Bahri Beci, *Rreth parimit tradicional-historik në shkrimin e shqipes*, Po aty.

ZBATIMI I DREJTSHKRIMIT DHE KULTURA GJUHËSORE NË MBISHKRIMET DHE BOTIMET ZYRTARE E PRIVATE NË GJAKOVË

Që në fillim të këtij shkrimi më duhet të them se, jam përpjekur të ofroj disa të dhëna që janë me interes të gjerë për zbatimin e drejtshkrimit me theks të posaçëm për mbishkrimet dhe botimet zyrtare e private në Gjakovë, të cilat kanë vërshuar jo vetëm në këtë qytet por edhe më gjerë. Duke i kushtuar një trajtim të veçantë këtij problemi që ka lëshuar rrënjë kudo, mendoj se do të mirëprehen me dashamirësi nga lexuesit tanë, si një ndihmë e rëndësishme për ta plotësuar e për ta përmirësuar këtë shëmtim të kohës para syve tanë duke mëkëmbur e goditur pamëshirshëm gjuhën standarde, kudo e ngado që ecim.

Gjuha është një fenomen shoqëror që zhvillohet vazhdimisht. Edhe në gjuhë lindin elemente të reja, pra, dalin nga përdorimi elemente të vjetra ose bashkëjetojnë elemente të reja me elemente të vjetra. Nga variantet normative duhen dalluar në mënyrë të prerë trajtat jonormative dhe trajtat e gabuara, të cilat janë në kundërshtim të plotë me strukturën e gjuhës dhe duhen përjashtuar fare nga gjuha letrare. Gjuha, siç dihet, është mjeti më i rëndësishëm i marrëdhënieve midis njerëzve. Zbatimi i plotë i normës letrare ia zgjeron gjuhës mundësinë e frymëmarrjes për ta kryer sa më mirë funksionin e saj komunikues në shoqëri. Përdorimi i drejtë i fjalëve e i kuptimeve të tyre, lufta kundër fjalëve të huaja të panevojshme që prishin pastërtinë e gjuhës sonë letrare, nuk është aspak e moralshme të heshtet, as nga intelektualët, e as nga specialistët e gjuhës e të kalojmë “detin” pa i lagur këmbët. Kjo ngjajnë sikurse të kryhet ndonjë krim fizik para syve tanë e të ecim drejtë rrugës pa u djersitur fare. Mendoj që edhe ne jemi bashkëfajtorë me ata që po i shkaktojnë dëm të madh gjuhës shqipe. Ata që shkruajnë e ne që heshtim, duhet të ruhen nga fetishizmi i gjuhës së shkruar, qoftë edhe i asaj që sot ne po e themi më shpesh “shqipja standarde”. Zhvillimi i gjuhës, mendoj, nuk ka qenë dhe nuk është proces që varet nga vullneti i arsyeshëm i letrarëve dhe i dijetarëve, qoftë edhe i gjuhëtarëve, por është i pavetëdijshëm e kolektiv, që shpesh vjen nga poshtë e ngjitet lart nga turma e gjallë (aktive). Gabimet, si këto që do të paraqiten më poshtë, të paktën ato që jetojnë gjatë, i rezistojnë qortimit të ashpër nga normativizuesit, janë shpesh prirje të thella të gjuhës në përgjithësi ose të një idiole në veçanti; kështu edhe kur i vëmë vetes qëllim për t’i flakur, nuk dihet a do t’ia arrinim po të mos njihnim burimin a shkakun, ashtu sikundër nuk mund të shërohet një sëmundje nëse injorohet shkaku.

Pra, ky punim, ka për qëllim të bëjë kundrim të mënyrës se si shkruhen mbishkrimet e ndryshme qofshin ato zyrtare, apo private. Asnjëherë s’duhet harruar të kemi parasysh për rregullat kryesore të cilave duhet t’u përmbahemi kur shkruajmë mbishkrime të ndryshme nëpër institucione shtetërore, fletëpalosje, ftesë dasmash, informime për organizim koncertesh e festivalesh, informim për ndonjë shitblerje a reklama të ndryshme zgjedhore, apo edhe ato të natyrës tregtare etj.

Lëkundje e shmangie të mëdha që vërehen nëpër mbishkrimet e cituara më lart, vërehen kryesisht në fushën e morfologjisë. Ne këtu po japim vetëm disa shembuj me karakteristikë e më të shpeshtë të disa prej tyre, që dëshmojnë se këtu puna s’qëndron aspak mirë dhe kërkon përveshje llërësh në mënyrë të ngutshme. Ka pak lokale, me veprimtari të ndryshme, jo vetëm në Gjakovë, por, edhe më tej, madje edhe në kryeqytet, që kanë vërshuar

anekënd pa kurrfarë turpi duke i dhënë qytetit një “peisazh” të zymtë drejtshkrimor. Psh.: Në disa dyqane që merren me gatimin e byrekëve shkruan: Në *duqanin* tonë kurdoherë ka *burek taze*. (në vend të: Në *dyqanin* tonë kurdoherë ka *byrek të freskët*). Në këtë rast emrat *duqanin* dhe *burek* janë të shkruar jo sipas drejtshkrimit të gjuhës shqipe, që në vend të zanores *u* duhej të shkruhet zanorja *y* në të dyja rastet e emrave. Po ashtu, edhe përdorimi i gabuar i mbiemrit *taze* nuk është me prejardhje shqipe, por me prejardhje nga turqishtja e nga kjo, shihet qartë se në një fjali na dalin tri gabime të rënda gjuhësore.

Në tekstin e një mbishkrimi tjetër shkruan: *Sallon Bukurijs BENA*. Në këtë mbishkrim na dalin gabime të tjera, të përdorimit të gabuar të një grupi zanoresh *-ie-* që shkruhet tek emrat , te të cilët ky grup zanoresh ndiqet nga një bashkëtingëllore e lëngët (*l* ,*ll* , *r*) dhe të gjitha fjalët e formuara prej tyre: diell, qiell etj., prandaj, emri *bukurie* shkruhet me grup zanoresh *-ie-* dhe jo me *-je-* *bukurijs*. Nuk duhet harruar se nga këto tri fjalë kemi edhe dy gabime të tjera:

1. Fjala e dytë *Bukurijs* është shkruar me shkronjë të madhe që sipas drejtshkrimit është një lëshim drejtshkrimor, sepse fjala e dytë nuk është emër i përveçëm, prandaj është duhet të shkruhet me shkronjë të vogël;

2. Emri, *Bena*, që në këtë rast është emër i përveçëm, sipas drejtshkrimit duhet të vihet edhe në thonjëza sepse dallon nga sallonet tjera, pra, salloni “*Bena*” dhe jo *Bena* pa thonjëza (foto 3).



Në një mbishkrim tjetër për çështje shëndetësore shkruan:

Për të mirën e shëndetit Tuaj: (foto 4).



4. E shkruar me gabime

E shkruar drejt

Pstron dhe shëron Boshtin Kurrizor.
Pastron Veshkat dhe Melqin.
Largon (Celulitin) Peshën.
Liron dhe forcon enët e Gjakut.
Stabilizon Reumen.
Stabilizon dhimbjet e Lukthit
Përmirson Trombozen.

a. pastron dhe shëron boshtin kurrizor;
b. pastron veshkat dhe mëlçinë;
c. largon peshën;
ç. liron dhe forcon enët e gjakut;
d. stabilizon reumën;
dh. qetëson dhimbjet e lukthit;
e. përmirëson trombozën .

Meqenëse , padituria është fajtores për gabimet gjuhësore po sjell një shembull si ky i paraqitur më lart .

1. “ *Pstron dhe shëron Boshtin Kurrizor*”. Në këtë shembull, nga katër fjalë të shkruara , “*vetëm tri*” janë të shkruara me gabime gjuhësore” !!!

2. “*Pastron Veshkat dhe Melqin*”,

3. “*Largon (Celulitin) Peshën*”,

4. “*Liron dhe forcon enët e Gjakut*”,

5. “*Stabilizon Reumen*”,

6. “*Satabilizon dhimbjet e Lukthit*”,

7. “*Pëmirson Trombozen*”.

Për këtë dëshiroj të ndalem te pika e përmendur që ndodh shumë shpesh, por gjithnjë e vështuar kalimthi: drejtshkrimi i gjuhës shqipe. Mendoj që para rasteve si këto që paraqitëm dhe shumë të tjerave që na ndjekin në shtrembërimin e drejtshkrimit e me bashkëpraninë e këtyre të metave nuk duhet heshtur, por duhet të përballemi para një të keqeje që mund ta quaja kaq “arrogante”.

E quaj të nevojshme të sjell edhe dëshmi të tjera. Do ta quaja gjithashtu të padrejtë, të m’i marrin këto vërejtje si goditje dashakeqe. Përkundrazi, kjo është një përpjekje për të treguar se deri në çfarë përmasash është dukuria dhe cili është përfundim që duhet nxjerrë: pozitiv, pohues, pse jo edhe nxitës në këtë drejtim. Përballë një gjendjeje të tillë duhet të ndryshojë kahu i punës së gjuhëtarëve, pedagogëve e mësuesve të gjuhë shqipe që nga shkolla fillore, e mesme e gjer në universitet. Të mos merremi dhe aq shumë me maninë e shkatërruesve të drejtshkrimit e të gjuhës standarde në përgjithësi, të mos shpenzojmë kohë dhe aq energji me polemika shterpe. Gjuhëtarët të bëhen bartës të diturisë përballë paditurisë.

Të metat në drejtshkrim nuk përfundojnë vetëm me kaq. Kjo është bërë “modë”, madje, edhe krenari për këtë kohë “moderne” se, askush nuk kritikohet, e asnjë gazetar nuk shkruan një artikull. Krijohet përshtypja për një popullatë të paarsimuar edhe përkundër gjithë këtij shkollimi, ndoshta jo të mirëfilltë. P.sh.: Nëpër vitrinat e byrektoreve thuajse kudo shkruhet: *burek*, në vend të *byrek* dhe një varg fjalë të tjera që shkruhen me **u** dhe jo me **y** si: *byro*, *bërryl*, *dybek*, *dyqan dyshek* etj.

Po ashtu, në mbishkrime të tjera, sipas mjeshtërisë të zejeve të ndryshme vërehen mjaft gabime drejtshkimore si: *argjentar* në vend të *argjendar*, përdorimi i **q-së** në vend të **ç-së**, në përdorimin e emrit **qaj** në vend të **çaj** dhe përdorimi i gabuar i numrit shumës të emrit “*qajna me cop 1.99 euro*” në vend të *çajra me copë*...etj.

Natyrisht, përveç gabimeve drejtshkimore të komentuara në të folur dhe në të shkruar, përdoren edhe një mori gabimesh në shumësin e emrave mashkullorë, ata të cilët e formojnë shumësin rregullisht me mbaresën –*ë* emrat mashkullorë që dalin më:

-ac *përtacë, tullacë* dhe jo *pëtaca, tullaca*;

-aç *gjembaçë, kulaçë* dhe jo *gjembaça, kulaça*;

-ek *byrekë, dyfekë, fishekë, lejlekë* dhe jo *byreka, fisheka, lejleka*

Përfundim. Rëndësi të veçantë në kalimin e një gjendjeje të tillë jo të mirë dhe në përparimin e mëtejshëm të gjuhës dhe kulturës gjuhësore kanë edhe mjetet e informimit, e në radhë të parë radioja dhe televizioni (sidomos emisionet e tyre shkollorë, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me lëndën e gjuhës amtare) si dhe gazetatat, revistat që merren me çështje të gjuhës, revistat pedagogjike etj.

VEPRA E MITRUSH KUTELIT, NDIHMË E MADHE NË ZHVILLIMIN DHE PASURIMIN E GJUHËS LETRARE SHQIPE

Shkrimtarët janë miqtë më të mëdhenj të gjuhës së kombit tonë dhe për ta vërtetuar këtë mjafton të kujtojmë emra të tillë si Naim Frashëri, Gjergj Fishta, Ernest Koliqi, Jakov Xoxa, Ismail Kadare etj. Lista është më shumë se kaq, por ne do të ndalemi tek Mitrush Kuteli, për të cilin studiuesit tashmë e kanë thënë fjalën e tyre duke e cilësuar si shkrimtarin kryesor që ndihmoi në hedhjen e bazave të gjuhës letrare shqipe. Në këtë realizim madhor, Kutelin e ndihmojnë vetë konceptet e tij për gjuhën amtare, të cilat siç shprehet Nasho Jorgaqi, “janë jo vetëm ato të një atdhetari të flaktë, që e sheh atë si një nga tiparet kryesore të kombit dhe pasuri të madhe shpirtërore të popullit, por edhe të një artisti të shquar, që i përkushtohet asaj shpirtërisht, intelektualisht e fizikisht”.¹³⁷ Si njohës i shkëlqyer, si gjurmues i pashoq i mjeteve gjuhësore të njohura e të panjohura, të hershme e të freskëta, me vlera kumtuese e me vlera shprehëse, Kuteli krijon një mënyrë të tillë e cila sjell zgjerimin e kufijve të gjuhës letrare.

Është pranuar tashmë se origjinaliteti i shkrimtarit varet nga raporti që ai ndërton me gjuhën dhe Kuteli është padiskutim rasti që e vërteton më së miri këtë, sepse ai di t’i “qepet” fjalës shqipe në tërësi dhe fjalës së vendlindjes në veçanti duke e funksionalizuar atë në shtresat kuptimore të tregimeve dhe rrëfenjave të tij. Në mënyrë më të përmbledhur, do të nënvizonim se pasuria gjuhësore e veprës së tij është unike për tre arsye: së pari për vetë konceptin që shkrimtari ka për veshjen gjuhësore të cilën e konsideron parësore për një vepër letrare si dhe aftësinë dhe talentin që ai ka për ta realizuar këtë synim, së dyti gjerësia e thellësia veprës në pikëpamje përmbajtësore dikton një përkushtim të thellë ndaj gjuhës dhe së treti jo më pak i rëndësishëm është formimi i tij i shkëlqyer kulturor, vendlindja e tij e dalluar për pasuritë natyrore e kulturore, origjina, familja, fëmijëria, lidhjet e tij të hershme me folklorin etj. Të gjitha këto së bashku e sjellin veprën e Kutelit drejt një peisazhi gjuhësor gjithëkombëtar nga më të ylbortët, nga më interesantët.

Vepra e Kutelit është në vetvete një shkollë gjuhësore dhe prirja e tij kah gjuha letrare kombëtare nuk është aspak e rastësishme, përkundrazi, ajo realizohet në mënyrë të vetëdijshme, përmes një përpunimi të hollë e mjeshtëror duke ju nënështruar një sistemi rregullash të rrafshëve të ndryshme gjuhësore: fonetike, gramatikore, leksikore, sintaksore etj.

Duke qënë se Kuteli, ashtu siç është thënë, në thelbin përmbajtësor të veprës së vet pasqyron strukturën e Shqipërisë së përjetshme, e Shqipërisë që mbetet, që ekziston sot e nga mot, pavarësisht kohërave e sistemeve, atëhere edhe materializimi gjuhësor i saj ruan në të njëjtën kohë karakterin arkaik dhe modern, madje mund të thuhet se pikërisht arkaizmi bëhet burim i modernizmit të tij gjuhësor. Në rrjedhë të këtij arsyetimi, është e natyrshme edhe prania e njësive leksikore, strukturave sintaksore, frazeologjizmave etj., të cilat kanë një shtrirje më të gjerë kohore dhe që i kapërcejnë natyrshëm kufijtë e ngushtë krahinorë duke u bërë pjesë e një leksiku më të përgjithshëm. Kuteli priret për ta ngritur gjuhën e veprave të tij

¹³⁷ Citim i shkëputur nga parathënia e serisë së veprave të Kutelit: *Vepra Letrare 1*, f. 57

në nivelin e gjuhës letrare kombëtare duke e përzgjedhur dhe përpunuar atë jo vetëm si shkrimtar, por edhe si një gjuhëtar profesionist, prandaj bashkëjetesa harmonizuese e diagonaleve të ndryshme gjuhësore është elementi kryesor që e shënon prozën e tij, si të parën prozë moderne shqiptare e njëkohësisht të papërsëritshme në llojin e vet. Po ta përqasim vlerësimin për gjuhën me metodat artistike krijuese, do të thoshim se ai sjell në letrat shqiptare një lloj realizmi magjik gjuhësor, një rrëfim gojor që kalon në rrëfimin letrar modern përmes të cilit pasqyrohen ambiente të mbushura me ngjarje që tregojnë ngjarje të tjera dhe shpalosen fate personazhesh e jetë brezash njerëzore që nga ilirët dhe në vijimësi, në kohët moderne.

Në veprën e Kutelit, pikësëpari, mbizotëron përshkrimi i ambientit rural, ambient i mbushur me ngjarje që kanë lidhje me të kaluarën, me mërgimin, me heroizmin dhe atdhedashurinë, por edhe me probleme të përjetshme të racës njerëzore siç janë ballafaqimi i së mirës me të keqen, i dashurisë me urrejtjen, i jetës me vdekjen etj. Gjithnjë në përputhje me këtë përmbajtje dhe me stilin e veprës, Kuteli do të bëjë një punë të madhe në përzgjedhjen dhe pasurimin e fjalëve duke i estetizuar e veshur ato me përbërës kuptimorë plotësues, duke i ngjyrosur stilistikisht e duke mos munguar të krijojë dhe fjalë të reja sipas gjedheve të njohura të shqipes e pse jo edhe në mënyrë origjinale. Pra, ky autor shfaq edhe parapëlqimet e tij ndaj kategorive fjalësore apo fjalëformuese, çka përbën dhe një tipar të stilit të tij, tipar që i jep origjinalitet dhe e bën krejtësisht të dallueshëm nga shkrimtarët e tjerë të mëdhenj. Ai ka fjalorin e vet dhe fjalët e veta më të dashura të cilat i japin frymë dhe gjallëri ideve të tij të mëdha, ballafaqimeve të rëndësishme e bazike dhe kundërtënieve jetësore të personazheve të tij dhe jo pak të tilla bëhen stilformuese në veprën e tij. Sjellja gjuhësore e Kutelit ngjan me delikatesën e kopshtarit të dashuruar mbas çdo luleje e bimëze, mbas çdo rrënje e sythi, mbas çdo degëze të përgjumur apo të harlisur; sjellja e tij gjuhësore tenton “hirin e fjalës”, fuqinë e saj biblike dhe ia del më së miri.

Në veprën e Kutelit vërehet qasja e tij e fortë drejt gjuhës letrare, jo vetëm për ta pasqyruar atë, por edhe për të dhënë ndihmesën e tij në pasurimin dhe freskimin e saj me mjete të reja. Përgjatë rrugëtimit të tij krijues, Kuteli i ka shpërthyer kufijtë krahinorë duke shkuar gjithnjë e më shumë drejt gjuhës kombëtare, drejt zgjerimit të saj dhe për ta vërtetuar këtë mjafton të ndalemi disa çaste tek krijimi i tij i mëvonshëm “Nga Dyrakioma në Bardhonë” e cila krahasimisht me krijimet e tjera të mëparshme, është në nivel të lartë e pastruar nga krahinorizmat, nga fjalët e huaja, veçanërisht nga turqizmat, duke i lënë vendin fjalëve të moçme shqipe dhe arkaizmave, historizmave, neolatinizmave të cilat shërbejnë për të krijuar koloritin gjuhësor, të tilla si: *fallafore*, *fellëtirë*, *mandria*, *mbroth*, *namëna*, *sindozot*, *heshtë*, *shigjetë* etj. dhe çka është më e rëndësishme një numri të konsiderueshëm neologjizmesh të cilët më së shumti janë neologjizma stilistikë të tillë si: *begatore*, *dashatare*, *gjahtoreshtë*, *gojtare*, *gostiar*, *haje*, *hamullimë*, *hobetar*, *majmale*, *qiqërimë*, *shkarrëzimë*, *vezullimë*, *vigjëlesë*, *zbardhëllimë*, *drekëtar*, *vigmë*, *dekunë*, *strunjak*, *burbujë* etj.

Kuteli ndihmoi në shtrirjen e gjerë të shqipes së shkruar në disa drejtime: në leksik, në fjalëformim, në shprehjet frazeologjike, në togfjalësha e mënyra shprehjeje të goditura, në drejtim të figurshmërisë etj., por veçanërisht, në drejtim të leksikut, sepse ndryshe nga rrafshet e tjerë gjuhësore, leksiku dihet që mbetet përherë një portë e hapur për t’u futur fjalë të reja, për të riaktivizuar fjalë të vjetra apo për të rikuptimësuar fjalë të ndryshme.

Pavarësisht, se Kuteli njihet si shkrimtar me prirje të fortë drejt leksikut krahinor, ai di të lëvizë gjuhën në të gjitha shtresat e veta dhe ta verë atë mbi baza letrare kombëtare në shumë e shumë mënyra tek të cilat do të përpiqemi të ndalemi konkretisht:

- Kuteli zgjedh fjalën e duhur edhe përtej mjedisit të tij gjeografik, duke i bërë vend në veprën e vet leksikut ndërdialektor, futjes së shumë fjalëve të cilat janë karakteristikë e trevave të tjera duke i dhënë kështu veprës së tij një frymëmarrje mbarëshqiptare. Ai e di mirë se “thesari i gjuhës shqipe është i thellë dhe perlat e tij mund t’i shtien në dorë vetëm ata lëvruar të artit të fjalës, që shtegtojnë ngaherë nëpër trojet dhe mjediset e atdheut”¹³⁸ ndaj dhe kjo dukuri ndodh jo vetëm në krijimet që vijnë me tematikë nga eposi apo krijimtaria tjetër popullore, tek të cilat prania e leksikut ndërdialektor është si të thuash edhe e detyruar, por edhe në krijimet që lidhen mirëfilli me vendlindjen e autorit. Përmendim disa të tilla si: *ahti, amëza, bacë, bret, bërlyket, bështinë, cub, cucë, dakikë, diellishtë, drangë, e pabëme, falmeshëndet, faroj, fiskajë, gjog, gjysmëterr, kaptinë, karpë, kashais, katua, kryet, kukamë, kullë, lartoj, log, loke, lëmashk, mazgallë, mjegullinë, mriz, mrizoj, ndezulli, ndoresh, nëmë, petka, pshon, qoftëlargu, quar, rruginë, thurimë, tutem, vajtore, vasho, vashë, vikamë, vrugëllon, vullaja, vëllam, zezonë* etj.

Tregues tjetër i kulturës së gjerë të Kutelit, i intuitës së tij të hollë jo vetëm prej krijuesi, por edhe prej gjuhëtari, tregues që ai nuk është thjesht një fanatik i leksikut popullor të krahinës së tij, por edhe një dashatar i madh i gjuhës gjithkombëtare, është dhe futja në ligjërim e një grupi fjalësh të leksikut arbëresh si: *adunarem, e mungët, gjegji* (për *dëgjoi*), *marvazezë, noteshë, radë, shkluhë* etj.

-Kuteli sjell njësi të vjetra, të qëmoçme (përdorëm këtu një nga arkaizmat e gjetur dendur në prozën e tij; shënim i L.S.) të cilat kanë lidhje me mjedisin gjeografik, me leksikun e liqenit të Ohrit, me bujqësinë, blegtorinë, me fenë, etnografinë, me etnozoologjinë, me etnobotanikën e zonës edhe përtej saj, por meritë kryesore e tij është se kur këto fjalë janë të panjohura ai i vendos në kontekste të tilla që ato të bëhen të kuptueshme për lexuesin. Si të tilla mund të përmendim: *anagjore* për *po ashtu*, *damf* për *kundërmimin e rakisë*, *derrpë* për *pyllin shumë të dendur me driza*, *kalpëtoj* për *zë plasat e një fuçie a voze*, *klisyrë* për *grykë mali*, *kulluzmë* për *një vend ose tip foleje që ndodhet midis bimësh të egra të ngatërruara*, *këltyrë* për *kapak*, *lakove* (fjalë përkëdhelëse) për *vëlla*, *lavomë* për *plagë*, *qiqërimë* për *mjegullën e lehtë që mbulon tokën në verë*, *ushë* për *kasollen e vogël të ndërtuar me degë e fletë ku fshihet gjahtari*, *rrëzall* për *pjesën e rrënjës me gjithë fije apo kallinj*, *sumbull* për *kopsë* etj. Të gjitha këto fjalë, të zgjedhura me kujdes dhe të vendosura në kontekstet përkatëse, siç do të shprehej Gjovalin Shkurtaç “kthehen në mjete të plotvlershme e kalojnë jashtë caqeve të gjuhës së letërsisë, dalin në lëmin e gjerë të stileve funksionale e të gjuhës së folur të përditshme. Në mënyrë të veçantë kjo mund të thuhet për rastet kur fjala dialektore vjen e plotëson ndonjë mungesë të gjuhës letrare duke dhënë mundësi të plotësohet fondi aktiv i fjalorit ose të përtërihet ai duke nxjerrë jashtë përdorimit fjalë të huaja të panevojshme”¹³⁹, si për shembull:

O mbret, a do ta thërrasësh *njëmend* arapin të më presë kokën? (Vepra 4, f. 180);
Disa me rroba bojë hiri prej stofe... disa mbanin këpucë të bardha...më të shumtit kishin

138 Gj. Shkurtaç, *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë 2009, f. 37

139 Po aty

bastunka të hollë... Midis kësaj *lyshtre* shquhej një burrë mesatar nga trupi...(Vepra 1, f. 318-319); Ariu zemërohet. Kthehet e i bie njërit një *shukretë*, e hedh tutje; i bie tjetrit dhe e le në vend.(Vepra 1, f. 260-261); *Kalori* mustaqeverdhë ktheu në të djathtë pelën barsë dhe mori udhën e Lagjes së Poshtme...(Vepra 1, f. 250); ...po brendapërbrenda zien si kazan me avull, që mundohet të hedhë tutje *këltyrën*, të shpërthejë jashtë, të lajë e shpëlajë cdo ndyrësi.(Vepra 1, f. 248); Mbathej... me opinga të lehta të bëra me dorën e saj, lidhur me *ovgjala* ndënë gju.(Vepra 1, f. 223); Atëhere vëllai i Xinxifilos hedh prapa pasqyrën dhe *namëta* bëhet një det i madh pa fund, pa anë.(Vepra 4, f. 366); U mbloodha *lakove* ca luleshtrydhe...(Vepra 3, f. 60) etj.

-Hijeshojnë veprën me praninë e tyre një sërë fjalësh të rralla për gjuhën letrare, si dhe mjeshtëria e realizimit të ndërtimeve sintaksore mjaft shprehëse. Si të tilla përmendim: *shkarrëzimë, agullimë, ajkësinë, blerishte, brambullimë, burbujë, bërtimë, çetoj, dekunë, grazhdoj, gropishte, i murrtuar, i zymtuar, imshtë, majmale, njomishte, qiqërimë, strunjak, thirrme, zbardhëllimë* etj.

-Kuteli jep një ndihmesë të madhe për pasurimin e shqipes letrare vecanërisht përmes fjalëformimit, duke krijuar fjalë të cilat qartas duket se burojnë prej gurrës popullore. Gjedhet krijuese janë të larme: me prapashtesim: *barkul, begator, darkëtar, dashatar, delmator, drejtar, gojtare, gostiar, kalor, krushqar, lagëtyrë, muziktar, mëshirtar, pjellëtoe, përgjëratë, shërimtar, zemëratë, zezulinë, pagëtyrë* etj; me anë të kompozimit: *dorëbardhë, hejmprehtë, brirëheshtë, bujëmadh, buzëbardhë, dhëmbërruazë, fustanëbardhë, emërharruari, gojëlidhuri, kuqzikuq, këmishëgjatë, lemerimadhe, mustaqepresh, nakarmëdhenj, nusetrimja, shkumëbardhë, sypëgërë, syqielltë, veshoputë, vetëmfillthi, zëmadv* etj; me anë të përngjitjes: *asfare, asqë, mosgjë, sidokudo, sindozot*, etj.

Kuteli jep një ndihmesë të madhe për pasurimin e shqipes letrare veçanërisht përmes fjalëformimit, duke krijuar fjalë të cilat qartas duket se burojnë prej gurrës popullore. Gjedhet krijuese janë të larme:

me prapashtesim: *barkul, begator, darkëtar, dashatar, delmator, drejtar, gojtare, gostiar, kalor, krushqar, lagëtyrë, muziktar, mëshirtar, pjellëtoe, përgjëratë, shërimtar, zemëratë, zezulinë, pagëtyrë* etj;

me anë të kompozimit: *dorëbardhë, brirëheshtë, bujëmadh, buzëbardhë, dhëmbërruazë, fustanëbardhë, flakëfërfëllonjës, gojëlidhuri, hicgjë, kuqzikuq, këmishëgjatë, lemerimadhe, mustaqepresh, nakarmëdhenj, nusetrimja, perëndilutës, shkumëbardhë, sypëgërë, syqielltë, vetëmfillthi, zëmadv* etj;

me anë të përngjitjes: *asfare, asqë, mosgjë, sidokudo, sindozot* etj.

Për shembull: *Skuqnin* sytë e gallupëve që rrinin përquark *kokëndezur*, të akrosur.(Vepra 4, f. 420); Gjer dje ai *zbatharak* më puthte këmbë e dorë.(Vepra 4, f. 411); Zunë të dalin sheshit thinjtë *kreshtështizë*. (Vepra 4, f. 330); Sa keq i vjen tani asaj rabeckës *fustanleckës* e asaj laraskës *këmbëtaskës*...(Vepra 4, f. 308); Po nën *burojën* e akullit uji vazhdon të rrjedhë. (Vepra 4, f. 330); *Emërharruari* ndodhi *zemërpaktë*...(Vepra 4, f. 231) etj.

-Vlerë të veçantë për gjuhën letrare në veprën e Kutelit paraqet edhe leksiku i figurshëm. Duhet thënë se Kuteli tregon ndjeshmëri të lartë artistike ndaj gjuhës, sepse ai arrin të figurativizojë edhe fjalët më të zakonshme të gjuhës siç janë për shembull mbiemrat lëndorë: *e grynjtë, e zëmbaktë, i bunghtë, i dushkët, i kërptë, i sedeftë, i shkëmbtë, i shëllirtë*

etj; duke mos folur këtu për përdorimin vetjak të disa mbiemrave të poetizuar përmes prapashtesimit si: *avulloshe, bardhoshe, begatore, freskoshe, hidhatake, i bryllët, i trazirtë, majoshe, mbrëmësor, miturake, pjellëtore, thinjoshe* etj, të cilët gjithashtu ndihmojnë krijimin e një stili gjuhësor origjinal.

Për shembull: Ai u mpi në shtratin e *shkëmbtë* dhe thëthin panxhat nëpër gjumë. (Vepra 4, f. 330); E gjeti... në një front të *dushkët*... (Vepra 4, f. 220); ...mbani gjer asaj dite ndonjë pulisht *krekoshe*. (Vepra 4, f. 436) etj.

-Kuteli realizon rikuptimësimin e figurshëm e vlerësues të shumë fjalëve abstrakte si për shembull: *cingunëria, çupërlinëria, djegurja, djelmuria, drizëria, fismëria, lingëria, lirësia, logoria, shtangësia, stërnipëria, stërstërnipëria, trillesa, turqëria, ujqëria, vashëria, vogëlia* etj.

-Krijoi modele sintetizmi, ekonomizimi gjuhësor, veçanërisht tek ndajfoljet e krijuara me anë të prapashtesimit si: *arithi, capthi, derrçe, dyzash, fytas, gogolçe, hidhshëm, krahënderë maçoqce, marrtas, rrokas, vrulltas, zuzarhi* etj.

-Rikuptimësohen edhe një grup fjalësh me natyrë popullore të krijuara ose të rikrijuara me anë të prapashtesave zvogëluese -*kë, -q, -th, -ush, -z* etj, duke marrë veç kuptimit bazë, nuancat e ironisë, talljes apo përkëdheljes sipas rastit, si për shembull: *atëlosh, burrkë, burrth, e bukurëz, e hollëz, fillthi, i gjelbërth, i vogëlith, kikithi, lalush, linkthi, njëmendthi, vëlasho, zonjëz* etj.

Për shembull: I japin një si *rrogushkë* e nuk e venë në bukë të madhe... (Vepra 1, f. 291); *Felaqi feluqi*, fiton *hatëruqi*. (Vepra 1, f. 306) etj.

-Bien në sy për figurshmëri foljet e krijuara nga emrat si: *farkoj, hirosem, kosarit, përkëmbet, vegëloj* etj. Për shembull: As ty s'të marr, se më *kobon*. (Vepra 4, f. 400); ...kur ua desh puna *kosaritnin* njerëz. (Vepra 4, f. 407) etj.

-Kuteli zgjeroi dhe pasuroi sinoniminë e gjuhës letrare në të gjitha tipat e saj, veçanërisht ata stilistikë me burime të ndryshme, si për shembull: *dhemkë* (dhembje), *djallore* (djallëzore), *e qëmoçme* (e moçme), *qamatare* (qaramane), *shtrigore* (shtrigë), *syqielletë* (sy ngjyrëqielli), *thatimë* (e thatë) etj.

-Zgjeroi dhe përpunoi variantet stilistike sinonimike dhe ndërtime të tjera të ngjashme të tipit: *atëkohë, asokohe, asohere; e poshtme, e rëposhtme; fillthi, vetëmfillthi, fillikat; robërshë, robinjë, shtrigë, shtrigore, shtrigushe; skllaveshë, skllavinjë; tani, tanithi; thatime, thatoke; vrullshëm, vrulltaz* etj.

-Zgjeroi e zhvilloi antoniminë leksikore, stilistike e semantike të shqipes letrare, duke plotësuar në sistem strukturën leksikore të saj, për shembull: *barkplot – barkbosh, degëvarur – degëngritur, dorëborë – dorëzezë, dorëngushtë – dorëgjerë – dorëhollë, gjuhëhollë – gjuhëtrashë, gojëprishur – gojëmjaltë, mustaqebubuzhel – mustaqepresh, pizgëtrashë – pizgëhollë, zemërgurësi – zemërgjerësi* etj.

Fakti më domethënës për afrimin e Kutelit me gjuhën letrare, mbetet pasqyrimi i gjerë i leksikut të veprës së tij në fjalorët e shqipes, duke filluar që me shtresën e leksikut bisedor, leksikut krahinor të trevës juglindore, si dhe atij ndërdialektor, leksikut të huazuar dhe leksikut letrar dhe vetëm një pjesë e vogël, e pakonsiderueshme në tërësinë e njësive leksikore të veprës kanë mbetur jashtë tyre.

Duke u ndalur tek fjalorthët shpjegues me të cilët është pajisur seria e veprave të Kutelit, jemi përpjekur të hetojmë konkretisht pasqyrimin në fjalorët e shqipes të atyre

njësive leksikore, të cilat i takojnë një fondi të lashtë leksikor ose që kanë karakter ngushtësisht krahinor, vërehet se gati gjashtëdhjetë përqind e tyre janë të pasqyruara në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe të 1980-ës dhe pjesa tjetër nuk është pasqyruar. Mbeten pa u përfshirë, kryesisht njësi dialektore të cilat emërtojnë elemente të veshjeve të hershme, objekte të vjetra, të cilat sot ose kanë dalë nga përdorimi ose përdoren shumë rrallë, si për shembull: *çepurkë, dajandë, daniskë, garan, jekuce, krazë, leckarkë, mastrapan, matare, molla e kuqe, mollaqe, mollokoq, mëregë, mërezhë, otra, pashmangë, pepellashkë, pepellashkë, peristil, pllaskhtë, pod, pojatë, poshtagë, prapapash, qakapikë, shkurtelkë, shpargë (pjesë pelenash), steren, tallamaz, tatrivan, telik* etj. dhe përfshihen të tilla si: *bulirë, çetur, damaluk, hordop, jatak, komçë, mazgallë, mballomë, palare, plevicë, shajkë, shaneshin, stringël, tabut, torbë* etj.

Një kategori tjetër fjalësh të cilat mund të sjellin pasurim duke u përfshirë në fjalorë, janë edhe ato që i kanë gjegjëset e tyre në shqipen letrare si për shembull: *bërtimë* (bërtitje), *drangu* (shuli), *fërmon* (fryn), *gëmbër* (shkëmb i madh, rrasë), *i brydhët* (i bryllët), *kalor* (kalorës), *kanare* (kërdi, kasaphanë), *karpë* (shkrep), *marmaros* (nguros), *murtar* (i murrmë, i nxirë), *pallajsë* (pallat), *skorovod* (lugat, kanxhallos) etj., të cilat sjellin ngjyresa kuptimore dhe shërbejnë si stilkrijuese. Si stilkrijuese shërben edhe përdorimi me denduri të lartë i njësive të leksikut popullor si p.sh. i emrit *çap(i)* në vend të emrit *hap*; i foljes *sos* në vend të foljes *mbaroj*, *arrij* etj.

Pasqyrohen në fjalorët e shqipes një grup njësisht të leksikut krahinor që emërtojnë dukuri natyrore, frymorë, veprime etj. si: *agshol, brrac, buljareshë, bungishte, byrazer, cubar, dashtra, frëngjyzë, fërtymë, imshhtë, lolis, ngjelkë, zografis* etj. dhe mbeten jashtë tyre njësi të tilla leksikore si: *laskandur, sahishtë, skorovod, drethkë, fërmon, kamai, kanare, krezhë, marmaros, ngrafis, namëna, tërhas, traminë, zgëllij, xhaftoj, sinjak* etj. Disa prej këtyre fjalëve kanë gjegjëset e tyre letrare e disa nuk i kanë, por sidoqoftë disa syresh vlen të pasqyrohen në fjalorë, si për shembull fjalët: *karabatak, torozhan* të cilat emërtojnë lloje zogjsh karakteristike të krahinës, *damf* që emërton aromën dehëse të rakisë e të verërave etj.

Si fjalë që presin pas derës për të hyrë ndër fjalorët e shqipes duken veçanërisht, kategoria e fjalëkrijimeve, të tilla siç janë emrat: *burrth, burojë, bërtimë, dekunë, delmator, drekëtar, gostiar, hobetar, mëshirtar, mysafirkë, ndragësi, nënurdhës, pagëtyrë* etj.

Do të veçonim një fjalëkrijim interesant siç është leksema *nënurdhës* të cilën duket se autori e ka krijuar sipas gjedhes së fjalës *nënkëmbës*, por e veçanta është se ajo, ndryshe nga e dyta, mbart edhe një ngarkesë ironie e talljeje për tipin e njeriut që i rri gatitu për çdo gjë personit që ka një pozicion hierarkik lart tij. Për shembull: Qyqja... po grishte për drekë *nënurdhësit* e Kuma Maros. (Vepra 4, f. 323).

Do të ishte me interes të veçantë përfshirja në fjalorët e shqipes sidomos e disa neologjizmeve në formën e mbiemrave të cilët më së shumti janë stilistikorë, të tillë si: *begatore, i bryllët, i bunghtë, i bërlyktë, i krirtë, i murrtuar, i ndërdyshëm, pjellëtoare, vrapëtare* etj. Po kështu për përfshirje në fjalorët e shqipes mund të diskutohet edhe për disa fjalëkrijime në formën e ndajfoljeve të cilat shprehin një kuptim më të intensifikuar apo më të ekonomizuar si: *gogolce, maçokce, njëmenthi, qetas, zuzarçe* etj.

Vlejnë të futen në fjalorët e shqipes edhe disa fjalëkrijime onomatopeike siç është rasti i fjalës *dang(u)*, megjithëse e ka fjalën e saj gjegjëse *shul* etj., si dhe e disa të tjerave si: *tërtëllashkë* (femër që flet shumë e pa brumë), *dëdëckat* (të dridhurat), *zhingërin* etj.

Në fund, përmbledhtas, mund të thuhet se ndihmesa më e madhe e Kutelit në pasurimin e gjuhës letrare shqipe, qëndron:

së pari tek prurjet në fushën e leksikut të veçantë si ai në fushën e etnografisë, në fushën e etnobotanikës e të etnozoologjisë për të cilën folëm edhe më herët;

së dyti në prurjet e leksikut të fushës së fjalëformimit ;

së treti prurjet në fushën figurshmërisë dhe frazeologjisë, por me vlerën dhe sasinë e këtyre të fundit nuk u ndalëm, meqënëse ato për nga shumëllojshmëria e cilësia kërkojnë një studim më vete.

ISA BAJÇINCA

NË 40-VJETORIN E KONGRESIT TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Po të më pyeste ndokush se ç' do të mund të thosha për Kongresin e Drejtshkrimit dhe vendimet që po merreshin atë ditë të lagësht nëntori, kur po mbyllte punimet me Rezolutën dhe përqafimet e duartrokitjet, në një përvjetor, sikur është ky, ndoshta nga fjalët e para që do të nxirrja, do të ishin: “Ngjarja më e madhe për gjuhën shqipe dhe për bashkimin kombëtar të të gjithë shqiptarëve në gjuhën dhe në kulturën...”, kurse sot, natyrisht ndjekur nga një *Eh, kush e di nëse...*

Kumtesën që lexova në 25-vjetorin e Kongresit, e filloja kështu: “Të flasësh për një çështje kaq të shenjtë e kaq të rëndësishme në rrafshin gjithëkombëtar, siç është shqipja letrare (e njësuar), dhe kjo në një përvjetor të saj, doemos do të gjendesh në një dilemë veshur në emocione dhe, njëkohësisht të kaplon një si frikë në mos do të thuash diçka që nuk duhej thënë dhe, sidomos, në mos do të lësh pa thënë diçka që duhet të thuhet patjetër...”.

Dhe, duke ndjekur diskutime, debate dhe jo rrallë edhe vështrime kritike e ide deri absurde, të thëna nga gojë intelektualësh, por dhe gjuhëtarësh (disa dhe pjesëmarrës të Kongresit) për rrugën që paska ndjekur standardizimi i shqipes, ose më mirë, sesi paskësh përfunduar në punimet e Kongresit të Drejtshkrimit, nuk ke si të mos mbetesh me gojë hapur: Vallë, janë të bindur vërtet për ato që thonë për shqipen, apo kanë ndonjë motiv a ndonjë shtysë tjetër ... Dhe, duke i njohur këto zhvillime dhe disa qëndrime dhe të ndonjë institucioni (edhe nga ato qëndroret) në qershor 2012, në Javën Albanologjike të Institutit Albanologjik, jo pa një si parandjenjë, do të theksoja:

“Dua të besoj që institucione (Akademitë, universitetet, Lidhja e Shkrimtarëve, televizionet publike, shoqata të gjuhës shqipe, ente e organizma shkollorë e të tjerë), do ta shënojnë këtë përvjetor, 40-vjetorin, me një veprimtari të ngjeshur, në radhë të parë që të shihet nëse standardi i krijuar në Kongresin e Drejtshkrimit gjeti zbatimin e tij në praktikë sipas pritshmërisë, nëse ka një shkallë të lakmueshme të zotërimit të standardit dhe të përdorimit të tij në institucione, sikur janë shkollat, në mediat elektronike e shtypi, në jetën kulturore – teatri, botimet letrare e shkencore, institucionet shkencore e organizmat shtetërorë – ministritë, Kuvendi, gjykatat, materialet e tyre të botuara, duke nisur nga Kushtetuta e ligjet, për t’u shtrirë deri tek njoftimet e shpalljet publike, fletëthirrjet nga organe civile e policore, fletëpagesat e forma të tjera të komunikimit publik. Nëse ka dështime në këto rrafsh, të diskutohen arsyet e ngecjeve, por dhe forma e mënyra për të ngritur shkallën e kulturës së gjuhës e të komunikimit, si dhe të merren masa konkrete për të organizuar forma që do të mund të sillnin rezultate në këtë drejtim....”.

Për këto arsye që shtrova këtu, Universiteti i Korçës, për mendimin tim, me organizimin e kësaj Akademie..., sa e nderon Kongresin e Drejtshkrimit, po aq, ndoshta dhe më shumë nderon këtë institucion të lartë të arsimit, sepse, me këtë veprimtari u shprehet një falënderim në mënyrën më dinjitoze, jo vetëm atyre që përgatitën, diskutuan dhe morën vendime për standardizimin e shqipes në Kongresin e ‘72-it, po dhe të gjithë intelektualëve: shkrimtarë, gjuhëtarë e veprimtarë vështrimqartë e mendjendritur ndër breza, të cilët punuan dhe sakrifikuan, e pasuruan dhe e spastruan gjuhën shqipe dhe e deshën aq shumë, një

dashuri, jehona e së cilës duket sikur është e gjallë dhe endet në librat po dhe majave të bjeshkëve tona për të mbjellë farën e saj tek brezat e ardhshëm...

Kujtoj që, sa herë të marrim të diskutojmë për rrugën që ka ndjekur shqipja në zhvillimet e saj, për probleme të veçanta – fjalë e trajta fjalësh, çështje të shkrimit e të shqiptimit, forma e alternativa dhe diversitete (një nocion shumë i pëlqyer nga diskutues, sidomos të rinj), para se të shfaqim ndonjë dyshim, të japim ndonjë propozim për ndryshime eventuale (ose dhe plotësime), gjithnjë duhet të mbajmë parasysh, krahas synimit për të ruajtur njësinë, edhe konsideratën për mundin e dijen që kanë derdhur brezat para nesh.

Fundja, kulturat e mëdha, qytetërimet, sot modele për t'u ndjekur nga të gjithë, a nuk shquhen për faktin se gjithnjë, brezi që vjen mbështetet në arritjet para tyre dhe jo në shembjen, për të vënë themele të reja.

Në këtë sihyrje (që duket e gjatë), dua të theksoj dhe dy nga kërkesat që janë ngritur shpesh, për mendimin tim, më shumë sa për të justifikuar kundërshtimet e autorëve të tyre për mënyrën e standardizimit dhe vetë standardin. E para, shqipja sikur qenka standardizuar në kushte të pafavorshme politike, në sistemin totalitar dhe jo në një demokraci të mirëfilltë dhe, e dyta, dialekti i gegërishtes pothuaj qenka përjashtuar nga standardi.

Unë nuk di që ndonjë gjuhë të jetë standardizuar në një demokraci të zhvilluar, sa kohë që madje ndonjë gjuhë të ketë vënë themelet e standardit edhe në shoqëri skllavopronare (arabishtja), kurse shumë të tjera në periudha të mëvonshme, po jo në shoqëri demokratike. Fundja, të mirat kombëtare nuk maten as mbi faktin se kur janë krijuar dhe as nga kush janë krijuar, po sa përmbushin atë për çka janë krijuar dhe sa janë të hapura për t'iu përshtatur kërkesave të kohës.

Në qoftë se në vitet '70 - '80 zhvilloheshin herë pas herë debate e diskutime në sesione e konferenca shkencore, për probleme të zbatimit të shqipes standarde në jetën publike të zotërimit në shkollë, dhe, ç'është e drejta, bëheshin përpjekje të mëdha për shtrirjen dhe ngritjen e shkallës së zotërimit dhe zbatimit të standardit, nga fillimi i viteve '90, nisën diskutime, shpesh të zhurmshme, disa herë nga studiues, sigurisht jo gjithmonë për të mirën e shqipes dhe të njësisë së saj, po më shumë nga të tjerë intelektualë dhe analistë e gazetarë, shumë prej të cilëve duket që në shqipen standarde synonin të derdhnin tërë pezmin që kishin mbledhur ndaj sistemit socialist totalitar, ndaj krimeve e veprimeve edhe në fushë të kulturës, sepse shqipen e njësuar e konsideronin prodhim të atij sistemi. Nuk shihej standardi i shqipes në strukturën tërësore, sikur nuk zgjonin ndonjë interes për ta elemente të dy ish-varianteve të shqipes letrare që, në njëfarë mase, ishin shkrirë në shqipen standarde, duke hapur mundësi potenciale për prurje të vazhdueshme nga idioma më të ulëta se standardi, po e tëra shikohej nga këndi se çfarë ishte përjashtuar nga standardi, më shumë duke e vështruar përballë të folmeve të veçanta të dialektit të gegërishtes.

Këtë do ta konsideronin të keqen më të madhe dhe shkakun pse një pjesë e gegërishtfolësve, dhe sidomos e kosovarëve, nuk paskan arritur dot ta zotërojnë këtë standard, i cili, fjala e tyre, na qenka i huaj për ta. Krahas paskajores, e cila madje është quajtur nga dikush edhe "palca kurrizore e shqipes", janë ngritur dhe kërkesa të tjera për të thjeshtësuar drejtshkrimin e shqipes dhe kjo sikur mendohet se duhet bërë duke kufizuar shumë përdorimin e ë-së së patheksuar në shkrim, gjithnjë duke u mbështetur në shqiptimin; me fjalë të tjera, duke shtrirë zbatimin e parimit fonetik në dëm të parimit morfologjik, i cili synon të ruajë morfemat, pavarësisht nga shqiptimi.

Në tërë këtë, më se një herë, çështjet shtrohen sikur ne të jemi në fazën e standardizimit të një gjuhe të paqenë, të një gjuhe të trandur në themele, prandaj shpesh jepen propozime për ndryshime mbi kritere (sidomos fonetike), që nuk gjejnë mbështetje në tërë shqipen, dhe sidomos jo në ligjërimin e standardit.

Ata që propozojnë ndryshime të ndjeshme në shkrimin e shqipes, nuk mbajnë parasysh faktin se, me anë të ndryshimeve (të mëdha sikur i duan ata), jo që nuk e lehtësojnë dot shkrimin e shqipes, po do ta ngatërrojnë e vështirësojnë shumëfish. Kjo gjendje shkakton dhe një huti të përgjithshme. (Dua të përmend në parantezë një dilemë për një nga pasojat e mundshme në këtë huti që kanë prodhuar disa nga diskutimet e propozimet, deri edhe të atyre të Këshillit Ndërkademi: Një mësuese e shqipes nga një shkollë e rrethit të Vushtrrisë, disa ditë para zhvillimit të konkursit të kulturës së gjuhës “Gjuhëtari i ri”, me telefon, më shtroi këtë pyetje: Do t’i korrigjoni testet sipas Drejtshkrimit të Shqipes apo sipas Fjalorit të Drejtshkrimit të autorëve Dhrimo dhe Memushaj?)

Duke ndjekur propozimet që janë dhënë (në diskutime, në disa nga konferencat, në debate televizive, në Këshillin Ndërkademi, në Fjalorin Drejtshkrimor të Shqipes, 2011), dua të vë në dukje, fare shkurt, dy-tri çështje.

1. Shkrimi i emrave mashkullorë/asnjanës. Për mendimin tim, ka dy arsye pse këta emra duhet të shkruhen me *ë* fundore:

E para, është tradita e gjatë dhe shqiptimi i shumicës së tyre (parimi fonetik) krejtësisht identik me emra të gjinisë femërore: *burrë/furrë; djalë/fjalë; mjaltë/baltë; ballë/shkallë, rrallë; kalë/valë; gjumë/shumë* e të tjerë, pra sipas parimit morfologjik. (Ndoshta mund të diskutoheshin emra, si: *lum, lëm, djath* e ndonjë tjetër).

E dyta, kjo çështje nuk mund të shihet ndarazi nga shkrimi i emrave të gjinisë femërore (me rrokje tejfundore të theksuar, po të përdorej *ë*-ja fundore në shkrim), të cilët as që i diskuton kush, sado që, sipas parimit morfologjik, duhen shkruar me *ë* fundore. Le të krahasohen me emrat mashkullorë: *ndrikull, vetull/popull* (madje: *rregull-i/rregull-a*); *flutur* e të tjera dhe fjalë të huaja: *kurrikul-a, oper-a, kamer-a*. Fundja, fjalët e huaja, le të vendosim t’i shkruajmë si të duam, por të shqipes nuk mund të përjashtohen. Pra ato, po të ndiqeshin qëndrimet e shfaqura në Fjalorin Drejtshkrimor të autorëve Dhrimo-Memushaj, do të duheshin shkruar sipas parimit morfologjik, sikurse *burr!*)

Dhe, më tutje, po të ndiqej ky parim, do të shtrihej deri tek shkrimi i foljeve në shumësin e së kryerës së thjeshtë: *lamë/shkruam, latë/shkruat, lanë/shkruan; blemë/ndiem, kthjem* e të tjera.

2. Lidhur me shkrimin e *ë*-së paratheksore tek fjalë të prejardhura si: *miqësi, ligjësi, bujqësi*, dua të theksoj që, shkrimi pa *ë* i fjalëve të këtij tipi mund të prodhojë dhe asimilim tingujsh në shqiptim, si: *qetësi/qetsi – qeci!* etj. Dhe, më tutje, në raste kur tema është më *e* të patheksuar, si: *vetëdijësim (vetëdije), sipërfaqësor (faqe)* e të tjera, a nuk shkaktojnë më shumë ngatërime sesa lehtësime?!

3. *Ë*-ja e paqendrueshme. Ndoshta me të drejtë duhet shtruar përdorimi ose jo i mbiemrave që formohen me prapashtesën *-të* (*-ët* për shkak të lehtëshqiptimit), sepse kushti i vështirëshqiptimit zhduket në rrokje të hapur: djem të *shkathët*, po vajza të *shkathta*, ujë i *cekët*, po ujëra të *cekta...*; ndonëse, në qoftë se do të grumbulloheshin bashkëtingëllore karakteri të ndryshëm, si: *i dobët/e dobët/të dobëta*, po sidomos grupe bashkëtingëlloresh, si:

i belbët/e belbëta, i përbashkët/e përbashkëta, kjo *ë* duhet ruajtur, sepse shfaqen vështirësi shqiptimi.

Në fund, dua të shpreh shqetësimin tim sepse ne sikur po merremi shumë me drejtshkrimin dhe jo me çështje të tjera që janë shumë më të rëndësishme, si: leksiku i varfëruar, shtrirja e fjalëve të huaja pa kriter, struktura sintaksore sidomos të tipit: *abuzon* dhe *abuzimi* (me qenie njerëzore) deri tek “*janë zhgënjyer/të zhgënjyer* me vendimin e senatit”, “*u magjepsën me bukuritë e papara*”, “*nuk udhëhiqet kështu me ekonominë e vendit*” e margaritarë të tjerë (tipike për shqipen në Kosovë dhe në Maqedoni) – për Qendrën Universitare të Prishtinës, sikur e quaj unë.

Dhe më tutje, kjo sidomos në Shqipëri (me përpjekje që të shtrihen edhe në Kosovë) dukuri të tilla si:

-përdorimi vetëm i trajtës së shkurtër *i* edhe për shumësin (Kjo çështje *i* përket ***të gjithëve***);

-përdorimi i përemrit ***kush*** edhe për sende e emra abstraktë (***Kush*** është ***çështja*** kryesore? ***Kush këngë*** të pëlqen më shumë?);

-përdorimi i trajtave të kallëzores të përemrave vetorë të vetës së parë e të dytë njëjës me parafjalët ***nga, tek (nga mua/tek mua, nga ty/tek ty)*** e të tjera.

Sikur vura në dukje jo vetëm unë, për standardin duhet punuar shumë, por gjithnjë me shumë kujdes, sepse duhet të kemi parasysh dhe atë thënien e mençur popullore: “Për t’i ndrequr vetullën, i nxori syrin”!

KONSULTAT GJUHËSORE DHE PËRVJETORI I KONGRESIT TË DREJTSHKRIMIT

Në jetën kulturore dhe shoqërore të popujve ka ngjarje të veçanta, që në dukje të parë janë të rëndomta, madje edhe me emërtime të thjeshta, që kanë rëndësi dhe shënojnë kthesa të vërteta afatgjata për ardhmërinë e atyre popujve. E tillë është, Konsulta e Prishtinës e vitit 1968, që si një këshillim i rëndomtë i gjuhëtarëve, i mësimdhënësve dhe i intelektualëve të tjerë, përfaqësues të institucioneve shkencore, mësimore, botuese, pastaj të revistave e gazetave, mori vendime me ndikime afatgjata për interesin e përgjithshëm kulturor të një pjese të kombit tonë. Këto vendime ishin të qarta dhe të drejtpërdrejta, sepse synonin që në Kosovë të zbatohen rregullat gjuhësore dhe drejtshkrimore të gjuhës shqipe të parapara në Projektin që e kishte hartuar komisioni profesional i gjuhëtarëve në Tiranë. Në këtë mënyrë Kosova po bënte një hap vendimtar drejt forcimit të integritetit të saj kombëtar dhe po hapte rrugën e sigurt të zhvillimit në planin e përgjithshëm arsimor e kulturor brenda identitetit të saj të pandashëm të etnisë shqiptare. Ky vendim ishte një përcaktues i kahershëm në rrugën e zhvillimit dhe të bashkimit kombëtar të popullit tonë.

Kosova kishte ecur në vazhdimësi në këtë rrugë, sepse i kishte përcjellë rregullisht ecuritë e veçanta të përpjekjeve gjithëkombëtare për njësimin e gjuhës dhe zhvillimin e traditës kulturore unike të popullit tonë.

Kështu, mund të konstatojmë se të gjitha këshillimet gjuhësore që janë mbajtur në Prishtinë, duke filluar nga ai i vitit 1952 e deri te Konsulta gjuhësore e vitit 1968, kanë pasur paraprijës tubimin identik në Tiranë.

Që në vitin 1952, në Konsultën e parë gjuhësore në Prishtinë ishte e pranishme tendenca përfruese ndërmjet dy dialekteve kryesore të shqipes për gjuhën e përbashkët të shqiptarëve, e cila iu ishte kundërvënë me argumente të arsyeshme ideve kufizuese të së ashtuquajturës *pangegënishte*, të përfaqësuar atëherë nga gjuhëtari Selman Riza. Pos të tjerave, polemikat rreth kësaj teme ishin bërë edhe objekt i një tregimi satirik të shkruar nga Ramë Zuka (pseudonim i Zekiria Rexhës), që me titull “Për çka e patën” është botuar në revistën letrare “Jeta e Re”.

Pra, intelektualët e Kosovës që nga fillimi e kanë vijuar rrugën unfikuese të gjuhës e cila është ndjekur institucionalisht në Shqipëri. Kështu, ka ndodhur që në Tiranë të mbahet këshillimi për gjuhën në vitin 1956, kurse fill pas tij, në Prishtinë, më 30 dhe 31 maj 1957, është mbajtur mbledhja e gjuhëtarëve në të cilën ka ecur përpara gjithashtu procesi i përcaktimit të disa parimeve për njëjtësimin e drejtëshkrimit të shqipes. Në këtë drejtim shqiptarët në Maqedoni kishin bërë një hap edhe më përpara, sepse në gazetën e tyre “Flaka e vëllazëimit” kishte filluar të zbatohet drejtshkrimi identik me atë të shqipes që përdorej në Tiranë. Vlen të theksohet në këtë rast, se përgjegjësit e kësaj gazete bënë propagandë që edhe në Kosovë të veprohej në këtë mënyrë. Në një vizitë që studentët Katedrës së Albanologjisë nga Prishtina i kishin bërë redaksisë së kësaj gazete, redaktori i saj, Reis Shaqiri, pos të tjerave, kishte pohuar: “Në nuk mund të bëhemi profetë dhe të dimë se si do të vijin punët e shqiptarëve në të ardhmen, por është detyra e jonë të ecim drejt bashkimit...”

Konsulta vijuese gjuhësore, e treta me radhë në vazhdimësi të kësaj periudhe, e njohur si mbledhje e "*lëvruessve të gjuhës shqipe, e arsimitarëve dhe e intelektualëve të tjerë*", e mbajtur në Prishtinë më 14, 15 dhe 16 janar 1963, vjen fill pas një aktiviteti të ngjashëm që ishte bërë një vit më parë në Tiranë. Edhe kjo mbledhje kishte synime të qarta për afrimin e dy kryedialekteve brenda gjuhës letrare shqipe, mbase edhe për njësimin e plotë të drejtshkrimit, por ndërhyrja e faktorit politik i zmbropsi për pak kohë prirjet e tilla që të përvetësohet drejtshkrimi i shqipes, i cili zbatohet në atë kohë në Tiranë. Megjithatë, edhe ky këshillim për gjuhën shqipe kishte ecur në drejtimin e duhur. Këtë e dëshmon edhe botimi *Rregullat e drejtshkrimit të shqipes*, të cilin e hartoi një komision i zgjedhur në këtë Konsultë, që është botuar në Prishtinë më 1964.

Konsulta e Prishtinës e vitit 1968 që mbahej një vit pas hartimit të "*Projektit të rregullave të drejtshkrimit të shqipes*", e realizoi synimin për njësimin drejtshkrimit të gjuhës sonë, duke miratuar unanimisht këtë projekt të rëndësishëm në fushën e zhvillimit të përgjithshëm kulturor dhe shoqëror të mbarë popullit shqiptar.

Duke i pasur parasysh rrethanat e përgjithshme kulturore dhe shoqërore në zhvillimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare jashtë Shqipërisë shtetërore, mund të pohohet me të drejtë se për shqiptarët e Kosovës Kongresi i Drejtshkrimit i viti 1972, pati vetëm karakter promovues ceremonial, sepse puna e njësimi të shqipes ishte bërë në Prishtinë më 22 dhe 23 prill 1968.

Në këtë vit jubilar të dyzetvjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit dhe të 100-vjetorit të shtetit shqiptar, nuk duhet të harrohet edhe një ngjarje fort e rëndësishme, e organizuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës. Ishte simpoziumi shkencor me temën *Probleme aktuale të kulturës gjuhësore dhe të drejtshkrimit të shqipes*, i mbajtur në dhjetor të vitit 1980, në të cilin me një varg kumtesash dhe me diskutime të frytshme u trajtuan çështjet aktuale të shqipes standarde dhe të zbatimit të drejtshkrimit të saj unik. Brenda tre ditësh, sa zgjati ky simpozium, një ndihmesë të madhe dhanë sidomos tetë gjuhëtarët më të shquar nga institucionet shkencore dhe arsimore të Shqipërisë, të udhëhequr nga prof. Androkli Kostallari. Është thënë me të drejtë atëherë, se ky tubim mund të quhej edhe *Kongres i gjuhës shqipe*, sepse pati efekte afatgjata për përvetësimin e normës gjuhësore, si në Kosovë, ashtu edhe në viset e tjera shqiptare.

Duhet pohuar se tradita e konsultimeve për çështje gjuhësore ka vazhduar edhe më vonë edhe pas Kongresit të Drejtshkrimit. Kështu më rastin e 20-vjetorit këtij Kongresi, një këshillim i përbashkët i gjuhëtarëve shqiptarë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia është mbajtur në Tetovë, në verë të vitit 1992.

Në rrethanat e atëhershme të keqkuptimit të përgjithshëm të demokracisë, edhe në radhët e gjuhëtarëve të Shqipërisë kishte depërtuar ideja se duhej të përmysej çdo gjë nga e kaluara, prandaj duhej rishikuar edhe çështja e vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimit. Me gjithë qëndrimin e palëkundur të prof. Shaban Demirajt, që ishte në atë kohë në krye të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe të një pjese të përfaqësuesve të institucioneve shkencore, midis të cilëve ishte edhe drejtori i atëhershëm i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, prof. Jorgo Bullo, disa nga gjuhëtarët e Shqipërisë, thua se bënin gara se kush do të jetë më i zëshëm që ta kundërshtojë qëndrimin tonë, (kupto të pjesëmarrësve në këshillim nga Kosova dhe Maqedonia) se "nuk duhet të preken bazat mbi të cilat janë kodifikuar normat e drejtshkrimit të shqipes letrare". Si duket përmbysjen e vendimeve të Kongresit të

Drejtshtkrimi, ata e kishin kuptuar me gjasë si punë tashmë të kryer , si “fitore të pritshme të Demokracisë”(?!), prandaj ishin aq të zellshëm, sepse dëshironin të dëshmoreshin para “pushtetit demokratik” se ishin deklaruar për ndryshimin e normës gjuhësore qysh nga ky këshillim në Tetovë.

Dihet tashmë se si kishte përfunduar Konferenca shkencore kushtuar 20-vjetorit të Kongresit të Drejtshtkrimit dhe ndihmesa e veçantë e pjesëmarrësve nga Kosova, Maqedonia dhe diaspora për suksesin e saj. Këta përfaqësuesve të “demokracisë”, atëherë mbetën krejtësisht të vetmuar, sepse nuk iu pati bërë dobi as “pamfleti” i (tash i të ndjerit), Arshi Pipës, të cilin disa e konsiderojnë ende si “baba të gjuhësisë dhe si bard të kulturës shqiptare”. Ata mbetën të vetmuar me vajin në buzë sidomos për ”paskajoren”, e për shumë “vlera” të tjera dialektore e nëndialektore të gegënishtes, thua se ajo ishte gjuhë e veçantë, diçka si pronë private (?!) dhe nuk i përkiste shqipes sonë të përbashkët.

Mentalitetet e kufizuara krahinoriste që u goditen me të drejtë atëherë, nuk heshtën, por vazhduan “të punojnë” me zell, duke shpresuar se një ditë do t’ia arrijnë qëllimit që “ta nxjerrin në dritë” të vërtetën për “gegnishten e nëpërkëmbur” dhe të lirohen njëherë e përgjithmonë nga “gjuha e regjimit të Enverit dhe e toskobizantinëve përfidë”.(?!)

Koha kur Kongresi i Drejtshtkrimit po i afrohej përvjetorit të dyzetë, solli një ngjarje të paparë: “konferencën shkencore”, të mbajtur nga 15 deri më 18 dhjetor 2010 në Durrës, të kontestuar instucionalisht nga institucionet shkencore dhe mësimore, si në Tiranë ashtu edhe në Prishtinë, pastaj edhe individualisht nga albanologët tanë të shquar, midis të cilëve ishin edhe autoritet e pakontesueshme shkencore si: prof. Shaban Demiraj, prof. Kristo Frashëri, prof. Idriz Ajeti e të tjerë.

Kjo e ashtuquajtura konferencë që në zanafillë, mund të konsiderohej e dështuar, sepse e mbolli farën e përçarjes, duke i përjashtuar dhe diferencuar, jo vetëm individët, por edhe institucionet shkencore e mësimore, për t’ia hapur shtegun jo përmirësimit të standardit të gjuhës, por variantizimit,ristandardizimit, ose thënë më troç, përmbysjes së tij me anë të një terapie me veprim më të ngadalshëm shpartallues...

Dihet se gjuha si organizëm i gjallë (bashkë me dialektet e saj), i ka ligjet e zhvillimit të saj dhe do të ecë në rrugën e përcaktuar të domosdoshme zhvillimore, e cila është e përbashkët për gjuhët e të gjithë popujve të qytetëruar. Hullitë e këtij zhvillimi mund t’i vërejnë e t’i studiojnë vetëm dijetarët e mirëfilltë që kanë pikëvështrime larghedhëse, e jo ata që nuk mund të shkoqen nga mendësia e ngushtë krahinoriste, që kurrë nuk do të lirohen nga prapavështrimi dhe egoizmi.

Çdo kombi i qytetëruar e ka edhe gjuhën e përbashkët standarde apo edhe zyrtare, që përdoret në shkollë, në libra shkencorë, në letërsi, në administratën publike e shtetërore, në medime dhe përgjithësisht në jetën publike. Prandaj, duhet ta kenë të qartë që të gjithë shqiptarët se gjuha shqipe e njësuar nuk u bë më 1972, por ajo filloi të bëhet e tillë që nga filltet e saj si manifestim i përbashkët i sistemimit të vlerave të një bashkësie e, në mënyrë të veçantë, që nga dita e shkrimit të dokumentit të parë në këtë gjuhë. Ajo vazhdon të njësohet edhe sot e kësaj dite dhe do të njësohet edhe në të ardhmen bashkë me njësimin e kombit tonë që sot, fatkeqësisht, jeton duke qenë popull vendës me lidhje të pashkëputura territoriale, në gjashtë shtete brenda territorit të Ballkanit dhe në diasporën e tij shumë të përhapur në të gjitha kontinentet. Prandaj, jemi thellësisht të bindur se edhe në të ardhmen do të dështojnë të gjitha prirjet prapakthyese të kuazikomisionëve, qofshin ato edhe “ndërrakademike”, për të

krijuar variante te reja standarde mbi bazën dialektore të gegnishtes e , madje, edhe “idetë” donkishoteske për krijimin e kombit kosovar.

DISKUTIMET PËR STANDARDIN DHE PERCEPTIMI I TYRE

Kohët e fundit është zhvilluar një valë diskutimesh rreth shqipes standarde. Bartës të këtyre diskutimeve, autorë, kryesisht larg dijes shkencore në fushë të gjuhësisë, kanë bërë objekt sulmi dy nga vlerat më të rëndësishme të kombit: gjuhën shqipe dhe Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972), i cili ligjësoi standardin e saj. Në të vërtetë, sulmet nga më të ndryshmet kundër shqipes standarde dhe Kongresit të Drejtshkrimit nuk kanë munguar asnjëherë¹⁴⁰, por ato vinin nga provenienca kryesisht të marginalizuara (migracioni shqiptar)¹⁴¹ dhe të kufizuara (shkolla dhe politika serbe, krah të të cilëve u bënë një grusht i vogël shqiptarësh)¹⁴².

Si duket, diskutuesve të standardit duhet t'ua kujtojmë se në historinë e popullit shqiptar Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972) dhe Konsulta e Prishtinës (1968), krahas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë (1912) dhe çlirimit të Kosovës (1999), janë ngjarjet më të rëndësishme kombëtare të shekullit XX, që shënojnë jetën kombëtare dhe sendërtojnë unitetin e identitetit të popullit shqiptar. E dimë ndërkaq, se përpjekja për përmbysjen e këtyre institucioneve historike dhe për riorganizimin e shqipes standarde mbi baza të tjera, duke përfshirë këtu edhe ngritjen e një standardi të ri për nënshtetasit e Republikës së Kosovës, do të kishte pasoja largvajtëse në çintegrimin e të gjithë përbërësve kulturorë, mendorë, ekonomikë dhe madje shpirtërorë të popullit shqiptar, për të cilët është punuar shekuj me radhë.

Shqetësim përbëjnë prurjet e reja, diskutimet aspak shkencore dhe përpjekjet tepër të rrezikshme për përmbysjen e arritjeve më të mira të shqipes standarde dhe për krijimin e një varianti letrar të gegërishtes standarde dhe përtej tyre i një kosovarishteje letrare. Ne konsiderojmë se përballë këtyre koncepteve do të tristoheshin jo vetëm etërit e gjuhës shqipe të periudhës së Rilindjes: Naim Frashëri, Konstandin Kristoforidhi, Faik Konica, Gjergj Fishta e të tjerë, po edhe ata të veprave të para të gjuhës shqipe: Gjon Buzuku, Frang Bardhi e Pjetër Bogdani me të tjerë.

Nuk e di si do të reagonin tre shekuj më vonë pasardhësit tanë, kur të diskutojnë sjelljen e brezit tonë ndaj gjuhës shqipe, por nga këndi i njohjes së zhvillimit të gjuhëve tre shekuj më parë, e di si do të reagonin filozofët, filologët, shkrimtarët e bardët e gjuhësisë universale: Francesco Soave, Leibniz, Rimbaud etj., dhe e di si do të reagonin shkrimtarët e parë shqiptarë të cilët punuan aq shumë për mosbdarjen e gjuhës shqipe.

Propaganduesve të ndarjes së gjuhës shqipe sot nuk u mjafton ndarja e popullit shqiptar në shtete të ndryshme politike, nuk ju mjafton ndarja me kufij politikë, veçse vazhdojnë në mënyrën më anakronike t'i propagandojnë kufijtë e vjetër krahinorë, etnografikë, fisnorë dhe

¹⁴⁰ Shih tekstet e Arshi Pipës dhe të disa autorëve shqiptarë të mërgatës shqiptare në mbrojtje të gegërishtes në njërën anë dhe tekstet kryesisht politike të studiuesve e politikanëve serbë kundër bashkimit të shqiptarëve të ish-Jugosllavisë në përdorimin e shqipes së përbashkët standarde që më 1968.

¹⁴¹ *The Politics of Language in Socialist Albania*, New York, 1989.

¹⁴² Shih tekstet e Sefedin Sulejmanit (Shkup), Halit Ternavcit (Beograd), Sinan Hasanit (Beograd/ Prishtinë) etj.

fetarë të popullit shqiptar e të pasurisë materiale e shpirtërore të tij, në kohën kur Evropa vazhdon t'i bëjë të padukshëm edhe kufijtë shtetërorë a ideologjikë të shekullit XIX e XX, për të cilët ka investuar shumë në pikëpamje intelektuale, filozofike, kulturore, politike, ekonomike dhe shtetërore. Propaganduesit e përkufizimeve të reja krahinore të shqipes vazhdojnë t'i shquajnë kufijtë etnografikë, në kohën kur Evropa vazhdon të rrënojë mure shumë të larta, për të cilat ka investuar djersën e disa popujve, të disa dekadave dhe madje të disa shteteve.

Në kohën kur filozofët, historianët, filologët, kulturologët dhe madje teologët, bëjnë përpjekje për të bërë sintezën e përbërësve të Bashkimit Evropian nën parullën “Duke bërë Europën”, nga Herodoti e deri te ideatorët e shekullit XX¹⁴³, ‘intelektualët tanë’ bëjnë përpjekje për të rrënuar pa ndjenjën më të turpshme të vogëlsisë së tyre, të gjithë atë që është sintetizuar gjatë shekullit XX në shkollën evropiane dhe shqiptare, për të provuar më tej një përpjekje të re në themelimin e një ‘identitetit të ri’ (kosovar) e të një gjuhe të re (kosovarishtes). Kujt i duhet sot përpjekja për identitet dhe gjuhë në Kosovë. Sigurisht disa prej tyre, këtë nesër do t’jua atribuojnë konstitucionalistëve të shtetit të Kosovës, gjë që nuk është aspak ashtu. Edhe konstitucionalistët më pak të njohur me dijen elementare të bërjes së shtetit e dinë sa e vështirë ka qenë njohja e prejardhjes ilire dhe e gjuhës së tyre, gjuhës së shqiptarëve deri në mesin e gjysmës së parë të shekullit XX, pavarësisht se këto teza i atribuohen më shumë shkollës gjermane-austriake se sa shkollës shqiptare. Për shkak të dokumenteve shumë të vona të shqipes së shkruar edhe përkrahësit më të flaktë të prejardhjes së popullit shqiptar nga ilirët, mbështetjet e tyre i bëjnë kryesisht në emra njerëzish e emra vendesh, duke e ndërlikuar kështu gjuhën më shumë me gjetjet arkeologjike se me zhvillimet e brendshme të saj¹⁴⁴. Pavarësisht prej teorive, shkollave dhe projekteve gjuhësore individuale e institucionale, të cilat merren kryesisht me zhvillimin e brendshëm të shqipes dhe pothuajse me asgjë nuk cenojnë identitetet nacionale të popujve të vegjël, kohëve të fundit ka lëshuar degët e ndikimit etnohistorik e etnogjuhësor një dije e cila po bëhet pjesë e pandarë e teorive indoevropiane, e kjo është shkolla e sociologjisë së dijes me emrin “Athina e zezë”¹⁴⁵. Në vend që të ndjehemi mirë dhe madje të nderuar për vendin që dija evropiane na e ka siguruar me kohë në familjen eurpoiane dhe që ne të vazhdojmë të plotësojmë praninë tonë me vepra kryesisht të natyrës pragmatike (fjalorë, vëllime me trashëgimi etnohistorike, epos etj.), ne kthehemi në një gjendje të komunikimit gjuhësor, të cilën në parim e kishte tejkaluar pothuajse brezi i Rilindjes Kombëtare, si komunikim brezi i dekadës së parë të shekullit XX, dhe si normë brezi i gjysmës së dytë të shekullit XX: 1968/1972.

Bartësit e këtyre ideve në Shqipëri dhe në Kosovë janë kryesisht publicistë, që, më parë se të merren me çështjen e një gjuhe të re, janë marrë me krijimin e një kombi të ri, kombit kosovar; janë gjuhëtarë, që, më parë se të merren me gjuhën shqipe dhe strukturën e brendshme

¹⁴³ Gjerësisht shih, Umberto Eco, “Në kërkim të gjuhës së përkryer në kulturën evropiane (përktheu, Genc Lafa), Shtëpia botuese Dituria, Tiranë, 2008.

¹⁴⁴ Shih këtu, përveç studiuesve shqiptarë edhe ata të huaj, Enzo Gati, “Ilirët”, (Përkthyer nga Rudina Taraneshi e Amik Kasoruh), *Bargjini*, Tiranë, 2005 dhe Pedro Bosch-Gimpera “Çfarë thotë arkeologjia për popujt indoevropianë” (Përktheu Xhevat Lloshi), Botimet Dudaj, 2003.

¹⁴⁵ Shih diskutimin e gjerë të teorisë ariane në veprat e Martin Bernalit, të përmbledhura në vëllimin “Athina e zezë (Rrënjët afro-aziatike të qytetërimit klasik wFabrikimi i Greqisë Antike 1785-1985), Përkthyer nga Dritan Thomollari dhe Ilirjana Angoni. Shtëpia botuese 55, 2009.

gjuhësore të standardit të saj, merren me paradigmat politike të saj; janë autorë tekstesh gjuhësore a publicistike, të cilët duke mos i njohur, a duke mos dashur t'i njohin parimet themelore mbi të cilat është krijuar standardi i sotëm i gjuhës shqipe, ankohen për mangësitë e tij, të cilat në parimet themelore të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972) paraqitin rregullat dhe synimet themelore të bazës së standardit. Në të vërtetë autorë të diskutimeve rrënuese janë pjesëmarrës të dikurshëm të Kongresit të Drejtshkrimit dhe politikanë të dikurshëm, të cilët më vonë hoqën dorë për shkaqe ekstrashkencore dhe ekstragjuhësore, si dhe një grusht të rinjsh, të cilët më parë se sa të merren me probleme të shqipes standarde nuk kanë treguar asnjë interesim dhe madje asnjë kujdes të veçantë për gjuhën si kulturë letrare, filozofike, kulturore dhe intelektuale¹⁴⁶. E vend, hapësirë dhe mundësi për të kontribuar në rezultatet e Kongresit të Drejtshkrimit kishte dhe ka edhe më tej edhe për brezin e ri.

Por brezi i ri problemin e standardit e shikon pa asnjë ngarkesë dhe pa më të voglin dyshim në rëndësinë historike dhe sidomos praktike që ka. Kohë më parë kam organizuar një test me 99 studentë të tri Programeve të Fakultetit të Edukimit (shkencat shoqërore, natyrore dhe teknologjike, të vitit të parë), me të cilin kam dashur të shoh gjendjen sociale dhe kulturore të njohurive të tyre me theks të veçantë mendimin që kanë ata për shqipen standarde.

Prej shënimeve të tyre teknike mund të shihet se ata vijnë kryesisht nga veriperëndimi dhe Rrafshi i epërm i Kosovës (komunat: Burim, Mitrovicë, Klinë, Drenas, Skënderaj, Vushtrri, Prishtinë, Albanik, Lipjan dhe Ferizaj). Ata kanë prejardhje sociale kryesisht rurale, prindër të arsimuar me shkollë të mesme apo më së shumti mësues në shkolla fshati, prej të cilëve kanë përvetësuar vlerat tradicionale kombëtare edhe në fushë të kulturës.

Përgjigjet e tyre kam arritur t'i sistemoj në tri rrafshe: trashëgiminë kulturore dhe arsimore në familje dhe në shkollë, literaturën e përsorur në shkollë dhe në shtëpi, si dhe mendimin e tyre për rolin e shqipes standarde në jetën e pritshme e në institucionet arsimore.

Prej përgjigjeve mbi trashëgiminë arsimore dhe kulturore të tyre kam konstatuar se ata kanë trashëguar biblioteka të djeguara në shkollë dhe në shtëpi nga Lufta e Kosovës dhe numër të kufizuar veprash letrare e shkencore përmes të cilave ata do të mund të ndërtonin komunikimin e tyre në shqipen standarde. Veprat që kanë lexuar ata janë kryesisht vepra që kanë

¹⁴⁶ Filozofi shqiptar nga Shkupi, Sefedin Sylejmani, duke diskutuar në pasditen e 24 nëntorit 1972 të seancës së katërt plenare, *Rreth Projektrezolutës së Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe*, në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, shprehte në trajtën më dogmatike kundërshtimin e tij për çfarëdo hapësire të shkrimit dhe shqiptimit të shqipes standarde, jashtë rregullave të përcaktuara nga Rregullat e Drejtshkrimit, diskutimin e tij e përfundonte në mënyrën më militante të dëgjuar në këtë Kongres: “Unë besoj se po t’i evitojmë këto gjëra që në moment na duken pak të vogla, do t’i mbyllem të gjitha shtigjet që të mos mbijë më bari i egër” (168-169). (Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, 20-25 nëntor 1972, I, Akademia e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1973, f. 168-169). Pikëpamjet e tij fillimisht dogmatike për shqipen standarde, dhe madje jo vetëm të saj në jetën shqiptare në Maqedoni dhe ish-Jugosllavi, Sejfedin Sulejmani do t’i përmbysë në emër të idealeve të jugosllavizmit, shumë here, pas demonstratave të vitit 1981. Ndërsa Sinan Hasani, atëherë nënkryetar i Kuvendit Federativ të Jugosllavisë, në të përditshmen federale të Beogradit “Borba”, të 5 korrikut 1981, “duke shkruar për nacionalizmin në kulturën shqiptare të Kosovës, preku edhe çështjen e formimit të gjuhës letrare shqipe, me të cilin shërbehen të gjithë shqiptarët në Jugosllavi. Sinan Hasani pas 13 vjetësh nga Konsulta e Prishtinës (1968), në të cilën tërë inteligjenca humaniste mori vendim për futjen e kësaj gjuhe letrare që është në përdorim sot, shprehu keqardhje “pse ka ndodhur kështu”. (Idriz Ajeti, “Për të vërtetën shkencore”, ASHAK, Prishtinë, 2006, f. 9).

lexuar edhe prindërit e tyre: letërsinë e Rilindjes, letërsinë sentimentale të viteve '30 në Shqipëri dhe viteve '60 në Kosovë. Pra, romane me temë sentimentale të viteve '30, të cilat i kanë lexuar edhe prindërit e tyre, që është edhe një dëshmi se edhe para Luftës së Kosovës bibliotekat e tyre nuk kanë qenë shumë të pasura. Fjala është kryesisht për veprat e shkrimtarëve Sterjo Spasse, Nazmi Rrahmani, Haki Stërmilli, Foqion Postoli, Ismail Kadare dhe më pak Jakov Xoxa e Rexhep Qosja: *Kështjella*, *Sikur t'isha djalë*, *Afërdita*, *Pse*, *Malsorja*, *Greminë e dashurisë*, *Lulja e kujtimit*, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, *Vdekja më vjen prej syve të tillë*, *Lumi i vdekur*. Shumë pak autorë veprash me poezi dhe asnjë dramë. Gjithsej rreth 50 vëllime në prozë dhe në poezi, nga Barleti e deri në ditët tona.

Prej vlerësimeve të tyre, në asnjë rast dhe në asnjë rrethanë nuk kemi vënë re konceptet e tyre për një standard tjetër, për vështirësi në të nxëniet dhe aq më tepër për kundërshtimin e tyre për standardin e sotëm. Përkundrazi, shembujt e sjellë këtu, tregojnë më së miri për interesimin e tyre për nxënien e standardit, për vlerësimin e tyre të standardit, si një vlerë të shenjtë kombëtare dhe për gatishmërinë e tyre që përkundër vështirësive sociale, kushteve dhe rrethanave nëpër të cilat kanë kaluar dhe gjenden, standardin ta përdorin si një prej arritjeve më të larta dhe më cilësore në komunikimin e përditshëm.

Prej përgjigjeve të tyre nuk është vështirë për të kuptuar rëndësinë që ata i japin shqipes standarde për mundëstë që ajo jep në arritjet, përkatësisht homogjenitetin e kombit shqiptar¹⁴⁷; duke përfshirë këtu edhe vlerësime emocionale¹⁴⁸; shqetësimet për gjendjen e tanishme¹⁴⁹ dhe perspektiven¹⁵⁰ e tij.

Prej përgjigjeve të tyre nuk është lehtë të kuptojmë se studentët e këtij brezi janë të liruar krejtësisht prej frustrimit krahinor, përkundrazi standardin e shohin si nevojë të komunikimit gjithkombëtar, falë rritjes së tyre brenda paradigmave që kanë përcaktuar mësuesit e tyre të mëshiruar me idealet e rilindasve. Ata dëshmojnë edhe njëherë se kundërshtarët e standardit janë

¹⁴⁷ “Pa shqipen standarde nuk do te kishim një dialog të pastër dhe të pasur” (*Agnesë Gojani*); “... e ndihmon pengimin e hyrjeve të fjalëve të huaja dhe përmirëson komunikimin tonë”. (*Fitore Berisha*); “Standardi është përfaqësimi i kombit tonë” (*Zelë Gashi*); “Shqipja standarde është shumë e nevojshme nëse duam të jemi një komb dhe të mos ndahemi” (*Kushtrim Kastrati*); “Shqipja standarde ka rëndësi vitale në zhvillimin intelektual të një kombi, pra kombit shqiptar. Ajo e bën më të lehtë komunikimin dhe do të luftonte lokalizimin” (*Elmi Begaj*); “Është ndër të arriturat më të mëdha për gjuhën tonë në përgjithësi deri në vitin 1972” (*Albulenë Mehana*).

¹⁴⁸ “Shqipja standarde është ajo shkallë e lehtë e gjuhës që të falë ngrohtësi shpirtërore, që është e pranueshme për veshin...” (*Blerina Gashi*); “...ajo është e pastër dhe e shenjtë për ne” (*Luljetë Hoxha*).

¹⁴⁹ “... shqipja standarde është një gjuhë e cila po mbushet me fjalë të huaja, por është vitale dhe po kontribuon për zhvillimin kombit shqiptar” (*Arbër Berisha*); “.... për fat të keq ka shumë mësues dhe profesorë që nuk e përdorin gjatë ligjërimit të tyre” (*Liridona Çeta*); “.... bazën për mësimin e gjuhës së pastër shqipe fëmijët nuk e mësojnë që në moshën fillestare” (*Tringa Rushiti*); “Mendoj se në shkollën fillore duhet kushtuar kujdes më shumë shqipes standarde” (*Gazmand Maksuti*); “... përdorimi i pamjaftueshëm në jetën e përditshme” (*Nazmije Jonuzi*).

¹⁵⁰ “Ndryshe nga dialektet që krijojnë paqartësi, gjuha standarde na ka ndihmuar mjaft për kuptimin e gjuhës më lehtë...” (*Valmira Vatovci*); “... mundëson për të komunikuar dhe për tu kuptuar më lehtë mes veti në shoqëri” (*Besiana Osmani*); “... standardi është perspektiva e duhur e nxënësve dhe studentëve në të folur dhe në të shkruar” (*Agon Drenjani*); “Shqipja standarde është një domosdoshmëri në ditët e sotme. Komunikimi është shumë më i lehtë nëse ne e njohim mirë gjuhën standarde shqipe...” (*Vlerona Berisha*); “Shqipja sot përdoret kryesisht në institucione kulturore, por ka ardhur koha që ajo të përdoret edhe në të folurit e përditshëm (...). Atë sot e përdorin kryesisht njerëzit që njëkohësisht edhe lexojnë më shumë sepse ata që lexojnë edhe fjalorin e kanë më të pasur”. (*Sevdije Gërguri*).

ata nuk arritën të dalin prej gëzhgjës krahinore dhe ata që nuk arritën të imponojnë mentalitetin e tyre në shkallë kombëtare.

Por le t'i kthehemi tani Manifestit të standardit, me të cilin punojnë studentët dhe të gjithë ata që përpiqen për të nxënë shqipen standarde. “Në këtë botim të parë të “Fjalorit drejtshkrimor”¹⁵¹, thuhet në *Parathënie* e tij “natyrisht, ka edhe mungesa e zbrazëti. Me studimet e mëtejshme shkencore e me ndihmën e masës së gjerë të lexuesve, të cilët janë të lutur të dërgojnë vërejtjet e tyre, këto mungesa e zbrazëti do të plotësohen në botimet e ardhshme”. Studiuesit që sado pak janë interesuar të dinë për bazën e skedarit të tij, do të mund të mësonin prej leksikografëve të gjuhës shqipe dhe madje prej administratës së Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë në Tiranë, se vetëm në skedarin e tij ka rreth 4.000.000 (katër milionë) skeda, që vazhdojnë të plotësohen çdo ditë jo vetëm në Tiranë po edhe në Prishtinë, Shkodër, Tetovë e institucione të tjera shkencore e arsimore, si dhe nga individë të pasionuar pas leksikografisë. Studiuesit që sado pak janë interesuar për bazën gjuhësore të shqipes, e cila pret të bëhet pjesë e fjalorit të përgjithshëm të shqipes, nuk e kanë vështirë të kuptojnë se përveç fjalësit të përgjithshëm të shqipes në skedarët e institucioneve dhe të individëve, ne kemi të regjistruar një fjalës të pasur, të cilin ende nuk e kemi botuar: *Fjalorët e patronimisë e antroponimisë, të toponimisë e oikonimisë, të frazeologjisë, të kuptimeve, të strukturave fjalëformuese* etj., të cilët popujt e tjerë tashmë i kanë botuar. Në vend të punës konkrete në regjistrimin dhe sistemimin e fjalësit të përgjithshëm të shqipes, ka disa vjet përpjekje të disa gjuhëtarëve të rinj, për të ‘teoretizuar’ nga këndi i sociolinguistëve, me mendimet e Claude Levi – Strauss-it, për gjuhët e fiseve të Amerikës Jugore apo të Lindjes së Largët dhe të folmet a varietetet e shqipes!¹⁵²

Kundërshtarët e shqipes standarde ankohen për kohën historike në të cilën është organizuar Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972) dhe për frymën ideologjike të asaj kohe, ndërsa vetë shkruajnë në shtypin ditor dhe sidomos paraqiten e flasin në mediat elektronike në frymën tipike titiste; ata atakojnë bardët e standardit të gjuhës duke përzgjedhur njëanshëm diskutimet e tyre gjatë dhe sidomos para Kongresit, duke i keqpërdorur kështu mendimet e tyre sipas modeleve tipike bolshevike; ata identifikojnë bazën dialektore të shqipes standarde, duke e identifikuar në mënyrë të njëanshme me personalitete të caktuara politike, ndërsa tkurrin në përmasa të skajshme kufijtë nëndialektorë të propozimeve të tyre, madje deri te propozimi për një standard të ri: kosovarishten; ata vazhdojnë të ankohen për bazën e rrudhur krahinore të shqipes standarde, ndërsa vetë punojnë për zgjerimin primitiv të gramatikës së saj; ata ankohen për përjashtimin e leksikut të gegërishtes, megjithëse vetë shqipen standarde vazhdojnë ta pasurojnë me sllavizma, italianizma, anglicizma e turqizma.

Duam t’u kujtojmë se gjuha shqipe dhe kombi shqiptar janë dy pjesë të pandashme të një identiteti, prandaj përpjekja e përtashme që prej tij të themelojnë identitete të reja krahinore, gjuhësore apo politike është përpjekje kundërhistorike e individëve dhe e grupeve të caktuara, është përpjekje me synimet largvajtëse, të cilat janë tejkaluar gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Anakronizmi i tyre del në pah edhe me faktin se ata përpiqen të krijojnë

¹⁵¹ *Fjalorit drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Prishtinë, Prishtinë, f.9

¹⁵² Shih kryesisht veprën “*Mendimi i egër*”, (Përktheu Eqrem Basha, *Dukagjini*, Pejë, 1999).

kombe në një kohë kur koha e formimit të kombeve është zëvendësuar me kohën e krijimit të shteteve. Duke u përpjekur ta rrënojnë strukturën bashkëkohore të standardit të saj, në të vërtetë ata, përpiqen që njëkohësisht t'i rrënojnë themelet e kombit modern shqiptar.

Nuk e dimë a ka nevojë të thuhet se disa nga kundërshtuesit më të flaktë të vlerave të standardit në Republikën e Shqipërisë, ka kohë që po përfundojnë lektorë në Seminarin e Gjuhës Shqipe në Beograd, ndërsa disa nga propaganduesit e idesë së identitetit kosovar, ka kohë që po vishen me pushtet në komisionet dhe në institucionet politike dhe shkencore e kulturore të Republikës së Kosovës. A është kjo arsyeja pse modelet e planifikimit gjuhësor dhe të ndërtimit të identitetit kombëtar na i kujtojnë modelet historike të planifikimit gjuhësor dhe ndërtimit të identitetit të disa popujve të ish-Jugosllavisë, të cilat përfunduan me rrënimë tragjike të gjithë ish-Jugosllavisë. Mirëpo, në vend që të dëgjonim dhe mësonim prej pasojave tragjike të tyre, të cilat studiuesi serb Milorad Radovanović i ka quajtur *ballkanizim i gjuhës*, ndërsa ne do ta quanim *jugosllavizim i gjuhës*, ka kohë që mësojmë prej nismave të tyre historike për krijimin e gjuhëve të reja: maqedonase, myslimane, malazeze etj., të cilat parim bazë të tyre kanë gjuhën serbe¹⁵³.

Mbase nuk është për t'u habitur pse brenda një kohe të shkurtër në Republikën e Kosovës, krahas gjuhës shqipe, në të vërtetë standardit të saj, janë sulmuar edhe disa shenja dhe vlera kombëtare, që simbolizojnë vlera historike të identitetit kombëtar, të popullit shqiptar e të trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të tij: emblema e Lidhjes së Prizrenit, flamuri kombëtar, himni kombëtar etj.

Po në këtë rrjedhë e shoh me shqetësim përpyjekjen e disa individëve dhe qarqeve vendore e ndërkombëtare për themelimin e të ashtuquajturit komb kosovar në fillim të shekullit XXI.

Por le ta gjykojmë këtë çështje këtu vetëm nga aspekti gjuhësor. Pavarësisht nga mendimet tona për etimologjinë e toponimit Kosovë, bota shkencore emrin e Kosovës e konsideron me etimologji sllave, ndërsa ne bëjmë atë që dhunshëm është bërë nën ish-Jugosllavi. Po e ndërtojmë identitetin tonë të ri (kosovar) mbi një etimologji sllave: kosovar! Një identitet të dyfishtë, një identitet tipik maqedon, vese të kthyer mbrapsht: ata nga një identitet i dyfishtë sllav (bullgaro-maqedon) në një identitet tipik antik (greko-maqedon), ndërsa ne, nga një identitet i vazhdimësisë iliro-shqiptare (të mbyllur si koncept që në periudhën e Rilindjes Kombëtare), në një identitet etno-gjeografik dhe etimologjikisht të ndarë dhe të mbishtresuar shqiptaro-sllavë.

A ka nevojë të mendohemi gjatë se si do të na gjykojnë pasardhësit nesër. Paraardhësit tanë na e lanë mbi kurriz një shtet sllav, ndërsa ne po ju lëmë pasardhësve në ndërdije një identitet me të cilin nuk shquhen saktë se cilët janë!

Konsiderojmë se përpyekje të tilla bëhen me qëllim të heshtjes së çështjes shqiptare, si çështje e pazgjidhur kombëtare dhe si çështje kombëtare e tërësisë evropiane, si dhe krijimit të standardeve të njëjta jo vetëm të Republikës së Kosovës po edhe të popullit të saj shumicë në fqinjin maqedonas. E konsiderojmë tepër shqetësues faktin se shqiptarët, kësaj here vetëm një pjesë e tyre, në prag të përfshirjes në familjen e Bashkimit Evropian, vazhdojnë të bëhen

¹⁵³ Për përvojën historike të njësimin dhe ndarjes së gjuhës serbe dhe kroate, shih, studimet dhe veprat e studiuesve serbë e kroatë: Milka Ivić, Radoslav Katić, Ranko Bugarski, Milorad Radovanović etj.

eksperiment me metoda tejet të ulëta, e kjo do të thotë me metoda të shekullit XVIII-XIX. Eksperimente të tilla, kishte vënë re, menjëherë pas rënies së periudhës së komunizmit, profesor Shefki Sejdiu, të cilat ai i quante “sfida që sjell koha e shoqërive të hapura”¹⁵⁴, dhe i kishte theksuar me forcë në Prishtinë dhe në Tiranë, si përpjekje për të mbrojtur jo gjuhën letrare (një nocion i popullarizuar pas Kongresit të Drejtshkrimit), po shqipen standarde, një term shkencor i gjuhësisë së përgjithshme.

Përgjithësisht konstatimet jopopullarizuese të linguistikës së profesor Shefki Sejdiut nuk patën ngjallur reagime të shtypit ditor dhe atij publicistik. U desh të ngrente zërin profesor Rexhep Qosja me manifestin e tij *Ideologjia e shpërbërjes*, (Tiranë 2006), për të kuptuar pretendimet largvajtëse të kundërshtarëve të shqipes standarde, jo vetëm për gjuhën, por edhe për identitetin dhe përbërjen fetare e kulturore të popullit shqiptar, që të shihet sa e rëndësishme është çështja e shqipes standarde dhe e identitetit kombëtar¹⁵⁵.

Duke e konsideruar gjuhën shqipe vlerë identifikuese të secilit qytetar të popullit shqiptar, mund ta konsideroj të palejueshëm diskutimin e standardit të shqipes në nivele grupesh, klanesh e individësh, të cilët më parë se për plotësimin e standardit të gjuhës, kanë synim rrënimin e identitetit historik të folësve të saj.

Studiuesit, shkrimtarët, publicistët dhe të gjithë ata që në një formë a një tjetër merren me gjuhën shqipe, ftohen që të punojnë në pasurimin e saj me vlera gjithëkombëtare dhe të angazhohen në mbrojtjen e saj prej prireve histerike të diskutimeve rreth saj.

Në parimet e përgjithshme të *Drejtshkrimit të gjuhës shqipe*, veç të tjerash thuhet: "Drejtshkrimi i njësuar i gjuhës shqipe kurorëzon një etapë të gjatë përpjekjesh për formimin e një gjuhe të vetme e të përbashkët për gjithë popullin shqiptar dhe çel rrugën për ta përmirësuar më tej normën drejtshkrimore të kësaj gjuhe në pajtim me zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës e të kulturës sonë kombëtare"¹⁵⁶. Për të vazhduar më tej: "Dalja e Drejtshkrimit të gjuhës shqipe dhe vënia e tij në jetë, pa dyshim, do ta gjallërojë, do ta pasurojë e do ta çojë më tej mendimin shkencor në këtë fushë. Zhvillimi i pandërprerë i vetë gjuhës sonë, kristalizimi i mëtejshëm i normës letrare do të shtrojë para teorisë së drejtshkrimit çështje të reja e mundësi të reja zgjidhjeje. Gjuhësia shqiptare do t'i vazhdojë studimet për këto probleme dhe do t'i bëjë këtij "Drejtshkrimi" përmirësimet e nevojshme në të ardhmen"¹⁵⁷.

Duke ju referuar mendimit të profesor Eqrem Çabejt, për gramatikën sintetike, në vend të gramatikës arkaike, nuk është vështirë të shohim se *Drejtshkrimi i sotëm i shqipes* ka ende mjaft

¹⁵⁴ Shih kumtesat e Profesor Sejdiut "*Tendenca variantizimi në gjuhën e sotme standarde*", lexuar në Prishtinë më 1996 dhe kumtesën "*Rreth disa tendencave dezintegruese dhe forcave kohezive brenda entitetit (proto)shqiptar*", lexuar në Konferencën për shqipen standarde, në Tiranë, më 1992, në të cilën për herë të parë autori shtroi disa probleme tashmë të njohura lidhur me terminologjinë dhe komplemantaritetin e diskutimit sociologjik të zhvillimit të shqipes së kohës dhe perspektivës së saj në kontekst të zhvillimit të brendshëm dhe të jashtëm të shoqërisë shqiptare, ballkanike dhe europiane.

¹⁵⁵ Me vepra dhe studime të veçanta, shqipen standarde dhe kur e kur edhe identitetin kombëtar e kanë mbrojtur në vazhdimësi edhe: Gjovalin Shkurtaj, Xhevat Lloshi, Emil Lafa, Shefikje Islamaj, Qemal Murati, Bahtijar Kryeziu etj.

¹⁵⁶ *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, (Komisioni hartues: Prof. Androkli Kostallari (Kryetar), Prof. Mahir Domi, prof. Eqrem Çabej, B.shk. Emil Lafa), Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1974, f. 36.

¹⁵⁷ Po aty, f. 13.

punë për të lehtësuar përdorimin e tij, madje duke filluar me përdorimin e shkronjës së madhe deri te disa fenomene apo dukuri fonetike, e te disa struktura morfologjike e korpuse njësish leksikografike, prej të cilave dalëngadalë duhet të lirohet edhe drejtshkrimi i shqipes standarde.

Le të jetë kjo përsëritje e udhëzimeve themelore të Drejtshkrimit një kujtesë se për të punuar në shqipen standarde e në themele të saj ka vend për të gjithë, duke filluar nga drejtshkrimi i saj, por kusht për të marrë pjesë në këtë ngrehinë të madhe kombëtare është që pjesëmarrësi të jetë skalitës e jo rrënues. Gjuha, ka thënë Roland Bart, është “institucion shoqëror dhe sistem vlerash. Si institucion shoqëror ajo nuk është asesi veprim, ajo nuk i shtrohet asnjë lloj paramendimi; ajo është pjesë shoqërore e ligjërimit; individi i vetëm nuk mund ta krijojë as ta ndryshojë; në thelb ajo është kontratë kolektive, së cilës po të duam të komunikojmë duhet t’i shtrohem në tërësi; për më tepër ky prodhim shoqëror është autonom në mënyrën e një loje, që ka rregullat e veta, sepse nuk mund të përdoret pa e pas nxënë”¹⁵⁸.

¹⁵⁸ Roland Bart, “*Aventura semiologjike*”, (Përktheu: Rexhep Ismajli), *Dukagjini*, Pejë, 2008, f. 215-216.

TERMINOLOGJIA SHQIPE NË RRAFSHIN E GLOBALIZMIT

Globalizmi përbën modele vlerash të përgjithshme e të përbashkëta, politiko-ekonomike, kulturore etj., të përfthuara nga vende moderne të zhvilluara që qarkullojnë në të gjitha shoqëritë e sotme të botës, të hapura ndaj ekonomisë së tregut, shkëmbimit të ideve, e çdo dukurie tjetër. Vendi ynë, vështuar në këtë kontekst, i përket dy fazave të zhvillimit të tij, si shoqëri e mbyllur para vitit 1990 dhe e hapur pas vitit 1990. Në fazën e parë globalizmi paraqitej si dukuri e politizuar dhe e ideologjizuar, e kuptuar edhe si një koncept i kufizuar që i përkiste fushës së ekonomisë, prodhimit, çka është pasqyruar në “Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe”, 1980¹⁵⁹, ku përkufizohet: “Realizim i planit vetëm në sasi ose kryerja e një detyre vetëm në përgjithësi, pa pasur parasysh ose duke shkelur kërkesat për cilësi të mirë të prodhimit e për të gjitha asortimentet; metodë e huaj dhe e dëmshme në fushën ekonomike, shoqërore politike etj. që e paraqet punën vetëm në përgjithësi vetëm me shifra të përgjithshme, pa bërë analizën e thelluar të çështjeve etj”. Po kështu jepet pak a shumë e njëjta ide edhe në “Fjalorin e 2006”¹⁶⁰: “të qenët global; vështrim a vlerësim i punëve, i ngjarjeve etj. në mënyrë globale; / kryerja e diçkaje vetëm në sasi ose në përgjithësi; metodë që e paraqet punën në përgjithësi, pa bërë analizën e thelluar të çështjeve etj”.

Sot, mbi konceptin e ri të futur në botën moderne ka studime të shumta rreth globalizmit, meqë si dukuri ai përfshin të gjitha fushat e jetës dhe prek çdo vend, të madh ose të vogël, siç është edhe vendi ynë si shoqëri e hapur pluraliste e ekonomisë së tregut.

Dukuria e globalizmit si koncept lidhet me mbizotërimin dhe një anë të një fushe të jetës (politike, ideologjike, ekonomike, kulturore etj.) që vjen nga një vend a disa vende të zhvilluara e që depërton si e përbashkët në shumë vende të botës ose në të gjithë botën, duke ndikuar mbi anë të veçanta të tyre, si ndikim i së përgjithshmes mbi atë lokalen, ku e para shprehet me termin *globalizëm*, kurse e dyta me *glokalizëm*¹⁶¹.

Si parim bazë dhe si kriter vlerësimi i globalizmit në një fushë të caktuar të jetës së çdo shoqërie pluraliste duhet të jetë *ndërkombëtarësia e një dukurie, e vlerësuar si nevojë dhe domosdoshmëri*. Pra, kur është e dobishme, çdo vlerë e përbashkët duhet të mbizotërojë mbi atë që është lokale, karakteristike për një vend të caktuar. Globalizmi i referohet kështu inkorporimit të globales në lokalen, globalizmit mbi glokalizmin.

Në fushën e gjuhës, koncepti i globalizmit hyn me veçantitw e veta dhe shfaqet me një varg veçorish në varësi të niveleve të gjuhës dhe të shtresave leksikore, me të cilat lidhet kjo dukuri. Në nivelet bazë të saj, si në sistemet fonetike e morfologjike, që përbëjnë sisteme të mbyllura e të pandryshueshme, ose që në rrjedhë të kohërave ndryshojnë shumë ngadalë,

¹⁵⁹ Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe, 1980, ASHRPSSH, IGJL, f. 556.

¹⁶⁰ Fjalor i Gjuhës Shqipe, 2006, ASHSH, IGJL, f. 318

¹⁶¹ Rr. Paçarizi, *Shqipja–Globalizmi dhe glokalizmi*, në SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE, Prishtinë, 2008, f. 209. Autori shkruan: “Në gjuhësi ky term u përdor për herë të parë nga sociologu Roland Robertson më 1961, duke përshkruar përshtatjen e komoditetit global në kushtet lokale, që do të thotë akomodimin e globalizmit në rrethana lokale.”.

globalizmi s'gjen vend të lirë për të depërtuar në gjerësi dhe në thellësi të dukurive gjuhësore, të këtyre niveleve, ndonëse në raste të rralla depërton duke prekur strukturën sintaksore të fjalisë shqipe. Kjo çon në cenimin, sipas rastit, edhe të ndonjë ane morfologjike, siç mund të vihet re në një strukturë të tillë si: “*Klinton takoi Eçevit*”. Shpesh kjo ndikon mbi shqipen në aktivizimin e strukturave të parregullta sintakso-morfologjike të tilla si: *Petro* (jo: *Petroja* ose *Petrua*) takoi *Janko* (jo: *Jankon*). Në nivele të tjera, si në sistemin leksikor dhe atë semantik globalizmi gjen shtigje për të depërtuar lehtë. Këtu mund të futet edhe sistemi fjalëformues, meqë lidhet me formimin e njësive të reja gjuhësore. Megjithatë edhe në këto nivele, dukuria e globalizmit depërton në shkallë të ndryshme. Në sistemet leksikore dhe semantike, si sisteme të hapura, dukuritë e globalizmit, të ndikuara nga hyrja e elementeve të huaja, vërehen në masë të konsiderueshme. Ky ndikim lidhet sot në mënyrë të veçantë me kontaktet e gjuhës shqipe me gjuhët e tjera dhe kryesisht me një gjuhë universale, ose me shtrirje ndërkombëtare, siç është anglishtja. Vështruar nga kjo pikëpamje anglishtja e sotme mund të krahasohet me latinishten e Mesjetës dhe të Rilindjes, ndonëse në funksionimin e këtyre dy gjuhëve, si gjuhë të komunikimit ndërkombëtar, ka dallime. Kështu, latinishtja në formën e shkruar që e kufizuar për një shtresë elitare për fusha të caktuara: fe, filozofi e disa fusha të tjera si: matematikë, fizikë, mekanikë, gjeologji etj. e zotërohej nga njerëz të elitës, të fjalës e të shkencës. Në kohën e sotme, këtë rol po e luan gjuha angleze, e cila funksionon e shfaqet me veçori të ndryshme në krahasim me latinishten. Shkalla e zotërimit të saj është ndërkombëtare: ajo flitet e shkruhet nga ish-kolonitë. Sot janë krijuar gjuhët hibride si: *hindglisht*, *chinglisht* etj. Ndikimi i anglishtes si gjuhë me shtrirje ndërkombëtare deri universale çon në ndryshime të theksuara, sidomos në gjuhë të caktuara, të pazhvilluara. Depërtimi i saj realizohet përmes faktorëve jashtëgjuhësorë, ekonomikë, politikë e kulturorë. Si bazë nga hyn globalizmi janë vendet me teknologji të përparuar në të gjitha fushat. Megjithatë rol luajnë shoqëritë shumëkombëshe, organizatat e ndryshme ndërkombëtare, ku lidshipi janë shtetet e mëdha e të fuqishme, e ku vendin parësor e zë Amerika.

Sikurse në gjuhë të tjera, edhe në shqipe vihen re ndikime në leksik, sidomos në leksikun terminologjik. Nga ana tjetër depërtimi i globalizmit realizohet në këtë shtresë leksikore, meqë ky sistem është universal nga përmbajtja e elementeve përbërës të termave. Siç dihet çdo sistem terminologjik i përgjigjet një sistemi konceptor, ndonëse i veçantë për çdo gjuhë nga forma, nga shprehja, nga termat, por universal nga përmbajtja, nga koncepti. Sistemi terminologjik i çdo fushe dijeje është sistemi më dinamik dhe më i hapur ndaj ndikimeve të huaja dhe, duke qenë i tillë, dukuritë që lidhen me anët e përbashkëta të koncepteve, bëjnë të mundur depërtimin në sisteme terminologjike. Vështruar nga kjo pikëpamje shumë çështje të mprehta të globalizmit në gjuhë përqendrohen për t'u studiuar në këtë fushë. Sigurisht, ndërkombëtarësia e përmbajtjes ndikon edhe mbi ndërkombëtarësinë e formës, çka bën më të pranueshme në gjuhë huazimin e termave ndërkombëtarë. Kjo do të thotë se vetia e ndërkombëtarësisë në terminologji¹⁶² lidhet me një varg anësh të saj si leksik special, i cili shërben si kryeporta e termave të huaj, e sidomos të termave nga gjuhë me shtrirje ndërkombëtare, siç është bërë sot anglishtja. Kështu, p.sh., ajo

¹⁶²A. Duro, *Prirja për specializim e mjeteve të shprehjes në terminologji*, “GJUHA JONË”, Tiranë, 1986, nr. 2.

del me një varg veçorish, të cilat përfshijnë si formën, ashtu edhe përmbajtjen. Po përmendim një varg tiparesh të përhapjes së globalizmit gjuhësor në fushën e leksikut të shqipes.

1. Universaliteti i përmbajtjes së koncepteve si shprehje e përmbajtjes së njëjtë të tyre në rrafsh ndërkombëtar, ndonëse format e shprehjes (termat) janë kombëtare, të veçanta për secilën gjuhë.

2. Ndërkombëtarësia e formës shfaqet edhe tek një varg formash shprehjeje, siç janë termat ndërkombëtarë, tek të cilët ndërkombëtarësia shfaqet në shprehjen e njëjtë ose shumë të afërt të koncepteve. Këtu futen një varg ndërkombëtarizmash terminologjike, të cilët mund të klasifikohen sipas prejardhjes nga gjuhë të ndryshme dhe sipas formës së huazimit¹⁶³:

a. ndërkombëtarizma me prejardhje nga greqishtja e vjetër: *apogje, antitezë, akrobat, bibliotekë, ikonë, teoremë, organ* etj. (40 terma)

b. ndërkombëtarizma me prejardhje nga latinishtja: *akt, album, altar, fosil, integral, konferencë, objekt, placentë, tension* etj. (33 terma)

c. ndërkombëtarizma me prejardhje nga frëngjishtja: *aleancë, anketë, banket, dekor, elitë, jubile, kredit, restaurant, xhaketë, zhargon* etj. (43 terma)

d. ndërkombëtarizma me prejardhje nga anglishtja europiane ose amerikane: *boks, doping, eksport, folklor, koktej, kek, pulovër, piknik, rekord, tenis, xhaz* etj. (39 terma)

e. ndërkombëtarizma me prejardhje nga italishtja: *alarm, bariton, duet, flaut, galeri, kanal, libret, mandolinë, novelë, sallam, valutë* etj. (36 terma)

f. ndërkombëtarizma me prejardhje nga gjuhë të tjera si gjermanishtja: *diktat, lajtmotiv, shinë, shtab* etj. (10 terma); nga rusishtja: *bolshevik, kulak, tajgë* etj. (5 terma); nga spanjishtja: *çokollatë, kakao, rumba* etj. (6 terma); nga portugalishtja: *marmelatë, zebër, vanilje* etj. (3 terma); nga arabishtja: *algjebër, alkool* etj. (2 terma) etj.

g. ndërkombëtarizma nga fjalë të greqishtes së vjetër ose të latinishtes, të cilave u është ndryshuar kuptimi, pasi janë marrë prej gjuhëve të ndryshme të reja: *akademi, azot, biokimi, dekadë, enciklopedi, leksemë, proton, telefon, vitaminë* etj. (33 terma)

gj. ndërkombëtarizma që në shqipe formohen me *-izëm*: *amatorizëm, darvinizëm, frejdzizëm, humanizëm, idealizëm, platonizëm, sadizëm, vandalizëm* etj. (29 terma)

h. ndërkombëtarizma që kanë lindur nëpërmjet metonimisë: *amper, donkishot, dizel, kuisling, om, volt* etj. (10 terma) etj.

3. Ndërkombëtarësia e formës e ardhur nga një gjuhë me shtrirje ndërkombëtare, siç vërehet te shumica e termave të informatikës nga anglishtja, të njëjtë nga shqiptimi e shkrimi: *softuer, harduer, monitor* etj.¹⁶⁴

4. Ndërkombëtarësia e formës së brendshme, siç janë kalket semantike e strukturore¹⁶⁵, të krijuara përmes huazimit të modeleve të formimit, duke interpretuar format e njëjta të

¹⁶³J. Kole, *Mbi fjalët ndërkombëtare në gjuhën shqipe*, ASHRPSSH, IGJL, "Studime filologjike", Tiranë, 1984, nr. 3, f. 116. (Nga punimi në fjalë janë përmendur disa terma, kurse në kllapa jepet sasia e dhënë në punim për çdo grup të veçantë).

¹⁶⁴A. Duro w F.Vrapi, *Veçori të termave me burim nga anglishtja në gjuhën shqipe*, Konferenca shkencore "GJENDJA DHE ZHVILLIMI I TERMINOLOGJISË SHQIPE - PROBLEME E DETYRA", ASHSH, Tiranë, qershor 2009, f. 197-211. (Nga punimi në fjalë janë përmendur disa terma, kurse si nënshtresë leksikore janë rreth 238 njësi (terma))

brendshme. Kjo ka të bëjë me standardizimin e terminologjisë, me atë që Vysteri e quan harmonizim të formave të brendshme, si te *flag/flagur*, *mouse/mi*, *password/fjalëkalim*, *entry/hyrje*, *pin/thumb*, *key/çelës*, *shift/zhvendosje*, *memory/kujtesë*, *navigate/lundroj*, *interface/ndërfaqe*, *endnote/fundshënim*, *bypass/anëkalesë* etj.

Vetia e ndërkombëtarësisë që përbën një ndër anët qenësore të vetë ekzistencës dhe të funksionimit në gjuhë e lidh dukurinë e globalizmit me shumë fije me të, prandaj edhe studimet gjuhësore rreth leksikut janë përqendruar edhe në leksikun ndërkombëtar, tek i cili shfaqen realisht shumë probleme të globalizmit gjuhësor në gjuhën shqipe. Kështu p.sh., prof. Xh. Lloshi, i cili është marrë posaçërisht me këtë problem thekson, se “*Globalizimi shoqërohet me ndërlikime të ndjeshme kulturore e gjuhësore*”¹⁶⁶.

Megjithatë, siç u nënvizua edhe më sipër globalizmi gjuhësor ndikimin më të madh e ka mbi leksikun, e ku vendin e parë e zë leksiku terminologjik. Ndonëse ky nivel leksikor përbën shtresën më të ndjeshme ndaj ndikimeve të huaja, duhet nënvizuar se, edhe këtu ky ndikim ushtrohet në mënyrë të diferencuar. Kështu p.sh., si shtresa më e prekshme e ndikimeve të huaja del leksiku terminologjik i fushave më të ngushta të dijes, i cili është më i hapur për hyrjen e fjalëve të huaja, në krahasim me leksikun e fushave bazë, ku leksiku terminologjik është më i ngulitur. Siç dihet, vendin e parë këtu e zënë ndërkombëtarizmat, të cilat përbëjnë një shtresë pak a shumë të konsoliduar, të vërejtur qysh para vitit '90. Sipas Josif Koles, një pjesë e mirë e gjuhëtarëve jo vetëm që e kanë pranuar ndërkombëtarësinë në gjuhë, por e kanë shtrirë atë edhe jashtë fjalëve.¹⁶⁷ Kjo për terminologjinë përbën veçorinë themelore të saj.

Tradicionalisht, qysh nga Lashtësia, si edhe në Mesjetë terminologjia ka qenë ndërkombëtare, e përfaqësuar prej latinishtes. Nga shek. X deri në shek. XVIII latinishtja mbeti gjuha e studimit në të gjitha universitetet e mëdha europiane. Me të shkruheshin traktatet shkencore, filozofike, teologjike etj. Me krijimin e gjuhëve letrare për çdo komb-shtet, çdo terminologji kishte fytyrën e vet kombëtare, por përmbajtja mbetej ndërkombëtare, çka është kryesisht e vlefshme dhe për shqipen¹⁶⁸. Në përfundim të kësaj periudhe, ajo u zëvendësua kryesisht nga leksiku vendës, që përbënte bazën e çdo terminologjie të shqipes. Që në shkrimet e Aleksandër Xhuvanit hasim përpjekjet e para për përcaktimin e fjalëve ndërkombëtare në shqipë¹⁶⁹ (si shumica e termave shkencorë në: *kimi*, *fizikë*, *matematikë*, *gjeografi*, *botanikë*, *elektricitet*, *filozofi* etj. me origjinë greke e latine. Më tej, sipas P. Gecit fjalët *laborator*, *muskulaturë*, *import*, *eksport* i kanë edhe kombet e tjerë¹⁷⁰. Kështu rreth viteve '50 të shek. XX,

¹⁶⁵A..Duro, *Studime gjuhësore (terminologji, gjuhësi kompjuterike, kritikë-bibliografi)*, QSA, IGJL, Tiranë, 2012, f. 168.

¹⁶⁶Xh. Lloshi, *Shqipja – Gjuhë e hapur dhe dinamike*, “Studime filologjike”, ASHSH, IGJL, Tiranë, 2002, nr. 3-4, f. 22-32.

¹⁶⁷J. Kole, *Mbi fjalët ndërkombëtare në gjuhën shqipe*, ASHRSSH, IGJL, “Studime filologjike”, Tiranë, 1984, nr. 3, f. 105.

¹⁶⁸E. Lafe, *Për leksikun dituror të “Meshari” i Gjon Buzukut*. në: Buzuku dhe gjuha e tij, ASHSH, IGJL. Tiranë, 2005, f. 406-411.

¹⁶⁹Cituar sipas J. Koles, shih A. Xhuvani, *Vepra I*, Tiranë, 1980, f. 7.

¹⁷⁰Cituar sipas J. Koles, P. Geci, *Pasuria e leksikut të shqipes dhe fjalori i gjuhës shqipe* në “Buletin i USHT, Seria Shkencat shoqërore”, 1959 ose në STUDIME MBI LEKSİKUN DHE MBI FORMIMIN E FJALËVE NË GJUHËN SHQIPE, II, Tiranë, 1972, f. 159.

terminologjia u pasurua me terma ndërkombëtare krahas futjes në të të termave të ngritur mbi bazën e leksikut të përgjithshëm, duke e plotësuar terminologjinë me brumin e shqipes e të ndërtuar me gjedhet fjalëformuese, me huazime dhe zëvendësim të disa termave shqip me huazime, ku pati edhe teprime, që cilësohet si shfaqje të purizmit (*dheshkronjë* me *gjeografi* etj.). Këto përcaktime, edhe pse në heshtje u pranuan edhe nga gjuhëtarë të tjerë, si A. Kostallari, që i dha rëndësi ndarjes së huazimeve nga këndvështrimi i përfshirjes në “Fjalor”, në fjalë të huaja me karakter ndërkombëtar dhe fjalë të huaja jondërkombëtare¹⁷¹. Po kështu profesor Jani Thomai i grupon fjalët ndërkombëtare “*internacionalizmat*” sipas fushës së përdorimit dhe sipas burimit. Në grupin e parë shumicën e përbëjnë ndërkombëtarizmat në jetën politiko-shoqërore (*kushtetutë, diktaturë, parti, ideologji* etj.); në fushën e shkencës e të teknikës (*histori, gjeologji, gramatikë, telegraf, radio* etj.); e me radhë art, transport, mjekësi, sport etj. Sipas burimit i ndan në fjalë ndërkombëtare me prejardhje nga greqishtja (*gramatikë, morfologji, sintaksë, fonetikë, sinonim, homonim* etj.), nga latinishtja (*linguistikë, republikë, senat, kushtetutë* etj.), nga italishtja (*kanto, soprano, tenor* etj.), frëngjishtja (*adresë, deklaratë, ekip* etj.), anglishtja (*futboll, basketboll, hemboll, skaut* etj.).¹⁷²

Nga sa më sipër, globalizmi si dukuri gjuhësore duhet të orientohet drejt terminologjisë, sepse pikërisht prej këtij fillojnë ardhurizmat¹⁷³ (huazime të sapofutura) dhe pastaj depërtojnë në gjuhën e përgjithshme deri në thjeshtligjërime. Për rrjedhojë, duhet të ndërrojë kahu i vështimit të globalizmit në gjuhën standarde. Sot po pakësohen fjalët e huaja edhe nga gjuhët e vendeve të mëdha, *frëngjishtja*¹⁷⁴, *italishtja*¹⁷⁵, *rusishtja*¹⁷⁶ etj. Edhe ato që ne i marrim prej tyre, ato vetë në këto gjuhë kanë hyrë nga anglishtja, si gjuha e realizimit të globalizmit gjuhësor. Sot dëgjohen: *format, monitoroj*, që depërtojnë deri në të folurin e zakonshëm (në thjeshtligjërime): *kjo nuk funksionon, duhet të integrohen në jetë* etj. Të gjitha këto shtresime, sidomos ato më të vjetrat janë bërë objekt studimesh nga gjuhëtarë të veçantë, të cilat ose janë vështuar drejtpërdrejt, ose janë prekur në punime të ndryshme.

¹⁷¹A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e Fjalorit të gjuhës sotme shqipe*, në STUDIME MBI LEKSİKUN DHE MBI FORMIMIN E FJALËVE NË GJUHËN SHQIPE, Tiranë 1972, f. 33.

¹⁷²J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe* (shblu, ribotim), Tiranë, 2002, f. 235.

¹⁷³M. Kore, *E ardhmja e shqipes standarde në proceset integruese*, në SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE, Prishtinë, 2008, f. 265.

¹⁷⁴A. Omari, *Vëzhgime rreth zhvillimeve të shqipes së sotme nën ndikimin e gjuhëve të huaja*, në SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE, Prishtinë, 2008, f. 227.

¹⁷⁵Po aty, f. 230, shih dhe V. Proko-Jazexhiu, *Leksiku terminologjik i agronomisë në gjuhën shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Botimet albanologjike*, Tiranë, 2012, 223 f.).

¹⁷⁶E. Shehu, V. Proko-Jazexhiu, *Ndikimet e rusishtes mbi shqipen 1944-1990*, TAKIMI VI VJETOR I INSTITUTIT ALB-SHKENCA, Tiranë, 2011. (I pari që ka vështuar ndikimin e gjuhës ruse mbi shqipen, sidomos në fushën e terminologjisë për nevojat e pasurimit dhe plotësimit të terminologjisë të shqipes dhe ngritjes së tyre në sistem të qëndrueshëm është prof. Emil Lafe në përmbledhjen kushtuar 100-vjetorit të A. Desnickajës “*Razvitije knizhnoj leksiki albanskogo jazika vo vtoroj pollovinje XX veka (vlijanije ruskogo jazika) XX veka*”, në STUDIA LINGUISTICA, Sankt-Peterburg, 2001. Ai e ka vlerësuar ndikimin e gjuhës ruse mbi zhvillimin e leksikut politik-shoqëror të shqipes mbi bazën e modeleve fjalëformuese ruse, të cilat çuan në ndërtimin e termave me brumin e vet shqipes, çka ka ndihmuar për ndërtimin e termave të rinj me bazë shqipe, por edhe për zëvendësimin e termave të huaj. Për këtë si bazë kanë shërbyer modelet e ndërtimit të termave në gjuhën ruse, çka del nga përjasja me termat e huaj në shqipe të huazuar nga gjuhët neolatine si *bërthamor-jadernij -nuklear, tretës-rasvoritel-solvent*. Në punimin e vet prof. E. Lafe paraqet në mënyrë sintetike tipat bazë të fjalëformimit të shqipes, mbi të cilët ka ushtruar ndikim gjuha ruse).

Sot përgjithësisht termat ndërkombëtarë përfaqësohen prej anglicizmave, ndonëse ato kanë përbërë një farë shtrese leksiku të kufizuar edhe para vitit '90, sidomos në disa fusha. Si të tilla janë evidentuar një varg prej tyre.

në mekanikë: *antifrizë, bajpas, bluming, buldozer, bunker, çizel, ekonomajzer, fllanxhë, hon, karter, konvejër, lingotë, niples, parking, skreperoj, silenciator, standard, tramvaj, vagon, ventilator, vinç* etj. (42 terma).

në sport: *sport, gol, faull, aut, korner, start, futboll, volejboll, hence, maç, trajner, trajning (trajnim), kros, pas, set, tur, sprint, dribloj, tenis* etj. (28 terma).

në tregtinë e jashtme: *trust, lokaut, licensë, eksport, eksportoj, import, importoj, klering, bum, dollar, sterlinë* etj. (11 terma)

Anglicizma kanë depërtuar prej kohësh aty-këtu edhe në fusha të tjera, si në *elektronikë* (6), *zootekni* (4), *agrokimi* (3), *fizikë* (3), *ushtri* (3), *mineralogji* (1), *muzikë*: (si terma vendësorë) (5), *mjekësi* (2), *etnografizma* (fjalë a terma me karakter vendësor) (9); si në shtresë leksikore rreth 120 njësi (terma).

Në vitin 1982, prof A. Kostallari vërente se “Gjuha shqipe është gjuha ku kanë depërtuar më pak anglicizma se në çdo gjuhë tjetër të Europës”¹⁷⁷, kurse prof. H. Shehu, i cili është marrë posaçërisht me studimin e anglicizmave edhe të kësaj periudhe (1989), nënvizonte se “fjalët angleze në shqipen e sotme letrare kanë depërtuar si terma të veçuar në pak fusha të veprimtarisë shoqërore”¹⁷⁸. Po aty pohohet se një pjesë e tyre, ndonëse si terma, janë zëvendësuar me barasvlerës shqip, por jo gjithnjë me një fjalë të vetme, sidomos në fushën e sportit: *trajnoj-stërvit, penalti-njëmbëdhjetëmetërsh, hence-goditje dënimi, korner-goditje nga këndi, autopozicion jashtë loje, kros-vrapim në natyrë*. Siç mund të shihet, disa terma shqip, si relativisht të gjatë, nuk kanë qenë gjithnjë të suksesshëm, çka ka bërë që krahas tyre, të përdoren edhe terma nga anglishtja. Një pjesë prej tyre, ndonëse e vogël, janë futur në fondin aktiv të shqipes, sidomos në leksikun themelor të terminologjisë, duke u përfshirë në rrethin fjalëformues të saj, si: *import-importoj-importim-importues-e, pas-pasoj-pasim-pasues-e* etj.

Duke u nisur nga ky këndvështrim vërehet lehtë, se para vitit 1990 anglicizmat kanë funksionuar pothuajse vetëm si terma në disa fusha të veçanta të dijes; si të tillë ata nuk kanë arritur të mëvetësohen plotësisht si shtresë me status të vetin në leksikun e shqipes. Në këtë këndvështrim kjo shtresë mund të krahasohet me rusizmat, gjermanizmat e ndonjë tjetër. Megjithatë njësitë e saj mund t'i veçojmë në fusha speciale të veçanta të dijes, duke i renditur sipas shkallës së mbizotërimit sasior. Një pjesë prej tyre janë evidentuar në punime të veçanta të ndonjë studiuesi, si: F. Leka¹⁷⁹, H. Shehu,¹⁸⁰ V. Dervishi,¹⁸¹ E. Dashi¹⁸², H. Pasho¹⁸³, A. Duro¹⁸⁴ etj.

¹⁷⁷A. Kostallari, “Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare”, “Studime filologjike”, ASHSH, IGJL, nr. 2, Tiranë, 1982.

¹⁷⁸H. Shehu, “Mbi zëvendësimin e disa huazimeve angleze”, “Gjuha jonë”, Tiranë, 1989, nr. 1.

¹⁷⁹F. Leka, *Për njësimin, pastrimin dhe pasurimin e mëtejshëm të terminologjisë tekniko-shkencore në gjuhën shqipe*, në përmbledhjen “PROBLEME AKTUALE TË KULTURËS SË GJUHËS SHQIPE”, Prishtinë, 1983, f. 121-127; *Terminologjia tekniko-shkencore dhe gjuha e sotme letrare shqipe*, “Studime filologjike”, Tiranë, 1985, nr. 1, f. 53-62.

¹⁸⁰Shih 20.

Pas viteve '90, në botimet shkencore të ne, u vu re një prirje e fortë, herë-herë mbizotëruese, trysnia e anglicizimit të terminologjisë. Dhe jo vetëm në botime, por edhe në leksionet universitare: për shkak të mungesës së teksteve shqipe në disa lëndë, çdo gjë që rekomandohet nga pedagogët për t'u lexuar nga studentët është kryesisht në gjuhën angleze.

Edhe pse fjalorët terminologjikë të botuar nga Instituti i Gjuhësisë përfshijnë një numër të konsiderueshëm termash, nuk e përballojnë dot vërshimin e termave të rinj, veçanërisht për degë që kanë marrë zhvillim vitet e fundit në botë. Mjafton të ndjekësh ribotimet e disa librave referencë, nganjëherë edhe vetëm pas një viti, të cilat përmbajnë gjithmonë kapituj të rinj që lidhen me aspekte të tjera dhe të reja të trajtimit të problemeve të ndryshme, me teknologji të reja etj. Këto kërkojnë studime të mëtejshme, të kujdesshme dhe përpjekje të organizuara për t'i bërë të njohura rezultatet e tyre edhe përmes literaturës në shqipe.

Kjo nuk është një dukuri e veçantë për shqipen. Te ne ndikimi i anglishtes ndodhi më vonë, për shkak të faktorëve gjeopolitikë. (Gjërat me sa duket filluan të ndryshojnë thelbësisht në pjesën më të madhe të gjuhëve të Europës, në shek. XX, kur anglishtja u kthye në gjuhën bazë të të gjitha kërkimeve shkencore. Prej gati më shumë se një shekulli, terminologjia e anglishtes moderne ka filluar të depërtojë thellë në fjalorët terminologjikë¹⁸⁵, duke u huazuar edhe prej shumë gjuhëve të tjera. E për këtë arsye është aktuale shprehja e prof. Xh. Lloshit: "Gjuha e globalizmit është anglishtja..... të gjithë fjalorët terminologjikë duhet t'i ribëjmë anglisht-shqip dhe shqip-anglisht."¹⁸⁶ Për shkaqe që tashmë dihen, disa studiues, ndonëse të paktr, janë marrë me studimin e anglicizmave në mënyrë të drejtpërdrejtë, si: H. Shehu¹⁸⁷, N. Caka¹⁸⁸, ose edhe në kuadrin e problemeve të gjuhës shqipe standarde, si: Xh. Lloshi¹⁸⁹, R. Ismajli, Gj. Shkurtaj¹⁹⁰ etj.), për anglicizmat e kësaj periudhe është pohuar se ata (anglicizmat) në masën mbizotëruese kanë vijuar të hyjnë në shqipe si terma në fusha të ndryshme të dijes, sigurisht në një sasi shumë herë më të madhe se para vitit 1990. Si veçori themelore e funksionimit të tyre në gjuhë është se ata tashmë takohen jo vetëm në rrethinat e leksikut me përdorim të kufizuar, por

¹⁸¹V. Dervishi, "Formimi i terminologjisë së mekanikës në gjuhën shqipe", Disertacion, Tiranë, 1990.

¹⁸²E. Dashi, "Formimi i terminologjisë së zooteknisë në gjuhën shqipe", "Studime filologjike", Tiranë 1991, nr. 1.

¹⁸³H. Pasho, *Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe nga Rilindja deri në v. '80 të shek. XX*, Tiranë, 2005, 198 f.

¹⁸⁴A. Duro, *Studime gjuhësore (terminologji, gjuhësi kompjuterike, kritikë-bibliografi)*, QSA, IGJL, Tiranë, 2012, f. 156-171.

¹⁸⁵Shih Xh. Lloshi, *Shqipja standarde në rrethanat e dygjuhësisë*, "Studime filologjike", ASHSH, IGJL, nr. 3-4, Tiranë 2001, f. 51-52. Autori shkruan: "Fjalorët terminologjikë nuk mund të hartohen më tej, duke vënë si detyrë paraqitjen sa më të gjerë të shqipërimeve, dhe të mos cenohet prej kësaj kodifikimi tërësor i fushës, në atë nivel që e kemi arritur, të vetëdijshëm se më pas do të bëjmë ribotime gjithnjë të përmirësuar".

¹⁸⁶Xh. Lloshi, *Shqipja – Gjuhë e hapur dhe dinamike*, "Studime filologjike", ASHSH, IGJL, nr. 3-4, Tiranë, 2002, f. 22-32.

¹⁸⁷H. Shehu, "Rreth fjalëve angleze ose me prejardhje nga anglishtja në gjuhën e sotme shqipe" në përmbledhjen "SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE", 19, Prishtinë, 2001.

¹⁸⁸N. Caka, *Terminologjia e informatikës në gjuhën shqipe dhe standardizimi i saj në fjalorë*, në LEKSIKOGRAFIA SHQIPE – TRASHËGIMI DHE PERSPEKTIVË, Tiranë, 2005, f. 239-249.

¹⁸⁹Xh. Lloshi "Gjuha shqipe letrare përmes kontestimit", "STUDIME", 8-9, 2001-2002, Prishtinë, 2002, f. 101-119.

¹⁹⁰Gj. Shkurtaj, *Si të shkruajmë shqip (Baza të shkrimit akademik)*, Kreu VIII, Pasurimi dhe pastrimi i gjuhës shqipe nga fjalë të huaja të panevojshme, Tiranë, Toena, 2012, f. 255-270.

edhe hyjnë më në thellësi të gjuhës, sidomos disa syresh, ndonëse rrallë, përdoren deri në thjeshtligjërime me përmbajtjen konceptore si terma, por me kuptime të thjeshtësuara, siç dëgjohen në të folurit e shfrytëzuesve të zakonshëm të internetit, deri tek nxënësit, fëmijët: *klikoj, maus, printoj, printer* etj.

Krahas kësaj, ndryshe nga më parë, janë kristalizuar e janë mëvetësuar edhe dy nënshtrës të tjera, të identifikuar në bazë të funksionit që kryejnë: anglicizmat që funksionojnë si fjalë të zakonshme si të vetme ose që krijojnë me fjalët shqipe sinonime, por me kuptime specifike, si: *shopping* dhe *pazar* (*psonisje*), *disko*, *dixhej*, *pab* dhe *lokal*, *párti* dhe *mbrëmje* (vallëzimi), si edhe anglicizma si fjalë librore (jotërma), që përdoren në masmedia, në publicistikë, në botën e spektaklit me diferencime kuptimore ose, sipas rastit, të njëjta me fjalë shqipe, duke i zhvendosur ndonjëherë këto të fundit ose duke u përdorur paralel me to si: *shou* dhe *spektakël*, *performancë* dhe *shfaqje*, *rezort* dhe *vend pushimi*.

Pikërisht problemi qëndron në gjetjen e një *baraspeshe*, apo *barazimi*, siç thotë dhe prof. Xh.Lloshi: “...*parapëlqej jo përjashtimin, por praninë e të dyja anëve të këtyre barazimeve...*”¹⁹¹ ndërmjet huazimeve të pashmangshme dhe termave të shqipes, por në të vërtetë deri në futjen e një termi shkencor të shqipes në fjalorin e gjuhës së përditshme, është një rrugë e gjatë.

Futja e anglicizmave si shfaqje më e spikatur e globalizmit, është e përqendruar kryesisht në fushën e informatikës. Termat e rinj të huaj i mbishtresohen termave të huaj të kaluar, sot krahas tyre kemi edhe terma të rinj: *monitor*, *klikoj*, *çatoj*, edhe të dikurshëm *presion*, *dimension*, *ekuilibër*, *iniciativë*, *kompliment*, *posedoj*, *shoëman*, *benifite*, për të cilët më pas janë përdorur *trysni*, *përmasë*, *baraspeshë*, *nismë*, *përgëzim*, *kam në pronësi*, *prezantues i shfaqjeve artistike*, *të mira materiale*. Dikur në vend të *influcencë* përdorej *ndikim*. Sot krahas *influcencë* përdoret edhe *impakt* (nga angl.); po kështu krahas *tastierë* edhe *kibord*¹⁹².

Sh. Islamaj në artikullin “*Shqipja në kontekstin e ri shoqëror-gjuhësor*” ndër të tjera trajton gjerësisht anglicizmat (sidomos termat që lidhen me informatikën) në huazimet e sotme të shqipes dhe sugjeron se si duhet vepruar me to, duke i ndarë në të zëvendësueshëm e të pazëvendësueshëm.¹⁹³

Duhet pohuar në mënyrë të sintetizuar se termi anglez, sikurse dhe çdo term tjetër i huaj, është e nevojshme të vështrohet i ballafaquar me termin shqip në kuadrin e kërkesave që ai duhet të kënaqë, për t’u përfshirë si njësi e përshtatshme në një sistem terminologjik të një fushe të caktuar të dijes në gjuhën shqipe, në përputhje me kërkesat që shtrun terminologjia para normës dhe standardizimit, siç janë njëkuptimësia, përpikëria, motivueshmëria e qartësia, të cilat duhet t’i gëzojë çdo term standard, qoftë i huaj, qoftë shqip. Prandaj, në përputhje me normën dhe standardin terminologjik, sipas rastit, kalohet nga njësi e huaj tek ajo amtare ose anasjelltas, duke pranuar atë njësi që i kënaq sa më shumë kushtet për të qenë term normë dhe standard.

¹⁹¹Xh. Lloshi, *Shqipja – Gjuhë e hapur dhe dinamike*, “Studime filologjike”, ASHSH, IGJL, nr. 3-4, Tiranë, 2002, f. 22-32

¹⁹²Shih për më gjerë, N. Caka, *Terminologjia e informatikës në gjuhën shqipe dhe standardizimi i saj në fjalorë*, në LEKSIKOGRAFIA SHQIPE – TRASHËGIMI DHE PERSPEKTIVË, Tiranë, 2005, f. 239-249.

¹⁹³Sh. Islamaj, “*Shqipja në kontekstin e ri shoqëror-gjuhësor*”, *Gjuha shqipe*, nr. 1/2007, f. 52-70.

“Fjalëformimi i shqipes, - shkruan prof. Lafe, -karakterizohet nga një zhdërvjelltësi e madhe. Ai mbështetet në radhë të parë në mjetet dhe tipat fjalëformues të gjuhës popullore, por një peshë në rritje po marrin edhe kalket strukturore e kuptimore prej gjuhëve të zhvilluara. Një zhvillim cilësor përbën fjalëformimi terminologjik, ku janë përpunuar mjete e tipa fjalëformues me kuptime sistemo terminologjike.....Ndeshja e fjalës shqipe me fjalën e huaj me pasojë neologjinë ose huazimin është ndoshta dukuria që bie më shumë në sy në fushën e leksikut, ku veprimtaria e planifikimit gjuhësor duhet të jetë e pandërprerë e sistematike jo vetëm për të ruajtur fjalorin e shqipes nga gërryerja, po edhe për hir të qartësisë së kuptimit”¹⁹⁴.

Ky ka qenë edhe konceptimi i shqipërimeve që mbetet gjithmonë e që lidhet me anën tjetër të globalizmit, mbi vënien lehtë të globalizmit gjuhësor përmes shqipërimeve të suksesshme për zëvendësimin e termave të huaj, për t’iu kundërvënë globalizmit në anët negative të tij.

Pra globalizmi si dukuri nuk duhet mbivlerësuar, por as nënvlerësuar, por duhen marrë prej tij ato anë pozitive që nuk prekin veçoritë kombëtare, sidomos të gjuhëve të vendeve të vogla, siç është dhe gjuha shqipe.

Si përfundim, duhet nënvizuar se globalizmi gjuhësor i gjen portat hapur për të depërtuar në gjuhë nëpërmjet terminologjisë. Nisur nga veçoritë që ka terminologjia me tiparet e saj themelore, si ndërkombëtarësia e përmbajtjes, ndërkombëtarësia e formës së jashtme dhe ndërkombëtarësia e formës së brendshme, këto probleme duhet të shtrihen më gjerë në fushën e terminologjisë të fushave të ndryshme të dijes. Ne, në këtë kumtesë, vetëm sa hapim një shteg për studime të mëtejshme, mbi bazën e një lënde më të gjerë nga fusha e leksikut terminologjik, si pjesë e rëndësishme, me dinamikë dhe më e prekshme ndaj ndikimeve të huaja e leksikut të gjuhës standarde shqipe.

¹⁹⁴E. Lafe, *Shqipja standarde në vështrim strukturor dhe funksional*, “Studime filologjike”, ASHSH, IGJL, nr. 3-4, Tiranë, 2002, f. 12-21.

LEKSIKOGRAFI DHE ORTOGRAFI: ASPEKTE TË NORMËS DREJTSHKRIMORE
NË FJALORIN SHQIP-GREQISHT TË
THIMI MITKOS

Në parafjalën e botimit të “Bletës shqiptare” (Aleksandri, 1878), Mitkoja përmend thënien lapidare të Herderit: “*Një komb nuk mund ... të dalë nga barbaria, përveçse duke punuar gjuhën e vet*”¹⁹⁵. Është interesante të kujtojmë se, ashtu si Herderi, Mitkoja arrin në këtë përfundim pas përvojës së pasur që grumbullon gjatë mbledhjes së lëndës folklorike.

Është një shkollë e dyfishtë për të: kontakt në shkallë të gjerë me traditën gojore të shqiptarëve, pra me burimet e gjuhës së popullit, dhe, nga ana tjetër, përballje me kërkesën e të shkruarit të shqipes, e më tej, me nevojën e hartimit të veprave kodifikuese të saj, të cilën e thekson me raste të ndryshme. Kështu, në janar 1868, në një letër dërguar Dh. Kamardës, Mitkoja shkruan se “*U lutemë të mos panteehini semos u (a unë) bëj të diturin, të dishmin, a filologun mbi gluhën tenë, por tue këlenë këjo e pashkruar gluhë, e humbur edhe e rbjerë, dua t’u dëftoj vetëmë fjalat të dialektit tonë*”, dhe shtron kërkesën për “*një leksikó shqip e gërqisht*”¹⁹⁶. Më 1875, në parathënien shqip të variantit të “Bletës”, që ishte parashikuar të shtypej në Athinë e që mbeti në mes të udhës¹⁹⁷, ai bën fjalë “*për ndariën, e të paabashkuarit e të paa-diturit*” e shqiptarëve, “*që gjenden paa gramatikë të gjuhës vëndit tyre, e përandaj diemët Shqypëtarë jan të nxituarë të mësonjën disa Tyrqishten, disa Italishten e disa Gërqishten gjuhë, por edhe këto për-së-shqarë-thi, e paa ondi tuke ubërë aqë më tepërë paa hir gjysëmakë, a të gjymës-mësuarë për dëm të vetë-vetehes edhe të vatanit tyre*”. Dhe shpjegon më poshtë se “*Mbë këta të mangët tuke shtirë sytë më tepërë, kuur paa shkrime të gluhës vëndit është një gjë e paamunçime të gjytetërohen e të hapën sytë Shqypëtarët të tërë, vepërova këtë të shkruame*”.

Po a ishte në gjendje Mitkoja të merrte përsipër një barrë të tillë? Përgjigjen na e jep ai vetë, kur, me një çiltërsi e modesti të pashoqe, thotë se “Bleta” “*më kallëzon më tepërë për një punëtuar kallës-mbë-ledhësin, sesa për një të dijtëshim bulk*”.

¹⁹⁵ Th. Mitko, *Vepra*, përgatiti Q. Haxhihasani, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë 1981, f. 61.

¹⁹⁶ Th. Mitko *op.cit.* 610.

¹⁹⁷ “*Vivlia ime ndë Athinë, nuk humbi, po me të panumuruarat lajthitje të shkronjashtypsit, katandisi ajo, e u bë një gjë për të mos dalë ndë dritë – aq e papëlqyeshme, e prandaj e lëreva*”. (Nga një letër e Mitkos për Dh. Kamardën, Kajro, 15 shkurt 1878). Th. Mitko *op.cit.* 620. Në dorëshkrimet e Mitkos janë ruajtur një numër bocash të “Bletës” së Athinës, ndër të cilat ia vlen të veçohen ato me versionin shqip të parathënies greqishtë, që mban titullin Παράφρασις εις την Αλβανικήν, ose, sipas fjalëve të tij, *Nkëthyerë mbë Shqypen Parthënme*. Kjo do të thotë se *Parthënme* që shkruar së pari në greqisht e më pas u përkthye prej Mitkos në gjuhën shqipe. Teksti shqip jep shkas për një sërë komentesh të natyrës gjuhësore, por këtu do të ndalemi vetëm në faktin se, me sa vërejmë, Mitkoja e pati konceptuar fillimisht “Bletën” si një botim dygjuhësh dhe u përpoq ta realizonte si të tillë. Fakti që në botimin e Aleksandrisë kemi vetëm versionin greqisht të parathënies, tregon se autori hoqi dorë nga ky qëllim, siç duket edhe nga letra që i shkruan Kamardës në shkurt 1878: “*Tani e dhash n’ Aleksandri, edhe u nis pardje të shtyposet përsëdyti pak më e shkurtër, ndonëse më qëndron shumë shtrenjtë shtypësi, e i lutem zotit të dalë e pëlqyer*”. Th. Mitko *op.cit.* 620.

Ky “punëtuar kallës-mbë-ledhës” pati qenë edhe “farë-hedhës” a “themel-vënës” dorëmbarë i një Fjalori shqip-greqisht¹⁹⁸, që vetëm konvencionalisht mund të quhet i tillë, ngaqë, këtu, greqishtja shërben jo aq si pikëmbërritja (*target language*) e një fjalori dygjuhësh sesa si metagjuha (*metalanguage*) e një fjalori të shqipes.

Gjatë hartimit të Fjalorit, Mitkos i është dashur të përballet me një sërë çështjesh të pazgjidhura deri atëherë, sikurse ishin:

a) alfabeti që do të përdorte

b) kriteret e përcaktimit të trajtave shkrimore normative.

Për punë të alfabetit ai sqaron më se një herë se mori “*shkrimet Elinishte, me pak ndërrysim, të zakoniës të dijshimit Zotit Dh. Kamardhë Shqypëtarit nga Syqelia, përse gluha Shqype, tuke paturë të ngushtë farë e fis me të lashtë Elinishte, e më të shumtë rënja gjithë-një ndër të dyja, është fështirë të shkruhet me të tiera shkrime pa vdierrë të madhe pjesë nga thelpi e nga shenjat e Elinishtes*”¹⁹⁹.

Në botimin e “Bletës” së Aleksandrisë, ai na jep në mënyrë analitike grafemat që përdor, marrë prej Kamardës: *Αλφάβητον γενικόν αλβανο-ηπειρωτικόν υπό Δημητρίου Καμάρδα εν Αιβόρνω (πλην του b και d)* [Alfabet i përgjithshëm albano-epirotas, hartuar prej Dhimitër Kamardës në Livorno (përveç b dhe d)]²⁰⁰. Shënojmë se titulli greqisht përkon plotësisht me titullin origjinal në italisht të Kamardës: *Alfabeto generale albano epirotico*, Livorno 1869.

Fjalori, me rreth 6000 zëra e me numër më të madh fjalësh, po të mbahet parasysh se ka të tilla që hasen vetëm në brendësi të lemave, ka karakteristikat e një veprë përshtuese, që synon në radhë të parë të nxjerrë në dritë pasurinë leksikore të shqipes. Norma drejtshkrimore dhe leksikore nuk janë bërë ende synim parësor i tij, por ato përvijohen vetiu sa herë duhet zgjedhur trajta përfaqësuese mes një numri trajtash që ofrojnë tradita shkrimore dhe të folmet e shqipes.

Mitkoja nuk ka në duar zgjidhje të gatshme, ndaj edhe përdor një sistem të dendur referencash të brendshme dhe citon shpesh shkrimtarë e vepra të traditës apo autorë bashkëkohorë.

Sa i përket bazës dialektore të Fjalorit, ia vlen të përmendet se Mitkoja dallonte tre grupe dialektore të shqipes, që janë *dangëllishte-toskërishtja*, *labërishte-çamërishtja* dhe *gegërishtja*. Grupin e parë ai e përmend në pasqyrën e lëndës së “Bletës” së Athinës, ku na bën me dijeni se ka perifrazuar në dangëllishte-toskërishte veprën e Dora d’ Istrias kushtuar shqiptarëve. Mitkoja bën fjalë këtu për “*Një pjesë të historisë së Dora d’ Istrias për kombësinë shqiptare botuar në*

¹⁹⁸ Shih Dh. Q. Qirjazi, “Mjaltë” nga hojet dhe trojet e shqipes: Fjalori dorëshkrim shqip-greqisht i Th. Mitkos dhe suaza ballkanike e tij, në R. Ismajli (ed.) *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit*, ASHA e Kosovës – Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Prishtinë 2012, f. 609-625.

¹⁹⁹ Nga parathënia shqip e “Bletës” së Athinës. Shënojmë se, megjithatë, në dorëshkrimet e Mitkos gjejmë edhe faqe të tëra të shkruara me gërma latine, çka do të thotë se çështja e alfabetit vazhdonte të përbente një nga shqetësimet intelektuale të tij. Një dëshmi e hershme e përdorimit të alfabetit latin prej Mitkos, është edhe kopja e letrës që i dërgon Kamardës në janar 1868, të cilën po ia ofrojmë lexuesit në këtë botim jubilar.

²⁰⁰ “Bleta” 1878: ζ’-η’. Në faqen 1 të “Bletës” Mitkoja na njofton se e mori përkthimin shqip të esesë së Dora d’ Istrias prej Dh. Kamardës, “*shqypëtar nga Siqelia [që] e nkëtheu mbë gjuhën shqype me shkronja italishte mbë 1867*”, dhe shton se “*ndë Shqypëri të poshtëme të pakë njerëzë dinë shkronjat italishte*”.

frëngjisht dhe përshtatur në dialektin shqiptar të Italisë prej Dhimitër Kamardës, [ripërshtatur] prej meje [Mitkos] në të folmen dangëllishte-toskërishte²⁰¹.

Ç’ kupton Mitkoja me dangëllishte-toskërishte dhe a është ai i pari që bën fjalë për një ndarje të tillë dialektore të shqipes? Për t’iu përgjigjur pyetjes është e nevojshme të krahasohet përkthimi i Kamardës, në njërën anë, me versionin e botuar te “Bleta” e Aleksandrisë, dhe, në anën tjetër, me dorëshkrimin e përshtatjes që Mitkoja i bëri atij përkthimi²⁰². Meqenëse kjo punë mbetet për t’u kryer në një të ardhme të afërt, po kufizohemi tash për tash në një kumtim gojor të prof. Gj. Shkurtajt, sipas të cilit një ndarje e tillë nuk ka qenë e njohur në vitet e Rilindjes, ndonëse sot mund të përputhet me njërin prej nëndialekteve të toskërishtes.

Për grupet e tjera dialektore të shqipes mësojmë tërthorazi nga i njëjti burim (“Bleta”, 1875), kur Mitkoja përmend “*këngët popullore ... të ndara në dangëllishte-toskërishte, labërishte-çamërishte dhe gegërishte*”²⁰³. Kjo ndarje nuk përmendet në parathënien e “Bletës” së Aleksandrisë, ku flitet për “*Këngë shqiptare të Shqipërisë së madhe dhe të ngulimeve shqiptare në Greqi dhe Itali ...*”²⁰⁴.

Fakti që ai vetë na thotë se shkruan në dangëllishte-toskërishte mund të interpretohet në mënyra të ndryshme. Mund të lidhet thjesht me dialektin që ai ka mësuar qysh i vogël, ose mund të jetë tregues i një vlerësimi të dangëllishte-toskërishtes si dialekt që do të shërbejë si një lloj *koineje* për shqiptarët e asaj kohe. Mendimi i Mitkos për ta përshtatur a kthyer shqipen e Kamardës në dangëllishte-toskërishte tregon se ai e gjen të nevojshme t’iu drejtohet bashkatdhetarëve në një gjuhë më të kuptueshme sesa ajo që përdor Kamarda²⁰⁵, e kjo gjuhë mund të jetë një dialekt që ndodhet më afër të folmeve të tjera të shqipes, apo edhe një trajtë si të thuash mbidialektore, e cila ndërthur në mënyrë selektive elemente të të folmeve truallore të shqipes.²⁰⁶

²⁰¹ A) Μέρος της ιστορίας της Δώρας Ιστριάδος περί Αλβανικής εθνότητος εκδοθείσης Γαλλιστί και παραφρασθείσης εις την εν Ιταλίᾳ Αλβανικὴν διάλεκτον υπό Δημητρίου Καμάρδα, υπ’ εμού δε εις την Δαγκλο-Τοσκικήν.

²⁰² Siç del nga letërkëmbimi i Mitkos, por edhe nga sa do të thuhet në vijim (shih shën. 11 dhe 18), Mitkoja është marrë deri në fund të jetës me këtë përkthim dhe u përpoq ta botonte si libër më vete.

²⁰³ Δ) Δημοτικά ἄσματα ..., διηρημένα εις Δαγκλο-Τοσκικά, Αρβορο-Τσαμικά, και εις Γεγικά.

²⁰⁴ Αλβανικά ἄσματα της μεγάλης Αλβανίας και των εν Ελλάδι και Ιταλίᾳ αλβανικῶν αποικίων, ηρωικά, ερωτικά, γαμήλια, κωμικά και αλληγορικά. Këtu me “Shqipëri të madhe” shënohen trojet kompakte të shqipes.

²⁰⁵ Në janar 1879, Mitkoja i shkruan De Radës: “*Meqenëse kam nëpër duar përkthimin në shqip të Dora d’ Istrisë ‘Kombësia shqiptare’, përkthimin e zotit at Dhimitër Kamardës në Livorno, dhe meqë të folurën shqip të vendeve tuaj që ka përdorur at Kamarda mund ta kuptoj me vështirësi, m’u desh të kërkoja dhe të gjeja tekstin greqisht ose frëngjisht*”. Th. Mitko op.cit. 631. Po kështu, ai i kërkon De Radës që shkrimin e vet për topografinë e Korçës, që do ta botonte te “Flamuri i Arbërit”, t’ia përshtasë “*ndë dialettë tonë, që ta ndëlgonjën shqypëtarët. Pse gluhën tuaj, besomë as unë s’e ndëlgonj. ... E këtë punë më shumë se një herë ta shkrojtja zotërisë sate*”. Letër e 16.10.1884, Th. Mitko op.cit. 669. Megjithatë, Mitkoja ka përfshirë në Fjalorin shqip-greqisht një numër të madh fjalësh të të folmeve arbëreshe, e madje krijon fjalë të reja prej atij brumi, sikurse është folja *vapëzohem* ‘varfërohem’ (<arb. i *vapëk* ‘i varfër’): “... *tregëtia, qëkur hyri anglezi n’ Egjiptë, nuk na vete mbarë. Vendi u vapëzua keq*”. Letër për De Radën, 16.02.1886, Th. Mitko op.cit. 678.

²⁰⁶ Mitkoja përdor qëllimshëm trajta që nuk janë të dangëllishte-toskërishtes, siç shohim p.sh. në letrën e janarit 1868 për Kamardën: *tue këlenë* këjo e pashkruar *gluhë*, e humbur edhe *e rbjerë*.

Duket se kontakti me shqiptarë prej anësh të ndryshme të Shqipërisë e ka ndihmuar Mitkon për të njohur dallimet dhe konvergimet e dialekteve të shqipes²⁰⁷. Në këtë pikë na duket e udhës të përmendim edhe vlerësimin e Mitkos për gegërishten, i cili ngjan me atë të Kristoforidhit, por edhe i paraprin këtij të fundit në kohë, ngaqë formulohet më 1875²⁰⁸: “*Sa për llojin e gjuhës shqipe, kam përdorur nganjëherë trajta të gegërishtes, ngaqë ajo është disi më e zhdërvjelltë dhe më e pasur në fjalëformim, ndërsa trajtat e pësoreve të saj ngjajnë më shumë me greqishten*”²⁰⁹. K. Kristoforidhi, në Prologun e “Gramatikës së shqipes” (Kostandinopojë, 1882), shkruante: “*Gegërishtja, si një dialekt i gurrës së shqipes, është më burimori, më i pastri dhe më i pasuri ndër dialektet e saj. Studimi i gegërishtes është domosdoshmërisht i nevojshëm për çdo shqiptar dhe albanolog, për të kuptuar qartë rrënjën dhe degëzimet e fjalëve të shqipes; pra cilido që nuk e njeh atë, nuk mund të quhet zotërues i shqipes ...*”²¹⁰.

Ndonëse objekt i kësaj kumtese është qëmtimi i elementeve të normës drejtshkrimore të përvijuara në fletët e një vepre leksikografike, është e kuptueshme se ato mund të vendohen kryesisht e në radhë të parë nëpër shkrimet e vetë Mitkos si dhe në zgjidhjet a konvencionet, të vetat a të të tjerëve, që ai parapëlqen kur i duhet të regjistrojë një këngë, një përrallë apo të përkthejë në shqip fjala vjen fabulat e Ezopit. Kësisoj, ky *mbledhës i pasionuar* i fjalës shqipe është edhe një *shkrues i thekur* i saj. Le të mos harrojmë se në kohët që jetoi ai e vetmja mënyrë përjetësimi e fjalës së folur ishte të shkruarit e saj, e se shprehja e njohur latine *verba volant, scripta manent* bartte atëbotë një peshë shumë më të madhe sesa në epokën tonë.

²⁰⁷ Të vihet re, p.sh., konstatimi i mëposhtëm i Mitkos: “*Pjesa më madhe e Shqipërisë kanë një zanore si y frëngjisht a i grek, p.sh. sy (oeil), që ... shqipëtarët e Jugut, të Çamërisë dhe Haonisë (Eperus) nuk e kanë*”. Letër e 10.11.1883 për De Radën. Th. Mitko op.cit. 662.

²⁰⁸ Një dëshmi të fillimeve të shek. XIX për gegërishten na e jep iluministi grek A. Psalidhas (1764-1829), mësues në njërën nga shkollat e dëguara të Janinës, i cili mbante lidhje me Ali Pashën dhe ka qenë njohës i shqipes e i shqiptarëve: Η άνω Αρβανιτιά λέγεται με ένα όνομα Γκεγγαριά, και οι εγκάτοικοι Γκέγγιδες. Τούτοι οι Γκέγγιδες διαφέρουν πολύ από τους Ηπειρώτας Αρβανίτας και κατά τον ιματισμόν και κατά το ανάστημα και κατά τον οργανισμόν και κατά το πνεύμα, και κατά την γλώσσαν επειδή η γλώσσα τους ιδιωτίζει και ο ιδιωτισμός τούτος επαινείται από τους πολλούς Αρβανίτας τους λοιπούς”. [“*Shqipëria e epërme quhet me një emër Gegëri dhe banorët (e saj) gegë. Këta gegët dallojnë shumë prej shqiptarëve të Epirit edhe për nga veshja edhe për nga shtati edhe për nga organizimi edhe për nga intelekti, si edhe prej gjuhës, ngaqë gjuha e tyre veçon dhe kjo veçanësi lëvdohet prej shqiptarëve të tjerë të shumtë*”.] Αθανασίου Ψαλίδα, Η Τουρκία κατά τας αρχάς του ΙΘ΄ αιώνας, εκδιδόμενη υπό Γ. Χαριτάκη [A. Psalidhas, *Turqia në fillimet e shek. XIX*, botuar nga G. Haritaqis], rev. *Ηπειρωτικά Χρονικά* 6 (1931) 58, Janinë.

²⁰⁹ «Ως δε προς το ύφος της Αλβανικής γλώσσης μετεχειρίσθην ενίστε τύπους της γεγικής διαλέκτου, διότι αυτή είναι οπωσούν ευστροφωτέρα και πλουσιωτέρα προς παραγωγάς, και οι τύποι δε των μετοχών αυτής είναι επί το ελληνικώτερον». Nga parathënia e “Bletës” së Athinës. Për të qenë sa më afër së vërtetës, na duhet të themi se Kristoforidhi shkruante qysh më 1857 se “*Gjuha shqipe përbëhet nga dy dialekte, gegërishtja dhe toskërishtja, që dallohen mjaft njëri prej tjetrit nga fjalët, shqiptimi dhe idioma. Ndër këto dy dialekte gegërishtja pranohet se është më e pastër dhe më e pasur, kurse toskërishtja ndoshta është më e butë dhe më e rregullt*”. Shih Memorandum i K. Kristoforidhit për gjuhën shqipe, sipas Xh. Lloshi, *Kristoforidhi përmes dokumentimit*, Bota shqiptare, Tiranë 2005, f. 221.

²¹⁰ «Η Γεγική, ως πρωτότυπος διάλεκτος της Αλβανικής, είναι η γνησιωτέρα, η καθαρωτέρα, και η πλουσιωτέρα των άλλων. Η σπουδή της Γεγικής διαλέκτου είναι απαραίτητως αναγκαία εις άπαντα Αλβανόν ή Αλβανολόγον, όπως εννοήση ευκρινώς την ρίζαν και τας παραγωγάς των λέξεων της Αλβανικής, όθεν ο μη ειδώς αυτήν, δεν δύναται να γείνη κάτοχος της Αλβανικής γλώσσης ...». K. Χριστοφορίδου, «Γραμματική της Αλβανικής Γλώσσης κατά την τοσκικήν διάλεκτον», K/πολη 1882, f. 1.

Nuk mundesh veçse me admirim e nderim të pacak të kundrosh mijërat e fletëve të dorëshkrimeve të Mitkos. Ai shkruan kudo e kurdo, mbi copa zarfash a mbi fletët e hesapeve të tregtarit, herë nxituar herë kujdesur, për të mos humbur fjalët e njeriut që ka përballë, për të hedhur në kartë një varg a një fjalë të urtë që i kujtohet atë çast, por edhe për të zbutur sadopak brengën a hallin a “*mallin e shtampësë*”²¹¹, që nuk iu nda gjithë jetën. Shfletimi i letërkëmbimit të tij tregon sa mund e kohë i është dashur për të shkruar e rishkruar tekstet e këngëve a të krijimeve të tjera popullore me shpresën se do të “shtampoheshin” dikur²¹². Kjo shpresë-brengë a brengë-shpresë e mbante gjallë dhe e trazonte shpirtin e tij²¹³. Dhe mbase kjo ka qenë një ndër arsytet që ai jo thjesht e shkruan dhe e përjetëson, por edhe e *bukur-shkruan* e e “ledhaton” fjalën shqipe. Te Mitkoja, gjuha a gluha e folur bëhet mirëfilli dhe metaforikisht *fjalë-shkruar*, bëhet dhe mbetet “nuse” *sy-shkruar* e *vetull-gramë*!

Cilat kanë qenë disa nga kriteret që zbatoi Mitkoja për të hedhur hapat e parë drejt një norme drejtshkrimore? Nga studimi i lëndës së fjalorit dallojmë disa syresh.

- *Kriteri etimologjik*. Fjala shkruhet duke marrë parasysh etimologjinë e saj.

Në këtë rast rëndësi të dorës së parë ka konceptimi dhe zbatimi i një kriteri të tillë dhe jo aq çështja janë a s’janë të drejta etimologjitë e Mitkos. Për fjalën *defter*, p.sh., ai mendon se duhet shkruar *dëfter* ngaqë beson se rrjedh prej foljes *dëftej*:

deftër-i. Κατάστιχον, κατάλογος, (Concil.) πίναξ, (dëftēnj = δεικνύω), δείκτης. Γραπτέον deftēr. [**deftër-i**. Regjistër, listë, (Concil.) tabelë, (dëftēnj = tregoj), tregues. Duhet shkruar deftēr.]

Fjala *vik* ‘vig’ beson se duhet shkruar *vyk* për arsye se lakedemonasit përdornin fjalën βαβύκα ‘urë’:

vik-u. Γέφυρα αυτοσχέδιος, άτεχνος· ως π.χ. εν απλούν ξύλον βαλμένον αντί γεφύρας. «Mos u-bën ur’ e vik». Βαβύκα Λακεδαίμων· η γέφυρα. Όθεν γραπτέον vyk. [**vik-u**. Urë e improvizuar, e ndërtuar shkeleshko; si p.sh. një copë dru që shërben si urë. «Mos u-bën ur’ e vik». Βαβύκα Laqedemonasit; ura. Për rrjedhojë duhet shkruar vyk.]

Për foljen *durlas* i duket se duhet shkruar *drulas* në rast se lidhet vërtet me gr. τρώγω [trógo], τρωγализώ [trogalízo]:

durlás ή **durëlás** (ρμ.ουδέτ.). Ασωτεύω, πολυεξοδεύω. durlísnja, durlíta, durlít, durlíturë. Κυρίως πολυεξοδεύω εις φαγοπότια. Φαίνεται γραπτέον drulas, ή drujlás αν τωιοντι σχετιζηται με το ελλ. τρώγω, τρωγάλια, -ίζω. durlítēs = σπάταλος, άσωτος. [**durlás** a **durëlás** (folj.asnj.).

²¹¹ “Ma unë, tue pasunë mǎlln’ e shtampësë, gjithë atyneve [të mirave] u ktheva faqenë, veçë iu lutshë të më shtampohej libri, ashtu qi kur të kthenje prej dheut sine të keshe një qirī ndezunë ndorë, për të ndritunë atë të vobek dhë t’ Arbënit...”. P. Bogdani, Të primitë përpara letërarit [lexuesit], *Cuneus prophetarum*, 1685. Sipas R. Ismajli, *Tekste të vjetra*, Dukagjini, Pejë 2000, f. 323.

²¹² Për foljen shtyp të shqipes së sotme Mitkoja përdor foljet *shtypos*, *shtip*, *tiparit*, *shpall me stampë* dhe *stamponj*. Shih Th. Mitko op.cit. 622, 634, 668 etj.; 673; 712; 712 përkatësisht.

²¹³ Më 7.10.1884 i kumton De Radës se “G. Meyeri më kish shkruarë se kish të më shtyposnjë të mbeturat e ‘Bëletës’”, ndërsa më 29.5.1885 e njofton se “Prej Meyerit pata një libër ‘Della lingua e della letteratura albanese’ në gjuhën italishte. Dy të tretat nga tufa ime të shqypevet ia dërgova për të shtyposurë e po i dërgonj edhe të tjeratë”. Th. Mitko op.cit. 668 dhe 674 përkatësisht. Disa vite më pas (1887) do t’i ankohet De Radës që “Meyeri nuk më shtyposi as kënkëkat e mija, as istorinë [e] Dora d’Istria[s]. Jam kaq i mëruar, përse më mbetenë si të vdekura gjithë këto të shkruame”. Th. Mitko op.cit. 696.

Dal nga binarët, harxhoj pa masë. durlísnja, durlíta, durlít, durlíturë. Kryesisht harxhoj pa masë në të ngrëna e të pira. Duket se do shkruar drulás, a drujlás nëse vërtet lidhet me gr. τρώω, τρωάλια, -ίζω. durlítës = dorëlëshuar, i çrregullt.]

-Përhapja gjeografike e fjalës. Mitkoja jep të dhëna për shtrirjen gjeografike të trajtave të ndryshme, duke iu dhënë përparësi të tërthortë atyre që janë më të përhapura:

dhrī-a, και **ardhī**, **hardhī-a**. Αμπελόκλημα. Οι δε Δίβριοι λένουν αυτό **thúprë-a**. Έτι λέγεται **'rdhī-a**. [**dhrī-a**, dhe **ardhī**, **hardhī-a**. Hardhi. Dibranët i thonë **thúprë-a**. Thuhet edhe **'rdhī-a**.]

grënthëlië-ja (πελ.λ. 66). Αθήν (του λαιμού ιδίως, αδένωμα, εληιαίς του λαιμού. (καθ' ημάς) **gjëndrë**. Ίδε. [**grënthëlië-ja** (πελ.λ. 66). Gjëndër (kryesisht e grykës, adenomë, ganglionet e grykës. (ndër ne) **gjëndrë**. Shih.]. Të vihet re këtu shënimi (*ndër ne*) dhe sqarimi se trajta tjetër haset tek arvanitët.

déle-ja. Πρόβατον. (πλθτ.) dhén-të και (διαλεκ.) dén-të. [**déle-ja**. Dele. (shum.) dhén-të dhe (dial.) dén-të.]

Ai shtie në përdorim edhe fjalë që hasen vetëm në një të folme e megjithatë mund të përdoren më gjerë. Nga fjalët e mëposhtme, e para haset ndër arbëreshë dhe e dyta ndër arvanitë:

fushamírë-i (flj. 3, 199). Βοσκός, ποιμήν. [**fushamírë-i** (flj. 3, 199). Bari, çoban.]

farmírë-i (πελσγ. 10). Θεός. «Farmiri të të ruanjë». [**farmírë-i** (πελσγ. 10). Zot. «Farmiri të të ruanjë».]

-Fjalë e huaj a fjalë anase? Në shembullin që vijon, indikacionet *turq.* dhe *sllave* tregojnë mbase parapëlqimin e Mitkos për fjalët vendase:

bardhák (τρκ.). kúngull-i, kotróve-ja, katróve-ja, kënátë-a, (κρνίδ.) gurgúne-ja, (γζακβ.) gërçák-u. [**bardhák** (turq.). kúngull-i, kotróve-ja, katróve-ja, kënátë-a, (Kranidh.) gurgúne-ja, (Gjakovë) gërçák-u.]

delimér και **dylimér-i**. Αρχιποιμήν (Χαον.). το δε çobán, σλαβικόν. (flj. 151) **delmiér**. [**delimér** dhe **dylimér-i**. Kryebari (Kaon.). fj. çobán, sllave. (flj. 151) **delmiér**.]

-Tradita shkrimore. Në normëzimin e trajtave, Mitkoja merr parasysh traditën shkrimore të shqipes, të përvijuar në botime më të hershme.

çōnj (ρήμ.ενργ.). Στέλλω, μεταφέρω, σηκώνω και (Υδρ.) ευρίσκω. ζόνja, çona, ço και (μετχ.) çúarë. çóhem, ως (αυτοπαθ.) σηκώνομαι, εξηγούμαι. Έτι (κμρδ.) δηλοί ελαύνω, εγείρω, (o Budi γράφει mçōnj = απάγω ... 276) και επάγω, οδηγώ. [**çōnj** (folj.vepr.). Dërgoj, bart, ngre dhe (Hidr.) gjej. ζόνja, çona, ço dhe (pjes.) çúarë. çóhem, si (vetëvet.) çohem, shpjegohem. Po ashtu (Kamard.) ka kuptimin shtyj, nxis, (Budi shkruan mçōnj = bart ... 276) dhe çoj, drejtoj.]

káit-i. Ακρίβεια, οριστικότητα, αρμοδιότης (η λέξις αραβική). «foli me kait = ωμίλησεν ωρισμένως, ακριβώς, προσφυώς, καταλλήλως, αρμοζόντως, προσφόρως, αναλόγως». Εις το Γεγικόν σύγγραμμα «Concilium Albanum» γράφεται kájdë. «me njii kájdë u kaa përgjegj» (Conc. 89). Κατά το (Concil. σλ. 108, στ. 18) δηλοί τύπον, διατύπωσιν, κανονισμόν, πρόγραμμα. [**káit-i**. Saktësi, përcaktueshmëri, të qenit kompetent (fjala është arabe). «foli me kait = foli qartësisht, saktë, me vend, siç duhej, përshtatshëm, shkoqur, sipas vendit». Në librin gegërisht «Concilium Albanum» shkruhet kájdë. «me njii kájdë u kaa përgjegj» (Conc. 89). Sipas (Concil. f. 108, rreshti 18) ka kuptimin formulë, formulim, rregullore, program.]

gjíndië-a. Λαός, έθνος, φυλή, άνθρωποι. «Vien e ngrëhet gjindia mbi gjindën (dps, 86, 7) – Gjeniatë arbëreshka ndahenë posi të lashtëtë Elinë mbë kattër (φλτ. 27)». Κατά δε Χριστοφορίδην γραπτέον gjëndia (ίδε την λέξιν) gjíndëjë. [**gjíndië-a.** Popull, komb, fis, njerëz. «Vien e ngrëhet gjindia mbi gjindën (dps, 86, 7) –Gjeniatë arbëreshka ndahenë posi të lashtëtë Elinë mbë kattër (φλτ. 27)». Sipas Kristoforidhit duhet shkruar gjëndia (shih fjalën) gjíndëjë.]

Nga zërat e fjalorit që dhamë më sipër, por edhe në raste të tjera, duket qartë se Mitkoja përdor një metagjuhë ad hoc për sa i përket normës drejtshkrimore dhe leksikore. Disa nga fjalët më të shpeshta të kësaj metagjuhe po i rendisim më poshtë shoqëruar me shembujt përkatës.

-γράφων / γράφε [shkruaj]:

gřep-i. Άγκιστρον, και (flj. 65, 2) πηρούνι. Γράφων την λέξιν, gërép-i ή gërríp. [**gřep-i.** Gřep, dhe (flj. 65, 2) pirun. Shkruaje fjalën, gërép-i a gërríp.]

jelék (γράφε jelék εκ του ίλë)· (φόρεμ.) γελέκι, εσωκάрдιον. Юδ. **elék-u.** [**jelék** (shkruaj jelék [që rrjedh] nga fj. ílë); (veshje) jelek. Sh. **elék-u.**]

-γραφτέον [duhet shkruar]: Shih më sipër fj. **deftër-i.**

-επομένως γραπτέον [rrjedhimisht duhet shkruar]:

báith-i, γ. Υπογάστριον, το υπό τον ομφαλόν μέρος της κοιλίας. (ίσως εκ του banj ή bar = φέρω, φορώ, βαστώ). Επομένως γραπτέον bajth ή bájëth-i. Юτι (πελ. λεξ. 26) **báith** και **sbáith.** [**báith-i,** geg. Nënbar, pjesa e barkut poshtë këthizës. (ndoshta prej fj. banj a bar = φέρω, φορώ, βαστώ). Rrjedhimisht duhet shkruar bajth ose bájëth-i. Edhe (πελ. λεξ. 26) **báith** dhe **sbáith.**]

-ίσως γραπτέον [mbase duhet shkruar]:

greállë. (έπίρρ. fljamb.). Βραγχωδώς, βραχνιασμένα. Юδε ngjírurë. i grállë = βραγχώδης (flj. 142). «Ish mëm' e madheja mbi thron mbë diellë, e vajënej greelë». Юσως γραπτέον hrállë. [**greállë.** (ndajf. fljamb.). Me zë të çjerrë, me zë të ngjirur. Shih ngjírurë. i grállë = i ngjirur (flj. 142). «Ish mëm' e madheja mbi thron mbë diellë, e vajënej greelë». Mbase duhet shkruar hrállë.]

-όθεν γραπτέον [pra duhet shkruar]: Shih më sipër fj. **vik-u.**

-φαίνεται γραπτέον [duket se do shkruar]: Shih më sipër fj. **durlás.**

-ίσως λεκτέον [ndoshta duhet thënë]:

gosnúk-u (αλ.ιτ.). Ευχαριστημένος, χαρούμενος, περιχαρής (dpd.). Юσως λεκτέον gasnúk, εκ του gaz. [**gosnúk-u** (shq.It.). I kënaqur, i gëzuar, gazmor (dpd.). Ndoshta duhet thënë gasnúk, prej fj. gaz.]

-κάλλιον [më mirë]:

komb-i, κάλλιον **kom-i.** [**komb-i,** më mirë **kom-i.**]

-ίσως σημαίνει κάλλιον [më mirë mbase ka kuptimin]:

vikás (Hahn)· φωνάζω εν ανάγκη, όμοιον με το γ. bërtás. Юσως σημαίνει κάλλιον φωνάζω κινούμενος, ως οι πάπιας vik, vik, vik. Юτι (φυλέτ. 60) διεγείρω, ερεθίζω. [**vikás** (Hahn); thërras për ndihmë, e njëjtë me g. bërtás. Më mirë mbase ka kuptimin thërras duke ecur, sikurse patat vik, vik, vik. Po ashtu (φυλέτ. 60) nxis, eksitoj.]

-εσφαλμένον φαίνεται [duket e gabuar]:

dëbërtōnj. Διαπερώ, διατρέχω, διατρυνώ. «Posi shigjeta... i dëbërtonjin e i thernjin zemërënë zotnjësë beekuome (bd. 149). 176». Έτι «Kamb’ e duor dëbërtuom (σελ. 249)». (To dëpërtōnj εσφαλμένον φαίνεται). «vorretë t’i dëbërtonjë (bd. 176-216)». [**dëbërtōnj.** Depërtoj, përshkoj, shpoj tejpertej. «Posi shigjeta... i dëbërtonjin e i thernjin zemërënë zotnjësë beekuome (bd. 149). 176». Edhe «Kamb’ e duor dëbërtuom (f. 249)». (Tr. dëpërtōnj duket e gabuar). «vorretë t’i dëbërtonjë (bd. 176-216)».]

Edhe nga këta pak shembuj kuptojmë se Mitkoja ndodhej në kërkim të vazhdueshëm e se shfrytëzonte çdo burim të mundshëm për të mbështetur këtë apo atë trajtë përfaqësuese. Nga ana tjetër, janë karakteristike për metagjuhën e fjalorit fjalët *mbase*, *duket se*, *ndoshta* etj., që tregojnë se autori është i vetëdijshëm për kompleksitetin e çështjeve që trajton dhe për brishtësinë e zgjidhjeve që ofron.

“Në çetele të kujtimit...”: Kontekstualiteti dhe intertekstualiteti i veprës së Mitkos

Kjo Akademi Solemne, e mbledhur në 40-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit të shqipes dhe në prag të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, na shtyn të hedhim sytë 100 + 40 vjet më parë, në motet kur burra zamani si korçari e shqiptari Thimi Mitko endeshin udhëve të kurbetit dhe mbanin *“një qirī ndezunë ndorë, për të ndritunë atë të vobek dhë t’Arbënit...”*²¹⁴.

Fjalët e sapocituara të Pjetër Bogdanit na shtyjnë të qëmtojmë ndërtekstorësinë e shenjtëve të shqipes dhe mesazhet që ata i përcjellin së sotmes. Siç do të shihet më poshtë, Mitkoja dialogon ballëllartë e ballëllarë me paraardhës e me pasardhës, por, para se të ndalemi në këtë lloj dialogimi, e për ta bërë ndoshta më të plotë suazën e tij, e shoh me vend të them dy fjalë edhe për kontekstualitetin ballkanik të veprës së këtij pionieri të shqipes letrare.

I ardhur nga universiteti i Selanikut, ku qëllon t’u flas studentëve për gjuhët ballkanike, duke e krahasuar rrugën e shqipes me atë të simotrave të gadishullit tonë, më duket dhe më pëlqen të them se shqipja standarde, *ajka e tamblit të gluhës së arbërve*, ishte një hap mbrothësie e përparimi i mbarë shqiptarëve dhe, në kuptimin iluminist, i mbarë popujve të Ballkanit. Për arsyen e thjeshtë se drit’ e diturisë nuk njeh kufij e se mbrothësia e njërit ndikon në përparimin e tjetrit.

Më duhet të them gjithashtu, se vështrimi i gjërave në kuadër ballkanik, pra krahasimi i rrugës së formimit të gjuhëve standarde në Ballkan, e pasuron serinë e argumenteve në favor të tezës se shqipja letrare u ngrit mbi themelí të shëndosha e se, pa mohuar ideologjizimet a politizimet e skajshme të një kohe të shkuar, ajo nuk qe një artific i imponuar me mjete politike.

Rasti i Greqisë fqinjë, ku, me gjithë përpjekjet e shtetit të ri grek, gjatë një shekulli e gjysmë, për të përhapur trajtën elitare të greqishtes, gjuha popullore arriti të mbijetojë e të jetë sot gjuhë zyrtare, tregon se politikat gjuhësore janë të destinuara të dështojnë në rast se nuk marrin parasysh prirjet objektive të gjuhës dhe fazat më të hershme të ecurisë së saj.

Rreth 150 vjet më parë, aty nga fundi i viteve 1870, J. Vretoja i shkruan Mitkos një letër. Është përpjekur të sigurojë në Stamboll abonentë për blerjen e “Bletës”, që, sipas zakonit të

²¹⁴ Shih shën. 17.

kohës, do të botohej pasi të grumbulloheshin të hollat e nevojshme. Vretoja duket pakëz i zhgënjyer nga numri i paktë i pajtimtarëve, dhe në fund të listës me emrat e tyre, që ia dërgon Mitkos, shënon këto fjalë: *"Ma shumë s'munda të shkruanjë se dhé [endë] s'kanë mësuarë se çë munt t'u shuanjë etjenë, ndonëse gajasnjënë."*²¹⁵

Por, pavarësisht këtyre pengesave, Mitkoja nuk do ta humbasë besimin e nuk do t'i reshtë përpjekjet *"për gjuhën tënë, sa të shtijem farën e shenjtë e të zerë rrënjë, pastaj do të mbijë e do të shtohet vetiu edhe të mirën që bëjmë sot, zot' i jetës do na e shpërblejë"*²¹⁶. Këto fjalë i shkruan më 1888, kur ka filluar ta lërë drita e syve e jo drita e shpirtit atdhetar.

Njerëz si Thimi Mitkoja, ku ndërthuren mrekullisht madhështia e veprës dhe modestia për atë që bënë, vazhdojnë të mbeten e duhet të mbeten gurë themeli në ndërtesën morale të shoqërive të sotme. Mitkoja, një njeri që e nisi jetën si tregtar, e kërkoi dhe e gjeti tjetërkund pasurinë. Ai mbushi "qypa" me mjalatë e gjuhës së zjarrit dhe kuvendon me ne me fjalët pleqërishte të Atdhetarit dhe Ndriçimtarit. Shikoni çfarë shkruan ai në *Parthënmen* e vitit 1875. "Bleta", thotë, *"... më kallëzon më tepërë për një punëtuat kallës-mbë-ledhësin, sesa për një të dijtëshim bulk. Ajo që më holqi mua me-vërtetë mbë këtë, kële një njejme dëtyrë, e një mall që m' ushti që mbë vogëli e urrit bashkë me mua, sa të jem edhe unë i vëjëjtëshim ndoopak për filiën time Shqypëtaren..."*.

A nuk na kujtojnë këto fjalë Buzukun (*"n'së dashunit së botësë sanë desha me u fëdigunë, për sã mujta me ditunë, me zditunë pak mendetë e atyne qi të ndiglonjinë..."*²¹⁷), Budin (*"...sã i madh kã qenë gjithëherë kujdesi e dëshiri i zemërsë sime për ndimë(t) të Patriesë e të gjuhës sanë, qi u vduorrë ende po vdärenë mã të shumënenë veçese për letërë e për të mpsuom."*²¹⁸), Bardhin (*"Tue pasunë ditë e përditë ... kujtuem me qish copë librë keshë me ndihmuem ... gjuhënë tanë qi po bdaretë e po bastardhohetë sã mã parë të ve..."*²¹⁹), "qiririn" bogdanian (*"Ma unë, tue pasunë mãlln' e shtampësë, gjithë atyneve [të mirave] u ktheva faqenë, veçë iu lutshë të më shtampohej libri, ashtu qi kur të kthenje prej dheut sine të keshe një qirir ndezunë ndorë, për të ndritunë atë të vobek dhë t'Arbënit e të Sherbësë..."*²²⁰) dhe naimian (*"Në mest tuaj kam qëndruar / e jam duke përvëlur, / që t'u ap pakëzë dritë, / natënë t'ua bënj ditë..."*²²¹)?

Në këtë mënyrë, Thimi Mitkoja, ky emër *"i dhëmkosur"* thellë *"në çetele të kujtimit"*²²² të shqiptarëve e të shqipes, mbetet edhe sot e kësaj dite një *"i dijtëshim bulk"* e një *"i mençëm plak"*, fjala dhe vepra e të cilit kanë për ta frymëzuar mot pas moti e brez pas brezi *"filiën shqypëtare"*.

²¹⁵ Folja *gajasnjë* me kuptimin 'më thahet buza për një pikë ujë'.

²¹⁶ Letër për V. Dodanin, 31.12.1888. Th. Mitko *op.cit.* 707.

²¹⁷ Gj. Buzuku, *Meshari*, sipas R. Ismajli, *Tekste të vjetra*, Dukagjini, Pejë 2000, f. 32.

²¹⁸ P. Budi, *Pasëqyra e trëfyemit*, sipas R. Ismajli, *op.cit.*, f. 166.

²¹⁹ F. Bardhi, *Dictionarium latino-epiroticum*, sipas R. Ismajli, *op.cit.*, f. 247.

²²⁰ P. Bogdani, shih shën. 17.

²²¹ N. Frashëri, *"Fjalët e qiririt"*, në Naim Frashëri, *Vepra letrare*, ShB "Naim Frashëri", Tiranë, 1995, v. II, f. 15.

²²² *Në çetele të kujtimit, që dhëmkoset pak-nga-pak, / ja shënova kohës sonë fluturimin vraparak*. L. Poradeci, "Naim Frashërit", në Lasgush Poradeci, *Vepra letrare*, ShB "Naim Frashëri", Tiranë, 1990, f. 72.



Zarf i letërkëmbimit të Th. Mitkos me Dh. Kamardën.

NEXHMIJE KASTRATI

PËRDORIMI I FOLJES NË ESETË E PJESËMARRËSVE TË KONKURSIT “GJUHËTARI I RI”

Në këtë kumtesë do të diskutojmë disa probleme të përdorimit të foljes në disa ese nxënësish pjesëmarës në konkursin e kulturës së gjuhës “Gjuhëtari i ri”, organizuar nga Shoqata e Gjuhës Shqipe e Kosovës, i cili sivjet ka zhvilluar sesionin e dhjetë.

Esetë që janë marrë në shqyrtim, nuk janë më të mirat, po përzgjedhja e tyre është bërë mbi kriterin e gjasës. Kjo, sepse interesi ynë ishte që të zbulonim probleme dhe arritje në zotërimin e normës së përdorimit të foljes, duke nisur që nga trajtat e ndryshme mënyrore kohore e deri tek drejtshkrimi i tyre.

Korpusi: Ese të nxënësve të klasave 6 deri 9.

Përzgjedhja: 26 nga 110 ese, nga më të mirat (me pikët maksimale) deri tek ato që kanë marrë fare pak pikë.

Temat: “Bisedë me një shkrimtar të njohur”, “Sa më ka marrë malli!..”Një dëshirë..”, “Sa me pasion që fliste për luftën!...”

Qëllimi: Shkalla e zotërimit të normës morfologjike e drejtshkimore, ndonjëherë edhe nga këndvështrimi i bashkëpërshtatjes së formave, sidomos kohore brenda diskursit.

Çështje të interesimit:

-*(Mos)përdorimi i paskajores* së tipit “me thanë”, “me shkue”;

-*Përdorimi i trajtave të lidhore*, me theks të veçantë dhe në përshtatjen e trajtave kohore të foljeve (qoftë pas foljeve modale *duhet, mund*, e pas foljeve *filloj, vazhdoj*, dhe qoftë pas foljesh të tjera në fjalinë e përbërë);

-*Trajta të foljes* si ndikim nga shqipja e folur ose nga shqipja e përdorur në media.

Shënim. Do të diskutohet dhe një detyrë nga testi, për të parë sa e kanë zotëruar nxënësit përdorimin e ndërtimit foljor – *duhet plus pjesore*.

(1) Nga të gjitha esetë që kemi marrë në analizë, për çudi, asnjë nga autorët nuk ka përdorur ndonjë folje në trajtën e paskajores geqe. E themi për çudi, sepse, pothuaj të gjithë, qoftë në ligjërimin bisedor dhe qoftë në debate për probleme të veçante (provime në klasë, ndonjë intervistë, në ndonjë emision, le të jetë dhe në radio e televizion), domethënë në ligjërimin gojor, kush më shumë e kush më pak, këtë formë foljore e përdorin shumë shpesh. Njësoj dhe në biseda në shoqëri, pothuaj në të gjitha situatat.

Mirëpo, formën tjetër, të së ashtuquajturës paskajore e dytë, të tipit *për të thënë*, e kanë përdorur disa herë. Le të sjellim ndonjë shembull:

“(Por këtë do ta bëj...), në mënyrë që të tejkaloj të gjitha vështirësitë që *më dalin* përpara *për të më ndëprerë* rrugëtimin....” (5 pikë nga 12);

“15 rreshta *për ta përshkruar* ndjenjën që pata, nuk mjaftojnë... (Tema “Një tufë lulesh për....”).

Fytyra e gjyshes zhduket shpejt e nuk rri *për t’u çmallur*...

(2) *Trajta të lidhore* përdorin që të gjithë. Nxënësit e dalluar, pothuaj pa përjashtim, zbatojnë me rreptwsi normën e bashkëpërputhjes së trajtave kohore e mënyrore. Në përshkrimet e natyrës e të situatave, në kujtimet që sjellin nga ndonjë ngjarje e së kaluarës, si dhe në dialogë të imagjinuar (në ndonjë intervistë), shumë nga nxënësit përdorin kryesisht folje në të pakryerën e lidhore. Është për të vënë re që ata, po ashtu, përdorin trajta të së pakryerës së foljes kryesore pas foljeve modale *duhet* dhe *mund* të përdorura në trajta të kohës së kryer të thjeshtë dhe të më se të kryerës së dëftores, njësoj si dhe pas foljeve që tregojnë fillimin dhe vazhdimin e veprimit. E theksuam këtë përdorim, për shkak se në përdorimin publik të shqipes standarde, në situata të tilla gjuhësore, folja kryesore këtu ndër ne përdoret në një trajtë të së tashmes, si p.sh.

Pastaj filloi të flasë mysafiri në studio.

T'i shohim përdorimet në disa shembuj:

Por ti *duhet të jesh* e fortë, aq e fortë, sa *t'i ndezësh* dritat dhe *t'i hapësh* dyert e jetës. (14 pikë nga 18)

Filloi të frynte një erë e lehtë dhe më *bëri të ndihesh* mirë. (8 nga 12)

Nuk *munda ta shkelja* Hënën, sado që e imagjinoja... (8 nga 13)

Dielli *vazhdonte të më ngrohte*, kurse *plazhi filloi të mbushej dalëngadalë*... (8 nga 13).

Më pas nuk *kisha dëshirë të hiqja* dorë nga kjo dëshirë. (7 nga 18)

... Po na *priste dhe refuzonte të ikte*.

Më *duhej të nisesha* sa më shpejt, sepse.... (10 nga 13)

Këtë herë *lulet m'u desh t'i lija* mbi varrin e gjyshes... (10 nga 13)

(Në shembullin e fundit të vihet në dukje përdorimi i drejtë i foljes *lë* në kohën e pakryer të lidhore – me *i (të lija)*, shumë përdorues te folje të tilla, në këto trajta, ruajnë zanoren *ë* (si, *kjo duhet të vëhet në dukje etj.*)

Megjithëkëtë, disa nga nxënësit nuk e kanë zotëruar këtë normë nw shkallën e duhur, prandaj kemi gjetur dhe disa raste, që janë tw pakta, qw kanw tw bwjnw me mospërshtatjen e këtyre trajtave:

Pas një jave *vendosëm të shkojmë* në plazhin e Ulqinit. (8 pikë nga 12)

Më *duket* se *lulet gëzonin* dhe ishin të lumtura. (6 nga 13)

Më *dridhen duart të shkruaj*, lotët *filluan të rrjedhin*. (Po aty)

Me kalimin e kohës *fillova të shkruaj* poezi. (7 nga 18)

Fillova ta kuptoj atë ndjenjë të çuditshme... (8 nga 12)

2. Për sa i përket zotërimit të normës për përdorimin e ndërtimit të kallëzuesit me strukturë *duhet plus pjesore*, në ese nuk kemi gjetur ndonjë shembull, por në një nga detyrat për kulturën e gjuhës, që ishte:

Duke përdorur foljen modale (duhet) në trajtën e kohës së tashme të habitores dhe foljen kryesore (ngre) në formën e pashtjelluar të pjesores, rishkruaj fjalinë:

“Mbi këtë lumë (ne) duhet të ngremë sa më parë urën e re”.

Përgjigjet kanë qenë të ndryshme:

(a) Ne *dashkemi ngritur* urën e re...; dhe

(b) Mbi këtë lumë ne *dashkemi ngritur* ... urën e re...

Vetëm një nxënës nga grupi në shqyrtim, e ka shkruar fjalinë si duhet (por pa përdorur përemrin NE):

Mbi këtë lumë u dashka ngritur sa më parë një urë e re.

Në fund do të theksoja se, edhe në bazë të shembujve që u sollën këtu, nuk është i saktë pohimi i disa studiuesve nga Kosova që “mosfutja” në standard e formës së pashtjelluar të paskajores geqe, përbën një problem të madh për zotërimin e standardit të shqipes nga folës të truallit të gegërishtes.

“FJALORI DREJTSHKRIMOR I GJUHËS SHQIPE” I A. DHRIMOS E R. MEMUSHAJT (KRAHASUAR ME NORMAT E KONGRESIT TË DREJTSHKRIMIT)

Kongresi i Drejtshkrimit, i mbajtur 40 vjet më parë, caktoi si detyrë përmirësimin dhe plotësimin e rregullave të drejtshkrimit në të ardhmen kur të jetë e nevojshme, duke marrë parasysh ndryshimet që pëson gjuha letrare gjatë zhvillimit, si edhe çështjet e reja që nxjerr praktika gjuhësore.

Ndër përpjekjet e bëra për përmirësimin dhe përditësimin e gjuhës standarde dhe të drejtshkrimit të saj në këtë 40-vjetor, po veçojmë përpjekjet e prof. R. Memushajt, i cili ka shkruar herë pas here për çështje të normës gjuhësore, duke qenë i vetëdijshëm se praktika e studimit të kodeve normative të shqipes standarde ka treguar se disa rregulla e zgjidhje të tyre nuk përliqen nga sistemi gjuhësor dhe nga praktika ligjërimore. Dëshmi e kësaj janë edhe gabimet e folësve në zbatimin e normave të gjuhës standarde dhe luhatjet e tyre në zgjedhjen e trajtës së duhur gramatikore. Një rregull në zbatimin e së cilës gabohet shpesh dhe nga shumë folës, kërkon vëmendjen e planifikuesve gjuhësorë për ta rishikuar e thjeshtuar apo edhe për ta braktisur. Sipas tij, përmirësimet duhet të bëhen duke u mbështetur jo në intuitën dhe në të folmen krahinore, por në vrojtimin e ligjërimit të folur për të parë mospërputhjet midis shkrimit e shqiptimit si dhe të ligjërimit të shkruar për të thjeshtuar rregulla të ndërlikuara, me qëllim që të shmangen vështirësitë në zbatimin e tyre.

Në këtë kuadër, Memushajt ka hartuar disa rregulla drejtshkrimore, plotësuese të ‘Drejtshkrimit’ të vitit 1972, në librin ‘Shqipja standarde’ (2005) si dhe ka sjellë mjaft propozime mbi normativizimin e mëtejshëm të gjuhës shqipe në ‘Fjalorin drejtshkrimor’ (2011) me bashkautor gjuhëtarin A. Dhrimo.

Duke i parë në një këndvështrim krahasues me rregullat e “Drejtshkrimit të gjuhës shqipe” rregullat drejtshkrimore të “Shqipes standarde” janë të hartuara me një metodë të re, ato janë më të sistemuara, vijnë të riformuluara, të pajisura me shpjegime më të zgjeruara gjuhësore, në veçanti gramatikore. Dallimet që vihen re:

1. Normat drejtshkrimore që janë në trajtën e shënimeve në “Drejtshkrimin..”, këtu janë ngritur në nivelin e rregullave të plota drejtshkrimore. E tillë është rregulla për drejtshkrimin e zanores *ë* të pathesuar tek fjalë të përbëra, tema e parë e të cilave del me *ë* të theksuar, kurse e dyta nis po me zanore të theksuar: *njëanësi*, *i njëanshëm*, *zëëmbël*. Një tjetër shënim i kthyer në rregull është edhe rregulla për drejtshkrimin e zanores *ë* pastheksore jofundore tek emrat mashkullorë që e bëjnë shumësin me prapashtesën –*ër*: *mbretër*- *mbretërit* etj.

2. Rregulla të zgjeruara me shënime shtesë, siç është shënim shtesë për shkrimin me zanoren *ë* të foljes *qëndroj* e rrjedhojat e saj *qëndrim*, *i qëndrueshëm* etj., në pajtim me drejtshkrimin e ngulitur. Një shënim tjetër i tillë vihet re edhe në rregullën për mosshkrimin me zanoren *ë* të theksuar, por me zanoren *e* të mbiemrit *i gjerë* dhe rrjedhojat e tij *gjerësi*, *gjerësisht*, *zgjeroj* etj., megjithëse trajta geqe e këtij mbiemri del me zanoren *a* hundore të theksuar.

3.Ndarje e një rregulle të vetme në disa rregulla përbërëse. Rregulla e drejtshkrimit të zanores *ë* të theksuar në fjalët e prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura, ku kjo zanore është fundore e temës së parë fjalëformuese ndahet në dy rregulla, një rregull për drejtshkrimin e fjalëve të prejardhura dhe një rregull për drejtshkrimin e fjalëve të përbëra e të përngjitura. Kjo ndarje bën që rregullat të jenë më të qarta, më të kuptueshme, sepse shpjegimet janë më të plota në varësi të formimit të fjalëve.

4.Pajisja e rregullave me më tepër shpjegime të fjalëformimit, siç vihet re në tek dy rregulla mbi mosshkrimin e zanores *ë* pastheksore jofundore për mbiemrat e formuar me prapashtesën *–shëm, –të*, e cila plotësohet me shpjegimin për mospërdorimin e kësaj zanoreje për mbiemrat tema e të cilëve mbaron me zanoren *–ë*: *i natyrshëm*; gjithashtu, mosshkrimi i zanores *ë* pastheksore tek format e habitores, sqarimi është se nuk shkruhet kjo zanore tek format e së tashmes dhe të së pakryerës së habitores të foljeve që në formën e pjesores dalin me *–ë*: *marrkam, qenkam* etj. Ndërsa në ‘Drejtshkrimin...’ e Kongresit përcaktohet vetëm se nuk shkruhet kjo zanore tek gjymtyra e parë e trajtave të përngjitura të habitores, duke krijuar një përgjithësim të gabuar për të gjitha trajtat foljore të habitores.

5.Përfshirja më e madhe e parimit semantik dhe morfologjik në shpjegimin e normave. Për shkrimin e fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë lidhëse, Memushaj shpjegon se shkrimi i fjalëve njësh apo ndaras mbështetet në parimin semantik dhe në parimin morfologjik, sipas të cilave shkruhen bashkë të gjitha ato njësi të përbëra që nga pikëpamja leksikore shënojnë një koncept të vetëm dhe nga pikëpamja gramatikore sillen si fjalë e vetme, kurse ndaras të gjitha ato njësi që shënojnë koncepte të ndryshme dhe që nga pikëpamja gramatikore janë pjesë e një togfjalëshi apo e një shprehjeje. Me vizë në mes shkruhen ato njësi që shënojnë një koncept të vetëm, por që nga pikëpamja gramatikore janë në rrugën e njëfjalësisimit. Ndërsa në “Drejtshkrimin...” shkrimi i fjalëve njësh, ndaras apo me vizë lidhëse arsyetohet duke u nisur vetëm nga pikëpamja leksikore.

Një tjetër vepër e cila bën objekt përditësimin e shqipes standarde dhe drejtshkrimin e saj është “Fjalori drejtshkrimor” i botuar në vitin 2011. Në këtë vepër përveç paraqitjes së normës drejtshkrimore aktuale, janë dhënë edhe propozimet për përmirësimet e mundshme të drejtshkrimit, që nuk duhen kuptuar kurrësi si një mikroreformë drejtshkrimore. Dy gjuhëtarët Memushaj – Dhrimo pranojnë se “Fjalori drejtshkrimor” i vitit 1976 ishte një hap tjetër i mëtejshëm për përsosjen e drejtshkrimit të gjuhës sonë standarde. Por ai vuante nga mangësitë e një pune të parë në këtë lëmë, nuk jepte një pamje të plotë të fjalësisit të gjuhës së atëhershme standarde dhe sidomos jetën e plotë të fjalëve, format themelore të trajtave të tyre të ndryshme. Ai linte pa përgjigje një numër jo të vogël çështjesh të domosdoshme të drejtshkrimit dhe nuk jepte shumë e shumë forma, mungesa e të cilave e vë shpesh në vështirësi atë që shkruan.

Duke pasur parasysh këto çështje problemore, në “Fjalor...” jepen disa zgjidhje për drejtshkrimin e disa zanoreve, grupe zanoresh, shkronjës së madhe si dhe shmangien e formave normative dytësore.

Një nga çështjet më problemore të drejtshkrimit të shqipes është ajo e shkrimit të zanores [ë] të patheksuar. Për sa i përket shkrimit të *ë*-së fundore, çështja paraqitet më e ndërlikuar, pasi këtu, siç e vumë në dukje më sipër, pushon së vepruari parimi fonetik, dhe hyjnë në lojë faktorë

morfologjikë e semantikë, për arsye se në këtë pozicion kjo zanore është kthyer në një lloj formanti që kryen funksione të rëndësishme leksiko-gramatikore.

Në “Fjalor” propozohet mosshkrimi i *ë*-së fundore aty ku prania e saj nuk justifikohet morfologjikisht si në emrat mashkullorë të tipit *atë, ballë, burrë, lëmë, mjaltë* etj. Me kalimin e këtij grupi emrash nga gjinia asnjane në gjininë mashkullore, paradigma e tyre është njëzuar me atë të emrave mashkullorë me temë më bashkëtingëllore, me përjashtim të rasës emërore të pashquar njëjës. Në këtë mënyrë, këta emra edhe ortografikisht përfshihen në klasën e gjerë të emrave mashkullorë me temë në bashkëtingëllore, duke u shmangur një klasë përjashtimore.

Emrat femërorë *gondolë, kamerë, motërmë, operë, pauzë* etj., si dhe disa emra mashkullorë, në njëjës të trajtës së pashquar *astronautë, bojskautë* etj., në “Drejtshkrimin ...” shkruhen me *ë* fundore, në kundërshtim me rregullën e theksit në shqipe, sipas së cilës *ë*-ja fundore dy rrokje pas theksit as shqiptohet dhe as shkruhet. Në “Fjalorin drejtshkrimor” të dy këto klasa fjalësh jepen pa *ë* fundore: *kamer, motërm, oper, pauz* etj., në emërore njëjës të pashquar përkatësisht *astronaut, bojskaut, dinosaur* etj.

Emrat e njëjësive të matjes që vijnë nga emra të përveçëm, në shumës të pashquar janë shkruar me prapashtesën e shumësit –*ë*: *një amper- dy amperë; një om – dy omë; një volt- dy voltë* etj., ndryshe nga Fjalori drejtshkrimor i vitit 1976 dhe fjalorët normativë, që në shumës të pashquar i japin pa –*ë*: *dy amper, dy om, dy volt* etj.

Zanorja *ë* si prapashtesë e shumësit është përdorur më gjerësisht për emrat mashkullorë të frymorëve me dy a më shumë rrokje, po edhe në emra jofrymorësh nga turqishtja, ndryshe nga fjalorët normativë që disa emra të tillë i japin me prapashtesa të tjera, p.sh. *zgalemë* në vend të *zgalema, zhapikë* në vend të *zhapike* etj., dhe vetëm *oxhakë* në vend të *oxhakë* dhe *oxhaqe*, që japin këta fjalorë.

Nga ana tjetër, është mënjeluar zanorja –*ë* në shumësin e emrave të jofrymorëve në të mirë të prapashtesës –*e* dhe –*a*, e cila është parapëlqyer sidomos për emrat njërrrokësh. Në fjalor vihen re: *automate* për *automatë, auditore* për *auditorë* etj., *dikotfona* për *diktofonë, mermere* për *mermerë, orare* për *orarë* etj.

Drejtshkrimi i zanores [ë] patheksore jofundore, është mbështetur në parimin e zgjidhjes sistimore për grupe fjalësh me natyrë të njëjtë. Prirja për të ruajtur të pandryshuar temën fjalëformuese si në *cen-cenoj, cenos, vend-vendos* etj., është zbatuar me rreptsi edhe në rastet kur në fjalorët normativë rrjedhojat jepen me zanoren [e] të errësuar në [ë], si p.sh., në rrjedhojat nga fjalët *rreze* dhe *shembull*: *rrëzëllen, rrëzëllim, rrëzëllimë, rrëzëllor, rrëzëllues dhe shëmbëllez, shëmbëllim, shëmbëllesë e shëmbëlltyrë*. Në “Fjalorin...” temat e këtyre fjalëve të prejardhura shkruhen me *e*: *rrezëllen, rrezëllim, rrezëllimë, rrezëllor, rrezëllues dhe shembëllez, shembëllim, shembëllesë e shembëlltyrë*.

Në “Fjalor” vihet re edhe mosshkrimi i zanores *ë* pastheksore jofundore tek fjalë të tilla si *cuklan, cukloj, thekrim, thekrishte, draparak, draprim*, në përputhje me rregullën përkatëse sipas së cilës fjalët e prejardhura të formuara ngga tema më grupin –*ër* që paraprihet nga bashkëtingëlloret *p/b, f/v, t/d, j, k* ose nga grupet *nd* e *st*, dhe prapashtesa që nisin me zanore, duhen shkruar pa zanoren *ë* të temës. Ndërkohë, në fjalorët normativë gjejmë plot shembuj të

shkeljes së kësaj rregulle, p.sh.: *cukëlan, cukëloj* (nga *cukël*); *thekëroj, thekërim, thekërishte, thekërore* (nga *thekër*), *drapërak, drapërim, drapëroj, drapëror* (nga *drapër*) etj

Një nga synimet kryesore të Fjalorit ka qenë mënjanimi i zgjidhjeve josistimore, si dhe i formave normative dysore a dyvariantëshe të shumësi i emrave, në të mirë të ngritjes në normë vetëm të njëres prej tyre. Kështu është bërë, për shembull, me emrat *kabëll, kuadër e teatër*, për të cilët si trajtë përfaqësuese është pranuar ajo me *-ëll* përkatësisht me *-ër*, kurse si prapashtesë shumësi *-a*, pra *kablla, kuadra e teatra*. Po kështu, edhe për emrat e frymorëve më *-ër* (*mjeshtër, peditër, ftiziatër, otojatër, shatër e thjeshtër*) është pranuar shumësi me prapashtesën *-a* dhe jo me prapashtesë zero, pra *mjeshttra, peditra, ftiziatra, otojatra, shatra, thjeshttra*, duke shmangur homoniminë me format e rasave të zhdrejta të njëjësit. Edhe për emrat që dëshmojnë dy trajta shumësi, njëra me prapashtesën trajtëformuese *-ë* dhe tjetra me ndërrimin *k~q* dhe prapashtesën *-e* (*oxhak–oxhaqe*), në Fjalor është mbështetur më fort variant i parë, nisur nga ajo që ky variant po shkon duke u shtrirë në gjuhën tonë, ndërkohë që rasti i anasjellë nuk ndeshet asnjëherë.

Një grupim shumë më i kujdesshëm u është bërë shumësive të emrave që shënojnë frymorë, duke parapëlqyer për ta prapashtesën *-e*, dhe atyre që shënojnë sende a koncepte (*elementë–elemente*). Atje ku deri tani janë përdorur shumësa emrash të tillë sendesh me *-ë*, kur ka qenë e mundshme, pa bërë ndryshime të skajshme, në Fjalor janë parapëlqyer variantet me prapashtesat *-e* ose *-a*. Njëherazi është mënjanuar rregullisht trajta e dytë deri tani herë pas here normative me *-ra* e femërorëve, duke e pranuar vetëm atje ku kjo formë ka ngjyrimë kuptimore me ngarkesë stilistike keqësuese: *gosti, hajmali, kafene*, jo edhe *gostira, hajmalira, kafenera* etj.

Në lidhje me drejtshkrimin e mbiemrave, fjalët e përbëra mbiemërore që kanë si mjet lidhës zanoren *-o-*, shkruhen pa vizë lidhëse, sepse këtë funksion e kryen pikërisht kjo zanore: *ekonomikoshoqëror, ideoartistik, koreanojugor, letraroartistik* etj. Por atje ku nuk ka një zanore të tillë lidhëse, është përdorur viza lidhëse: *agrar-industrial, mësimor-edukativ, montim-ndërtim* etj.

Ndër njësimet e bëra në këtë klasë fjalësh janë dhe ato për mbiemrat e formuar nga emra vendesh me prapashtesat *-ian* (*-jan*) e *-iot* (*-jot*), të cilët në fjalorë shkruhen disa me *-ian* e *-iot* dhe disa me *-jan* e *-jot*, pa ndjekur ndonjë kriter të caktuar, p.sh.: *kuksian, laçian, tuzian* krahas *hasjan, lezhjan, shkupjan* etj. ose *lunxhiot, qipriot, niviciot* krahas *himarjot, lukovjot, sarandjot, suljot* etj. Në mungesë të studimeve akustike lidhur me shqiptimin e tingullit nistor të këtyre prapashtesave, është ndjekur parimi i përdorimit më të përgjithshëm, duke parapëlqyer trajtën me *-ian*: *kuksian, laçian, tuzian, hasian, lezhian, shkupian* etj.

Përpjekjet për shmangien e formave dysore vihen re edhe në sistemin foljor. Së pari, trajta dysore e vetës së tretë njëjës të së pakryerës së habitores *ardhkej, dashkej, lënkej, nxjerrkej, thënkej, punuakej, shkruakej* etj. është mënjanuar në të mirë të formës me *-kësh*: *ardhkësh, dashkësh, lënkësh, nxjerrkësh, thënkësh, punuakësh, shkruakësh* etj. Duke pranuar si normative vetëm këto trajta, i është dhënë tërthorazi përgjigje edhe çështjes së temës trajtëformuese të formave të kohëve të thjeshta të habitores, të cilat formohen nga forma e pjesores dhe jo nga tema e së tashmes a nga ndonjë temë tjetër, siç vihet re në ligjërim apo edhe në ndonjë fjalor. Pra, *ardh-ka, dash-ka, lën-ka, nxjerr-ka, thën-ka, punua-ka, shkrua-ka* etj., dhe jo *vika, doka, lika, nxirrka, thoka, punoka, shkroka* etj.

Së dyti, foljet *ndiej*, *ziej* e *përziej* në Fjalor shkruhen me grupin *ie* të pandryshuar në të gjitha format e së kryerës së thjeshtë dhe të së tashmes së dëshirores, pra: *ndieva*, *ndieve*, *ndieu*, *ndiem*, *ndiet*, *ndien*; *ndiefsha*, *ndiefsh*, *ndieftë*, *ndiefshim*, *ndiefshi*, *ndiefshin* dhe jo *ndjeva*, *ndjeve*, *ndjeu*; *ndjefsha*, *ndjefsh*, *ndjeftë*, *ndjefshim*, *ndjefshi*, *ndjefshin* siç i japin gramatikat dhe Fjalori drejtshkrimor i 1976-ës.

Së treti, foljet *bie*, *shpie* e *shtie* në urdhërore njëjës do të shkruhen përkatësisht *bier*, *shpier* e *shtier* dhe jo *bjer*, *shpjer* e *shtjer* si deri tani. Ky ndryshim jo vetëm e lehtëson drejtshkrimin nga një përjashtim, po edhe sjell një njësim më të madh të grupeve të formave në paradigmen e këtyre foljeve. Në këtë mënyrë janë mënjeluar dy rregulla drejtshkrimore të vështira për t'u zbatuar.

Së katëri, foljet *ec*, *hip* dhe *ik* janë bashkuar me mbarë grupin e foljeve me temë në bashkëtingëllore, duke ua hequr zanoren fundore *i*: *ec*, *hip*, *ik* dhe jo *eci*, *hipi*, *iki*. Në këtë mënyrë zhduken foljet e ashtuquajtura “hibride” dhe, bashkë me to, edhe zgjedhimi hibrid.

Një tjetër çështje problemore në drejtshkrimin e shqipes përbën përdorimi i shkronjës së madhe në emërtimet e përbëra gjeografike, sidomos shkrimi i emrave të përgjithshëm në përbërje të emërtimeve të përveçme. Rregulla e “*Drejtshkrimit...*” sipas së cilës emrat e përgjithshëm, si: *breg*, *buzë*, *çukë*, *det*, *fushë*, *gadishull*, *grykë*, *gji*, *hundë*, *istëm*, *ishull*, *kanal...* etj., kur nuk janë pjesë përbërëse e një emërtimi të përveçëm, por përdoren si përcaktues të një emri gjeografik ose përcaktohen prej tij, shkruhen me shkronjë të vogël, nuk shpjegon qartë statusin e emrit të përgjithshëm. Po t’iu referohemi shembujve të tjerë që gjemë aty: *Shkalla e Tujanit*, *Shkëmbi i Kavajës*, *Gropa e Shkodrës*, bëhet më e paqartë ç’lidhje kuptimore vendoset në këta shembuj mes emrit *shkallë*, *shkëmb* dhe *gropë* me emrat e përveçëm, pra kur këta emra të përgjithshëm janë “pjesë përbërëse” dhe kur “nuk janë pjesë përbërëse” të emërtimeve,

Paqartësia e përdorimit apo jo të shkronjës së madhe tek këta terma gjeografikë shpjegohet duke iu referuar disa emërtimeve të tilla si: *ishulli i Korfuzit* dhe *kanali i Korfuzit*, *gadishulli i Karaburunit* dhe *hunda e Karaburunit*, *qyteti i Shkodrës* dhe *liqeni i Shkodrës* etj. Në shembujt e parë të çdo çifti, edhe po të heqim emrin e përgjithshëm (*ishulli i Korfuzit* = *Korfuzi*, *gadishulli i Karaburunit* = *Karaburuni*, *qyteti i Shkodrës* = *Shkodra*), duket qartë se emri i përgjithshëm nuk është pjesë përbërëse e emërtimeve.

Ndërsa në shembujt e tjerë emri i përveçëm që mbetet po të heqim emrin e përgjithshëm, do të shënojë diçka tjetër nga ç’tregon emërtimi dyfjalësh (*kanali i Korfuzit* --- *Korfuzi*, *hunda e Karaburunit* --- *Karaburuni*, *liqeni i Shkodrës* --- *Shkodra*), çka do të thotë se në këto raste emri i përgjithshëm është pjesë përbërëse e emërtimeve.

Një tip tjetër është edhe tipi ku emrat e përgjithshëm janë bërë pjesë e emërtimeve të përveçme dhe si të tilla shkruhen me shkronjë të madhe si p.sh.: *Lumi i Vlorës*, *Guri i Hasit*, *Ishulli i Lezhës* e ndonjë tjetër, në të cilat emri i përgjithshëm përdoret më tepër me kuptim metaforik p.sh., emërtimi *Lumi i Vlorës* nuk shënon lumin (ky quhet Shushicë), por krahinën që shtrihet në të dy anët e këtij lumi; *Guri i Hasit* nuk tregon ndonjë gur a shkëmb në Has, por një krahinë; *Ishulli i Lezhës* emërton një fshat të Lezhës, dhe jo një ishull. Kuptohet vetiu se shkrimi i fjalës së parë me shkronjë të madhe shpjegohet me shkuptimësimin e saj në përbërje të këtyre emërtimeve të përveçme.

Një tjetër zgjidhje që gjejmë në Fjalor është përdorimi i shkronjës së madhe në fjalë të tilla si: Krishtlindje, Bajram, Pashkë, Djall, Perëndi, Zot etj., të cilat në “Drejtshkrimin ...” shkruhen me shkronjë të vogël.

Këto janë vetëm disa nga shumë format normative të ndryshuara në përputhje me zhvillimet gjuhësore të kohës që kanë propozuar gjuhëtarët Memushaj – Dhrimo. Këto ndryshime, sipas tyre, janë caku përtej të cilit nuk mund të ndërhyhet në normën drejtshkimore të shqipes standarde. Por pranimi i tyre dhe kthimi në normë varet, në fund të fundit, nga tumirja prej planifikuesve gjuhësorë. Qëllimi i tyre ishte mbushja e zbrazëtisë së krijuar nga mungesa e një fjalori drejtshkrimor që të pasqyrojë arritjet e derisotme në njësimin e normës morfologjike, fonetike e drejtshkimore të shqipes standarde, duke dhënë një vepër në të cilën janë jetësuar pjesa më e madhe e çështjeve të diskutueshme të drejtshkrimit dhe që do të shërbejë si bazë konkrete për zgjidhjen përfundimtare të tyre.

PASTRIMI I GJUHËS SHQIPE NGA HUAZIMET - ÇËSHTJE E DITËS

Është folur dhe shkruar shpesh për çështjen e pastrimit të gjuhës shqipe si një domosdoshmëri jo vetëm me karakter gjuhësor por rrjedhimisht dhe me karakter kombëtar pasi *gjuha është e para që na lidh e na bashkon si komb.*²²³

Gjuha si tipar themelor i çdo bashkësie etnike si pasqyrimi më besnik i jetës është trashëgimi më i rëndësishëm i traditës shoqërore, që lidh jo vetëm brezat e një epoke, por edhe zinxhirin e pandërprerë të të gjithë brezave.²²⁴

Duhet bërë përpjekje për pastrimin dhe pasurimin e gjuhës, jo vetëm nga gjuhëtarët dhe dashamirësit e saj, por nga të gjithë shqipfolësit duke e mbrojtur atë nga gjymtimi i huazimeve të cilat po i marrin frymën fjalës shqipe.

Kur flasim për çështjen e pastrimit të gjuhës nga huazime të panevojshme në mendje na vjen një shprehje e Hafiz Ali Korçës i cili ka thënë: “*Nuk duhet ta mbushim, gjuhën tonë ëngjëllore, me gjemba e me ferra që nuk i qërojmë dot më vonë.*”

Por tashmë gjembat i kanë mbjellë burrat e shtetit, gjyqtarët e vendit, hartuesit e teksteve, i kanë mbjellë gazetarët, studentët, nxënësit, e kështu me radhë, i ka mbjellë teknologjia e re që me vete bart “thesin me fjalë të huaja” të cilat ne i përqafojmë shumë shpejt dhe fillojmë t’i përdorim gjerësisht pa u shqetësuar aspak për nevojën që ato kanë për t’u shqipëruar.

Profesor Gjovalin Shkurtaj në librin e tij *Si të shkruajmë shqip* do të shprehë: “...vëmë re me keqardhje e na sëmbon zemra se pak, shumë pak, përditë e më pak, kujdesemi për gjuhën shqipe, aq sa, mjerisht, është vështirë, shumë vështirë, të gjesht sot shqiptarë që ta flasin e ta shkruajnë bukur e drejt gjuhën shqipe.”²²⁵

Kështu mjafton të bësh një kërkim (search përdorin të rinjtë) të thjeshtë në tekstet shkollore, letrare, në fletoret zyrtare, në vendimet gjyqësore, ose në fjalime të përfaqësuesve të shtetit, mjafton të lexosh titujt e lajmeve, të emisioneve të ndryshme kulturore e shoqërore, mund të dëgjosh gazetarët që “*lançojnë*” zërin e tyre, i cili shpërmdahet në të gjitha skajet shqipfolëse e me vete mbart armën gjymtuese të gjuhës...

Është për të ardhur keq se sa shumë shembuj do të mund të pasurojnë temën që po trajtojmë dhe sa shumë e varfërojnë gjuhën tonë njëkohësisht. Shembujt janë marrë nga fjalime të përfaqësuesve të shtetit tonë dhe zyrtarëve të Kosovës:

...i promovon këto vlera të bashkëjetesës .

...ne i inkurajojmë të gjithë shqiptarët, të integrohen në familjen evropiane

...e meritojnë ta kenë angazhimin;

Promovon – Shpall, paraqes;

Inkurajojmë - I jap zemër, e nxit, e përkrah;

Integrohen - Bëhen pjesë e pandarë, përfshihen;

²²³ Gjergj Fishta;

²²⁴ Gjovalin Shkurtaj “*Ta duam dhe ta ruajmë gjuhën tonë të bukur*”, 1998

²²⁵ Gjovalin Shkurtaj “*Si të shkruajmë shqip*”, 2008

Angazhimin - Zotimin, i dal për zot, përfshirje;

“Nga ky *projekt* kanë përfituar të rinjtë e të rejtat të Kosovës, të cilët me përvojën e marrë në institucionet *prestigjioze* të SHBA-së janë bërë *kontribues* dhe bartës të ndryshimeve në shoqërinë tonë.”

Projekt - Plan;

Prestigjioze - Me vlerë;

Kontribues - Ndihmues;

“Së pari dua të shpreh përgëzimet e përzemërta, për këtë *iniciativë* të shkëlqyer... dëshmi e një *potenciali* të madh ...për *gjenerim* të vazhdueshëm... keni vendosur në *fokus*... vini për të *demonstruar potencialet* ... për ta rivendosur ekonominë në *performancën* e saj.”

Iniciativë – Nismë;

Potencial – Fuqi, me peshë;

Gjenerim – Zhvillim;

Fokus - Përqëndrim, vatërzim;

Demonstruar – Tregoj, shfaq;

Performancë – Shfaqje, dukje;

“Nuk ka presion... Është në interes të dy vendeve që të ketë takime të larta politike, të fqinjësisë së mire, dialog, ...siguri për të ardhmen dhe një *perspektivë integruese* për gjithë rajonin”.

Prespektivë – Mundësi;

Integruese – Lidhet ngushtë, bashkohet, shkrihet në një njësi;

Nëse do të hedhim një vështrim në *sistemin gjyqësor*, mjafton vetëm të lexojmë një vendim të shpallur nga gjykata dhe menjëherë do të ndeshemi me fjalë të tilla si:

Komponent – Përbërës, pjesë përbërëse;

Relacion – Prashtresë

Duke vazhduar kërkimin tonë tek *fletoret zyrtare* do ndeshemi me këto fjalë:

Abonent- Pajtues, Pajtimtar;

Publik – Shikues;

Version – Mënyrë;

Nëse lexojmë nenin 59 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë do të ndeshemi me këto fjalë:

“Shteti, brenda *kompetencave* kushtetuese dhe mjeteve që *disponon*, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:”

Kompetencë – E drejtë për vendimarrje;

Disponon – Kam, Zotëroj;

Kjo është gjendja e gjuhës sonë dhe më keq akoma paraqitet në fushën e gazetarisë por shembujt nuk janë përmendur qëllimisht pasi ato janë pjesë e përditshmërisë sonë. Çdokush nga ne, në çdo çast, bezdiset nga shpeshtia e përdorimit të huazimeve të panevojshme në shtyp apo televizion.

Çështja e pastrimit të gjuhës shqipe është çështje e ditës dhe secili nga ne duhet të japë ndihmesë në këtë fushë, pasi gjuha është biografi e popujve , sepse në gjuhë dhe me gjuhën, më mirë se në çdo dokument a material, ruhet historia e tyre intelektuale, sociale dhe morale.../ Gjuha, në të vërtetë, është pasuria jonë më e madhe.²²⁶

Po e mbyllim këtë kumtese, por jo këtë çështje me një thënie të Pedersenit.

“Gjuha shqipe është i vetmi mjet i ndriçimit dhe i përparimit moral. Ajo është një gjuhë e fuqishme dhe e bukur që duhet të jetë krenaria e folësve të saj dhe një mjet i shenjtë për zhvillimin kulturor dhe intelektual të kombit të vjetër shqiptar” (H. Pedersen).

²²⁶ Rexhep Qosja “Nocione Albanologjike”, 1983